RAPORTI PËRFUNDIMTAR

Mbi
"*Auditimin Financiar*"

Tiranë, tetor 2026

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I	**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	**4 – 11**
a	Përshkrim i shkurtër i Bashkisë Korçë	
b	Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij	
c	Qëllimi i auditimit, periudha nën auditim dhe paraqitja e objektivave	
d	Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave	
e	Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve	
f	Paraqitja e gjetjeve kryesore	
g	Paraqitja e rekomandimeve kryesore	
I.1	Konkluzioni i Përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit	
II	**HYRJA**	**11 – 16**
1	Objektivat dhe qëllimi i auditimit	
2	Identifikimi i çështjes	
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
4	Përgjegjësitë e audituesve	
5	Kriteret e vlerësimit	
6	Standardet e auditimit	
7	Metoda e auditimit	
8	Dokumentimi i auditimit	
III	**PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**	**16 -**
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	16 – 22
2	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	*22 – 176*
2.1.	*Auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin.*	*22 – 30*
2.1.2	*Auditimin mbi veprimtarinë e Njësisë së uditut të Brendshëm*	*30 – 33*
2.2.	*Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit*	*33 – 46*
2.2.5	*Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave dhe evidentimi i detyrimeve të paarkëtuara progresiv dhe për vitin buxhetor.*	*46 – 79*
2.3.	*Auditim i llogarive vjetore viti 2025*	*79 – 108*
2.4.	*Auditim mbi zbtimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm*	*108 – 155*
2.5	*Të ndryshme (shqyrtim ankesash)*	*155 - 158*
IV	**REKOMANDIME**	**158 – 176**

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
NJP	Njësia e Prokurimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

I. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit:

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore dhe Pronës Publike në Kontrollin e Lartë të Shtetit (KLSH), në zbatim të planit vjetor të auditimeve, kreu auditimin financiar me objekt *"Vlerësimin e veprimtarisë së Bashkisë Korçë në fushën ekonomike dhe financiare"*, për periudhën nga data 01.01.2025 deri më 31.12.2025. Auditimi u krye në përputhje me kërkesat dhe parimet e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI), Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së, Kodin e Etikës, si dhe duke marrë në konsideratë praktikat më të mira profesionale të auditimit në këtë fushë.

Bashkia Korçë është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila organizohet dhe funksionon në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, si dhe kuadrin tjetër ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi.

Në ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të përcaktuara me ligj, Bashkia Korçë vepron në territorin e juridiksionit të saj administrativ nëpërmjet organeve të vetëqeverisjes vendore, përkatësisht Kryetarit të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak, si dhe strukturave administrative në varësi të saj.

Bashkia ushtron një sërë funksionesh dhe përgjegjësish në ofrimin e shërbimeve publike vendore, administrimin e pasurisë publike dhe menaxhimin e burimeve financiare në dispozicion të saj.

Bashkia Korçë kufizohet në veri me Bashkinë Maliq, në lindje me Bashkinë Devoll, në perëndim me Bashkinë Skrapar dhe në jug me Bashkinë Kolonjë. Qendra administrative e Bashkisë është qyteti i Korçës, ndërsa territori i saj shtrihet në një sipërfaqe prej 805.99 km².

Në përbërje të Bashkisë Korçë janë njësitë administrative Korçë, Qendër Bulgarec, Mollaj, Voskop, Vithkuq, Lekas, Voskopojë dhe Drenovë, të cilat përfshijnë gjithsej **63 fshatra**, të shpërndarë në njësitë administrative rurale që rrethojnë qendrën urbane të bashkisë, si më poshtë:

*Njësia Administrative Qendër Bulgarec – 13 fshatra***:** Bulgarec, Lumalas, Biranj, Melçan, Porodinë, Dishnicë, Shamoll, Belorta, Kuç i Zi, Barç, Çiflig, Malavec, Neviçisht.

*Njësia Administrative Vithkuq – 13 fshatra***:** Vithkuq, Leshnje, Gjanc, Lubonjë, Rehovë, Roshanj, Trebickë, Grabockë, Treskë, Stratobërdh, Panarit, Shtyllë, Çemericë.

*Njësia Administrative Lekas – 11 fshatra***:** Lekas, Marjan, Gjonbabas, Gurmujas, Shkozan, Xerje, Tudas, Gjergjevicë, Lavdar Brozdovec, Mazrek, Poponivë.

*Njësia Administrative Voskop – 7 fshatra***:** Voskop, Dërsnik, Polen, Vinçan, Goskovë e Lartë, Goskovë e Poshtme, Damjanec.

*Njësia Administrative Voskopojë – 5 fshatra***:** Voskopojë, Shipskë, Krushovë, Gjonomadh, Lavdar.

*Njësia Administrative Mollaj – 5 fshatra***:** Mollaj, Floq, Pulahë, Ujë Bardhë, Kamenicë.

*Njësia Administrative Drenovë – 9 fshatra***:** Drenovë, Boboshticë, Dardhë, Mborje, Qatrom, Ravonik, Turan, Shëngjergj, Moravë.

Në përmbushjen e funksioneve dhe përgjegjësive të saj, Bashkia Korçë administron një sërë shërbimesh publike vendore, si dhe pasurinë dhe burimet financiare publike që ka në administrim.

Financimi i veprimtarisë së Bashkisë realizohet nëpërmjet transfertave nga buxheti i shtetit, të ardhurave të veta të krijuara nga taksat, tarifat dhe burime të tjera, si dhe financimeve të tjera të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, Bashkia harton dhe zbaton buxhetin vjetor dhe Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA), administron të ardhurat dhe shpenzimet publike, realizon investime dhe menaxhon pasurinë publike vendore.

Për periudhën objekt auditimi, veprimtaria ekonomike, financiare dhe buxhetore e Bashkisë Korçë është administruar nëpërmjet strukturave përgjegjëse për financat, buxhetin, kontabilitetin, administrimin e të ardhurave dhe menaxhimin e burimeve publike.

Auditimi u fokusua në vlerësimin e proceseve dhe procedurave të ndjekura nga Bashkia Korçë për planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, administrimin dhe mbledhjen e të ardhurave, kryerjen dhe administrimin e shpenzimeve, realizimin e investimeve, si dhe administrimin dhe përdorimin e pasurisë publike vendore.
Në këtë kuadër, vëmendje e veçantë iu kushtua vlerësimit të përputhshmërisë së veprimtarisë ekonomike dhe financiare me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe respektimit të parimeve të ligjshmërisë, rregullsisë, ekonomicitetit, eficiencës, efektivitetit dhe menaxhimit të mirë financiar.
Auditimi synoi gjithashtu të evidentojë fushat ku ekzistojnë mangësi apo dobësi në sistemet e menaxhimit dhe kontrollit, si dhe të japë rekomandime për përmirësimin e proceseve të administrimit financiar dhe forcimin e menaxhimit të burimeve publike.

b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij:
Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Korçë për periudhën e aktivitetit 2025, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese, administruese dhe raportimit financiar, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

c. Qëllimi i auditimit, periudha nën auditim dhe paraqitja e objektivave.
Për *auditimin financiar*, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.
Periudha e auditimit, është nga data 01.01.2025 deri më datën 31.12.2025.
Objektivat e auditimit, sipas drejtimeve të programit të auditimi nr. 735/1 prot., datë 01.07.2026, si vijon:
- *Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar e publik;*
- *Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e buxhetit dhe administrimit të të ardhurve;*
- *Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për pasqyrat financiare të vitit 2025;*
- *Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i fundit.*

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave:
Për realizimin e auditimit është zbatuar qasja e auditimit të bazuar në risk, duke kombinuar vlerësimin e riskut të auditimit me përzgjedhjen e periudhave dhe kampioneve për ekzaminim. Kjo metodologji synon orientimin e burimeve dhe procedurave të auditimit drejt fushave me materialitet dhe ekspozim më të lartë ndaj riskut**,** me qëllim rritjen e eficiencës dhe efektivitetit të procesit të auditimit.
Në përputhje me metodologjinë e auditimit të KLSH-së, audituesit kanë kryer identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në nivelin e fushave të llogarive dhe proceseve financiare, duke marrë në konsideratë natyrën, kompleksitetin, rëndësinë dhe ndjeshmërinë e tyre, si dhe dobësitë e mundshme në sistemet e kontrollit të brendshëm. Në bazë të këtij vlerësimi është përcaktuar natyra, koha dhe shtrirja e procedurave të auditimit, si dhe janë përzgjedhur zërat dhe transaksionet që do t'i nënshtroheshin ekzaminimit.
Përzgjedhja e kampioneve është realizuar mbi bazën e gjykimit profesional të audituesve, duke marrë në konsideratë nivelin e riskut, materialitetin, natyrën e transaksioneve, vlerën e tyre dhe ndjeshmërinë e fushave të audituara. Procedurat e kryera kanë synuar mbledhjen e evidencës së mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, për të mbështetur konkluzionet dhe opinionin e auditimit.

Në përcaktimin e shtrirjes së procedurave është marrë në konsideratë edhe parimi i materialitetit, i cili përfaqëson pragun mbi të cilin një keqdeklarim, pasaktësi apo devijim, individualisht ose në mënyrë të agreguar, mund të ndikojë në vendimmarrjen e përdoruesve të informacionit financiar.
Bazuar në gjykimin profesional dhe vlerësimin e ndjeshmërisë së zonave të llogarive objekt auditimi, materialiteti është përcaktuar në masën 2% për zonat e llogarive të planifikuara për auditim. Për qëllime të dhënies së opinionit, është marrë në konsideratë niveli i materialitetit prej 53,909 mijë lekë për shpenzimet, të llogaritura mbi bazën e zërit të shpenzimeve.
Për mbledhjen, verifikimin dhe analizimin e evidencës së auditimit, janë përdorur, sipas natyrës dhe objektit të procedurës, një kombinim i metodave dhe teknikave audituese, ndër të cilat:
- *kontrolli aritmetik*, për verifikimin e saktësisë së përllogaritjeve dhe përpunimit të të dhënave financiare;
- *kontrolli i dokumentacionit justifikues*, për vlerësimin e mbështetjes dokumentare dhe ligjore të transaksioneve;
- *inspektimi fizik*, për verifikimin e ekzistencës dhe gjendjes faktike të aktiveve, punimeve apo shërbimeve;
- *kontrolli i vlerësimit*, për verifikimin e saktësisë së vlerave të pasqyruara në dokumentacionin dhe pasqyrat financiare;
- *konfirmimi nga palët e treta*, për sigurimin e evidencës së pavarur lidhur me saldot, detyrimet, të drejtat apo transaksionet;
- *kontrolli sipas treguesve dhe analizave krahasuese*, për evidentimin e tendencave, devijimeve dhe ndryshimeve të rëndësishme në të dhënat financiare;
- *verifikimi i transaksioneve*, për vlerësimin e ligjshmërisë, rregullsisë dhe saktësisë së regjistrimit dhe raportimit të tyre;
- *intervistimi i punonjësve dhe strukturave përgjegjëse*, për marrjen e informacionit dhe sqarimeve mbi proceset dhe veprimtaritë e audituara;
- *shqyrtimi i raporteve, evidencave dhe informacioneve të administruara nga subjekti*, si dhe i burimeve të tjera relevante për auditimin;
- *përdorimi i pyetësorëve dhe instrumenteve të vlerësimit të kontrollit të brendshëm*, për identifikimin dhe vlerësimin e kontrolleve të vendosura nga subjekti.

Të dhënat dhe evidencat e administruara gjatë procesit të auditimit janë analizuar në funksion të objektivave të auditimit, duke vlerësuar ligjshmërinë, rregullsinë, plotësinë, saktësinë, transparencën dhe besueshmërinë e informacionit financiar**,** si dhe funksionimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm.
Në përfundim, rezultatet e procedurave të auditimit, së bashku me evidencën e mbledhur dhe të analizuar, janë përdorur për formimin e konkluzioneve të auditimit dhe dhënien e opinionit, në përputhje me kërkesat e standardeve dhe metodologjisë së auditimit të KLSH-së.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve:
Nga shqyrtimi i evidencave konstatohet se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 23 gjetje dhe ka dhënë 26 rekomandime, nga të cilat 16 gjetje dhe 18 rekomandime për masat organizative dhe 7 gjetje dhe 8 rekomandime për masë 3-E (mungesë të ardhurash).

2. Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.
f. Paraqitja e gjetjeve kryesore:
- Nga auditimi i sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Bashkinë Korçë, si dhe i strukturës organizative dhe kuadrit të brendshëm rregullator të institucionit, rezultoi se kuadri i brendshëm organizativ dhe etik paraqet nevojë për plotësim dhe harmonizim. Konkretisht, Bashkia

Korçë nuk ka hartuar dhe miratuar një Kod Etike institucional si dokument i veçantë, i cili të përcaktojë në mënyrë të unifikuar parimet e integritetit, standardet e sjelljes profesionale, përgjegjësitë individuale të punonjësve, trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit dhe mekanizmat për monitorimin e zbatimit të tyre. Gjithashtu, rezultoi se Rregullorja e Brendshme e organizimit dhe funksionimit të administratës nuk është harmonizuar me strukturën organizative faktike të miratuar për vitin 2025, pasi në të vijon të parashikohet Sektori i Kontrollit Veterinar pranë Drejtorisë së Kontrollit të Territorit, ndërkohë që ky sektor nuk rezulton më pjesë e strukturës organizative të miratuar.

- Nga auditimi i organizimit dhe funksionimit të Njësisë së Auditit të Brendshëm në Bashkinë Korçë rezultoi se, nuk është ngritur Komitetin e Auditimit, duke mos siguruar strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, monitorimin e zbatimit të rekomandimeve dhe mbështetjen e titullarit në forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Nga shqyrtimi i Planit Vjetor të Auditimit rezultoi se planifikimi nuk është bazuar plotësisht në analizën e riskut, pasi nuk janë përfshirë për auditim procese dhe struktura me risk të lartë, si aktiviteti i prokurimeve publike dhe Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit (lejet e ndërtimit/ zhvillimit).

Dosjet e auditimit, megjithëse janë organizuar sipas strukturës së Manualit të Auditimit të Brendshëm, nuk arkivohen pranë arkivit të Bashkisë.

- Për vitin 2025, buxheti përgjithshëm rezultoi me një realizimi prej 79%, ndërsa realizimi i investimeve ishte vetëm 49%, pasi nga vlera 418,005 mijë lekë të planifikuara u realizua vlera 203,290 mijë lekë, duke mbetur pa u realizuar vlera 214,715 mijë lekë. Mosrealizimi lidhet kryesisht me vonesat në procedurat administrative, mosrealizimin e financimeve dhe të ardhurave të parashikuara, shtyrjen e projekteve shumëvjeçare dhe mungesën e përshtatjes në kohë të programit të investimeve me kapacitetet reale financiare të Bashkisë.

- Nga auditimi mbi vlerësimin e risqeve buxhetore që burojnë nga detyrimet e prapambetura, rezultoi se Bashkia Korçë në fund të vitit 2024 kishte detyrime të prapambetura në vlerën 14,904,085 lekë, ndërsa për likuidimin e tyre në buxhetin e vitit 2025 ishte planifikuar vetëm vlera 4,332,709 lekë, ose rreth 29% e stokut të detyrimeve të mbartura, sipas Vendimit të KB nr.19, datë 25.02.2025. Gjatë vitit 2025 ishin krijuar detyrime të reja në shumën 61,171,378 lekë, duke e çuar totalin e detyrimeve në vlerën 76,075,464 lekë (progresiv). Pjesën më të madhe të tyre, vlera 40,712,689 lekë ose rreth 66.6% të totalit të detyrimeve, e përbëjnë detyrimet që burojnë nga ekzekutimi i vendimeve gjyqësore.

Në rastin e detyrimit prej 10,571,376 lekë për TVSH-në e projektit "Shfrytëzimi inteligjent i energjisë", Bashkia e ka regjistruar këtë detyrim si detyrim të prapambetur, megjithëse sipas kontratës detyrimi për pagesën e TVSH-së i përkiste Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

- Nga auditimi i detyrimeve financiare që rrjedhin nga vendimet gjyqësore, rezultoi se gjatë vitit 2025 bashkia ka regjistruar 7 vendime gjyqësore me vlerë detyrimi 38,473,043 lekë, *nga e cila*: 6 vendime për dëmshpërblim lidhur me pensionet e invaliditetit me vlerë 38,022,134 lekë, *për këto raste është evidentuar dhe tarifa përmbarimore me vlerë 5,020,473 lekë, duke e çuar efektin financiar të kësaj kategorie në 43,042,607 lekë*, si dhe një vendim për një punonjës të larguar me vlerë 450,909 lekë**.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit për vendimin e fundit nuk rezultoi që titullari të ketë analizuar shkaqet e humbjes së çështjes gjyqësore ose të ketë kërkuar evidentimin e përgjegjësive administrative të personave, veprimet apo mosveprimet e të cilëve mund të kenë ndikuar në krijimin e detyrimit. Mungesa e analizës së dokumentuar pengon identifikimin e shkaqeve të humbjes së procesit dhe marrjen e masave për të ulur rrezikun e detyrimeve të ngjashme në të ardhmen.

- Nga verifikimi i Formatit nr. 7/a "*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*" të pasqyrave financiare, rezultoi se në mbyllje të vitit ushtrimor 2025, llogaria 211 "*Pyje, kullota,*

plantacione" paraqitet në vlerën 110,930,754 lekë. Referuar analizës së regjistrit të aktiveve në këtë llogari janë regjistruar 84 objekte në vlerën totale 20,310,296 lekë, të cilat sipas natyrës së tyre ekonomike nuk i përkasin kësaj llogarie, por duhet të klasifikohen në llogarinë 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore*" (sipas Aneksit 3.3 b/lidhur RPA). Si rezultat, pasqyrat financiare nuk paraqesin në mënyrë të saktë klasifikimin e aktiveve afatgjata materiale, duke ndikuar në informacionin kontabël mbi strukturën e aktiveve, regjistrin e inventarit fizik dhe llogaritjen e amortizimit sipas kategorive përkatëse.

- Nga auditimi rezultoi se llogaria 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore"**,** sipas Formatit 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)", në fund të vitit 2025 paraqitet në vlerën 6,230,694,402 lekë**.** Referuar analizës së inventarit kontabël, nuk është kryer çregjistrimi i 10 objekteve të ujësjellës-kanalizimeve me vlerë totale 38,896,711 lekë**,** të cilat sipas dokumentacionit duhej të ishin transferuar pranë shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Korçë**.**

Mos çregjistrimi i aktiveve të transferuara ka sjellë: mbivlerësimin e llogarisë 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore*" me 38,896,711 lekë, pasqyrim jo të saktë dhe jo të plotë të aktiveve afatgjata materiale në pasqyrat financiare, ndikim në llogaritjen e amortizimit dhe në besueshmërinë e informacionit financiar.

- Nga auditimi i pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë Korçë viti 2025, rezultoi se llogaria 466 "*Kreditorë për mjete në ruajtje*" paraqitet me gjendje në vlerën 48,640,843 lekë në fund të vitit 2024 dhe vlerën 49,021,470 lekë në fund të vitit 2025. Kjo llogari përfaqëson garancitë kontraktore (5% e vlerës së kontratës) të mbajtura për investimet e realizuara dhe është raportuar në mënyrë analitike pranë Degës së Thesarit, si dhe është pasqyruar në anekset e bilancit të vitit 2025.

Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se garancitë që i përkasin periudhës 2015–2025, për të cilat periudha e garancisë nuk ka përfunduar, janë në vlerën 19,309,991 lekë. Gjithashtu, nga dokumentacioni i administruar rezultoi se Drejtoria e Financës dhe Zhvillimit Ekonomik, me shkresën nr. 584 prot., datë 20.01.2026, i është drejtuar Drejtorisë së Planifikimit të Zhvillimit të Territorit dhe Kontrollit (PZHKT), duke kërkuar marrjen e masave për ekzekutimin e procedurave lidhur me garancitë e kontratave, periudha e të cilave ka përfunduar.

- Nga auditimi i dokumentacionit dhe regjistrit të pronave rezultoi se Bashkia Korçë administron gjithsej 2222 prona**,** nga të cilat 257 prona në përdorim dhe 1965 prona në pronësi**.** Nga pronat në pronësi, 279 prona janë pajisur me certifikatë pronësie, ndërsa 47 prona janë në proces certifikimi**.** Megjithëse 279 prona janë regjistruar ligjërisht në emër të Bashkisë Korçë, ato nuk janë regjistruar në kontabilitet si aktive afatgjata materiale, me argumentin se nuk disponojnë një vlerë financiare të përcaktuar.

- Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore rezultoi se Bashkia Korçë, edhe për vitin 2025, nuk ka realizuar planin e miratuar të të ardhurave, ku nga vlera e planifikuar prej 1,238,189 mijë lekë, janë realizuar 891,101 mijë lekë, ose **72%** e planit, duke rezultuar një mosrealizim prej 347,088 mijë lekë. Edhe gjatë vitit 2024 niveli i realizimit ka qenë **61%,** me një mosrealizim prej 485,774 mijë lekë. Megjithëse në vitin 2025 evidentohet një përmirësim i nivelit të realizimit me 11 pikë përqindje dhe ulje e diferencës së mosrealizimit me 138,686 mijë lekë, planifikimi vijon të mos mbështetet në analiza të plota të potencialit fiskal, të bazës së tatimpaguesve dhe të trendit historik të arkëtimeve.

Nga analiza sipas kategorive të të ardhurave rezultoi se të ardhurat nga taksat vendore janë realizuar vetëm 52% të planit, me një mosrealizim prej 293,415 mijë lekë, ku ndikimin kryesor e ka dhënë mosrealizimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë (TNI) (*34% e planit*), taksës mbi tokën bujqësore (*44%*), taksës mbi truallin (*53%*) dhe taksës së ndikimit nga legalizimet (*28%*).

Të ardhurat jotatimore janë realizuar në masën 90% të planit, me një mosrealizim prej 50,114 mijë lekë, kryesisht në tarifat e pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit, mirëmbajtjes së varrezave, zënies së hapësirës publike, tarifës vjetore SH.M.RR.&S.K. dhe të ardhurave nga institucionet e varësisë.

Ndërkohë, në zërin "Të ardhura të tjera" janë arkëtuar 48,080 mijë lekë si kontribut në fondin publik të banesave sociale, pa qenë kjo shumë e planifikuar në buxhetin e vitit 2025, duke evidentuar mangësi në procesin e planifikimit buxhetor dhe në vlerësimin e burimeve reale të financimit.

- Nga auditimi i administrimit të tarifave të parkimit rezident, parkimit me pagesë dhe tarifave për leje transporti rezultoi se:

Për parkimin rezident, lejet janë lëshuar kryesisht mbi bazën e kërkesave të paraqitura nga banorët, pa u mbështetur në një metodologji të dokumentuar që të marrë në konsideratë nevojat e zonës, kapacitetin e vendeve të parkimit dhe numrin e mjeteve në pronësi të banorëve. Gjithashtu, nuk janë evidentuar kontrolle periodike të dokumentuara, në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, për verifikimin në terren të mjeteve përfituese dhe vlefshmërisë së lejeve.

Për parkimin me pagesë**,** nga 320 vende parkimi të miratuara, me plan të ardhurash 14,000,000 lekë, janë arkëtuar 13,079,250 lekë, duke rezultuar mosrealizim në vlerën 920,750 lekë. Nga verifikimi nuk rezultoi dokumentacion i mjaftueshëm kontrolli dhe rakordimi ndërmjet numrit të mjeteve të parkuara, biletave të përdorura, kohëzgjatjes së parkimit dhe arkëtimeve. Mungojnë, ndër të tjera, akt-rakordimet, evidencat për administrimin e blloqeve të biletave dhe aktet e kontrolleve periodike.

Për tarifat e lejeve të transportit, gjatë vitit 2025 janë lëshuar 30 certifikata transporti, 1 licencë, 3 certifikata për transport mallrash për të tretë dhe 20 autorizime. Procesi i evidentimit dhe përcaktimit të të ardhurave është mbështetur kryesisht në kërkesat e subjekteve, pa u evidentuar kontrolle të dokumentuara apo shkëmbim sistematik informacioni me DRSHTRR dhe QKB, për verifikimin e mjeteve dhe subjekteve që plotësojnë kushtet për pajisje me leje/autorizim. Kjo krijon risk për mosidentifikimin e të gjithë subjekteve dhe mjeteve që duhet të përfshihen në skemën e pagesës.

- Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH, përcjellë me shkresën nr.1348/16 Prot, datë 13.10.2025, rezultoi se statusi i zbatimit të tyre, në mënyrë të përmbledhur, paraqitet si më poshtë:

- Nga auditimi i dokumentacionit të administruar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, si dhe nga kryqëzimi i listave të përcjella nga A.SH.K/ Drejtoria Vendore Korçë, me pagesat e kryera për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet, rezultoi se në fillim të vitit 2025 janë trashëguar 373 debitorë, me detyrim të papaguar në vlerën 24,407,330 lekë. Gjatë vitit 2025 janë arkëtuar detyrime të periudhave të mëparshme për 84 debitorë, në vlerën 2,999,685 lekë, *ndërkohë që gjatë vitit janë krijuar detyrime të reja për 85 persona, në vlerën 2,953,821 lekë.*

Në fund të vitit 2025 rezultojnë 374 debitorë, me detyrim progresiv në vlerën **24,361,466 lekë**, i cili është pasqyruar në llogarinë 468 "*Debitorë të ndryshëm*".

Gjithashtu, megjithëse gjatë vitit 2025 janë dërguar 326 njoftime dhe kërkesa për pagesë dhe janë nxjerrë 234 urdhra bllokimi, nuk janë marrë të gjitha masat e nevojshme dhe efektive për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura.

Mos ndjekja në mënyrë të plotë dhe efektive e procedurave për mbledhjen e detyrimeve ka sjellë që në fund të vitit 2025 të mbeten të paarkëtuara 24,361,466 lekë, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Korçë dhe duke rritur riskun e vështirësimit të arkëtimit të këtyre detyrimeve.

- Nga auditimi i administrimit dhe arkëtimit të gjobave për pagesat e vonuara të detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, rezultoi se deri më 31.12.2025, detyrimet e llogaritura për kamatëvonesa/gjoba për pagesë të vonuar arrijnë në vlerën **45,720,154 lekë**. Kjo vlerë përfshin detyrimet e mbartura deri në fund të vitit 2024, shtesat e llogaritura gjatë vitit 2025, si dhe detyrimet e llogaritura për vitin 2025, pas zbritjes së arkëtimeve të realizuara.

Llogaritja e gjobave për pagesë të vonuar është kryer mbi bazën e 0.06% të detyrimit të papaguar për çdo ditë vonesë (nëpërmjet sistemit), por jo për një periudhë më të gjatë se 365 ditë, si dhe përcaktimeve të paketave fiskale vendore. Megjithatë, niveli i detyrimeve të akumuluara për kamatëvonesa mbetet i konsiderueshëm në raport me arkëtimet e realizuara, ç' ka tregon nevojën për forcimin e masave të administrimit, njoftimit dhe ndjekjes së subjekteve debitore, me qëllim arkëtimin në kohë të detyrimeve dhe shmangien e akumulimit të mëtejshëm të kamatëvonesave.

- Nga auditimi i procedurave të ndjekura për evidentimin dhe arkëtimin e taksës së tokës bujqësore, rezultoi se në fund të vitit 2025 gjendja debitore është 95,861,361 lekë, me një rritje prej 13,202,562 lekë krahasuar me vitin 2024. Gjatë vitit 2025 janë krijuar 10,641 familje debitore për këtë taksë, ku numri më i lartë rezulton në NJ.A. Bulgarec, ndërsa më i ulëti në NJ.A. Lekas. Pavarësisht njoftimeve të kryera nga strukturat e Bashkisë dhe njësitë administrative, nuk është kryer punë e mjaftueshme për përditësimin e bazës së të dhënave të subjekteve debitore dhe ndjekjen e plotë të procedurave për arkëtimin e detyrimeve. Për një pjesë të debitorëve, problematikat lidhen me lëvizjet demografike, emigracionin dhe mungesën e përditësimit të të dhënave.

- Nga auditimi i administrimit të tarifës së parkimit në Bashkinë Korçë u konstatua se, gjatë lidhjes së kontratave për vendparkime të rezervuara, në 5 raste është përcaktuar një kohëzgjatje rezervimi prej 6–7 orësh në ditë, në kundërshtim me Vendimin e KB nr. 158, datë 26.11.2024, Kapitulli IV, pika 2. Si rezultat, janë llogaritur dhe arkëtuar më pak të ardhura në shumën 30,770 lekë.

Gjithashtu, për disa subjekte me aktivitet hotelier (gjithsej 6 subjekte), të cilat ushtrojnë aktivitet të pandërprerë, 24 orë/ditë dhe 365 ditë/vit, vendparkimet e rezervuara janë administruar me orare të kufizuara. Sipas dokumentacionit të administruar ka rezultuar se nuk janë kryer kontrolle dhe verifikime periodike mbi përdorimin faktik të tyre. Për subjektet e evidentuara, diferenca ndërmjet detyrimit për rezervim 24-orësh dhe detyrimit të arkëtuar sipas kontratave është 1,295,300 lekë.

Për rrjedhojë, moszbatimi i plotë i përcaktimeve të Paketës Fiskale, mungesa e monitorimit periodik të përdorimit faktik të vendparkimeve dhe mosvlerësimi i natyrës së aktivitetit të subjekteve kanë sjellë mosarkëtim të plotë të të ardhurave vendore në shumën totale **1,326,070 lekë** *(1,295,300 + 30,770)*.

- Nga auditimi i administrimit dhe likuidimit të kontratave të qirasë për pyje-kullota dhe tokë bujqësore rezultoi se Bashkia Korçë ka lidhur dhe administron kontrata qiraje për tokë bujqësore dhe pyje-kullota, ndaj të cilave rezultojnë detyrime të papaguara prej disa vitesh**.**

Për kontratat e tokës bujqësore, rezultojnë **11** kontrata debitore, me detyrim total **39,284,877 lekë,** ku për 3 kontrata me vlerë 2,039,679 lekë Bashkia Korçë është detyruar të ndjekë procedura gjyqësore për arkëtimin e detyrimeve dhe prishjen e kontratave, çështje të cilat janë në proces gjykimi.

- Nga auditimi i dokumentacionit mbi veprimtarinë e Policisë Bashkiake, rezultoi se gjatë vitit 2025 janë vendosur gjithsej 1,951,000 lekë gjoba**,** nga të cilat 135,000 lekë ndaj subjekteve private dhe 1,816,000 lekë për kundërvajtje rrugore. Sipas analizës së arkëtimeve të paraqitur nga Policia Bashkiake, gjatë vitit 2025 janë arkëtuar 115,000 lekë nga subjektet private dhe 924,620 lekë nga kundërvajtjet rrugore, ose në total 1,039,620 lekë**.**

Nga të dhënat e Sektorit të Financës rezultoi se detyrimet e kontabilizuara për gjobat e vendosura gjatë vitit 2025 janë në vlerën **1,946,000 lekë**, ndërsa detyrimet e mbartura nga viti 2024 janë në vlerën **71,000 lekë**, duke rezultuar në një detyrim total prej **2,017,000 lekë**.

Krahasuar me të dhënat e Policisë Bashkiake, sipas të cilave vlera e penaliteteve të aplikuara gjatë vitit 2025 është **1,951,000 lekë**, konstatohet një **mosrakordim në vlerën 5,000 lekë**.

Në lidhje me arkëtimet e vitit 2025, sipas të dhënave të Sektorit të Financës, për të dy kategoritë e gjobave është likuiduar vlera 973,000 lekë. Nga kjo vlera prej 708,000 lekë rezulton e parashkruara për shkak të lehtësive ligjore në pagesë, ndërsa detyrimi i mbetur për pagesë paraqitet në vlerën 336,000 lekë. Sipas të dhënave të Policisë Bashkiake, gjatë vitit 2025 është likuiduar vlera 1,032,620 lekë, duke rezultuar një diferencë prej 59,620 lekë më shumë krahasuar me vlerën e paraqitur nga Sektori i Financës.
Gjithashtu, nga krahasimi i të dhënave të Akt-Rakordimit të mbajtur ndërmjet Drejtorisë së Financës dhe Degës së Thesarit, datë 31.12.2025, me të dhënat e likuidimeve të paraqitura nga Sektori i Financës, u konstatua një tjetër mospërputhje. Konkretisht, derdhjet për gjobat e Policisë Bashkiake me kod 7115420 paraqiten në vlerën 604,400 lekë, ndërkohë që Sektori i Financës paraqet likuidime në vlerën 973,000 lekë, duke rezultuar një diferencë prej 368,600 lekë, për të cilën nuk është dhënë argumentimi dhe dokumentacioni përkatës.
Sa më sipër, konstatohet se të dhënat e administruara dhe të raportuara nga Policia Bashkiake dhe Sektori i Financës nuk janë të rakorduara, si në lidhje me vlerën e gjobave të vendosura, ashtu edhe me vlerat e arkëtuara dhe të derdhura në Thesar. Mospërputhjet e konstatuara nuk janë shoqëruar me dokumentacion apo shpjegime të mjaftueshme për justifikimin e tyre, duke cenuar saktësinë dhe besueshmërinë e të dhënave financiare dhe të informacionit të raportuar.
- Nga auditimi rezultoi se Bashkia Korçë nuk ka siguruar një administrim efektiv të mbledhjes së detyrimeve tatimore të prapambetura, duke bërë që borxhi tatimor progresiv të vijojë të rritet nga vlera 632,853,801 lekë në fund të vitit 2024 në vlerën 668,442,106 lekë në fund të vitit 2025, me një rritje prej 35,588,305 lekë. Nga kjo vlerë, vlera prej 324,836,496 lekë i përkasin detyrimeve të bizneseve, *ku vlera 104,904,555 lekë janë detyrime të 772 subjekteve me status pasiv/të pezulluar/në proces çregjistrimi dhe vlera 343,605,610 lekë i përkasin detyrimeve të familjarëve*.
Auditimi evidentoi se, megjithëse Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore (DTTV) ka ndërmarrë masa si dërgimi i njoftimeve për pagesë, bllokimi i llogarive bankare dhe në raste të kufizuara vendosja e barrëve hipotekore, këto masa nuk kanë rezultuar të mjaftueshme për të garantuar arkëtimin e detyrimeve dhe uljen e stokut të borxhit. Gjithashtu u konstatua se një pjesë e konsiderueshme e borxhit i përket detyrimeve me moshë mbi 5 dhe mbi 10 vjet, të cilat përbëjnë rreth **68.8%** të totalit të borxhit të bizneseve. Nuk janë zbatuar në mënyrë të plotë të gjitha masat shtrënguese të parashikuara nga legjislacioni tatimor, veçanërisht vendosja e barrës siguruese dhe sekuestrimi mbi pasuritë e debitorëve, për shkak të mungesës së koordinimit institucional dhe mosdisponimit të informacionit të plotë mbi pasuritë.

g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:
Kryetari i Bashkisë Korçë, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme Juridike dhe Burimeve Njerëzore, të marrë masa për rishikimin, plotësimin dhe harmonizimin e kuadrit të brendshëm institucional, duke:
- hartuar, miratuar dhe vënë në zbatim Kodin e Etikës të Bashkisë Korçë si dokument të veçantë institucional, ku të përcaktohen qartë parimet e integritetit, standardet e sjelljes profesionale, përgjegjësitë e punonjësve, trajtimi i konfliktit të interesit dhe mekanizmat e monitorimit të zbatimit të tij; dhe
- rishikuar dhe përditësuar Rregulloren e Brendshme të organizimit dhe funksionimit të administratës, me qëllim harmonizimin e saj me strukturën organizative faktike të miratuar, duke reflektuar saktë strukturat, funksionet, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.
Kryetari i Bashkisë Korçë, në bashkëpunim me drejtuesin e Njësisë së Auditit të Brendshëm, të marrë masa për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit, sipas kërkesave ligjore; të rishikojë planifikimin strategjik dhe vjetor të auditimit mbi bazën e një analize të dokumentuar të riskut, duke vlerësuar për përfshirje edhe prokurimet publike dhe proceset e lejeve të ndërtimit e

zhvillimit; si dhe të sigurojë administrimin dhe arkivimin e dosjeve të auditimit sipas rregullave në fuqi.
Kryetari i Bashkisë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Zhvillimit Ekonomik, strukturat programore dhe Grupin e Menaxhimit Strategjik, të marrin masa për forcimin e procesit të planifikimit, programimit dhe monitorimit buxhetor, duke siguruar: (i) respektimin rigoroz të të gjitha fazave, procedurave dhe afateve të ciklit të PBA-së, përfshirë miratimin paraprak nga Këshilli Bashkiak të dokumenteve të kërkuara përpara dërgimit në Ministrinë e Financave; (ii) hartimin dhe miratimin e një kalendari të detajuar të punës për PBA-në, në përputhje me afatet ligjore dhe udhëzimet e Ministrisë së Financave; (iii) integrimin e parashikimeve të të ardhurave, tavaneve buxhetore dhe programeve të shpenzimeve mbi bazën e burimeve reale dhe të disponueshme të financimit; (iv) kryerjen e analizave periodike të realizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe, kur është e nevojshme, rishikimin në kohë të buxhetit; dhe (v) programimin e investimeve vetëm mbi bazën e një vlerësimi realist të burimeve të financimit, gatishmërisë teknike dhe administrative të projekteve.
Kryetari i Bashkisë Korçë, nëpërmjet Drejtorinë e Financës dhe Zhvillimit Ekonomik, të marrë masa që në procesin e hartimit të programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor për:
- identifikimin dhe inventarizimin e të gjitha detyrimet ekzistuese dhe potenciale, përfshirë detyrimet që burojnë nga proceset gjyqësore, shpronësimet, kontratat shumëvjeçare dhe detyrimet e kushtëzuara;
- kryerjen e një analize periodike e risqeve fiskale dhe të dokumentohet ndikimi i tyre në treguesit buxhetorë;
- planifikimin e fondeve të mjaftueshme për përballimin e detyrimeve të njohura dhe të pritshme, duke shmangur nevojën për rialokime të shpeshta gjatë vitit buxhetor;
- forcimin e procedurave të monitorimit të kontratave dhe koordinimit me institucionet financuese, me qëllim që detyrimet që u përkasin palëve të treta të mos regjistrohen si detyrime të Bashkisë pa bazë ligjore ose kontraktore;
Kryetari i Bashkisë të marrë masa për analizimin e vendimit gjyqësor për punonjësin e larguar, duke përcaktuar shkaqet e humbjes së çështjes dhe, nëse konstatohen shkelje, përgjegjësitë administrative përkatëse. Gjithashtu, të ngarkojë strukturat juridike dhe financiare të ndjekin në mënyrë të vazhdueshme vendimet gjyqësore dhe kostot e ekzekutimit të tyre, me qëllim planifikimin në kohë të detyrimeve dhe shmangien e shpenzimeve shtesë për buxhetin e bashkisë.
Të bashkëpunojë me Ministrinë e Shëndetësisë për delegimin e fondeve për kryerjen e pagesës së vendimeve gjyqësore në vlerën 43,042,607 lekë.
Drejtoria e Financës dhe Zhvillimit Ekonomik, të marrë masa për:
- rishikimin e regjistrit të aktiveve afatgjata materiale;
- riklasifikimin kontabël të 84 objekteve me vlerë 20,310,296 lekë nga llogaria 211 "*Pyje, kullota, plantacione*" në llogarinë 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore*", në përputhje me natyrën ekonomike të tyre dhe kërkesat e planit kontabël;
Drejtoria e Financës dhe Zhvillimit Ekonomik, të marrë masa për:
- çregjistrimin kontabël të 10 objekteve të ujësjellës-kanalizimeve, me vlerë 38,896,711 lekë**,** pranë shoqërisë Ujësjellës Kanalizime, duke reflektuar saktë ndryshimet në regjistrat kontabël dhe në pasqyrat financiare;
- rakordimin periodikisht të regjistrave të aktiveve me dokumentacionin e transferimeve dhe inventarin fizik.
Drejtoria e Financës dhe Zhvillimit Ekonomik në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit të Zhvillimit të Territorit dhe Kontrollit (PZHKT), të marrin masa për verifikimin e plotë të të gjitha garancive të evidentuara në llogarinë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje", të identifikojë kontratat për të cilat ka përfunduar periudha e garancisë, të njoftojë operatorët ekonomikë për paraqitjen e dokumentacionit përkatës dhe të procedojë, sipas rastit, me zhbllokimin ose ekzekutimin e

garancive, duke sistemuar gjendjen e kësaj llogarie në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe duke siguruar pasqyrim të saktë në pasqyrat financiare.
Kryetari i Bashkisë Korçë, nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Zhvillimit Ekonomik si dhe strukturat përgjegjëse për administrimin e pronave, të marrë masa për:
- përfundimin e procesit të identifikimit dhe vlerësimit të 279 pronave të pajisura me certifikatë pronësie;
- regjistrimin e tyre në kontabilitet si aktive afatgjata materiale, pas përcaktimit të vlerës së tyre kontabël sipas metodave të parashikuara në legjislacion;
- rakordimin periodik të regjistrit të pronave me regjistrat kontabël;
- ndjekjen e procedurave për përfundimin e certifikimit të 47 pronave të mbetura dhe vijimin e regjistrimit të tyre në kontabilitet pas përfundimit të procesit të regjistrimit dhe vlerësimit.
Drejtoria e Financës dhe Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për:
- hartimin e planit të të ardhurave mbi baza realiste, duke u mbështetur në analiza të dokumentuara të potencialit fiskal, bazës së tatimpaguesve, ecurisë historike të arkëtimeve dhe faktorëve ekonomikë që ndikojnë në realizimin e të ardhurave;
- kryerjen e analizave periodike mbi realizimin e të ardhurave sipas çdo zëri buxhetor, evidentimin e shkaqeve të devijimeve nga plani dhe marrjen në kohë të masave korrigjuese për përmirësimin e nivelit të arkëtimit;
- forcimin e administrimit fiskal, përditësimin e bazës së tatimpaguesve dhe monitorimin e vazhdueshëm të burimeve të të ardhurave, me qëllim rritjen e eficiencës në administrimin dhe arkëtimin e taksave e tarifave vendore;
Kryetari i Bashkisë, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për hartimin dhe zbatimin e një procedure të dokumentuar për administrimin e parkimit rezident, parkimit me pagesë dhe lejeve të transportit, e cila të përcaktojë kriteret dhe metodologjinë e planifikimit të vendeve dhe lejeve të parkimit, mënyrën e verifikimit periodik të përfituesve dhe mjeteve të parkuara, si dhe kontrollet dhe rakordimet ndërmjet vendeve të parkimit, biletave të përdorura dhe arkëtimeve.
Për kontrollet në terren të sigurohet bashkëpunimi i dokumentuar me Policinë Bashkiake, me qëllim rritjen e efektivitetit të kontrollit të brendshëm dhe garantimin e administrimit të plotë e të saktë të të ardhurave nga tarifat e parkimit.
Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Korçë, të marrë masa për evidentimin, verifikimin dhe ndjekjen individuale të të gjithë debitorëve të taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet, me qëllim arkëtimin e detyrimeve në vlerën **24,361,466 lekë**.
Për debitorët që nuk kryejnë pagesën vullnetarisht, të vijojë me marrjen e të gjitha masave administrative dhe ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi, duke dokumentuar në mënyrë të plotë çdo veprim të ndërmarrë deri në arkëtimin e detyrimeve.
Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Korçë, të marrë masa për evidentimin, njoftimin dhe ndjekjen sistematike të debitorëve për detyrimet e papaguara dhe kamatëvonesat përkatëse në vlerën 45,720,154 lekë, duke zbatuar në mënyrë të plotë procedurat ligjore të mbledhjes së detyrimeve, me qëllim rritjen e nivelit të arkëtimit dhe parandalimin e akumulimit të mëtejshëm të detyrimeve të prapambetura.
Sektori i Bujqësisë dhe Sektorit për Kontrollin dhe Mbledhjen e të Ardhurave për Njësitë Administrative, të marrë masa për përditësimin dhe verifikimin e bazës së të dhënave të taksapaguesve të tokës bujqësore, duke evidentuar debitorët sipas njësive administrative dhe duke ndjekur në mënyrë sistematike arkëtimin e detyrimeve në vlerën **95,861,361 lekë.**
Për debitorët që nuk shlyejnë detyrimet pas njoftimit, të vijojë zbatimi i procedurave të mbledhjes me forcë, përfshirë vendosjen e masave të sigurimit të detyrimit dhe ndjekjen e procedurave hipotekore, sipas legjislacionit në fuqi, me qëllim uljen e stokut të debitorëve dhe rritjen e të ardhurave nga kjo taksë.
Bashkia Korçë, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për rishikimin dhe unifikimin e

kontratave për vendparkimet e rezervuara, në përputhje me përcaktimet e Paketës Fiskale, duke siguruar që kohëzgjatja e rezervimit dhe detyrimi përkatës të përcaktohen sipas kushteve faktike të përdorimit dhe natyrës së aktivitetit të subjektit.
Të kryhen verifikime periodike mbi përdorimin faktik të vendparkimeve të rezervuara dhe të merren masa për evidentimin dhe arkëtimin e detyrimeve të papaguara në vlerën 1,326,070 lekë, në mënyrë që të sigurohet administrimi i plotë, efektiv dhe i barabartë i të ardhurave nga kjo tarifë.
Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Korçë të marrë masa për forcimin e kontrollit dhe monitorimit të kontratave të qirasë për pyje-kullota dhe tokë bujqësore, duke krijuar dhe mbajtur një regjistër të përditësuar të kontratave, detyrimeve dhe pagesave, me evidentimin e afateve të pagesës dhe të masave të ndërmarra ndaj çdo debitori.
Për çdo kontratë debitore, të merren pa vonesë masat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve në vlerën 37,245,198 lekë, dhe kur është rasti, për zgjidhjen e kontratave.
Për çështjet gjyqësore në proces të sigurohet ndjekje sistematike deri në ekzekutimin e plotë të vendimeve gjyqësore.
Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të marrë masa për rakordimin e plotë të të dhënave lidhur me gjobat e vendosura, të kontabilizuara, të arkëtuara dhe të derdhura në Thesar**,** për vitin 2025 dhe detyrimet e mbartura nga vitet e mëparshme.
Në mënyrë të veçantë, të verifikohen dhe të dokumentohen diferencat e konstatuara në vlerat 5,000 lekë, 59,620 lekë dhe 368,600 lekë, duke përcaktuar shkakun e krijimit të tyre dhe, nëse është e nevojshme, të kryhen korrigjimet përkatëse në evidencat kontabël dhe financiare.
Të vendoset një procedurë periodike rakordimi ndërmjet Policisë Bashkiake, Sektorit të Financës dhe Degës së Thesarit, ku të rakordohen numri dhe vlera e gjobave të vendosura, detyrimet e kontabilizuara, arkëtimet, parashkrimet/lehtësitë në pagesë, detyrimet e mbetura dhe derdhjet në Thesar.
Kryetari i Bashkisë Korçë, nëpërmjet Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për:
- hartimin dhe zbatimin e një plani konkret veprimi për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura, të bazuar në analizën e riskut, moshën e borxhit dhe aftësinë paguese të debitorëve.
- zbatimin në mënyrë të plotë dhe në kohë të të gjitha masave administrative dhe shtrënguese të parashikuara, përfshirë bllokimin e llogarive bankare, vendosjen e barrës siguruese dhe hipotekore, sekuestrimin e pasurive dhe ndjekjen e procedurave të ekzekutimit për debitorët në vlerën **668,442,106 lekë**.
- kryerjen e një analize të plotë të portofolit të debitorëve me status pasiv, të pezulluar ose të çregjistruar, me qëllim ndjekjen e procedurave ligjore për arkëtimin ose sistemimin e detyrimeve sipas legjislacionit në fuqi.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit:
Bazuar në rezultatet e auditimit në Bashkinë Korçë, KLSH ka dhënë ***"Opinioni i kualifikuar"*** për pasqyrat financiare të konsoliduara. Referuar gjetjeve të auditimit për përmirësimin e gjendjes janë dhënë rekomandimet përkatëse të klasifikuara në rekomandime organizative.

OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion mbi pasqyrat financiare të vitit 2025:
Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të konsoliduara Bashkia Korçë për periudhën ushtrimore viti 2025, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe

vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

"Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Korçë nuk paraqesin në mënyrë të drejtë disa elementë të përshkruara në paragrafin "Baza për Opinion", që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një ***opinioni të kualifikuar****, e shprehur kjo në bazën për opinionin".*

Baza për opinioni të kualifikuar[1]:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Njësia shpenzuese Bashkia Korçë, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (SNA-700).

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale, por jo të përhapura. Materialiteti i llogaritur nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit, bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së, për pasqyrat financiare të vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2025 është 53,909 mijë lekë, ndërsa gabimi i lejuar është 5,391 mijë lekë.

Opinioni i kualifikuar mbështetet në konstatimin e anomalive materiale që ndikojnë në paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare, konkretisht:

- Në llogarinë 211 "Pyje, kullota, plantacione", me gjendje në fund të vitit 2025 prej 110,930,754 lekë, rezultoi se janë përfshirë 84 objekte, me vlerë totale 20,310,296 lekë, të cilat, sipas natyrës së tyre ekonomike, nuk i përkasin kësaj kategorie aktivesh dhe duhet të riklasifikohen në llogarinë 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore".
- Në llogarinë 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore", e cila në fund të vitit 2025 paraqitet në vlerën 6,230,694,402 lekë, rezultoi se vijojnë të jenë të regjistruara 10 objekte të ujësjellës-kanalizimeve, me vlerë totale 38,896,711 lekë, të cilat, referuar dokumentacionit të administruar, duhet të ishin transferuar pranë shoqërisë Ujësjellës Kanalizime dhe për rrjedhojë të ishin çregjistruar nga evidenca kontabël e Bashkisë Korçë.
- Llogaria 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" paraqitet me gjendje 48,640,843 lekë në fund të vitit 2024 dhe 49,021,470 lekë në fund të vitit 2025, e panalizuar.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në zbatim të Programit të Auditimit nr. 735/1 prot, datë 01.07.2026, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 01.07.2026, deri më 24.07.2026, në institucionin Bashkia Korçë u krye auditmi "Mbi auditimin financiar" për periudhën nga data 01.01.2025, deri më 31.12.2025. Auditimi u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

1. K.GJ., *Përgjegjës grupi*
2. S.D., *anëtar*
3. M.M., *anëtar*

[1] SNA-705- Audituesi duhet të shpreh një opinion të kualifikuar kur ka marrë sërshmi të mjaftushme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku janë materiale por jo të përhapura.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIME DHE METODOLOGJIA

1. Objektivat dhe qëllimi: Objektivi i auditimit financiar është dhënia e një opinioni me siguri të arsyeshme mbi faktin nëse pasqyrat financiare të subjektit të audituar, për vitin ushtrimor 2025, paraqesin në mënyrë të drejtë dhe të saktë, në të gjitha aspektet materiale, transaksionet financiare, ngjarjet ekonomike, pozicionin dhe performancën financiare të subjektit, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi për raportimin financiar.

Në funksion të këtij objektivi, auditimi synon të vlerësojë nëse të ardhurat, shpenzimet, aktivet, detyrimet dhe përdorimi i burimeve publike janë regjistruar, administruar dhe raportuar në mënyrë të rregullt, të plotë dhe të besueshme, si dhe nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me kërkesat e legjislacionit dhe standardeve të zbatueshme.

Auditimi synon gjithashtu të identifikojë, nëse është e nevojshme, mangësitë dhe problematikat në proceset e raportimit financiar dhe në sistemet e kontrollit të brendshëm që mund të ndikojnë në saktësinë, plotësinë dhe besueshmërinë e informacionit financiar.

Nëpërmjet shprehjes së opinionit të auditimit, synohet të rritet shkalla e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare dhe të sigurohet një bazë e pavarur dhe objektive për vlerësimin e mënyrës se si janë administruar dhe raportuar fondet dhe burimet publike.

Në këtë kuadër, auditimi financiar shërben edhe si një mekanizëm për forcimin e transparencës, llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së nivelit drejtues të bashkisë në menaxhimin financiar dhe përdorimin e burimeve publike.

2. Identifikimi i çështjes: Identifikimi i çështjeve për auditim është orientuar nga vlerësimi i risqeve dhe përcaktimi i materialitetit, duke marrë në konsideratë natyrën, rëndësinë dhe ndikimin e mundshëm të transaksioneve dhe veprimtarive të subjektit në administrimin e burimeve publike. Qasja e auditimit është bazuar në gjykimin profesional të audituesve, përzgjedhjen e kampioneve dhe kryerjen e procedurave të auditimit në përputhje me kërkesat e kuadrit profesional dhe ligjor të zbatueshëm.

Në këtë kuadër, auditimi është fokusuar në vlerësimin e:

- saktësisë, plotësisë dhe rregullshmërisë së regjistrimit të transaksioneve financiare;
- mënyrës së administrimit dhe përdorimit të burimeve financiare dhe pasurore publike;
- funksionimit të kontrolleve të brendshme që lidhen me proceset financiare dhe raportimin financiar;
- besueshmërisë së informacionit të paraqitur në pasqyrat financiare;
- evidentimit dhe trajtimit në kohë të mangësive, parregullsive dhe rasteve të mosrespektimit të kërkesave ligjore.

Në vlerësimin e këtyre çështjeve është mbajtur në konsideratë edhe përgjegjësia e Bashkisë Korçë si njësi e vetëqeverisjes vendore për ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të saj në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe për ofrimin e shërbimeve publike në interes të komunitetit.

Nëpërmjet auditimit synohet jo vetëm evidentimi i problematikave të konstatuara gjatë periudhës së audituar, por edhe identifikimi i shkaqeve që kanë ndikuar në krijimin e tyre dhe dhënia e rekomandimeve konkrete për përmirësimin e proceseve, forcimin e kontrolleve të brendshme dhe rritjen e efektivitetit, transparencës dhe llogaridhënies në administrimin e fondeve publike.

Për përcaktimin e natyrës, kohës dhe shtrirjes së procedurave të auditimit është përdorur gjykimi profesional i audituesve, mbi bazën e vlerësimit të risqeve të anomalive materiale, të shkaktuara nga gabimi ose mashtrimi. Në varësi të rezultateve të vlerësimit të riskut, janë kryer teste të kontrolleve dhe procedura thelbësore, si dhe janë analizuar dhe klasifikuar devijimet e konstatuara.

Evidencat e mbledhura gjatë procesit të auditimit janë vlerësuar në drejtim të mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së tyre, me qëllim mbështetjen e konkluzioneve dhe opinionit të auditimit. Në bazë të procedurave të kryera dhe evidencave të administruara, audituesit kanë krijuar bazën e nevojshme për të arritur në përfundime të mbështetura dhe objektive mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare dhe raportimin financiar të Bashkisë Korçë.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese: Titullari i institucionit në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe Drejtori i Drejtorisë së Financës Buxhetit, Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, janë përgjegjës përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*", Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "*Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të tjera.

4. Përgjegjësitë e audituesve: Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Korçë në raport me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispoizcion të auditimit. Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë, Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre, si dhe Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit. Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si Përkatësia, Plotësia, Saktësia dhe vlerësimi, Periudha, Klasifikimi dhe kutueshmëria, Ligjshmëria dhe rregullsia, Ekzistenca, Të drejtat dhe detyrimet, Plotësia, Vlerësimi dhe alokimi, Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet. Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Korçë është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese. Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë. Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 "Parimet themelore të auditimit të sektorit publik", paragrafi 44-51.

5. Kriteret e vlerësimit: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Ligji nr. 154/2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*";
- *Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:* Ligji nr. 84/2022, datë 24.11.2022 "Për buxhetin e vitit 2025" dhe aktet normative që kanë ndryshuar këtë ligj; Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 "Për huamarrjen e qeverisjes vendore" , i ndryshuar; Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014

"Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" ndryshuar me Ligjin nr. 24/2015, datë 19.03.2015; VKM nr. 783 datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël"; Udhëzimi i MF nr. 35, datë 5.11.2008 "Për zbatimin e Ligjit nr. 9869, datë 04.02.2008 "Për huamarrjen e qeverisjes vendore"; Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm"; Udhëzimi MFE nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" , i ndryshuar; Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" , i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 5, datë 27.02.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura" ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014; Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 "Për përgatitjen e buxhetit vendor"; Udhëzimin plotësues të MF nr. 02, datë 10.01.2018 "Për buxhetin e vitit 2018", pikat 82-91 "Detyrimet e prapambetura të njësive të vetëqeverisjes vendore"; Udhëzimi plotësues i Ministrisë Financave nr. 01, datë 17.01.2019 "Për buxhetin e vitit 2019", pikat 106-110, "Detyrimet e prapambetura të njësive të vetëqeverisjes vendore", dhe pikat 116-117 "Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes vendore".

- Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare: VKM nr. 248, datë 10.4.1998 "Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësive që varen prej tyre" , i ndryshuar; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial" , i ndryshuar; Udhëzimi i MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar me Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 21.2.2022, etj.; Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 "Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial".

- Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH" , i ndryshuar; Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 "Për sistemin e taksave lokale" , i ndryshuar; Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, "Për taksat kombëtare" , i ndryshuar; VKM nr. 170, datë 25.4.2002 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre" , i ndryshuar; VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, "Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave" , i ndryshuar; Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, etj.

6- Standardet e auditimit. ISSAI 100 "Parimet themelore të auditimit të sektorit publik", i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 "Udhëzues të auditimit financiar"; ISSAI 2300 "Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare"; INTOSAI GOV 9100 "Udhëzues mbi standardet e kontrollit të brendshëm për sektorin publik" si dhe INTOSAI GOV 9110 "Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm". Standardet kombëtare të kontabilitetit; Standardet ndërkombëtare të auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC; Manuali i auditimit financiar dhe i përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i auditimit të brendshëm, etj. Standardet ndërkombëtare të auditimit mbi raportimin e audituesit të pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e udhërrëfyesit të IDI-t, etj.

7. Metoda e auditimit: Auditimi është kryer duke përdorur një qasje të bazuar në risk dhe në përzgjedhjen e periudhave dhe transaksioneve për t'u ekzaminuar**,** në përputhje me natyrën, objektivat dhe fushëveprimin e auditimit.

Qasja e auditimit të KLSH-së bazohet në identifikimin, vlerësimin dhe trajtimin e risqeve të auditimit, me qëllim që burimet e auditimit të orientohen drejt fushave dhe transaksioneve që paraqesin risk më të lartë ose kanë rëndësi materiale për objektivat e auditimit. Në këtë kuadër, përcaktimi i natyrës, kohës dhe shtrirjes së procedurave të auditimit është bërë mbi bazën e vlerësimit profesional të audituesve dhe të informacionit të administruar gjatë procesit të auditimit. Për qëllime të ekzaminimit, janë përzgjedhur me bazë risku dhe me zgjedhje kampione transaksione, dokumentacion dhe zëra të caktuar të shpenzimeve, duke synuar sigurimin e një baze të mjaftueshme dhe të përshtatshme provash auditimi për arritjen e konkluzioneve.

Vlerësimi i riskut dhe materialitetit[2]*:* Në përcaktimin e procedurave të auditimit është marrë në konsideratë rëndësia dhe ndjeshmëria e secilës zonë të llogarisë, si dhe risku që një devijim, gabim ose parregullsi mund të ndikojë në përfundimet e auditimit.

Materialiteti është përdorur si një nga elementet orientuese në planifikimin dhe kryerjen e procedurave të auditimit. Duke u bazuar në gjykimin profesional të audituesve, natyrën e zërave të audituar dhe rëndësinë e tyre, është përcaktuar një nivel materialiteti prej 2% për zonat e llogarisë të përfshira në auditim.

Materialiteti është konsideruar së bashku me nivelin e riskut, natyrën e transaksioneve dhe rëndësinë e tyre për objektivat e auditimit, me qëllim orientimin e procedurave drejt fushave ku mundësia dhe ndikimi i anomalive ose parregullsive vlerësoheshin më të rëndësishme.

Për mbledhjen, verifikimin dhe vlerësimin e evidencave të auditimit janë përdorur, sipas natyrës së çështjeve të audituara, procedurat dhe teknikat e mëposhtme:

1. Kontrolli aritmetik. Është verifikuar saktësia aritmetike e regjistrimeve dhe përllogaritjeve kontabël, duke kontrolluar mbledhjet, zbritjet, shumëzimet, mbartjet dhe hedhjet në llogaritë përkatëse.

Kjo procedurë ka synuar evidentimin e gabimeve të mundshme në përpunimin dhe regjistrimin e të dhënave financiare, deri në përfundimin e tyre në gjendjet dhe pasqyrimet sintetike. Në këtë kuadër janë kontrolluar, ndër të tjera, regjistrimet në ditarin e kontabilizimit të urdhër-shpenzimeve.

2. Kontrolli i dokumentacionit justifikues. Është kryer kontrolli me zgjedhje i dokumentacionit justifikues të transaksioneve, me qëllim vlerësimin nëse shpenzimet dhe regjistrimet kontabël ishin të mbështetura në dokumentacion të plotë, të rregullt dhe të përshtatshëm.

Kontrolli ka përfshirë, sipas rastit, urdhër-shpenzimet dhe dokumentacionin tjetër mbështetës, duke verifikuar lidhjen ndërmjet transaksionit të regjistruar dhe dokumenteve që e justifikojnë atë.

3. Inspektimi fizik dhe verifikimi i ekzistencës. Është kryer, sipas nevojës dhe natyrës së zërave të audituar, inspektimi fizik i aktiveve dhe verifikimi i gjendjeve ekzistuese, me qëllim vlerësimin e përputhshmërisë ndërmjet evidencave kontabël dhe gjendjes faktike.

4. Kontrolli i vlerësimit. Është verifikuar përshtatshmëria dhe saktësia e vlerave me të cilat aktivet dhe zërat e tjerë financiarë janë pasqyruar në evidencat dhe dokumentacionin kontabël. Kontrolli ka synuar të vlerësojë nëse vlerat e regjistruara dhe të raportuara janë përcaktuar në përputhje me kërkesat përkatëse dhe nëse pasqyrimi i tyre është i arsyeshëm në raport me gjendjen faktike dhe dokumentacionin mbështetës.

5. Konfirmimi nga palët e treta. Kur është konsideruar e nevojshme, është përdorur konfirmimi nga palët e treta për të verifikuar në mënyrë të pavarur informacionin e administruar nga subjekti.

6. Procedurat analitike dhe kontrolli sipas treguesve. Janë përdorur tregues dhe analiza të ndryshme për identifikimin e transaksioneve, regjistrimeve ose ndryshimeve që paraqesin

[2] **ISSAI 1320 (ISA 320)** trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.

karakteristika të pazakonta dhe që mund të jenë tregues të gabimeve, parregullsive apo dobësive në proceset financiare dhe kontabël.
Në këtë kuadër janë analizuar, ndër të tjera, raste të tilla si:
- mungesa ose paplotësia e dokumentacionit justifikues;
- mospërputhje në data, numra dhe referenca;
- korrigjime të shpeshta të regjistrimeve;
- mospërputhje ndërmjet dokumenteve dhe regjistrimeve kontabël;
- regjistrime ose shifra të pazakonta;
- raste të tjera që, në bazë të gjykimit profesional, kërkonin verifikim të mëtejshëm.

7. Verifikimi dhe kryqëzimi i informacionit. Për transaksionet dhe çështjet e përzgjedhura është kryer verifikimi i informacionit duke e krahasuar atë, kur ka qenë e mundur, me të dhëna ose dokumente të marra nga burime të ndryshme.

8. Intervistimi. Intervistat janë përdorur si procedurë për marrjen e informacionit nga personeli përgjegjës dhe personat kyç të subjektit, nëpërmjet pyetjeve të strukturuara dhe të orientuara drejt çështjeve objekt auditimi. Informacioni i marrë nëpërmjet intervistave është përdorur si evidencë plotësuese dhe, kur ka qenë e nevojshme, është verifikuar nëpërmjet dokumentacionit ose burimeve të tjera të informacionit.

9. Shqyrtimi i raporteve dhe informacioneve. Në funksion të objektivave të auditimit janë shqyrtuar raporte, analiza, evidenca, informacione financiare dhe administrative, si dhe dokumente të tjera të lidhura me çështjet objekt auditimi. Këto materiale janë përdorur për të kuptuar veprimtarinë e subjektit, për të identifikuar fushat me risk, për të mbështetur procedurat e kryera dhe për të formuar bazën e nevojshme për konkluzionet e auditimit.

8. Dokumentimi i auditimit: Dokumentimi i auditimit është kryer në përputhje me kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe standardet profesionale të auditimit, përfshirë ISSAI 1230 "Dokumentimi i Auditimit", duke synuar krijimin e një evidence të plotë, të qartë dhe të gjurmueshme të punës së kryer nga grupi i auditimit.
Dokumentacioni i auditimit përfshin evidencat dhe materialet e mbledhura gjatë procesit të auditimit, si dhe dokumentimin e procedurave të kryera, analizave të realizuara dhe vlerësimeve të bëra nga audituesit. Ky dokumentacion është hartuar në mënyrë të tillë që të mundësojë kuptimin e natyrës, kohës dhe shtrirjes së procedurave të auditimit**,** rezultateve të tyre dhe bazës mbi të cilën janë mbështetur konkluzionet e arritura.
Në dokumentimin e auditimit janë reflektuar rezultatet e procedurave të kryera, evidencat e administruara dhe çështjet e rëndësishme të identifikuara gjatë auditimit. Vlerësimi i këtyre evidencave është bërë mbi bazën e gjykimit dhe skepticizmit profesional të audituesve, duke synuar që përfundimet e auditimit të mbështeten në evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme.
Dokumentacioni i auditimit ka shërbyer si bazë për mbështetjen dhe justifikimin e konkluzioneve, gjetjeve dhe rekomandimeve të auditimit**,** si dhe si burim reference për hartimin e Projekt-Raportit dhe Raportit Përfundimtar të Auditimit. Në këtë mënyrë, dokumentimi siguron gjurmueshmërinë ndërmjet procedurave të kryera, evidencave të administruara, gjetjeve të identifikuara dhe përfundimeve të paraqitura në raport.
Pas përfundimit të punës audituese në terren dhe mbi bazën e evidencave të administruara, përfshirë të dhënat dhe konstatimet e pasqyruara në Akt-Konstatim, grupi i auditimit përgatiti Projekt-Raportin e Auditimit, i cili iu përcoll subjektit për vlerësim dhe paraqitjen e observacioneve, me shkresën nr. 735/3 prot., datë 04.08.2026**.** Brenda afatit 30-ditor të përcaktuar, subjekti Bashkia Korçë, me shkresën nr. 6776/16 prot., datë 02.09.2026, të protokolluar në KLSH me nr. 735/4 prot., datë 08.09.2026, përcolli kundërshtimet dhe observacionet e tij lidhur me Projekt-Raportin e Auditimit.

Grupi i auditimit shqyrtoi dhe analizoi me objektivitet, kujdes dhe paanshmëri kundërshtimet e paraqitura nga subjekti, duke i ballafaquar ato me evidencat e administruara, dokumentacionin e auditimit dhe kërkesat ligjore e rregullatore të zbatueshme. Në rastet kur kundërshtimet u mbështetën në evidenca të reja ose në argumente të vlerësuara si të bazuara, ato u morën në konsideratë në procesin e finalizimit të raportit.
Në përfundim të këtij procesi, grupi i auditimit hartoi Raportin Përfundimtar të Auditimit, në të cilin janë reflektuar rezultatet e auditimit, vlerësimi i kundërshtimeve të subjektit, konkluzionet e auditimit dhe rekomandimet përkatëse.
Raporti Përfundimtar i Auditimit i përcillet subjektit për zbatim të rekomandimeve dhe marrjen e masave për përmirësimin e veprimtarisë, me synim adresimin e mangësive dhe dobësive të evidentuara gjatë auditimit, forcimin e kontrolleve dhe përmirësimin e menaxhimit të fondeve dhe burimeve publike.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin "Bashkia Korçë":

Bashkia Korçë është njësi e qeverisjes vendore e nivelit të parë në Republikën e Shqipërisë dhe përbën një nga qendrat kryesore administrative, ekonomike, kulturore dhe turistike të juglindjes së vendit. Qendra administrative e Bashkisë është qyteti i Korçës.
Bashkia Korçë kufizohet në veri me Bashkinë Maliq, në lindje me Bashkinë Devoll, në perëndim me Bashkinë Skrapar dhe në jug me Bashkinë Kolonjë. Pas reformës administrativo-territoriale, territori i Bashkisë shtrihet në një sipërfaqe prej rreth 805.99 km², duke përfshirë qytetin e Korçës dhe një numër të konsiderueshëm njësish administrative dhe zonash rurale.
Shtrirja e gjerë territoriale dhe karakteristikat e ndryshme demografike, ekonomike dhe gjeografike të territorit përbëjnë një faktor të rëndësishëm në organizimin dhe administrimin e veprimtarisë së Bashkisë. Krahas qendrës urbane të Korçës, Bashkia administron edhe zona rurale dhe malore me karakteristika të ndryshme në drejtim të popullsisë, infrastrukturës, veprimtarisë ekonomike dhe aksesit në shërbimet publike.
Profili ekonomik dhe social. Ekonomia vendore karakterizohet nga një kombinim i veprimtarive të sektorit të shërbimeve, tregtisë, biznesit të vogël e të mesëm, bujqësisë, blegtorisë, përpunimit agro-ushqimor dhe aktiviteteve të lidhura me turizmin**.** Në zonat rurale një rëndësi të veçantë kanë bujqësia, pemëtaria dhe blegtoria, ndërsa në zonat me potencial turistik është zhvilluar turizmi rural, malor dhe kulturor. Potenciali turistik i territorit përbën një nga elementet që ndikon në zhvillimin ekonomik të zonës dhe në rritjen e kërkesës për infrastrukturë, shërbime publike dhe investime vendore**.**
Qyteti i Korçës përfaqëson qendrën kryesore urbane dhe ekonomike të territorit, me një aktivitet të konsiderueshëm tregtar, shërbimesh, kulturor dhe turistik. Ndërkohë, diferencat ndërmjet zonave urbane dhe atyre të thella rurale krijojnë nevoja të ndryshme për ndërhyrje publike, veçanërisht në fushat e infrastrukturës, transportit, arsimit, shërbimeve sociale, mirëmbajtjes së rrjetit rrugor dhe aksesit në shërbime.
Karakteristikat demografike dhe territoriale. Një ndër karakteristikat e territorit të Bashkisë është ndërthurja e zonave urbane me ato rurale dhe malore. Disa prej zonave më të thella, përfshirë Lekasin dhe Vithkuqin**,** përballen me problematika të lidhura me largimin e popullsisë, kushtet klimatike dhe aksesin në shërbime**.**
Lëvizjet demografike dhe përqendrimi i popullsisë në qendrën urbane kanë ndikuar në ndryshimin e kërkesës për shërbime publike. Në këtë kontekst, Bashkia përballet njëkohësisht me nevojën për të përballuar kërkesën në rritje për shërbime dhe infrastrukturë në zonat me përqendrim më të madh të popullsisë, si dhe me nevojën për garantimin e një niveli të përshtatshëm shërbimesh për komunitetet që jetojnë në zonat e largëta dhe me densitet të ulët të popullsisë.
Zhvillimi urban, infrastruktura dhe investimet. Bashkia Korçë ka realizuar dhe vijon të zhvillojë

një sërë investimesh dhe projektesh që synojnë përmirësimin e infrastrukturës publike, rigjallërimin urban, zhvillimin ekonomik dhe promovimin e turizmit.
Ndër projektet me rëndësi për qytetin është ndërhyrja në Pazarin e Korçës, e cila lidhet me ruajtjen dhe rivitalizimin e një prej elementeve me rëndësi të trashëgimisë kulturore dhe identitetit të qytetit, si dhe me përdorimin e tij si një nga pikat kryesore të zhvillimit turistik.
Në kuadër të zhvillimit urban janë ndërmarrë gjithashtu projekte që lidhen me rehabilitimin dhe rimodelimin e hapësirave publike, ndër të cilat përmenden Parku i qytetit, hapësira para teatrit dhe rruga "Gjon Buzuku"**.**
Investimet në infrastrukturë dhe hapësira publike përbëjnë një komponent të rëndësishëm të veprimtarisë së Bashkisë, duke kërkuar planifikim të përshtatshëm të burimeve, respektim të procedurave ligjore dhe rregullatore, si dhe monitorim të realizimit fizik dhe financiar të projekteve.
Veprimtaria dhe përgjegjësitë e Bashkisë. Në ushtrimin e funksioneve të saj, Bashkia Korçë përgjigjet për administrimin e një game të gjerë funksionesh dhe shërbimesh publike vendore, në përputhje me kompetencat e përcaktuara nga kuadri ligjor për vetëqeverisjen vendore**.**
Këto funksione lidhen, ndër të tjera, me administrimin e territorit dhe pronës publike, infrastrukturën dhe shërbimet publike vendore, menaxhimin e aseteve, zhvillimin ekonomik vendor, shërbimet sociale, arsimin parashkollor, kulturën, sportin, mbrojtjen e mjedisit dhe funksione të tjera të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. Për realizimin e këtyre funksioneve, Bashkia administron burime financiare dhe pasuri publike, çka kërkon një sistem efektiv të planifikimit, menaxhimit financiar, kontrollit të brendshëm, kontabilitetit, prokurimit, administrimit të aktiveve dhe raportimit.
Rëndësia e profilit të subjektit për auditimin. Karakteristikat territoriale, ekonomike dhe administrative të Bashkisë Korçë janë marrë në konsideratë gjatë planifikimit dhe zhvillimit të auditimit, pasi ato ndikojnë në profilin e riskut, kompleksitetin e veprimtarisë dhe mënyrën e administrimit të burimeve publike**.**
Në veçanti, shtrirja territoriale e Bashkisë, numri dhe larmia e shërbimeve të ofruara, niveli i investimeve publike, administrimi i aktiveve, realizimi i shpenzimeve, marrëdhëniet me operatorët ekonomikë dhe menaxhimi i projekteve publike përbëjnë fusha që kërkojnë vëmendje të veçantë nga këndvështrimi i auditimit.
Për këtë arsye, informacioni mbi profilin e subjektit është përdorur si pjesë e procesit të kuptimit të subjektit dhe mjedisit në të cilin ai ushtron veprimtarinë, në funksion të identifikimit dhe vlerësimit të risqeve të auditimit dhe përcaktimit të natyrës, kohës dhe shtrirjes së procedurave audituese.[3]

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.

2.1. Auditimi mbi kontrollin e brendshëm financiar publik, dhe auditi brendshëm.

2.1.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.

Në zbatim të nënpikës 1.1 të programit të auditimit: "Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK...", u audituа dokumentacioni si më poshtë:
1. Rregullorja e brendshme e miratuar;
2. Kod i brendshëm etik ose një kod sjellje, apo udhëzim për zbatimin e etikës;
3. Strukturën organike të institucionit me ndryshimet për vitet objekt auditimi dhe nëse ka pasur ndryshime në strukturë, a është reflektuar edhe në rregullore;

[3] **Burimi:** https://portavendore.al/bashkia-korce/

4. Shkresat e përcaktimit të NA në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", i ndryshuar;
5. Shkresat për krijimin e grupeve të Menaxhimit Strategjik;
6. Trajnimet e stafit si dhe planifikimet për trajnime të tyre;
7. Strategjinë dhe Regjistrin e Riskut;
8. Lista ose harta e proceseve të punës;
9. Raportet e Monitorimit;
10. Pyetësori i Vetëvlerësimit dhe a është dërguar në Ministrinë e Financave

Baza ligjore ku mbështetet auditimi mbi MFK është:

- ✓ Ligji nr.10296/2010 "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar
- ✓ "Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin" miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016;
- ✓ Ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"
- ✓ Ligji nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar
- ✓ Ligji nr.7961 /1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë' i ndryshuar,
- ✓ VKM nr.243/2015 "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive" i ndryshuar me VKM nr.746/2018
- ✓ Ligji nr.68/2017 "Për financat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore".
- ✓ Ligji "Për menaxhimin e sistemit buxhetor të RSH"
- ✓ Udhëzimi nr. 15 datë 20.07.2016
- ✓ Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

I. Komponenti "Mjedisi i Kontrollit".

Parimi nr. 1. "*Njësia publike demonstron angazhim për integritet dhe vlerat etike*"

Nga auditimi i kryer mbi funksionimin e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Bashkinë Korçë për vitin 2025, në kuadër të vlerësimit të komponentit "Mjedisi i Kontrollit", rezultoi se institucioni ka krijuar disa elementë formalë që lidhen me integritetin dhe sjelljen profesionale të punonjësve, të reflektuara kryesisht në Rregulloren e Brendshme të organizimit dhe funksionimit të administratës së Bashkisë Korçë, miratuar me Vendimin nr. 142, datë 01.03.2021, e ndryshuar me Urdhrin nr. 142/1, datë 11.07.2022, Urdhrin nr. 142/2, nr. 1791/2 prot., datë 06.09.2024 dhe Urdhrin nr. 142/3, nr. 1791/3 prot., datë 24.10.2024.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar rezultoi se Bashkia Korçë nuk ka hartuar dhe miratuar një Kod Etike institucional si dokument i veçantë, i cili të përcaktojë në mënyrë të unifikuar standardet e sjelljes, parimet e integritetit, përgjegjësitë individuale të punonjësve, mënyrën e identifikimit dhe trajtimit të konflikteve të interesit, si dhe mekanizmat e monitorimit të zbatimit të këtyre standardeve.

Pavarësisht faktit se në rregulloren e brendshme dhe në procedurat disiplinore janë përcaktuar disa detyrime të përgjithshme për punonjësit, këto dispozita nuk zëvendësojnë një dokument të posaçëm etik, pasi nuk krijojnë një kuadër të plotë dhe të formalizuar për menaxhimin e kulturës së integritetit në administratën publike. Mungesa e një dokumenti të tillë tregon dobësi në ndërtimin e mjedisit të kontrollit dhe nuk garanton që të gjithë punonjësit të kenë një referencë të qartë dhe të njëjtë mbi sjelljen e pritshme profesionale gjatë ushtrimit të funksioneve publike, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike", nenin 4 të Ligjit nr. 9131/2003, *ku përcaktohet se nëpunësi publik duhet të udhëhiqet nga interesi publik dhe parimet e etikës gjatë ushtrimit të funksionit*; Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 9, pika 1/1, shkronja "b", *sipas të cilit njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të garantojnë administrimin e veprimtarisë mbi bazën e ligjshmërisë, transparencës dhe përgjegjshmërisë*; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, *konkretisht kërkesat e komponentit "Mjedisi i Kontrollit".*

Parimi nr. 2: "*Titullari/Nëpunësi Autorizues (NA) Bordi apo Këshilli i drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje*":
Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet përgjegjshmëria e menaxherëve të nivelit të lartë për të ushtruar përgjegjësinë mbikëqyrëse mbi performancën e njësisë publike dhe implementimin e kërkesave kryesore për zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.
Është përcaktuar përgjegjësia menaxheriale e drejtuesve të të gjitha strukturave të bashkisë të cilët janë përgjegjës dhe raportojnë e i japin llogari, sipas shkallës hierarkike, eprorit direkt deri tek Kryetari ose tek nëpunësit të cilëve kryetari u ka deleguar përgjegjësinë, për: "Hartimin dhe monitorimin e planeve vjetore dhe periodike në përputhje me objektivat strategjike, afatmesme si dhe urdhrat dhe udhëzimet e Kryetarit, menaxhimin/administrimin e risqeve/problemeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë (nëpërmjet identifikimit, vlerësimit dhe kontrollit periodik të zbatimit të masave për zvogëlimin e risqeve).
Për periudhën vitin 2025, janë hartuar raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit për çdo 4-muaj, duke u paraqitur MF.
Titullari i institucionit merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga raportet periodike të njësive të menaxhmit dhe institucione të pavarura si KLSH, si dhe nëpërmjet raporteve të auditimit nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm.
Këshilli bashkiak me kompetencat e tij ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.
Parimi nr. 3. "*Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë*"
Nga auditimi i strukturës organizative të Bashkisë Korçë për vitin 2025, miratuar me shkresën nr. 281 prot., datë 14.01.2025 dhe ndryshuar me shkresën nr. 281/1 prot., datë 26.06.2025, rezultoi se ekzistojnë mospërputhje ndërmjet strukturës së miratuar dhe përcaktimeve të Rregullores së Brendshme të institucionit.
Konkretisht, në Rregulloren e Brendshme, Drejtoria e Kontrollit të Territorit parashikohet të përbëhet nga:
Sektori i Kontrollit Veterinar; Sektori i Kontrollit Jo Ushqimor dhe Licencimit; Sektori i Tregjeve dhe Zyra e Shërbimit të Parkimit me Pagesë. Ndërkohë, nga verifikimi i strukturës organizative të vitit 2025 rezultoi se Sektori i Kontrollit Veterinar nuk është më pjesë e strukturës së miratuar.
Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme Juridike dhe Burimeve Njerëzore nuk rezultoi të jetë ndërmarrë procedura për ndryshimin e Rregullores së Brendshme me qëllim harmonizimin e saj me strukturën aktuale organizative. Kjo situatë krijon një mospërputhje midis dokumenteve bazë të organizimit institucional dhe strukturës faktike, duke cenuar qartësinë mbi ndarjen e funksioneve, përgjegjësive dhe linjave të raportimit, veprime në kundërshtim me paragrafi 3.1 "Mjedisi i Kontrolli", Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Rregullores së brendshme miratuar me Vendimin nr. 142, datë 01.03.2021, dhe është ndryshuar/ka pasur shtesa me Urdhrin nr. 142/1 datë 11.07.2022, me Urdhrin nr. 142/2, nr. 1791/2 prot., datë 06.09.2024, dhe Urdhrin nr. 142/3, nr. 1791/3 prot., datë 24.10.2024, "Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Korçë", pika 60.1
Parimi nr. 4. "*Njësia publike demonstron angazhimin në realizimin e kompetencave*".
Nga auditimi i kryer mbi sistemin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Bashkinë Korçë rezultoi se institucioni ka krijuar strukturat përgjegjëse për administrimin e burimeve njerëzore dhe zbaton procedurat e rekrutimit në përputhje me kuadrin ligjor për shërbimin civil dhe marrëdhëniet e punës.

Bashkia Korçë ka hartuar procedura për rekrutimin, përzgjedhjen dhe administrimin e personelit, bazuar në: Ligjin nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; Ligjin nr. 7961/1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; VKM nr. 243/2015, i ndryshuar. Gjithashtu, rezultoi se Drejtoria e Burimeve Njerëzore administron proceset e punësimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore dhe institucioni ka hartuar Hartën e Proceseve të Punës së Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. Megjithatë, nga verifikimi i dokumentacionit dhe përgjigjet e strukturave përgjegjëse rezultoi se për vitin 2025 nuk është hartuar dhe miratuar një plan i brendshëm trajnimi, i cili të përfshijë zhvillimin profesional të punonjësve në fushat: Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli; menaxhimi i riskut; përgjegjshmëria menaxheriale; kontrolli i brendshëm; procedurat financiare dhe buxhetore.

Mungesa e programeve të trajnimit krijon risk që: punonjësit të mos jenë të përditësuar me ndryshimet ligjore;

të dobësohet zbatimi korrekt i procedurave financiare; të mos zhvillohen kapacitetet për identifikimin dhe menaxhimin e risqeve; të ulet efektiviteti i sistemit të kontrollit të brendshëm, veprime në kundërshtim me nenin 10 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, *ku përcaktohet përgjegjësia e drejtuesit të njësisë publike për krijimin e një sistemi efektiv kontrolli të brendshëm dhe garantimin e kompetencës profesionale të punonjësve*; nenin 22 të Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, *lidhur me zhvillimin profesional dhe trajnimin e vazhdueshëm të nëpunësve civilë*, dhe VKM nr. 142, datë 12.03.2014 "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në administratën publike", *lidhur me kërkesat profesionale të pozicioneve të punës*.

Mangësi në administrimin e dosjeve të personelit

Nga verifikimi me zgjedhje i dosjeve personale të punonjësve të Bashkisë Korçë rezultoi se në disa raste dokumentacioni i administruar nuk ishte i plotë.

Konkretisht:

Në dosjen personale të zj. V. C. mungonte certifikata personale.
Në dosjen personale të zj. M. J. mungonte certifikata personale.
Në dosjen personale të zj. A.R. mungonte certifikata personale.
Në dosjen personale të zj. N. D. mungonte certifikata personale.
Në dosjen personale të z. D. A. mungonte certifikata personale.
Në dosjen personale të zj. Gj. P. mungonte certifikata personale.
Në dosjen personale të M.B. mungonte certifikata personale.

Ndërkohë, nga verifikimi i dosjeve të tjera, konkretisht të zj. A. T., z. D. H. dhe zj. I. C., rezultoi se dokumentacioni ishte i plotë dhe në përputhje me kërkesat ligjore.

Mangësitë e evidentuara tregojnë mungesë uniformiteti në administrimin dhe kontrollin periodik të dosjeve të personelit, në kundërshtim me: VKM nr. 833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit të Regjistrit Qendror të Personelit", Kreu II, pika 3 dhe lidhja nr. 2, *ku përcaktohet dokumentacioni që duhet të përmbajë dosja personale e nëpunësit*; VKM nr. 124, datë 17.02.2016 "Për pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil", ndryshuar me VKM nr. 747, datë 19.12.2018, Kreu III, pika 23, *lidhur me administrimin dhe plotësinë e dokumentacionit të personelit*; Ligjin nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, *lidhur me detyrimin e administrimit korrekt të të dhënave të nëpunësve civilë.*

Parimi nr. 5. "*Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale*"

Nga auditimi rezultoi se Bashkia Korçë ka marrë masa për krijimin e strukturave menaxheriale përgjegjëse për koordinimin dhe monitorimin e veprimtarisë institucionale. Me Urdhrin nr. 545 prot., datë 21.01.2025, Kryetari i Bashkisë Korçë ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS), me përbërje nga drejtuesit kryesorë të institucionit. Gjithashtu janë ngritur Ekipet e

Menaxhimit të Programeve (EMP), të cilat kanë përgjegjësi për planifikimin, realizimin dhe monitorimin e programeve buxhetore.
Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se takimet e GMS janë dokumentuar nëpërmjet procesverbaleve përkatëse. Megjithatë rezultoi se institucioni nuk disponon një procedurë të shkruar që përcakton: frekuencën minimale të raportimeve; formatin standard të raportimit; përgjegjësitë individuale të raportuesve; afatet e dorëzimit dhe shqyrtimit të raporteve. Raportimet kryhen kryesisht mbi bazën e praktikës së krijuar dhe udhëzimeve të përgjithshme të Ministrisë së Financave.
Sa sipër në kundërshtim me Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, neni 8, neni 16.

II. Komponenti "Menaxhimi i Riskut".

Parimi nr. 6. "*Njësia publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me realizimin e tyre*"
Nga auditimi i dokumentacionit të administruar për menaxhimin e riskut në Bashkinë Korçë rezultoi se institucioni ka ndërmarrë hapa për ngritjen dhe funksionimin e procesit të menaxhimit të riskut.
Me shkresën nr. 2468 prot., datë 11.03.2025, Kryetari i Bashkisë Korçë ka caktuar koordinatorin e riskut për institucionin, duke ngarkuar me këtë përgjegjësi *K.K.*.
Gjithashtu, strukturat e bashkisë kanë hartuar dokumente të lidhura me identifikimin dhe administrimin e risqeve, ku përfshihen objektivat, aktivitetet kryesore, faktorët e riskut dhe masat e propozuara për reduktimin e tyre. Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se Regjistri i Riskut i hartuar nga Drejtoria e Financës nuk është protokolluar në sistemin zyrtar të administrimit të dokumentacionit të institucionit.
Mos protokollimi i këtij dokumenti krijon mungesë të gjurmueshmërisë administrative dhe nuk garanton që dokumenti bazë i procesit të menaxhimit të riskut të jetë pjesë e dokumentacionit zyrtar të institucionit.
Sa sipër në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, Nenin 19, pika 1, të Normave Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, *ku përcaktohet detyrimi për regjistrimin dhe administrimin e dokumenteve zyrtare që krijohen dhe administrohen nga institucionet publike*.
Parimi nr. 7. "*Njësia publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave*"
Nga auditimi rezultoi se Bashkia Korçë ka miratuar Strategjinë e Menaxhimit të Riskut për një periudhë trevjeçare. Me shkresën nr. 736 prot., datë 25.01.2024, Kryetari i Bashkisë ka urdhëruar njohjen e strukturave të institucionit me Strategjinë e Menaxhimit të Riskut dhe zbatimin e saj. Gjithashtu, rezultoi se çdo drejtori ka hartuar plane vjetore operative ku janë përcaktuar aktivitetet, afatet dhe objektivat përkatëse.
Megjithatë, nga analiza e dokumentacionit rezultoi se mungon një lidhje e plotë dhe e dokumentuar ndërmjet: objektivave strategjikë të institucionit; objektivave të programeve buxhetore; risqeve kryesore që mund të pengojnë realizimin e tyre; masave konkrete të trajtimit të riskut. Procesi i menaxhimit të riskut është trajtuar kryesisht në nivel operacional, ndërkohë që kërkohet një qasje e integruar institucionale.
Sa sipër në kundërshtim me Ligjit nr. 10296/2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, neni 10, neni 16; Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", *lidhur me planifikimin, monitorimin dhe lidhjen e objektivave të politikave me procesin buxhetor.*

III. Komponenti "Aktivitetet e Kontrollit".

Parimi nr. 10. "*Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit*"
Nga auditimi i proceseve financiare të Bashkisë Korçë rezultoi se institucioni kryen kontrolle të ndryshme gjatë ciklit të shpenzimeve publike. Konkretisht: urdhër-shpenzimet kontrollohen dhe

nënshkruhen nga Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues; kontrolli i dokumentacionit financiar kryhet përpara regjistrimit të shpenzimeve; transaksionet financiare regjistrohen nga strukturat përkatëse financiare; pagesat autorizohen nga personat kompetentë.
Megjithatë, rezultoi se Kryetari i Bashkisë Korçë nuk ka miratuar një procedurë të veçantë për gjurmën e auditimit, e cila të përcaktojë rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare nga fillimi deri në përfundim të tyre. Nuk rezultoi të jetë miratuar dokumentacion që përcakton: fazat e procesit; personat përgjegjës; kontrollet e kryera; dokumentet shoqëruese; mënyrën e ruajtjes së evidencave.
Sa sipër në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, neni 16, pika 2.

Parimi nr. 11. "*Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit të përgjithshëm të teknologjisë së informacionit*"

Nga auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit në Bashkinë Korçë rezultoi se institucioni disponon disa sisteme informatike të dedikuara për administrimin e proceseve të caktuara, konkretisht: sistemin informatik për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore; Sistemin e Menaxhimit të Buxhetit Vendor (SMBV); infrastrukturën serverike për ruajtjen e të dhënave; sisteme rezervë (backup) për rikuperimin e informacionit.
Nga verifikimi i masave të sigurisë së informacionit rezultoi se institucioni ka marrë masa për: ruajtjen e të dhënave në server; përdorimin e kopjeve rezervë; menaxhimin e aksesit të përdoruesve nëpërmjet kredencialeve personale; ndryshimin periodik të fjalëkalimeve; filtrimin e trafikut nëpërmjet pajisjeve të sigurisë së rrjetit.
Megjithatë, u konstatua se një pjesë e strukturave të administratës, për proceset e administrimit dhe përpunimit të të dhënave, përdorin kryesisht programe bazike si word dhe Excel, pa përdorimin e aplikacioneve të dedikuara për menaxhimin e proceseve administrative. Përdorimi i këtyre mjeteve, pa kontrolle të automatizuara dhe pa mekanizma të avancuar gjurmueshmërie, krijon risk për: ndryshime të paautorizuara të informacionit; humbje ose dëmtim të të dhënave; mungesë gjurmueshmërie mbi personat që kanë kryer ndryshime; dobësi në kontrollin e informacionit operacional dhe financiar.
Sa sipër në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, nenin 16; Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, komponenti "Aktivitetet e Kontrollit", ku kërkohet që kontrollet teknologjike të sigurojnë integritetin, konfidencialitetin dhe disponueshmërinë e informacionit.

Parimi nr. 12. "*Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave*"

Nga auditimi i procedurave financiare të Bashkisë Korçë rezultoi se institucioni zbaton kontrolle gjatë procesit të realizimit të shpenzimeve publike. Konkretisht: dokumentacioni financiar kontrollohet përpara regjistrimit kontabël; urdhër-shpenzimet nënshkruhen nga Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues; kryhen rakordime mujore të llogarive financiare; realizohet kontrolli i angazhimeve financiare; kryhen kontrolle mbi fondet në dispozicion në bashkëpunim me Degën e Thesarit.
Megjithatë rezultoi se jo të gjitha procedurat e kontrollit janë të formalizuara në dokumente të brendshme të miratuara. Në veçanti, nuk rezultoi të ekzistojnë procedura të plota të shkruara për: ndarjen e përgjegjësive në çdo fazë të procesit financiar; mënyrën e dokumentimit të kontrolleve; afatet dhe përgjegjësitë për kryerjen e rakordimeve; trajtimin e rasteve të devijimeve apo gabimeve të konstatuara.
Sa sipër në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, neni 8 dhe neni 16, si dhe Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, lidhur me saktësinë dhe kontrollin e informacionit financiar. Mungesa e procedurave të plota krijon risk për: zbatim jo uniform të kontrolleve; varësi nga njohuritë

individuale të punonjësve; vështirësi në kontrollin pasues; dobësim të sistemit të kontrollit të brendshëm.

IV. Komponenti "Informimi dhe komunikimi".

Parimi nr. 13. "*Njësia publike përdor informacionin e përshtatshëm dhe cilësor për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm*".

Nga auditimi i procesit të informimit dhe komunikimit institucional rezultoi se Bashkia Korçë ka krijuar mekanizma për publikimin dhe shpërndarjen e informacionit institucional nëpërmjet faqes zyrtare elektronike dhe kanaleve të tjera të komunikimit.

Në faqen zyrtare të Bashkisë Korçë publikohen informacione që lidhen me: strukturën organizative; rregulloren e brendshme; vendimet e Këshillit Bashkiak; projektbuxhetin dhe dokumentet buxhetore; raportet e performancës; aktivitetet institucionale; procedurat e konsultimit publik; informacionet ekonomiko-financiare. Gjithashtu, rezultoi se drejtuesit e programeve buxhetore kanë akses në informacionet lidhur me: miratimin e buxhetit; ndryshimet dhe rialokimet buxhetore; realizimin faktik të shpenzimeve.

Megjithatë, nga verifikimi i informacionit të publikuar rezultoi se disa të dhëna nuk ishin përditësuar në përputhje me ndryshimet faktike të institucionit. Konkretisht, nuk rezultoi i përditësuar informacioni lidhur me ndryshimet në strukturën organizative të institucionit; paketat fiskale të periudhave përkatëse.

Kjo situatë tregon mangësi në procesin e monitorimit të informacionit që publikohet për publikun dhe nuk garanton që informacioni i publikuar të jetë në çdo rast aktual, i saktë dhe i plotë.

Sa sipër në kundërshtim me: Ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", neni 7, Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ku përcaktohen parimet e transparencës dhe llogaridhënies së njësive të vetëqeverisjes vendore; Ligjin nr. 10296/2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", *komponenti "Informimi dhe Komunikimi", ku kërkohet që informacioni i përdorur nga njësia publike të jetë i përshtatshëm, i besueshëm dhe në kohë*.

Parimi nr. 14. "*Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm*".

Nga auditimi rezultoi se Bashkia Korçë ka krijuar kanale komunikimi të brendshëm nëpërmjet: postës elektronike zyrtare; shkresave administrative; komunikimeve ndërmjet strukturave; raporteve financiare dhe operative. Punonjësit kanë mundësi përdorimi të adresave elektronike zyrtare dhe strukturat raportojnë te nivelet përkatëse drejtuese. Gjithashtu, drejtuesit informohen mbi realizimin e buxhetit dhe nivelin e shpenzimeve sipas programeve buxhetore.

Megjithatë, rezultoi se institucioni nuk ka një procedurë të shkruar dhe të miratuar që përcakton: mënyrën standarde të komunikimit të brendshëm; periodicitetin e raportimeve; përgjegjësitë për transmetimin dhe analizimin e informacionit; afatet e raportimit.

Komunikimi realizohet kryesisht mbi bazën e praktikës së krijuar dhe udhëzimeve administrative. Mungesa e procedurave të formalizuara krijon risk për: komunikim jo uniform; vonesa në transmetimin e informacionit; mosidentifikim në kohë të problematikave; dobësim të kontrollit menaxherial.

Parimi nr. 15: "*Njësia Publike përdor komunikimin e jashtëm*":

Sipas këtij parimi, njësia publike komunikon me palët e jashtme lidhur me çështjet që ndikojnë në funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Bashkia Korçë realizon konsultime publike me banorët sipas kalendarit të konsultimeve, i cili është publik ne faqen e Bashkisë, si "Buxhetimi me Pjesëmarrje". Në të diskutohen projektbuxheti dhe Paketa Fiskale, konsultime me përfaqësues të biznesit, organizata jo qeveritare, apo grupe te interesit. Kjo sjell përmirësimin e strategjisë se komunikimit dhe përfitimin e një feedbacku të qartë ne lidhje me kërkesat e komunitetit. Gjithashtu bashkia realizon sondazhe online të cilat mund të plotësohen lehtësisht nga qytetarët me qëllim marrjen e opinioneve dhe reagimeve të tyre. Informacioni i marrë ndihmon të përputhen nevojat njerëzore me burimet publike, duke reflektuar prioritetet reale të banorëve.

Në faqen zyrtare të web-it ëëë.bashkiakorce.gov.al, rubrika "Transparenca" gjenden të publikuara të gjitha informacionet e përmendura si pjesë e kategorisë "Transparenca dhe llogaridhënia ekonomiko-financiare". Ky informacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe i përditësuar.

V. Komponenti "Monitorimi dhe Raportimi".

Parimi nr. 16. "*Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme*".

Nga auditimi rezultoi se Bashkia Korçë kryen disa forma monitorimi të veprimtarisë së saj institucionale.

Konkretisht: drejtuesit e strukturave hartojnë raporte periodike; realizohet monitorimi katërmujor i zbatimit të buxhetit; hartohen raporte monitorimi dhe dërgohen pranë Ministrisë së Financave; realizohet procesi i vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm; hartohet deklarata mbi cilësinë e kontrollit të brendshëm.

Gjithashtu, njësia e auditimit të brendshëm funksionon mbi bazën e planit vjetor dhe strategjik të miratuar.

Megjithatë rezultoi se mungon një procedurë e brendshme e miratuar që përcakton: metodologjinë e monitorimit; periodicitetin e vlerësimeve; përgjegjësitë e strukturave; mënyrën e ndjekjes së masave korrigjuese. Procesi i monitorimit realizohet kryesisht mbi bazën e kërkesave të përgjithshme të Ministrisë së Financave dhe praktikës së institucionit.

Sa sipër në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", neni 18.

Parimi nr. 17. *"Njësia publike kryen vlerësime të vazhdueshme dhe/ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm"*

Nga auditimi rezultoi se drejtuesit e niveleve të ndryshme raportojnë mbi aktivitetin e strukturave të tyre nëpërmjet: raporteve mujore; raporteve katër mujore; komunikimeve operative. Gjithashtu, janë evidentuar raportime në lidhje me zbatimin e buxhetit dhe realizimin e objektivave.

Megjithatë, institucioni nuk ka një procedurë të shkruar që përcakton qartë: formatin standard të raportimit; periodicitetin e detyrueshëm; indikatorët që duhet të raportohen; mënyrën e analizimit të devijimeve.

Parimi nr. 18. "*Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë*"

Nga dokumentacioni i administruar rezultoi se Bashkia Korçë ka kryer procesin e vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe ka raportuar pranë Ministrisë së Financave për cilësinë e sistemit MFK.

Raporti i cilësisë së sistemeve të kontrollit të brendshëm përmban disa problematika të identifikuara në komponentët e MFK.

Megjithatë, nga krahasimi i këtij raporti me gjetjet e evidentuara gjatë auditimit rezultoi se disa problematika të identifikuara nuk janë shoqëruar me: plane konkrete korrigjuese; afate zbatimi; persona përgjegjës; monitorim të realizimit të masave.

Mos ndjekja sistematike e masave korrigjuese krijon risk që: mangësitë të përsëriten nga një vit në tjetrin;

sistemi i kontrollit të brendshëm të mos përmirësohet; burimet institucionale të mos orientohen drejt fushave me risk më të lartë.

Konstatimi: Nga vlerësimi i pesë komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Bashkinë Korçë për vitin 2025 rezulton se institucioni ka ngritur strukturat bazë dhe zbaton pjesërisht kërkesat e kuadrit ligjor për kontrollin e brendshëm.

Megjithatë, sistemi paraqet mangësi që lidhen kryesisht me: mungesën e dokumenteve të plota rregulluese;

dobësi në formalizmin e procedurave; mungesën e planifikimit strategjik; mangësi në zhvillimin profesional të stafit; dobësi në dokumentimin e gjurmës së auditimit; nevojën për forcimin e kontrolleve teknologjike;

nevojën për përmirësimin e monitorimit të masave korrigjuese.

Këto mangësi nuk tregojnë mungesë totale të sistemit të kontrollit të brendshëm, por evidentojnë fusha ku kërkohet ndërhyrje menaxheriale për të garantuar një sistem më efektiv, të dokumentuar dhe të orientuar drejt menaxhimit të riskut dhe arritjes së objektivave institucionale.
Për sa trajtuar mësipër mbajnë përgjegjësi: *K.K., Nënkryetar i Bashkisë Korçë, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues të deleguar; V.Z., Drejtore e Drejtorisë së Financës, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar e Kontrollit, për mos garantimin e protokollimit dhe administrimit të dokumentacionit të procesit të menaxhimit të riskut; M.B., specialiste e Burimeve Njerëzore, për mos garantimin e plotësimit dhe kontrollit të dokumentacionit të dosjeve personale; A.D., Drejtore e Përgjithshme e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore, për mos planifikimin dhe mos zhvillimin e programeve të trajnimit profesional për punonjësit e institucionit dhe mos ndjekjen e procedurave për përditësimin dhe harmonizimin e dokumenteve organizative të institucionit dhe nënkryetari i Bashkisë Korçë.*
(Në fazën e Projekt raport auditimit, nga subjekti Bashkia Korçë për këtë pikë nuk u paraqitën kundërshti)

2.1.2. Organizimi dhe vlerësimi mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.

Në zbatim të pikës 1.2 të programit të auditimit, u vlerësua organizimi, funksionimi dhe veprimtaria e Njësisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB) të Bashkisë Korçë, me qëllim evidentimin e shkallës së përmbushjes së kërkesave ligjore dhe metodologjike, si dhe të efektivitetit të funksionit të auditimit të brendshëm në mbështetje të sistemit të kontrollit të brendshëm.
Për këtë qëllim u shqyrtua dokumentacioni që lidhet me:

- Kartën e Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Korçë;
- Planin Strategjik dhe Planet Vjetore të Auditimit, së bashku me pasqyrat shoqëruese;
- Planin e auditimeve të brendshme për vitin 2025;
- Raportimin vjetor pranë strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm;
- Dosjet e përhershme dhe dokumentacionin e subjekteve të audituara;
- Projekt-raportet dhe raportet përfundimtare të auditimit;
- Dokumentacionin lidhur me strukturën, rekrutimin, certifikimin dhe trajnimin e punonjësve të NJAB.

Kriteret e vlerësimit
Vlerësimi u krye në referim të:

- Ligjit nr. 114/2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik";
- Urdhrit nr. 4, datë 10.01.2020, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, "Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016";
- VKM nr. 83, datë 03.02.2016, "Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik";
- kërkesave përkatëse të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm, për aq sa janë të aplikueshme.

Në Bashkinë Korçë është krijuar Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB), e organizuar në nivel sektori, në përputhje me kriteret e përcaktuara për krijimin dhe organizimin e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik.
Për vitin 2025, struktura e NJAB ka qenë e përbërë nga një drejtues dhe tre auditues të brendshëm. Punonjësit kanë formim universitar kryesisht në fushat e ekonomisë, financës, kontabilitetit dhe auditimit, si dhe eksperiencë të ndryshme profesionale në funksionin e auditimit.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se drejtuesi i NJAB është i certifikuar si auditues i brendshëm dhe ka përmbushur detyrimet për trajnimin e vazhdueshëm profesional. Një nga

audituesit është në proces të konsolidimit profesional dhe, në periudhën e auditimit, nuk rezulton ende i certifikuar sipas kërkesave përkatëse.
Gjatë vitit 2025, një audites i brendshëm ka përfunduar marrëdhënien e punës për shkak të daljes në pension. Ky fakt ka ndikuar në kapacitetet njerëzore të NJAB dhe ka sjellë rritje të ngarkesës së audituesve të mbetur.

Nr.	Punonjësi	Funksioni	Arsimi	Vjetërsi në punë	Vjetërsi në auditim	Certifikimi	Trajnimi i vazhdueshëm
1	A.T.	Drejtues	Ekonomi/Financë	38 vjet	24 vjet	Nr. 32/2005-2006	42 orë
2	E.H.	Audites	Ekonomi	38.25 vjet	10 vjet	Nr. 1888/2016-2017	Pension, mars 2025
3	B.K.	Audites	Ekonomi, Financë, Kontabilitet	17.5 vjet	4.5 vjet	Nr. 2073/2022-2023	40 orë
4	A.R.	Audites	Kontabilitet & Audit	5 vjet	1 vit	-	-

Burimi: Dokumentacioni i Bashkisë Korçë.

Nga analiza e veprimtarisë së NJAB rezultoi se gjatë periudhës janar-dhjetor 2025 janë realizuar gjithsej 6 angazhime auditimi, të cilat kanë përfshirë auditime të përputhshmërisë dhe auditime financiare në struktura të ndryshme të Bashkisë Korçë.
Plani vjetor i auditimit ka pësuar ndryshime gjatë vitit, të cilat janë reflektuar dhe raportuar pranë strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, në përputhje me kërkesat metodologjike.
Gjithashtu, nga dokumentacioni i administruar rezultoi se Plani Strategjik 2025-2027 dhe Plani Vjetor i Auditimit për vitin 2025 janë miratuar dhe përcjellë pranë strukturës së harmonizimit brenda afateve të përcaktuara. Raportimi vjetor mbi veprimtarinë e auditimit të brendshëm është kryer gjatë vitit 2026.
Sipas të dhënave të raportuara nga NJAB, gjatë vitit 2025 janë realizuar 6 auditime, nga të cilat 2 auditime të përputhshmërisë dhe 4 auditime financiare.
Nga auditimet e kryera janë dhënë gjithsej 73 rekomandime. Prej tyre, 46 rekomandime, ose rreth 63%, rezultojnë të zbatuara; 17 janë në proces zbatimi, ndërsa 10 rekomandime rezultojnë të pazbatuara.
Në vlerësimin e grupit të auditimit, niveli i zbatimit të rekomandimeve është një tregues i rëndësishëm i efektivitetit të funksionit të auditimit të brendshëm. Megjithatë, numri i rekomandimeve të pazbatuara dhe atyre në proces tregon nevojën për forcimin e mekanizmave të monitorimit dhe ndjekjes së zbatimit të tyre, në mënyrë që problematikat e evidentuara nga auditimet të mos përsëriten dhe dobësitë e konstatuara të adresohen në mënyrë efektive. Nga ana tjetër, nuk janë evidentuar rekomandime të shprehura në vlerë monetare për shpërblim dëmi

Periudha	Rekomandime gjithsej	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar
Viti 2025	73	46	17	10

Burimi: Dokumentacioni i Bashkisë Korçë

Nga auditimi rezultoi se Bashkia Korçë nuk ka krijuar Komitetin e Auditimit.
Mungesa e këtij organi dobëson mekanizmin e mbikëqyrjes dhe të qeverisjes së funksionit të auditimit të brendshëm, pasi Komiteti i Auditimit ka rol në mbështetjen e pavarësisë së auditimit të brendshëm, shqyrtimin e çështjeve që lidhen me veprimtarinë e auditimit, ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve dhe forcimin e sistemit të kontrollit të brendshë, veprime në kundërshtim me kërkesat e nenit 12, pika “b” dhe nenit 14 të Ligjit nr. 114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, lidhur me krijimin dhe funksionet e Komitetit të Auditimit.

Gjithashtu, lidhet me kërkesat e Standardit Ndërkombëtar të Auditimit të Brendshëm 1110 – *Organizational Independence*, sipas të cilit pavarësia organizative e funksionit të auditimit të brendshëm duhet të mbështetet nga një strukturë efektive mbikëqyrëse.
Mungesa e Komitetit të Auditimit kufizon mekanizmat e mbikëqyrjes së pavarur të funksionit të auditimit të brendshëm dhe dobëson strukturën e qeverisjes dhe të kontrollit të brendshëm të Bashkisë.
Përgjegjësia: Kryetari i Bashkisë Korçë, S.F..
Planifikimi i auditimeve nuk mbështetet plotësisht në vlerësimin e riskut. Nga shqyrtimi i Planit Strategjik dhe Planit Vjetor të Auditimit rezultoi se, megjithëse këto dokumente janë hartuar sipas kërkesave metodologjike të Manualit të Auditimit të Brendshëm, planifikimi nuk ka adresuar në mënyrë të plotë fushat me risk të lartë. Konkretisht, në planifikimin e auditimeve nuk janë përfshirë për auditim Drejtoria Juridike dhe aktiviteti i prokurimeve publike, megjithëse këto procese paraqesin ekspozim të rëndësishëm ndaj riskut financiar, ligjor dhe operacional. Mos adresimi i këtyre fushave në planin e auditimit kufizon aftësinë e NJAB për të dhënë siguri të arsyeshme mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme në proceset me ekspozimin më të lartë ndaj parregullsive, keqmenaxhimit dhe përdorimit joefektiv të fondeve publike, veprime në kundërshtim me pikën 3.1.3 të Manualit të Auditimit të Brendshëm, sipas së cilës sistemet me risk të lartë duhet të përfshihen në procesin e planifikimit dhe të auditohen në përputhje me nivelin e tyre të riskut, si dhe me nenin 13 të Ligjit nr. 114/2015, lidhur me bazimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm në vlerësimin e riskut, dhe Standardi 2010 – *Planning* kërkon që plani i auditimit të mbështetet në një vlerësim të dokumentuar të riskut.
Mosfokusimi i mjaftueshëm i burimeve të auditimit në fushat me risk të lartë mund të sjellë mosidentifikimin në kohë të dobësive të kontrollit të brendshëm dhe të ekspozojë Bashkinë ndaj risqeve financiare, ligjore dhe operacionale.
Përgjegjësia: Drejtori i NJAB, A.T.
***Mosadministrimi dhe mosarkivimi i dosjeve të auditimit sipas kërkesave arkivore*.** Nga verifikimi i dosjeve të auditimit rezultoi se ato janë ndërtuar përgjithësisht sipas strukturës së përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm dhe përmbajnë dokumentacionin bazë të nevojshëm për realizimin e angazhimeve.
Megjithatë, pas përfundimit të auditimeve, dosjet nuk përcillen dhe nuk arkivohen pranë arkivit të Bashkisë, por vijojnë të mbahen në ambientet e NJAB. Kjo praktikë krijon risk për administrimin, ruajtjen dhe gjurmueshmërinë e dokumentacionit zyrtar, si dhe për respektimin e kërkesave lidhur me ruajtjen dhe administrimin e dokumentacionit për periudhat e përcaktuara ligjërisht, veprime në kundërshtim me nenin 22 të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për arkivat", si dhe nenin 19, pika 1, të Normave Teknike-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, miratuar me VKM nr. 99, datë 23.02.2011.
Mos arkivimi sipas procedurave përkatëse rrit riskun e humbjes, dëmtimit ose mos gjurmueshmërisë së dokumentacionit të auditimit dhe cenon administrimin e rregullt të dokumentacionit zyrtar.
Përgjegjësia: Drejtori i NJAB, A.T..
***Moskrijimi i dosjeve të përhershme të subjekteve të audituesh*me.** Nga auditimi rezultoi se NJAB nuk ka krijuar dosje të përhershme, në formë manuale dhe elektronike, për subjektet/njësitë e audituesh*me.
Dosja e përhershme është një element i rëndësishëm i dokumentimit të procesit të auditimit, pasi duhet të përmbajë informacion me rëndësi të qëndrueshme për subjektin, si struktura organizative, baza ligjore, sistemet e kontrollit të brendshëm, proceset kryesore, rezultatet e auditimeve të mëparshme dhe informacionin përkatës të riskut. Mungesa e këtyre dosjeve kufizon përdorimin e informacionit të akumuluar nga auditimet e mëparshme dhe ndikon në cilësinë dhe efikasitetin e planifikimit të auditimeve të ardhshme, në kundërshtim me pikën 6.3 të Manualit të Auditimit të

Brendshëm dhe kërkesat e Standardit 2330 – *Documenting Information*, lidhur me dokumentimin, organizimin dhe ruajtjen e informacionit të nevojshëm për mbështetjen e punës së auditimit.
Mungesa e dosjeve të përhershme dobëson memorien institucionale të NJAB, kufizon analizën historike të problematikave dhe e bën më pak efektiv planifikimin e auditimeve mbi bazë risku.
Përgjegjësia: Drejtori i NJAB, A.T.
Raportet e auditimit. Nga shqyrtimi i dosjeve të auditimit rezultoi se raportet e auditimit janë hartuar në përputhje me strukturën dhe kërkesat e përcaktuara në Manualin e Auditimit të Brendshëm. Në këtë drejtim, nuk u evidentuan mangësi të rëndësishme që kërkojnë trajtim në formën e një gjetjeje të veçantë.
Konkluzioni: Nga auditimi rezultoi se NJAB e Bashkisë Korçë ka ngritur dhe ka zhvilluar funksionin e auditimit të brendshëm dhe, gjatë vitit 2025, ka realizuar aktivitetin e planifikuar dhe ka përmbushur detyrimet kryesore lidhur me hartimin e dokumenteve strategjike dhe vjetore, kryerjen e angazhimeve të auditimit dhe raportimin pranë strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm.
Megjithatë, funksionimi i NJAB paraqet disa dobësi që ndikojnë në efektivitetin e këtij funksioni. Dobësitë kryesore lidhen me mosngritjen e Komitetit të Auditimit, planifikimin jo të plotë mbi bazë risku, mos arkivimin e dosjeve të auditimit sipas kërkesave arkivore dhe mungesën e dosjeve të përhershme për subjektet e audituesshme.
Në veçanti, mosfutja në planifikimin e auditimeve e disa proceseve me risk të lartë, si prokurimet publike dhe funksioni juridik, ul nivelin e sigurisë që NJAB mund t'i japë titullarit lidhur me funksionimin e kontrolleve të brendshme në këto fusha.
Gjithashtu, niveli i zbatimit të rekomandimeve prej rreth 63%, krahas 17 rekomandimeve në proces dhe 10 rekomandimeve të pazbatuara, tregon nevojën për forcimin e mekanizmave të monitorimit dhe ndjekjes së rekomandimeve, me qëllim që gjetjet e auditimit të adresohen në mënyrë të plotë dhe të qëndrueshme.
Për sa më sipër, vlerësohet se, megjithëse NJAB ka përmbushur një pjesë të konsiderueshme të detyrimeve të saj ligjore dhe metodologjike, nevojiten masa konkrete për forcimin e qeverisjes, pavarësisë, planifikimit mbi bazë risku, administrimit të dokumentacionit dhe monitorimit të rekomandimeve, me qëllim rritjen e efektivitetit të funksionit të auditimit të brendshëm dhe të kontributit të tij në forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të Bashkisë Korçë.
(Në fazën e Projekt raport auditimit, nga subjekti Bashkia Korçë për këtë pikë nuk u paraqitën kundërshti)

2.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit viti 2025.

Çështjet e audituara sipas pikës 2 të programit:
- Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor.
- Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative.
- Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor (grande dhe të ardhura) dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.
- Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve.

Dokumentacioni i audituar si më poshtë:
1. Dokumentacioni i hartimit të PBA 2025-2027, miratimi i tyre dhe korrespondenca me Ministritë e Linjës;
2. Dokumentacioni i programimit të buxhetit vjetor për periudhën objekt auditimi, i miratuar me VKB, fondet e transfertës së pakushtëzuar, të kushtëzuar dhe specifike nga MFE, si dhe korrespondenca zyrtare për ndryshimet në buxhet gjatë kësaj periudhe buxhetore;
3. Situacioni i shpenzimeve rakorduar me Degën e Thesarit;

4. Akt Rakordimi i të ardhurave rakorduar me Degën e Thesarit;
5. Shkresat përcjellëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për detyrimet e papaguara të institucionit ndaj të tretëve;
6. Dokumentet e hartuara në mënyrë periodike për monitorimin e zbatimit të buxhetit për periudhën objekt auditimi;
7. Dokumentacioni i mbajtur mbi debitorët dhe kreditorët.
8. Dokumentacion të bankës etj.,.

-<u>Auditimi i procedurave të ndjekura për hartimin e PBA dhe programimit të buxhetit vjetor</u>.

Përgatitja e Programeve Buxhetore Afatmesme 2025-2027 .

Nga auditimi i procedurave të ndjekura nga Bashkia Korçë për hartimin, miratimin dhe zbatimin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2025-2027, rezultoi se procesi është zhvilluar në disa faza, në përputhje me kërkesat e përgjithshme të kuadrit ligjor për menaxhimin e financave vendore, konkretisht:

Për organizimin dhe koordinimin e procesit të hartimit të PBA 2025-2027 është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me Urdhrin nr. 45 prot., datë 21.01.2025.

Është hartuar dhe miratuar kalendari i përgatitjes së PBA 2025-2027 dhe buxhetit vjetor 2025 me VKB nr. 152, datë 07.12.2025, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën nr. 1046 prot., datë 15.12.2025, në zbatim të nenit 33/1 të Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".

Janë miratuar vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për periudhën 2025-2027 me VKB nr. 11 prot., datë 25.01.2024, të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën nr. 103/1 prot., datë 01.02.2024.

Janë miratuar tavanet përgatitore të PBA 2025-2027 me VKB nr. 47 prot., datë 28.03.2024, të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën nr. 323/1 prot., datë 05.04.2024.

Pas miratimit të tavaneve përgatitore është nxjerrë Udhëzimi i Kryetarit të Bashkisë nr. 274 prot., datë 29.03.2024 për vijimin e procesit të përgatitjes së PBA-së.

Faza e parë e PBA 2025-2027 nuk rezulton të jetë miratuar nga Këshilli Bashkiak, por dokumenti është dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr. 4733 prot., datë 30.05.2024.

Pas udhëzimeve plotësuese të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 05.07.2024 "Për përgatitjen e PBA 2025-2027", janë miratuar tavanet përfundimtare me VKB nr. 108 prot., datë 25.07.2024, të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën nr. 676/1 prot., datë 02.08.2024.

Faza e dytë e PBA 2025-2027 është miratuar me VKB nr. 127 prot., datë 26.09.2024 dhe është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën nr. 965/1 prot., datë 01.10.2024.

Për hartimin e PBA-së dhe projektbuxhetit vjetor janë zhvilluar konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit nëpërmjet procesit të "Buxhetimit me pjesëmarrje", të dokumentuara me relacionet dhe procesverbalet përkatëse të datave 14.11.2024 dhe 18.11.2024.

Buxheti vjetor 2025 dhe PBA 2025-2027 janë miratuar me VKB nr. 176 prot., datë 26.12.2024 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën nr. 31 prot., datë 08.01.2025.

Programimi i shpenzimeve për vitin 2025-2027 Bashkia dhe i detajuar sipas programeve paraqitet, sipas PBA.

Nr.	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027
		000/lekë	000/lekë	000/lekë
1	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi AA122	500,771	456,707	474,369
2	Siguria Publike AB122	70,797	69,008	70,241
3	Mbështetja për Zhvillimin Ekonomik Vendor AC122	80,677	72,017	72,690
4	Mbrojtja e Mjedisit AD122	208,820	206,716	206,991
5	Shërbimet Publike vendore AE122	741,352	750,718	757,751
6	Kultura, Sport dhe Argetimi AF122	200,354	166,482	169,991
7	Arsimi Bazë dhe Parashkollor AG122	494,384	564,641	577,610
8	Arsimi i mesëm i përgjithshëm AH122	78,317	88,645	91,667
9	Përkujdesje Sociale AI122	82,546	76,355	80,414
10	Fonde Rezervë AJ122	10,000	10,000	8,000
11	Fond Kontigjence AK122	10,000	10,000	8,000

Nr.	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027
		000/lekë	000/lekë	000/lekë
	Totali	**2,478,018**	**2,471,289**	**2,517,724**

Burimi: *Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe MFK, përpunuar nga grupi i auditimit*

Sipas PBA 2025-2027 Bashkia Korçë tendenca e të ardhurave paraqitet në pasqyrën si më poshtë**:** Të ardhurat në 000/lekë (PBA) 2025-2027.

A	Të ardhurat	2025	2026	2027
1	Të ardhura të trashëguara			
I	**Totali**			
1	Nga taksat	1,237,946	1,265,635	1,275,492
II	**Totali**	**1,237,946**	**1,265,635**	**1,275,492**
1	Transferta e pakushtëzuar	628,561	662,216	698,154
2	Transfertë e pakushtezuar për rritjen e pagave	95,494	95,494	95,494
	Transferte e pakushtezuar sektoriale	455,317	447,944	448,584
III	**Shuma e transfertave**	**1.179.372**	**1.205.654**	**1.242.232**
1	Grante te huaja	60,700		
IV	**Shuma**	**60,700**		
	Totali I burimeve të veta (I +II+III+IV)	**2,478,018**	**2,471,289**	**2,517,724**

Burimi: *Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe MFK, përpunuar nga grupi i auditimit*

Gjithashtu, sipas PBA 2025-2027, burimet e financimit për periudhën afatmesme janë parashikuar nga të ardhurat vendore, transfertat nga buxheti i shtetit dhe grantet e huaja. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar rezultuan mangësitë si më poshtë:

1. *Mosrespektimi i procedurës së miratimit të fazës së parë të PBA 2025-2027.*

Faza e parë e PBA 2025-2027 nuk është paraqitur dhe miratuar nga Këshilli Bashkiak përpara dërgimit në Ministrinë e Financave, por është dërguar vetëm me shkresën nr. 4733 prot., datë 30.05.2024. Ky veprim nuk garanton respektimin e plotë të ciklit të miratimit dhe kontrollit institucional të dokumentit të PBA-së nga organi kolegjial vendimmarrës i njësisë së vetëqeverisjes vendore, veprime në kundërshtim me Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, neni 34, *i cili përcakton procedurat për përgatitjen dhe miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm nga njësitë e vetëqeverisjes vendore*; Udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e PBA 2025-2027.

Mos miratimi në kohë i fazave të ndërmjetme të PBA-së nga Këshilli Bashkiak krijon risk për: dobësimin e rolit mbikëqyrës të Këshillit Bashkiak në procesin buxhetor; mungesë transparence dhe kontrolli institucional mbi prioritetet financiare afatmesme; risk për mospërputhje midis prioriteteve strategjike të bashkisë dhe alokimit të fondeve.

2. ***Miratimi me vonesë i vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave***.

Vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për periudhën 2025-2027 janë miratuar me VKB nr. 11 prot., datë 25.01.2024, ndërkohë që sipas kërkesave të procesit të PBA-së duhet të jenë pjesë e fazës përgatitore të përcaktuar në kalendarin buxhetor, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 34/1; Udhëzimet vjetore të Ministrisë së Financave për përgatitjen e PBA-së. Mosrespektimi i afateve të përcaktuara ndikon në: cilësinë e planifikimit financiar afatmesëm; përcaktimin e saktë të tavaneve buxhetore; lidhjen ndërmjet parashikimit të të ardhurave dhe planifikimit të shpenzimeve.

3. ***Miratimi jashtë afatit i tavaneve përgatitore të PBA 2025-2027***.

Tavanet përgatitore të PBA-së janë miratuar me VKB nr. 47 prot., datë 28.03.2024. Nga auditimi rezulton se procesi nuk është zhvilluar brenda afateve të përcaktuara në kalendarin e menaxhimit të financave publike vendore, në kundërshtim me Ligji nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 34/6; Udhëzimet e Ministrisë së Financave për hartimin e PBA-së. Vonesa në miratimin e tavaneve përgatitore sjell: reduktim të kohës në dispozicion për njësitë shpenzuese për hartimin e kërkesave buxhetore; risk për hartim joefektiv të programeve buxhetore; vështirësi në lidhjen e objektivave strategjikë me burimet financiare.

Për sa konstatuar më sipër subjekti i audituar Bashkia Korçë, me shkresën nr. 6776/16, datë 02.09.2026 (protokolluar në KLSH me nr. 735/4 prot, datë 08.09.2026) Drejtoria e Financës kanë bërë komente dhe shpjegime, lidhur me problematikat e konstatuara nga grupi i auditimit si vijon*:*

Pretendimi i subjektit: *Në lidhje me gjetjen e auditimit sipas pikës 4 dhe rekomandimet 4.1 ju bëjmë me dije se referuar ligjit 68/2017, "Për financat e vetqeverisjes vendore", i ndryshuar, sipas nenit 33, Bashkia ka hartuar dhe miratuar në Këshillin Bashkiak me VKB nr. 152 datë 7.12.2023 "Kalendarin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe të Buxhetit Vjetor 2025 Bashkia Korçë". Sipas kalendarit, si dhe duke iu referuar ligjit 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, neni 34, bashkia ka miratuar me VKB nr. 11 datë 25.1.2024 "Për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave", pra sipas nenit 34 pika 1. Bashkia ka miratuar me VKB nr. 11 datë 25.1.2024 "Vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave", brenda afatit ligjor. Përsa i takon mosmiratimit të Fazës së Parë të PBA 2025-2027 në Këshillin Bashkiak, ju bëjmë me dije se duke iu referuar ligjit 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, neni 34, pika 5 dhe "Kalendarin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe të Buxhetit Vjetor 2025 Bashkia Korçë", brenda datës 1 qershor, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore i dërgon Ministrisë së Financave projektdokumentin e programit buxhetor afatmesëm, Bashkia Korçë ka dorëzuar dokumentin e Projekt Buxhetit Afatmesëm në Ministrinë e Financave me shkresën nr. 4733 datë 30.05.2024, pra është respektuar afati ligjor. Po sipas këtij ligji neni 36, pika 8, ky dokument është futur në Këshillin Bashkiak për miratim. Ky dokument nuk është miratuar nga Këshilli Bashkiak. Kjo vërtetohet dhe me dokumentin e paraqitur nga sekretarja e Këshillit Bashkiak, sipas të cilës ky dokument nuk mori kuorumin e duhur me 16 vota pro dhe 8 vota kundër.*

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në përgjigje të pretendimeve tuaja sqarojmë se konstatimi i auditimit nuk lidhet me faktin nëse vlerësimet dhe parashikimet e të ardhurave janë miratuar brenda datës 31 janar, por me faktin se këto veprime duhet të jenë pjesë integrale e ciklit dhe procedurës së përcaktuar për përgatitjen dhe miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm. Për rrjedhojë, respektimi i këtij afati, në vetvete, nuk provon përmbushjen e plotë të të gjitha etapave procedurale të procesit të PBA-së.

Në lidhje me Fazën e Parë të PBA-së, subjekti pretendon se detyrimi ligjor për dërgimin e projektdokumentit të PBA-së në Ministrinë e Financave brenda datës 1 qershor është respektuar, pasi dokumenti është dërguar me shkresën nr. 4733, datë 30.05.2024. Ky argument nuk kundërshton gjetjen e auditimit. Auditimi nuk ka konstatuar mosrespektim të afatit të dërgimit të projektdokumentit në Ministrinë e Financave, por faktin se Fazës së Parë të PBA-së i mungon miratimi paraprak nga Këshilli Bashkiak, në përputhje me procedurën e përcaktuar nga kuadri ligjor dhe kalendari i miratuar i PBA-së. Pra, respektimi i afatit të datës 1 qershor për dërgimin e dokumentit në Ministrinë e Financave nuk mund të konsiderohet si përmbushje e detyrimit procedural për miratimin e Fazës së Parë të PBA-së nga organi vendimmarrës i njësisë së vetëqeverisjes vendore. Këto janë dy veprime të ndryshme procedurale dhe duhet të vlerësohen veçmas. Për sa më sipër, argumentet e subjektit lidhur me respektimin e afatit të dërgimit të projektdokumentit në Ministrinë e Financave nuk e rrëzojnë konstatimin e auditimit, pasi nuk adresojnë mangësinë procedurale të identifikuar, konkretisht mosmiratimin e Fazës së Parë të PBA-së nga Këshilli Bashkiak, dhe për këto arsye observacioni juaj **nuk merret në konsideratë**.

- ***Planifikimi i shpenzimeve kapitale për vitin 2025 është bërë si vijon*:**

Nga auditimi i dokumentacionit të planifikimit buxhetor rezultoi se Bashkia ka hartuar dhe miratuar buxhetin vjetor për vitin 2025 me VKB nr. 176, datë 26.12.2024, i cili është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën nr. 31, datë 08.01.2025. Buxheti fillestar i miratuar paraqitet i balancuar, me të ardhura dhe shpenzime në vlerën totale 2,478,018 mijë lekë, duke respektuar parimin e balancimit buxhetor, siç tregohet në tabelën e mëposhtëm".

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani fillestar i vitit 2025	
		Të ardhurat	Shpenzimet
1	Transferta e pakushtëzuar	628,561	
2	Transferta e pakushtëzuar për rritjen e pagave	95,494	
3	Transferta e pakushtëzuar për menaxhimin e mbetjeve urbane	8,000	
4	Transferta e pakushtëzuar sektoriale	447,317	
5	Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore + Institucionet e varësisë	1,237,946	
6	Të ardhura të tjera (Fondet IPA)	60,700	
1	Shpenzime për paga (600)		991,373
2	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore (601)		166,394
3	Shpenzime operative (602)		815,956
4	Subvencione (603)		10,700
5	Transferta (604+606)		159,595
6	Fondi rezervë+Fondi I kontigjencës (609)		20,000
7	Shpenzimet kapitale (230+231)		243,000
8	Shpenzimet kapitale (230) grande te huaja		60,700
9	Principali+Interesi I kredisë (166+651)		10,300
	Total	**2,478,018**	**2,478,018**

Burimi: *Drejtoria e Financës dheBuxhetit dhe MFK, përpunuar nga grupi i auditimit*

Nga analiza e strukturës së të ardhurave dhe shpenzimeve rezulton se planifikimi është mbështetur në burimet e financimit nga transfertat e qeverisjes qendrore, të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore, të ardhura të tjera dhe financime të huaja, ndërsa shpenzimet janë shpërndarë sipas programeve buxhetore dhe klasifikimit ekonomik. Megjithatë, gjatë shqyrtimit të procesit të programimit buxhetor dhe planifikimit të investimeve kapitale për periudhën 2025–2027, u konstatuan mangësitë si më poshtë:

1. *Mospërputhje midis planit të shpenzimeve kapitale të miratuara në buxhetin vjetor dhe programit të investimeve afatmesme*.

Nga krahasimi i të dhënave të paraqitura rezulton se në buxhetin vjetor 2025 janë planifikuar shpenzime kapitale në vlerën 303,700 mijë lekë, siç paraqitet në tabelën si mëposhtë:

Në 000/lekë

Nr.	Emri i programit/objektit	Origjina e te ardhures	2025	2026	2027
1	Planifikim, menaxhim, administrimi/ Shpronesim varrezat pblike dhe investime	Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore	3,500	15,000	17,000
2	Planifikim, menaxhim, administrimi/ Salla e mbledhjeve smart për keshilltaret	Transfertat e pakushtëzuar	2,580		
3	Planifikim, menaxhim, administrimi/ Mirembajtja e infrastruktures dhe funksionimi i aparatit te Bashkisë	Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore	17,656	9,386	10,243
4	Planifikim, menaxhim, administrimi/ Projektet IPA	Financim i huaj	60,700		
5	Planifikim, menaxhim, administrimi/ Projekte te zhvillimit urban te hartuara dhe monitoruara	Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore	12,500	10,000	10,000
6	Siguria publike/Patrullim për sigurine publike	Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore	900		
7	Siguria publike/Sherbime te Mbrojtjes civile	Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore	1,230		
8	Mbeshtetje e zhvillimit ekonomik/ Subjekte të sistemuara në Tregun e Gjësë së Gjallë	Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore	200		
9	Mbeshtetje e zhvillimit ekonomik/ Subjekte të sistemuara në Tregun e Ushqimeve	Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore	98		
10	Mbeshtetje e zhvillimit ekonomik/ Siperfaqe pyjore e rehabilituar	Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore	8,442	13,370	13,720
11	Mbrojtja e Mjedisit/ Termoizolimi i banesave ne bashkepronesi	Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore	10,000	10,000	10,000
12	Sherbime publike vendore /Investime ne rruge	Transferta e pakushtezuar, Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore	79,784	93,489	89,336
13	Sherbime publike vendore / Sipërfaqe e gjelbër e mirëmbajtur dhe rehabilituar	Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore	28,612	7,853	5,081
14	Sherbime publike vendore / Mirembajtje për objekte ndertimore, miniparqe	Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore	5,000	7,749	2,819

15	Sherbime publike vendore / Rrjeti i ndricimit rrugor publik urban i mirëmbajtur	Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore	4,195	815	968
16	Kultura, sport dhe argetim/ Shfaqje teatri	Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore	250	268	268
17	Kultura, sport dhe argetim/ Objekte të trashëgimisë kulturore të mirëmbajtura	Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore	4,040	2,190	2,190
18	Kultura, sport dhe argetim/ Funksionimi i Bibliotekës	Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore	1,200	1,285	1,285
19	Kultura, sport dhe argetim/ Disiplinat e ndryshme sportive të mbështetura	Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore	120	257	257
20	Arsimi baze parashkollor/ Rikonstruksion Shkollash Arsimi Bazë	Transferta e pakushtezuar, Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore	32,124	60,000	59,000
21	Arsimi baze parashkollor/ Objekte të Arsimit Bazë të mirëmbajtura	Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore	14,050	15,400	17,000
22	Arsim i mesem i pergjithshem/Rikonstrukison i shkollave arsimi i mesëm	Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore	5,000	11,688	13,365
23	Arsim i mesem i pergjithshem/Shërbime Mbeshtesese të stafit të Arsimit të Mesëm të Përgjithshëm	Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore	300		
24	Perkujdesi social/ Familje dhe individë në nevojë që përfitojnë nga skema e NE	Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore	1,218		805
25	Perkujdesi social/ Familje në nevojë/Individë të subvencinuar për qeranë	Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore	10,000		
Total Investime			**303,700**	**258,750**	**253,337**

Burimi: *Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe MFK, përpunuar nga grupi i auditimit*

Kjo situatë tregon nevojën për një rakordim më të plotë ndërmjet dokumenteve të planifikimit buxhetor, planit të investimeve dhe burimeve të financimit.

2. ***Planifikim i investimeve kapitale pa një argumentim të plotë të prioriteteve dhe kostove***.

Nga shqyrtimi i listës së investimeve të planifikuara për periudhën 2025–2027 rezulton se janë përfshirë një numër i konsiderueshëm projektesh në fusha të ndryshme (infrastrukturë rrugore, arsim, mjedis, kulturë, shërbime publike dhe zhvillim ekonomik). Megjithatë, dokumentacioni i analizuar nuk evidenton në mënyrë të plotë kriteret e përdorura për renditjen e prioriteteve të investimeve, analizën e kostove dhe përfitimeve, ndikimin social-ekonomik të projekteve apo lidhjen e drejtpërdrejtë me objektivat strategjikë të zhvillimit të Bashkisë. Në disa raste, investimet janë planifikuar në vlera të përsëritura për disa vite radhazi, pa u evidentuar në materialet shpjeguese statusi i zbatimit, afatet e përfundimit, burimi i plotë i financimit dhe analiza e qëndrueshmërisë financiare.

3. ***Mangësi në lidhjen ndërmjet planifikimit të investimeve dhe kapaciteteve reale të realizimit***.

Nga analiza e planit të investimeve për vitet 2025–2027 rezulton një nivel i konsiderueshëm angazhimesh financiare në disa programe njëkohësisht. Megjithatë, nuk rezulton i dokumentuar një analizim i kapaciteteve zbatuese të strukturave përgjegjëse, procedurave të prokurimit, afateve të realizimit dhe mundësisë reale të përfundimit të investimeve brenda periudhës së planifikuar.

Konkluzion: Buxheti i Bashkisë për vitin 2025 është hartuar dhe miratuar në përputhje me kërkesat bazë ligjore dhe paraqitet i balancuar financiarisht. Megjithatë, procesi i programimit të investimeve kapitale paraqet nevojë për përmirësim lidhur me rakordimin e dokumenteve buxhetore, argumentimin e prioriteteve të investimeve dhe dokumentimin e analizave mbështetëse, me qëllim rritjen e transparencës, eficiencës dhe efektivitetit në përdorimin e fondeve publike.

Mangësitë e konstatuara krijojnë risk për: planifikim jo realist të investimeve kapitale; devijim ndërmjet planit buxhetor dhe realizimit faktik; mosrealizim të fondeve të planifikuara; shtyrje të afateve të përfundimit të projekteve; ulje të eficiencës dhe efektivitetit në përdorimin e fondeve publike; dobësim të transparencës dhe llogaridhënies ndaj komunitetit.

Mos dokumentimi i plotë i procesit të programimit, argumentimit dhe monitorimit të investimeve kapitale është në kundërshtim me: Ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, **neni 3** – *Parimet e menaxhimit të financave vendore, ku përcaktohet se administrimi i*

financave vendore duhet të bazohet në parimet e transparencës, efektivitetit, eficiencës dhe përgjegjshmërisë financiare, neni 20 – *Programi Buxhetor Afatmesëm i njësisë së vetëqeverisjes vendore, ku përcaktohet detyrimi që planifikimi buxhetor të jetë i lidhur me objektivat strategjikë dhe prioritetet e zhvillimit të njësisë vendore,* neni 21 – *Përgatitja e buxhetit vendor, ku kërkohet që parashikimet buxhetore të bazohen në vlerësime reale të burimeve financiare dhe nevojave për financim,* neni 37 – *Zbatimi dhe monitorimi i buxhetit vendor, që kërkon ndjekjen dhe vlerësimin e realizimit të objektivave dhe përdorimit me efektivitet të fondeve publike*; Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 4 – *Parimet e menaxhimit të sistemit buxhetor, ku përcaktohet përdorimi ekonomik, eficient dhe efektiv i fondeve publike*, neni 8 – *Përgjegjësia për menaxhimin financiar dhe kontrollin, sipas të cilit njësitë publike janë përgjegjëse për planifikimin, përdorimin dhe monitorimin e fondeve publike,* neni 12 – *Procesi i planifikimit buxhetor, ku përcaktohet lidhja ndërmjet objektivave të politikave publike dhe planifikimit të burimeve financiare;* Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 9 – *Funksionet dhe kompetencat e njësive të vetëqeverisjes vendore, ku përcaktohet përgjegjësia për administrimin e shërbimeve publike dhe zhvillimin vendor;* neni 23 – *Kompetencat e kryetarit të bashkisë në administrimin e burimeve financiare dhe zbatimin e vendimeve të këshillit bashkiak*; Ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 2 – *Parimet e prokurimit publik, përfshirë transparencën, trajtimin e barabartë dhe përdorimin me eficiencë të fondeve publike*.

- ***Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas miratimit me Vendim të Këshillit të Bashkisë, ndryshimet gjatë vitit, analiza e tyre sipas artikujve, arsyet e këtyre ndryshimeve***.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës specifike dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve. Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit. Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësimi). Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB. -Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit dhe janë të raportuara periodikisht pranë Degës së Thesarit. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara. Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Janë kryer ndryshime të vazhdueshme në buxhetin vjetor, veprime që tregon se planifikimi i buxhetit duhet të bëhet më i argumentuar, në mënyrë që gjatë vitit ndryshimet të jenë sa më të vogla. Gjatë vitit 2025 janë miratuar disa vendime të tjera të Këshillit Bashkiak të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë. Për vitin 2025 kanë ndodhur 12 ndryshime me VKB, 8 me urdhër të titullarit të institucionit ndryshime dhe 3 sponsorizime. Ndryshimet buxhetore gjatë vitit ushtrimor 2025 paraqiten në Aneksin nr. 1 dhe aneksin nr.2 në kapitullin anekse.

- ***Auditim mbi saktësinë e realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të celura, sipas burimeve të financimit e krahasuar me aktrakordimin me Thesarin, analiza e mosrealizimit të shpenzimeve.***

Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Korçë, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv buxhetor, të miratuar me Vendim të KB, apo nga ndryshimet e transfertave të pakushtëzuara sektoriale nga pushteti qendror, nga auditimi i shkresave, evidencave të çeljeve, shpërndarjes së fondeve gjatë vitit, të akt-rakordimeve periodike me degën e Thesarit , u konstatua se, si në planifikim dhe në realizim të buxhetit është respektuar disiplina buxhetore. Për vitin 2025 realizimi i treguesve të buxhetit në nivel bashkie, referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet në *Aneksin nr. 3 b/lidhur RPA.*

Nga auditimi i zbatimit të buxhetit të Bashkisë për vitin 2025, bazuar në akt-rakordimet mujore me Degën e Thesarit Korçë, evidencat e çeljes së fondeve, shpërndarjen e kredive buxhetore dhe realizimin faktik të shpenzimeve sipas kategorive ekonomike, rezultoi se institucioni ka respektuar procedurat formale të zbatimit të buxhetit dhe rakordimit financiar me Degën e Thesarit.

Megjithatë, nga analiza e realizimit të shpenzimeve rezultoi se niveli i përgjithshëm i realizimit të buxhetit për vitin 2025 ka qenë 79%, ku nga fondi total i planifikuar në shumën 3,396,291 mijë lekë, janë realizuar 2,695,516 mijë lekë, duke mbetur të parealizuara 700,775 mijë lekë.

Mosrealizimi më i ndjeshëm është evidentuar në zërin e investimeve (230–231), ku nga fondi i planifikuar përfundimtar prej 418,005 mijë lekë, është realizuar vetëm 203,290 mijë lekë, ose 49% e planit, duke rezultuar me një diferencë të parealizuar prej 214,715 mijë lekë, të paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Shpenzimet sipas llogarive ekonomike	Plani vjetor fillestar 2025	Plani përfundimtar 2025	Plani i çelur 2025	Realizimi i shpenzimeve 2025	% e realizimit/ planit vjetor
Shpenzime për paga (600)	991,373	1,004,437	943,692	906,758	90%
Shp. për sig shoq e shëndetësore (601)	166,394	168,639	155,691	150,446	89%
Shpenzime operative (602)	815,956	912,631	694,782	673,236	74%
Subvencione (603)	10,700	10,610	10,116	10,081	95%
Transferta tek organizatat (604)	149,370	192,783	169,908	166,656	86%
Transferta tek individët (606)	7,225	581,198	577,348	564,763	97%
Fondi rezervë+e kontigjencës (609)	20,000	19,700			0
Fondi e Emergjences	3,000	3,000			0
Shpenzime Principali (166)	10,300	10,300	8,395	8,395	82%
Shpenzime Interesi (651)	-				
Shpenzime për Oponenca teknike (230)	73,200	74,988	11,891	11,891	16%
Shpenzime për Investime (231)	**230,500**	**418,005**	**257,130**	**203,290**	**49%**
a.Nga te ardhurat e transf e pakushtez, specifike	230,500	350,194	189,319	135,479	39%
b.Nga Ministrite linjes		67,811	67,811	67,811	100%
Total	**230,500**	**418,005**	**257,130**	**203,290**	**49%**
Total Bashki + Institucione	**2,478,018**	**3,396,291**	**2,828,953**	**2,695,516**	**79%**

Burimi: *Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, përpunuar nga grupi i auditimit*

Nga verifikimi i dokumentacionit dhe shpjegimeve të administruara nga subjekti, u evidentua se shkaqet kryesore të mosrealizimit lidhen me: mosrealizimin e disa investimeve të planifikuara me financim të huaj;

vonesa në procedurat administrative për shpronësime; shtyrjen e realizimit të disa objekteve për periudhën pasardhëse; vazhdimin e projekteve shumëvjeçare në periudhat e ardhshme; mosrealizimin në nivelin e pritshëm të të ardhurave të veta vendore.

Nga analiza e procesit të hartimit dhe zbatimit të buxhetit rezultoi se disa investime janë programuar mbi bazën e pritshmërive financiare që nuk janë materializuar gjatë vitit buxhetor,

duke krijuar diferencë ndërmjet nivelit të fondeve të planifikuara dhe kapaciteteve reale financiare për financimin e tyre.
Në këto kushte, institucioni nuk ka kryer në mënyrë efektive rishikimin dhe përshtatjen e programit të investimeve me nivelin real të realizimit të burimeve financiare gjatë vitit, duke vijuar mbajtjen e objektivave të investimeve në nivele që nuk përputheshin me mundësitë reale të financimit. Kjo situatë ka ndikuar në mosrealizimin e treguesve të planifikuar buxhetorë, në uljen e eficiencës së përdorimit të fondeve publike dhe në dobësimin e lidhjes ndërmjet planifikimit buxhetor dhe kapaciteteve reale financiare të Bashkisë.
Mosrealizimi i investimeve të planifikuara ka sjellë përdorim jo optimal të procesit të planifikimit buxhetor, mosrealizim të objektivave të vendosura dhe rrezik për shtyrjen e përfitimeve publike të pritshme nga projektet e investimeve, në kundërshtim me: nenin 46 "*Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor*" të Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, *ku përcaktohet detyrimi i njësisë së vetëqeverisjes vendore për monitorimin e zbatimit të buxhetit dhe marrjen e masave për rishikimin e tij në rastet kur realizimi i treguesve buxhetorë nuk përputhet me planifikimin*; nenin 4 të Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, *lidhur me parimet e menaxhimit të financave vendore, veçanërisht parimin e realizmit, qëndrueshmërisë dhe përdorimit efektiv të burimeve financiare*; nenin 11 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, *lidhur me respektimin e parimeve të planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të buxhetit*; Udhëzimin standard të zbatimit të buxhetit të nxjerrë nga Ministria e Financave për vitin përkatës, lidhur me monitorimin periodik të realizimit të fondeve dhe marrjen e masave korrigjuese gjatë vitit buxhetor.

- ***Çelja dhe ekzekutimi i fondeve për investime, saktësia e raportimit buxhetor të tyre***

Për vitin 2025 janë planifikuar fonde për investime në shumën 492,992,425 lekë (të cilat janë nga grant i pakushtëzuar + transferta e pakushtëzuar sektoriale + të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore + transferte e kushtezuar+sponsorizime) dhe janë realizuar në vlerën 215,180,980.07 lekë, ose në masën 43%.
Fondet për investime nga të ardhurat e Bashkisë. Për vitin 2025 janë planifikuar në vlerën 425,182 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 147,370 mijë lekë ose realizuar në masën 34%.
Fondet për investime të financuara nga Ministritë e Linjës. Për vitin 2025 janë planifikuar në vlerën 67,811 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 67,811 mijë lekë.

- ***Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe kontigjencës si dhe fondeve të emergjencave civile***

a. *Fondi rezervë dhe fondi i kontigjencës.*
Për vitin 2025 fondi rezervë dhe fondi i kontigjencës është në total në shumën 20,000 mijë lekë, i cili është miratuar në buxhetin fillestar me VKB nr. 176 datë 26.12.2024 "Për miratimin e Buxheti vjetor 2025 dhe PBA 2025-2027 i Bashkisë Korçë, dhe u konfirmua nga Prefekti i Qarkut me shkresën nr. 31 datë 8.1.2025. Me VKB nr. 48 datë 29.5.2025 Për Miratimin e mbështetjes financiare për nxënësin Renis Mankollari, për pjesëmarrjen e tij në Olimpiadën Ndërkombëtare të Matematikës 2025. Për vitin 2025 me shkresën nr. 492/1 prot., datë 25.2.2025, të ardhur nga Ministria e Mbrojtjes, (AKMC), "Mbi fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile" Bashkisë i është akorduar fondi në vlerën 18,476,565 lekë**.** me VKB nr. 38 datë 24.4.2025 është bërë miratimi i përdorimit të fondeve të lira të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi I shpenzimeve	Shuma e Planifikuar	Përdorimi	Mbetja
1	Shpenzime për blerje kripe për Emergjencat Civile dimërore.	2,634	2,568	66
2	Shpenzime për blerje pajisje profesionale që ju shërbejnë strukturave të MZSH-së,	343	266	77

3	Shpenzime për blerje mjeti ATP	6,000	5,400	600
4	Shpenzime për blerje mjeti Fadromë e re	9,500	9,300	200
	TOTAL	**18,477**	**17,534**	**943**

Burimi: *Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, përpunuar nga grupi i auditimit*

Gjithashtu me VKM nr. 127 datë 28.2.2025 "Për miratimin e projekteve fituese të financuara për vitin 2025 nga fondi për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore, si dhe autoritetit kontraktor për zbatimin e projekteve, sipas Njësive të vetëqeverisjes vendore", u miratua fondi prej 8,000 mijë lekë për blerje kamion borëpastruese. Gjatë vitit 2025 dhe u likuiduar financimi i vitit 2025, në vlerën 4,760 mijë lekë dhe diferenca është financim në vitin 2026 dhe është shlyer. Me VKM nr. 307 datë 22.5.2024 "Për miratimin e projekteve fituese të financuara për vitin 2024 nga fondi për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore, si dhe të Autoritetit Kontraktor për zbatimin e projekteve, sipas Njësive të vetëqeverisjes vendore" është akorduar dhe shlyer për vitin 2025 fondi prej 19,659 mijë lekë për projektin Sistemim i përrenjve brenda territorit te Bashkisë Korçë, i cili është financuar me 2 vite buxhetore.

- ***Raportet e monitorimit për zbatimin e buxhetit***

Për vitet 2025 janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit, realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit e tyre në përputhje me kërkesat e ligjit organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.06.2008 *"*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" neni 6 dhe me kërkesat e Shtojcës 2 "Përmbajtja e raportit të monitorimit" dhe Shtojcës 5 "Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë", të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, *"Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore"* pikat 10, 12, 28, 29, 48. Për vitet 2025 janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit, realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit e tyre në përputhje me kërkesat e ligjit organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" neni 6 dhe me kërkesat e Shtojcës 2 "*Përmbajtja e raportit të monitorimit*" dhe Shtojcës 5 "Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë", të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore" pikat 10, 12, 28, 29, 48. Për vitin 2025 janë dërguar në MFE raportet e detajuara si më poshtë:
"Raport monitorimi Janar-Prill 2025" me e-mail date 27.5.2025.
"Raport monitorimi Janar-Gusht 2025" me e-mail date 29.9.2025.
"Raporti i monitorimit Janar-Dhjetor 2025" me e-mail date 23.2.2026.

- ***Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve etj.***

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Situata e planifikimit të detyrimeve të papaguara nga viti paraardhës në buxhet respektivisht paraqitet si vijon:
Informacion për planifikimin e likuidimit të detyrimeve të prapambetura.

Periudha	Detyrimet në fund të periudhës viti 2024	Vlera e detyrimeve të planifikuara	VKB nr. /datë	Llog 602+606	Llog. 230+231
Viti 2025	14,904,085.32	4,332,709.32	VKB nr. 19 datë 25.2.2025	4,332,085.32	

Burimi: *Drejtoria e Financës dheBuxhetit dhe MFK, përpunuar nga grupi i auditimit*

Të dhëna të hollësishme për detyrimet e prapambetura më 31.12.2025:

Detyrimet e NJQV	Detyrimi ne fillim te vitit I mbartur 31.12.2024	Detyrimi i krijuar ne periudhën 01.01.2025-31.12.2025	Total Detyrime	Stornim veprimi	Shlyerje e detyrimeve 2025	Mbetja e detyrimeve ne fund te periudhës 31.12.2025
a	1	2	3=1+2	4	5	6=5-4-3

a. Investime nga Ministrite e linjes e FZHSH	10,571,376.00		10,571,376.00	10,571,376.00		0
b.Investime nga Bashkia		12,934,383.00	12,934,383.00		12,934,383.00	0
Investime:						
Mallra dhe sherbime	4,332,709.32	7,524,306.24	11,857,015.56		11,857,015.56	0
Vendime gjyqesore		40,712,689.00	40,712,689.00		40,712,689.00	0
Totali	**14,904,085.32**	**61,171,378.24**	**76,075,463.56**	**10,571,376.00**	**65,504,087.56**	**0**

Burimi: *Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe MFK, përpunuar nga grupi i auditimit*

Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura rezultoi se, në fund të vitit 2024, Bashkia ka mbartur detyrime në vlerën totale prej 14,904,085 lekë. Për vitin 2025, në zbatim të VKB nr. 19, datë 25.02.2025, janë planifikuar për likuidim detyrime në vlerën 4,332,709 lekë, të evidentuara kryesisht në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve (llogaria 602 dhe 606). Nga analiza e detyrimeve të krijuara dhe të shlyera gjatë vitit 2025 rezultoi se, gjatë periudhës 01.01.2025 – 31.12.2025, janë krijuar detyrime të reja në vlerën totale prej 61,171,378 lekë, duke e çuar vlerën totale të detyrimeve për t'u menaxhuar gjatë vitit në 76,075,464 lekë (detyrime të mbartura dhe të krijuara gjatë periudhës). Struktura e detyrimeve paraqitet si më poshtë:

- Investime nga Ministritë e Linjës dhe FSHZH: detyrimi i mbartur në fillim të vitit 2025 ishte në vlerën 10,571,376 lekë, i cili është sistemuar gjatë vitit, duke rezultuar me 0 lekë detyrim të mbetur në fund të periudhës. Bazuar në kontratën e datës 27.03.2023 me objekt "Shfrytëzimi inteligjent i energjisë", të lidhur me operatorin ekonomik I. sh.p.k**.**, financimi i vlerës së TVSH-së ishte parashikuar të mbulohej nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE). Për shkak të mosalokimit në kohë të fondeve nga institucioni përgjegjës, pas kërkesave të vazhdueshme për sigurimin e tyre, Bashkia Korçë ka kontabilizuar detyrimet si detyrime të prapambetura nëpërmjet URDP nr. 21, datë 11.10.2023, në vlerën 4,198,040 lekë, URDP nr. 23, datë 14.12.2023, në vlerën 3,143,980 lekë dhe URDP nr. 4, datë 05.02.2024, në vlerën 3,229,356 lekë, në shumën totale prej 10,571,376 lekë. Më pas, me shkresën nr. 323/1 prot., datë 10.07.2025, Agjencia për Eficiencën e Energjisë, Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, ka njoftuar fillimin e procedurës për shlyerjen e detyrimit të TVSH-së. Në këto kushte, Bashkia Korçë i është drejtuar Degës së Thesarit me shkresën nr. 9454 prot., datë 16.09.2025, duke kërkuar stornimin e veprimit në vlerën 1,000,000 lekë, si dhe me shkresën nr. 206 prot., datë 09.01.2026, për stornimin e shumës së mbetur prej 9,571,376 lekë. Kërkesa për stornim është argumentuar me faktin se detyrimi për pagesën e TVSH-së i përket Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në përputhje me kushtet e kontratës, dhe jo Bashkisë Korçë.
- Investime të financuara nga Bashkia: gjatë vitit 2025 janë krijuar detyrime në vlerën 12,934,383 lekë, të cilat janë shlyer brenda të njëjtit vit, duke mos rezultuar detyrim i mbartur në fund të periudhës.
- Mallra dhe shërbime: detyrimet e mbartura nga viti 2024 në këtë kategori ishin në vlerën 4,332,709 lekë, ndërsa gjatë vitit 2025 janë krijuar detyrime të reja në vlerën 7,524,306 lekë. Vlera totale e detyrimeve në këtë kategori prej 11,857,016 lekë është likuiduar gjatë vitit, duke mos krijuar detyrim të mbartur në fund të vitit.
- Vendime gjyqësore: gjatë vitit 2025 janë krijuar detyrime në vlerën 40,712,689 lekë, të cilat lidhen me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore dhe janë shlyer brenda periudhës ushtrimore. Nga të dhënat e mësipërme rezultoi se, pavarësisht nivelit të konsiderueshëm të detyrimeve të krijuara gjatë vitit 2025, në fund të periudhës 31.12.2025 nuk rezultojnë detyrime të prapambetura të mbartura, pasi detyrimet e evidentuara janë shlyer gjatë vitit. Megjithatë, krijimi i detyrimeve të reja gjatë periudhës, veçanërisht në kategorinë e vendimeve gjyqësore, të cilat përbëjnë rreth 66.6% të totalit të detyrimeve të krijuara gjatë vitit.

- ***Mbi vonesat në likuidime*:**

Grupi i auditimit kreu me zgjedhje testime për të identifikuar pagesat e kryera për periudhën objekt auditimi me datën e urdhër shpenzimit mbi 30 ditë, nga data e lëshimit të faturës së furnitorit. Ligji

nr. 9936, datë 26.06.2008 *"*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", i ndryshuar, neni 52 dhe në ligjin Nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" neni 7. Nga kryerja e testimeve mbi urdhër shpenzimet, rezultuan shkelje të disiplinës buxhetore sa i takon likuidimit të faturave duke tejkaluar afatin ligjor**.** Konkretisht, janë likuiduar 44 fatura mbi afatin e parashikuar 30 ditor duke shkelur disiplinën buxhetore që dikton ligji për "*Menaxhimin e Sistemit Buxhetor*" si dhe ligjin nr. 48/2014 "*Për pagesat e vonuara në detyrimet konraktore e tregtare*" *neni 7*, Tejkalim të afateve që parashikon ligji nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", i ndryshuar, neni 52 ku citohet: "*specifikohet se Nëpunësi zbatues i njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën e thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, Brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OE-së", dhe si pasojë* duke implikuar risqe për krijimin e detyrimeve të reja (prapambetura).

- ***Efektet financiare në buxhet, si rezultat i zbatimit të vendimeve gjyqësore*.**

Nga auditimi i detyrimeve financiare që rrjedhin nga vendimet gjyqësore rezultoi se, gjatë vitit 2025, në strukturën financiare të institucionit janë administruar vendime gjyqësore që krijojnë detyrime për pagesë ndaj palëve përfituese. Sipas të dhënave të paraqitura, gjatë vitit 2025 janë regjistruar 7 vendime gjyqësore, me vlerë totale detyrimi prej 38,473,043 lekë, të cilat lidhen kryesisht me dëmshpërblime për page për punonjës të larguar nga puna. Konkretisht, detyrimi më i rëndësishëm financiar lidhet me vendimet gjyqësore për dëmshpërblim pensioni invaliditeti, ku janë administruar 6 vendime gjyqësore, me vlerë totale prej 38,022,134 lekë, si dhe janë evidentuar shpenzime shtesë për tarifa përmbarimore në vlerën 5,020,473 lekë. Për këtë kategori, detyrimi i përgjithshëm financiar arrin në 43,042,607 lekë. Nga analiza e të dhënave rezulton se pjesa më e madhe e detyrimeve të krijuara nga vendimet gjyqësore lidhet me çështjet e pensioneve të invaliditetit, të cilat kanë ardhur nga Ministria e Shëndetësisë. Nga auditimi u konstatua se, gjatë vitit 2025, institucioni ka administruar një vendim gjyqësor të formës së prerë, me objekt dëmshpërblim page në favor të një punonjësi të larguar nga puna, duke krijuar një detyrim financiar në vlerën 450,909 lekë.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se, pas administrimit të vendimit gjyqësor, Titullari i Autoritetit Kontraktor nuk ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për analizimin e shkaqeve dhe rrethanave që çuan në humbjen e procesit gjyqësor, si dhe nuk ka iniciuar procedurat për evidentimin dhe përcaktimin e përgjegjësive administrative të personave, veprimet ose mosveprimet e të cilëve kanë ndikuar në krijimin e këtij detyrimi financiar për institucionin. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar, pika 60.

Të dhënat mbi vendimet gjyqësore për vitin 2025 paraqiten në tabelën më poshtë:

	Numri i vendimeve gjyqësore si çelje më 01.01.2025	**Vlera e vendimeve gjyqësore si çelje më 01.01.2025**	**Numri i vendimeve gjyqësore të ardhura në financë gjatë vitit 2025**	**Vlera e vendimeve gjyqësore të ardhura në financë gjatë vitit 2025**	**Tarife permbarimore**	**Pagesa në lekë të kryera gjatë vitit 2025**	**Detyrimi në lekë më 31.12.2025**
Dëmshpërblim page për punonjësit e larguar nga puna			**1**	450,909		450,909	
Dëmshpërblim pension invaliditeti			**6**	38,022,134	5,020,473	43,042,607	

Burimi: *Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe MFK, përpunuar nga grupi i auditimit*

Detyrimet e prapambetura për vitin 2025 të paraqitura në Ministrinë e Financave me shkresën nr. 1461 prot., datë 12.02.2026 dhe detyrimet e prapambetura për periudhën janar-dhjetor 2024 të paraqitura në Ministrinë e Financave me shkresën nr. 1384 prot., datë 12.02.2025 paraqiten në tabelën si më poshtë:

Në lekë

		Viti 2025		
NR	**Emërtimi**	**Stoku në vlerë ne fund te vitit 2025**	**Shpenzime vjetore faktike për NJVQV-në**	**Stoku/Shpenzime vjetore faktike të NJVQV-së**
I	**Borxhe (a+b)**	**3.158.997**		
a	**Hua afatgjatë**	**3.158.997**		
a.1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraftt etj)	3.158.997		
a.2	Tituj të emetuar			
a.3	Garanci për të tretë			
b	**Hua afatshkurtër**			
b.1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraftt etj)			
b.2	Tituj të emetuar			
b.3	Garanci për të tretë			
II	**Detyrimet e prapambetura**			**0.00%**
Llogaria ekonomi	**Emërtimi**			
4864100	Vendime Gjyqesore			
4864200	Det.Prap. Sherbime			
4864201	D.P.EneriElektirke			
4864300	Det.Prap.Mirembajtje			
4864400	Det.Prap. Investime			
4864500	Det.Prap.Rimbursi.TVSH			
4864600	Mallra			
4864900	Det.Prap.Te Tjera			
4864601	Det.Prap.Sig.Shoqerore			
4864602	Det.Prap.Sig.Shendet			
4864603	Det.Prap.Ardh.Personal			
4864604	Det.Prap.Tatime Tjera			
4864901	Paga			
4864902	Shpronesime			
4864903	Trans.indiv			
4864904	Trans.Subjektet			
III	**Totali (I+II)**	**3,158,997**	**2,011,037,617**	**0.16%**

Burimi: *Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, përpunuar nga grupi i auditimit.*

- ***Kredia e Bankës CEB*.**

Me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 37 datë 13.06.2007 është miratuar zhvillimi i projektit të investimit me objekt "Ndërtimin e Banesave me Qëllim Social" në bazë të të cilit është nënshkruar marrëveshja e nën-huasë midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bashkisë Korçë datë 13.02.2008, në kuadër të marrëveshjes së kredisë të lidhur në Gusht të vitit 2007 ndërmjet Këshillit të Ministrave si përfaqësues i Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës (CEB). Në kontabilitet evidentohet vetëm likuidimi i principalit të kësaj kredie sepse kjo kredi nuk është marrë nga Bashkia Korçë, por nga Qeveria Shqiptare sipas marrëveshjes së nën huasë së sipër përmendur ajo është përdorur për projektet e strehimit social. Bilanci i pagesave deri në fund të vitit 2025 është sipas tabelës më poshtë:

	Vitet e disbursimeve dhe pagesave sipas transheve	**Principali sipas transheve (në €)**	**Pagesa e principalit sipas transheve (në €)**	**Pagesa e principalit sipas transheve (në lekë)**	**Diferenca e mbetur pa paguar e principalit (në €)**
Transhi I	2014-2023	340,214	340,214	43,383,200	0
Transhi II	2016-2025	640,000	640,000	77,523,200	0
Transhi III	2017-2026	110,000	99,000	11,774,400	11,000
Transhi IV	2018-2027	101,386	81,109	9,816,193	20,277
TOTAL		**1,191,600**	**1,160,323**	**142,496,993**	**31,277**

Burimi: *Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, përpunuar nga grupi i auditimit.*

Për veprimet dhe mosveprimet e konstatuara përgjatë këtij materiali ngarkohen me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë S.F. në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe Drejtori i Financës dhe Buxhetit dhe MFK V.Z. në cilësinë e Nëpunësit Zbatues.

2.2.5. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave nga taksat e tarifat, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Evidentimi i detyrimeve të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

Në zbatim të nënpikës 2.6 të Programit të Auditimit nr. 735/1 prot., datë 01.07.2026, u shqyrtuar, si më poshtë:
-Vendimi i Këshillit Bashkiak Korçë për miratimin e Paketës Fiskale për periudhën e auditimit;
-Struktura organizative dhe Rregullorja e Brendshme për funksionimin dhe organizimin e Bashkisë Korçë;
-Dokumentacioni në lidhje me agjentët tatimorë, kontrata, rakordimet me ta;
-Dokumentacioni i sektorit të taksave dhe tarifave vendore në lidhje me mënyrën e mbajtjes së regjistrave të tatim-paguesve, shkarkime nga Programi Excel i mbajtjes së "Regjistrit" të taksave, dosje fizike të mbajtura për subjektet tatimpagues;
-Evidencat e debitorëve për bizneset dhe familjarët, për taksat dhe tarifat vendore;
-Aktet e rakordimit me degën e thesarit për të ardhurat;
-Dokumentacioni shkresor dhe elektronik i dhënë nga subjekti, bazuar në pyetësorët e përgatitur nga audituesi i çështjes, dosje fizike të mbajtura për subjektet tatimpagues;
-Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore në lidhje me çështjen e të ardhurave;

Baza kryesore ligjore mbi të cilën operon*:*
- Ligji nr. 68-2017, "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore".
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar.
- Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për Procedurat Tatimore", i ndryshuar.
- Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, "Për Taksat Kombëtare", i ndryshuar.
- Udhëzimi i MF nr. 12, datë 4.4.2017, "Për Taksat Kombëtare".
- Udhëzimi i MF nr. 26, datë 04.09.2008, "Për Taksat Kombëtare".
- VKM nr. 7, datë 4.01.2012 "Për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare" i ndryshuar.
- VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për Licencat e tregtimit të Hidrokarbureve", i ndryshuar.
- VKM nr. 783, datë 10.11.2011 "Për procedurat e ndarjes së të ardhurave të taksës vjetore të mjeteve të përdorura me NJQV-të".
- VKB nr. 158, datë 26.11.2024 "*Për paketën fiskale viti 2025*", etj.

Nga verifikimi i të dhënave dhe shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore (DTTV), Bashkia Korçë, rezultoi se kjo bashki ka nënadministrimin e saj janë, 7 njësi administrative (*Korçë, Drenovë, Mollaj, Vithkuq, Voskop, Voskopojë dhe Bulgarec*), si dhe 62 fshatra.

- **Burimi i krijimit të të ardhurave.**

Për vitin 2025 burimet e financimit të Bashkisë Korçë janë në vlerën totale prej 2,695,516 mijë lekë (fakti), të cilat ndahen në kategori, si vijon:
- Të ardhurat nga burimet e veta në vlerën 741,384 mijë lekë;
- Transferta nga Buxheti Qendrorë 1,828,873 mijë lekë;
- Trashëgimi nga viti i shkuar (të ardhura + grande) në vlerën 116,469 mijë lekë;
- Sponsorizime në vlerën totale prej 3,460 mijë lekë;
- Financim nga grandi Qarku në vlerën totale 1,150 mijë lekë;
- Financim nga TAP në vlerën 4,180 mijë lekë.

a) Të ardhura nga burimet e veta, zënë 27.4 % të të ardhurave të përgjithshme.
Referuar evidencave të marrë nga Drejtoria e Financës dhe të rakorduara me Degën e Thesarit, realizimi i të ardhurave në total për të gjithë bashkinë për vitin 2025 paraqitet në masën 72% ose

nga vlera prej 1,238,184 mijë lekë të planifikuar është realizuar vlera 891,101 mijë lekë, me një diferencë prej 347,083 mijë lekë, ku në mënyrë analitike për çdo zë janë analizuar si më poshtë.
Në krahasim me vitin 2024, për vitin 2025 në planifikimin e të ardhurave evidentohet një ulej për vlerën 8,028 mijë lekë, ndërsa arktimet paraqiten në rritje për vlerën 130,664 mijë lekë.
*b) Transferta nga buxheti qendror paraqitet në vlerën 1,828,873 mijë lekë***,** e cila zë 67.8 % të të ardhurave të përgjithshme.
*c) Huamarrja***.** Bashkia Korçë nuk ka marrë hua.
d) Trashëgimi nga viti i shkuar paraqitet në vlerën 116,469 mijë lekë dhe zë 4.3 % të të ardhurave të përgjithshme).
*e) Sponsorizime paraqitet në vlerën totale prej 3,460 mijë lekë***,** duke zënë 0.12 % të të ardhurave të përgjithshme.

- ***Struktura për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore*:**

Nga shqyrtimi i dokumentacioneve u konstatua se, struktura organizative e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore për vitin 2025, është miratuar me Vendim nr. 2, datë 14.01.2025, i ndryshuar me vendim nr. 2/1, datë 26.06.2025, urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Korçë, nr. 15, datë 14.01.2025, i ndryshuar me urdhrin nr. 15/1, datë 26.06.2025, është e organizuar me 38 punonjës (1+5+32), por në fakt ka funksionuar me 34 punonjës. (tabela 1).

Tabela nr. 1. *Struktura e DTTV Bashkia Korçë*

	Viti 2025	
Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore	**Struktura**	**Fakt**
Drejtor Drejtorie	**1**	**1**
Sektori i regjistrimit, vlerësimit dhe shërbimit të taksapaguesve	**5**	**4**
Përgjegjës Sektori	*1*	*1*
Specialistë	*4*	*3*
Sektori i kadastrës fiskale, vlerësimit dhe shërbimit të taksapaguesve	**4**	**4**
Përgjegjës Sektori	1	1
Specialistë	*3*	*3*
Sektori i Kontrollit dhe Verifikimit në Terren	**6**	**5**
Përgjegjës Sektori	*1*	*0*
Specialistë	*5*	*5*
Sektori i Menaxhimit të Borxhit	**5**	**4**
Përgjegjës Sektori	*1*	*1*
Specialistë	*4*	*3*
Sektori për Kontrollin dhe Mbledhjen e të Ardhurave për Njësitë Administrative	**17**	**16**
Përgjegjës Sektori	*1*	*1*
Specialistë	*16*	*15*
Punonjës gjithsej	**38**	**34**

Burimi*: Bashkia Korçë, përpunuar nga grupi i auditimit*

Arsimi dhe Vendimet e emërimit te punonjësve të DTTV, janë paraqitur në Aneksin 2.6.1, b/lidhur RPA. Për periudhën nga data 01.01.2025 deri më 31.12.2025, për planifikimin dhe arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore është hartuar dhe zbatuar *Paketa Fiskale***,** e propozuar sipas Projekt Vendimit të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë dhe miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 158 Prot, datë 26.11.2024 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Korçë, administrimin e tyre dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2025*",* konfirmuar nga Prefektura Korçë me nr. 1186/1 prot., datë 05.12.2024.
Nga shqyrtimi i përmbajtjes së paketës fiskale për vitin 2025, rezultoi se ajo ka përcaktuar rregullat mbi mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe detyrave nga organet e kësaj NJVQV, për vendosjen e nivelit të taksave dhe tarifave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre, duke strukturuar gjithë kategoritë e taksave që administrohen nga ky organ vendor, kategoritë dhe grupimet përgjegjëse të pagimit të taksave dhe strukturat përgjegjëse për mbledhjen e këtyre të ardhurave.

Në Bashkinë Korçë bëhet publikimi i VKB-ve në platformën online "Vendime.al". (Në kuadër të Reformës Territoriale dhe Administrative është miratuar platforma online Vendime.al, e cila shërben për publikim të VKB-ve). Procesi për planifikimin, përllogaritjen e detyrimeve tatimore, ndjekjen e subjekteve debitore për taksa tarifa vendore është bazuar në rakordimin e të dhënave vjetore midis DTTV Bashkia Korçë, Drejtorisë Rajonale të Tatime Taksave Korçë, Qendrës Kombëtare të Biznesit, lidhur me numrin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në territorin që administron Bashkia Korçë analizën e rezultatit historik, pritshmërinë e vitit korrent dhe koordinimit midis drejtorive/ sektorëve që mbulojnë realizimin e tyre.
DTTV Bashkia Korçë përllogaritjen e njoftim detyrimeve e bën brenda afateve të përcaktuara në paketë fiskale, dhe bën njoftimin e të gjitha subjekteve/familjeve në lidhje me detyrimet tatimore. *Evidentohen mungesa pasi mungon një adresar i plotë dhe i qartë për kategoritë Familjarë dhe Biznes (nuk përdoren metoda alternative "e-mail" për njoftimin e tatimpaguesve).*

- ***<u>Rakordimi midis DTTV Bashkia Korçë dhe Drejtorisë së Financës të Bashkisë Korçë</u>***

Nga auditimi i procesit të administrimit, rakordimit dhe raportimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për vitin 2025, u konstatua se Bashkia Korçë nuk ka vendosur dhe dokumentuar një proces të plotë, periodik dhe të formalizuar të rakordimit ndërmjet strukturave përgjegjëse për administrimin e të ardhurave, Drejtorisë së Financës, Njësive Administrative dhe strukturës së Thesarit.
Në kushtet kur Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore (DTTV) administron të dhënat mbi detyrimet e tatimpaguesve, ngarkesat fiskale dhe arkëtimet, ndërsa Drejtoria e Financës i përdor këto të dhëna për evidentimin dhe raportimin financiar, rakordimi ndërmjet këtyre strukturave përbën një element të rëndësishëm të kontrollit të brendshëm, pasi duhet të sigurojë që të dhënat mbi detyrimet e regjistruara, arkëtimet dhe të ardhurat e raportuara të jenë të plota, të sakta dhe të pajtueshme me njëra-tjetrën.
Konkretisht, nga auditimi rezultoi se:
- Akt-rakordimi analitik vjetor i të ardhurave për periudhën 01.01.2025–31.12.2025 është nënshkruar nga përfaqësuesit e Njësisë së Zbatimit, Njësisë së Autorizimit dhe Degës së Thesarit Korçë, ndërkohë që nuk rezulton të jetë kundërfirmosur nga përfaqësuesi i strukturës përgjegjëse për administrimin e taksave dhe tarifave vendore (DTTV). Për rrjedhojë, dokumenti nuk përmban konfirmimin e strukturës që administron në burim të dhënat mbi detyrimet dhe realizimin e të ardhurave vendore.
- Nuk u evidentua dokumentacion që të provojë kryerjen e një procesi formal dhe të rregullt rakordimi, periodik ose vjetor, ndërmjet DTTV dhe Drejtorisë së Financës për të ardhurat e realizuara nga taksat dhe tarifat vendore. Gjithashtu, nuk rezulton të jetë vendosur një procedurë e dokumentuar për përcjelljen zyrtare të informacionit nga DTTV në Drejtorinë e Financës, duke përcaktuar burimin, periodicitetin, përgjegjësin dhe mënyrën e konfirmimit të të dhënave.
- Nuk rezultoi e dokumentuar kryerja e rakordimeve ndërmjet DTTV dhe Njësive Administrative për të dhënat që lidhen me ngarkesën tatimore, detyrimet e regjistruara, pagesat dhe detyrimet e mbetura të papaguara. Për pasojë, nuk sigurohet një gjurmë e plotë dokumentare që dëshmon se informacioni i administruar në nivel të njësive administrative është pajtuar me të dhënat e regjistruara në strukturën përgjegjëse për taksat dhe tarifat vendore.
- Për përgatitjen e informacionit financiar, Drejtoria e Financës përdor, ndër të tjera, të dhëna të nxjerra nga regjistri elektronik dhe përpunime manuale në Excel. Në mungesë të një procedure të formalizuar për kontrollin, rakordimin dhe miratimin e këtyre të dhënave, përpunimi manual rrit ekspozimin ndaj gabimeve në hedhje, ndryshimeve të paidentifikuara, mospërputhjeve ndërmjet burimeve të informacionit dhe vështirësive në identifikimin e origjinës së të dhënave të përdorura në raportimin financiar.

Për sa më sipër, problematika nuk lidhet vetëm me mungesën e një nënshkrimi në akt-rakordim, por me faktin se **nuk rezulton të jetë ngritur një mekanizëm i dokumentuar dhe i përsëritshëm për verifikimin dhe konfirmimin reciprok të të dhënave të të ardhurave vendore ndërmjet strukturave që i administrojnë, i përpunojnë dhe i raportojnë ato**.

Kjo situatë dobëson gjurmën e auditimit dhe sistemin e kontrollit të brendshëm, pasi nuk mundëson që në mënyrë të qartë të identifikohet burimi i të dhënave, personi përgjegjës për përgatitjen dhe verifikimin e tyre, kontrollet e kryera, diferencat e konstatuara dhe mënyra e trajtimit të tyre.

Situata e konstatuar lidhet me mungesën e një procedure të unifikuar dhe të miratuar nga Bashkia Korçë për rakordimin e të dhënave të të ardhurave vendore ndërmjet DTTV, Drejtorisë së Financës dhe Njësive Administrative, si dhe me mungesën e përcaktimit të qartë të përgjegjësive, periodicitetit, dokumentacionit dhe mënyrës së trajtimit të diferencave të konstatuara gjatë rakordimit.

Mungesa e një procesi të formalizuar dhe të dokumentuar rakordimi krijon risk për:

- pasaktësi në evidentimin dhe raportimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore;
- mospërputhje ndërmjet detyrimeve të regjistruara, arkëtimeve dhe të ardhurave të raportuara;
- mosidentifikim në kohë të diferencave dhe gabimeve në të dhënat fiskale;
- dobësim të gjurmës së auditimit dhe të kontrolleve të brendshme;
- rritje të varësisë nga përpunimet manuale dhe nga kontrollet individuale të punonjësve;
- cenim të besueshmërisë dhe plotësisë së informacionit financiar të përdorur për raportim dhe vendimmarrje.

Në këto kushte, ekziston risku që diferencat ndërmjet të dhënave të administruara nga strukturat përgjegjëse për taksat dhe tarifat vendore dhe të dhënave të përdorura për raportimin financiar të mos evidentohen dhe korrigjohen në kohë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, nenin 16, *mbi përgjegjësitë e drejtuesve për krijimin dhe funksionimin e kontrolleve të brendshme*; nenin 19, *mbi aktivitetet e kontrollit dhe dokumentimin e proceseve*; Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, *në lidhje me administrimin e saktë të detyrimeve tatimore, mbajtjen e evidencave dhe gjurmueshmërinë e tyre;* Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, *që ngarkon njësitë e vetëqeverisjes vendore me administrimin dhe mbledhjen e saktë të taksave dhe tarifave vendore (*neni 5, pika "ç";).

- ***<u>Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve</u>***:

Paketa fiskale e aplikuar nga Bashkia Korçë për periudhën nga data 01.01.2025, deri më 31.12.2025, është miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr**.** 158, date 26.11.2024 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Korçë, administrimin e tyre dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2025", konfirmuar nga Prefektura Korçë me nr. 1086/1 prot, datë 05.12.2024.

Paguesit e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Korçë janë bizneset, institucionet dhe familjet e të gjithë njësive administrative. Për përcaktimin e numrit të tyre janë konsideruar të dhënat e regjistrave të taksapaguesve, si dhe përjashtimet apo lehtësitë fiskale sipas paketës fiskale të miratuar nga Këshilli Bashkiak.

Nga të dhënat e paraqitura rezulton se për periudhën objekt auditimi, janë gjithsej 3,468 subjekte biznesi që kanë ushtruar aktivitet në fillim të vitit dhe për të cilat janë planifikuar taksa dhe tarifa vendore, siç paraqiten në tabelën nr. 2, si më poshtë:

Tabela nr.2: Evidenca e *subjekteve që kanë ushtruar aktivitet dhe për të cilat janë planifikuar taksa dhe tarifa vendore*

Nr.	Lloji Biznesit	Viti	Gjendja në fillim	Regjistrime te reja	Mbyllur aktivitet	Pezulluar	Pasive	Gjëndja në fund të vitit
A	B							
1	Biznesi Vogël	2024	2590	309	185	54		2660
		2025	2660	319	161	47		2771
2	Biznesi Madh	2024	803	36	22	9		808
		2025	808	54	16	1		845
(1+2)	Gjithsej	2024	3393	345	207	63		3468
		2025	**3468**	**373**	**177**	**48**	**97**	**3519**

Burimi: *DTTV Bashkia Korçë*

Nga auditimi rezultoi se në fund të vitit 2023 regjistri i subjekteve aktive ka qenë 3,393 subjekte kjo e dokumentuar me shkresën nr. 10,549 prot, datë 29.12.2023 në protokollin e Bashkisë Korçë. Ky nr. shërben si fillim i vitit 2024. Po në fund të vitit 2024 është protokolluar shkresa nr. 12,572 prot, datë 31.12.2024 me nr. aktiv biznesesh 3,450 subjekte i cili ka reflektuar të gjitha veprimet e bëra pranë QKB deri në muajin Nëntor të viti 2024 pasi veprimet e kryera në muajin Dhjetor pasqyrohen ne muajin Janar të vitit pasardhës. Gjatë viti 2025 më shkresën nr. 7,775 prot, datë 22.08.2025 është dërguar nga DRT lista e subjekteve që kishin kaluar pasivë ndër vite më nr. 97 subjekte të cilët kishin kaluar në status pasiv, transferuar, et.. Në fund të vitit 2025 referuar shkresë nr. 13,922/3 prot, datë 31.12.2025 me nr. aktiv biznesesh 3,475 subjekte i cili ka reflektuar të gjitha veprimet e bëra pranë QKB deri në muajin Nëntor të viti 2025 pasi veprimet e kryera në muajin Dhjetor pasqyrohen ne muajin Janar të vitit pasardhës. Të dhënat në tabelë janë gjeneruar në momentin e auditimit ku janë reflektuar dhe ndryshimet e bëra gjatë vitit 2026 për periudhën e vitit 2025.

Sipas dokumentacionit në dosjen e sektorit të kontrollit në terren, u konstatua se për të gjitha subjektet që janë klasifikuar pasiv dhe me mbyllje, janë kryer kontrolle të vazhdueshme për verifikimin e statusit të tyre sipas vetëdeklarimti të bërë.

- ***Analiza e realizimin e të ardhurave (taksa e tarifa vendore), Plan-Fakt për periudhën objekt auditimi, 01.01.2025 deri më 31.12.2025 konfirmuar nga Dega e Thesarit Korçë, sipas pasqyrës:***

Tabela nr.3: *Realizimi dhe planifikimi i të ardhurave vjetore 2025*

Nr.	Lloji Taksës	Viti 2024			Viti 2025		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
A	**TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE**	**626,963**	**281,791**		**614,434**	**321,257**	
1	TAKSË MBI NDËRTESËN	**207,129**	**131,333**	**63%**	**198,377**	**156,288**	**79%**
	a) taksë ndërtese për familje	109,932	62,110		98,553	69,955	
	b) taksë ndërtese për biznes	97,197	69,223		99,824	86,333	
2	TAKSË MBI TRUALLIN	**24,673**	**19,967**	**81%**	**28,470**	**15,021**	**53%**
	a) taksë trualli për familje	5,105	1,177		5,095	911	
	b) taksë trualli për biznes	19,568	18,790		23,375	14,110	
3	TATIM MBI TOKËN BUJQËSORE	57,863	26,432	46%	57,860	25,742	44%
4	TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN PËR BIZNESIN E VOGËL	2,500	1,552	**62%**	700	937	**134%**
5	TAKSË NDIK.INFRAST. NGA NDËRTIMET E REJA	280,000	78,544	**28%**	280,000	95,003	**34%**
6	TAKSË NDIK.INFRAST.NGA LEGALIZIMET	36,798	6,727	**18%**	28,000	7,806	**28%**
7	TAKSË HOTELI	8,000	8,901	**111%**	9,000	10,187	**113%**
8	TAKSË TABELE	10,000	8,335	**83%**	12,027	10,273	**85%**
B	**TË ARDHURA JO TATIMORE**	**493,549**	**382,699**		**508,355**	**458,003**	
1	TARIFË PASTRIMI	**202,768**	**166,159**	**82%**	**194,856**	**170,486**	**87%**
	a) tarifë pastrimi për familje	*104,484*	*84,268*		*98,277*	*87,521*	
	b) tarifë pastrimi për biznes	*96,128*	*80,280*		*94,537*	*81,159*	

Nr.	Lloji Taksës	Viti 2024			Viti 2025		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
	c) tarifë pastrimi për institucione/ojf	*2,156*	*1,611*		*2,042*	*1,806*	
2	TARIFË NDRIÇMI	**57,581**	**47,786**	**83%**	**59,920**	**51,129**	**85%**
	a) tarifë ndriçimi për familje	*27,988*	*22,212*		*28,168*	*24,383*	
	b) tarifë ndriçimi për biznes	*28,993*	*25,143*		*31,194*	*26,263*	
	c) tarifë ndriçimi për institucione/ojf	*600*	*431*		*558*	*483*	
3	TARIFË GJELBËRIMI	**38,216**	**30,879**	**81%**	**38,279**	**33,106**	**86%**
	a) tarifë gjelbërimi për familje	*15,484*	*12,171*		*14,280*	*13,543*	
	b) tarifë gjelbërimi për biznes	*22,212*	*18,333*		*23,515*	*19,143*	
	c) tarifë gjelbërimi për institucione/ojf	*520*	*375*		*484*	*420*	
4	TARIFË MIRËMBAJTJE VARREZA	17,033	13,835	**81%**	16,793	13,854	**82%**
5	TARIFË VJETORE E MIRËMBAJTJES SË SISTEMIT TË UJITJES	28,907	10,820	**37%**	29,266	11,885	**41%**
6	TARIFË REGJISTRIMI PËR LEJE TRANSPORTI	1,300	1,476	**114%**	1,555	1,296	**83%**
7	TARIFË VENDORE PËR SHQYRTIM LEJE ZHVILLIMI	1,375	450	**33%**	1,000	525	**53%**
8	TARIFË PËR LEJE NDËRTIMI	700	258	**37%**	700	229	**33%**
9	ÇERTIFIKATË PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI	425	530	**125%**	510	524	**103%**
10	MIRATIM PROJEKTI	1,500	965	**64%**	1,000	1,165	**117%**
11	TË ARDHURA TË TJERA (vertetime,çertifikata etj.)	6,755	8,605	**127%**	22,862	71,783	**314%**
12	TARIFË PËR SERVITUTIN E KALIMIT NË PRONË PUBLIKE	1,339	806	**60%**	548	880	**161%**
13	TARIFË PARKIMI	22,000	19,522	**89%**	23,970	19,126	**80%**
14	TARIFË MUR PERIMETRAL	2,000	759	**38%**	2,000	773	**39%**
15	TARIFË PËR ZENIE HAPESIRE PUBLIKE	27,699	21,723	**78%**	28,861	18,999	**66%**
16	TARIFË PËR DEPOZITIMIN E MBETJEVE INERTE	6,750	1,093	**16%**	3,500	1,781	**51%**
17	QERA OBJEKTI + QERA TRUALLI + QERA TOKA BUJQESORE	9,018	9,612	**107%**	11,756	9,280	**79%**
18	SHËRBIME ZJARRFIKSE NË OBJEKTE TË SIG.	50	0	**0%**	30	0	**0%**
19	SHËRBIME ZJARRFIKSE NDAJ TE TRETEVE	30	0	**0%**	40	35	**0%**
20	MARRJE ME QERA PYLLI (KULLOTA+TOKE BUJQESORE)	8,031	5,661	**70%**	8,556	6,328	**74%**
21	TË ARDH.NGA SHITJA E DRUVE	100	0	**0%**	100	0	**0%**
22	VËRTETIME TRANSPORTI	70	30	**43%**	30	21	**70%**
23	PRODHIME TË DYTA MEDICINALE	1,000	0	**0%**	1,000	0	**0%**
25	GJOBA POLICIA BASHKIAKE	1,400	346	**25%**	2,000	604	**30%**
26	GJOBË PËR VONESË NË PAGESË	6,000	7,116	**119%**	8,541	8,904	**104%**
27	GJOBA TË DREJT. SË KONTROLLIT TË TERRITORIT	200	40	**20%**	100	60	**60%**
28	GJOBA INSPEKTORIATI I NDËRTIMIT	2,500	1,573	**63%**	2,500	1,736	**69%**
29	GJOBA TË DREJTORISË SË TË ARDHURAVE	200	180	**90%**	220	140	**64%**
30	TË ARDHURA NGA INSTITUCIONET E VARËSISË	38,818	21,232	**55%**	35,960	21,911	**61%**
31	TË ARDH.NGA QERATË,BANESA SOCIALE	7,050	8,133	**115%**	8,513	8,261	**97%**
32	TË ARDHURA NGA BANESA SHTETËRORE	84	102	**121%**	72	67	**93%**
33	QERA NGA BANESAT NË PRON.TË BASHKISË, ENTI BANESAVE	149	96	**64%**	524	97	**19%**
34	KAMAT VONESA (QIRA OBJEKTI)	300	233	**78%**	180	346	**192%**
35	TË ARDHURA NGA PRIVATIZIMI I BANESAVE	2,201	2,679	**122%**	2,613	2,672	**102%**
C	**TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA**	**125,700**	**95,947**		**115,400**	**111,841**	
1	TATIM SHITJE PASURI E PALUAJTSHME	25,000	7,634	**31%**	15,000	13,651	**91%**
2	TAKSË REGJISTRIMI E PËRVITSHME (AUTOMJETE)	55,000	51,043	**93%**	55,000	54,440	**99%**
3	RENTA MINERARE	700	275	**39%**	400	186	**47%**
4	DIVIDENTI NGA U.K.KO	0	0	**0%**	0	0	**0%**
5	DIVIDENTI NGA KRËM	0	1,421	**0%**	0	0	**0%**
6	TATIMI MBI TE ARDHURAT PERSONALE	45,000	35,574	**79%**	45,000	43,564	**97%**
A+B+C	**TOTALI**	**1,246,212**	**760,437**	**61%**	**1,238,189**	**891,101**	**72%**

Burimi: *DTTV bashkia Kocë*

Në të ardhurat nga burimet e veta vendore përfshihen:

1. Të *ardhurat nga taksat vendore;*
2. *Të ardhurat nga taksat e ndara;*
3. *Të ardhurat jotatimore;*

Analiza e strukturës së të ardhurave vendore tregon se burimet kryesore të financimit për vitin 2025, dominohen nga të ardhurat jotatimore, taksa vendore dhe taksa e ndarë, të cilat së bashku përbëjnë 72% të totalit të të ardhurave;

1. *Të ardhurat nga taksat vendore* – përbëjnë **36%** të totalit të të ardhurave
2. *Të ardhurat nga taksat e ndara* – përbëjnë **12.5%** të totalit të të ardhurave
3. *Të ardhurat jotatimore* – përbëjnë **51.5%** të totalit të të ardhurave

Niveli i realizimit vjetor të të ardhurave*:* Për vitin 2025, planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën 1,238,189,865 lekë, ndërsa realizimi është në vlerën 891,101,462 lekë, ose 72 % e planit vjetor ose 347,088 mijë lekë më pak se planifikimi buxhetor. Krahasuar me vitin 2024, kur të ardhurat e realizuara paraqiteshin në masën 760,437 mijë lekë, realizimi në vitin 2025 paraqitet në vlerën 130,663 mijë lekë më shumë se viti 2024 ose 17%, si tregohet në tabelën nr. 4.

Tabela nr. 4, *Tregues të performancës së të ardhurave vendore*

Treguesi	Fakt 2024 (lekë)	Plan 2025 (lekë)	Fakt 2025 (lekë)	Fakt 2025 / Plan 2025 (në %)	Fakt 2025 / Fakt 2024 (në %)
Gjithsej të ardhura	**760,437,623**	**1,246,212,471**	**891,101,462**	**72%**	**117%**

Burimi: *DTTV bashkia Korçë, përpunuar nga grupi i KLSH, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

Sipas Vendimit KB Korçë nr. 176, datë 26/12/2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe buxhetit dhe nr. e punonjësve dhe dokumentin përfundimtar të BA 2025-2027", konfirmuar nga Prefektura Korçë me nr.12404/3 prot., datë 09/01/2025 plani i të ardhurave totale nga burimet e veta vendore për vitin 2025 është *parashikuar* në shumën plan 1,237,946 mijë lekë.

Me vendim të KB Korçë nr. 76, datë 31/07/2025 " Për miratimin e rritjes së planit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore në vlerën 243,812.5 lekë dhe kryerjen e pagesës për kthimin e shumës në po këtë vlerë për llogari të "Telekom Albania sh.a, One telecommunication".

Referuar VKB nr.89, datë 25/06/2026 "Për miratimin e buxhetit faktik të vitit 2025", konfirmuar nga Prefektura Korçë me nr.6806/1 prot., datë 03/07/2026 të ardhurat e veta nga 1,238,190 mijë lekë të programuara , *janë realizuar vetëm për* 891,101 mijë lekë ose 72% tyre.

Nga auditimi rezulton se,


- ***për vitin 2024*** planifikimi i taksave dhe tarifave vendore është: në masën 1,246,212,471 lekë ndërsa realizimi 760,437,623 lekë, ose në nivelin 61%, ku ka rezultuar diferencë mosrealizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën – 485,774,848 lekë.
- ***Për vitin 2025,*** planifikimi i taksave dhe tarifave vendore është 1,238,189,865 lekë, ndërsa realizimi 891,101,462 lekë, ose në nivelin 72%, ku ka rezultuar diferencë mosrealizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën – 347,088,403 lekë.

Konstatim*:* Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore rezulton se, *niveli i realizimit të të ardhurave vjetore ka ardhur në rritje nga 61% në vitin 2024, në 72% në vitin 2025, ndërkohë që vlera e mosrealizimit është ulur me 138,686,445 lekë (nga 347,088,403 lekë në vitin 2025 – 485,774,848 lekë mosrealizim për vitin 2024).*

Referuar evidencës së rakodimit mbi të ardhurat, evidentohet fakti se disa nga zërat paraqitet me realizim dhe disa të tjera me mos realizim. Planifikimi i të ardhurave duhet të mbështetet në analiza realiste të potencialit fiskal, të dhënat historike të arkëtimeve, bazën e tatimpaguesve dhe faktorët ekonomik që ndikojnë në mbledhjen e të ardhurave, me qëllim sigurimin e një planifikimi të saktë dhe të realizueshëm.

Si pasojë e mosrealizimit të të ardhurave krijohen devijime midis planifikimit dhe realizimit të buxhetit, ndikohet negativisht financimi i shpenzimeve dhe investimeve të planifikuara dhe ulet besueshmëria e procesit të planifikimit buxhetor dhe e projeksioneve financiare të njësisë vendore. Nga sa më sipër, del se për dy vite radhazi, planifikimi i të ardhurave rezulton i pa studiuar dhe i mbivlerësuar, pasi realizimi mbetet nën 72% të planit, ndërsa diferenca e mosrealizimit është në ulje nga një vit në tjetrin. Kjo tregon mangësi në disa zëra në procesin e planifikimit buxhetor.

Të ardhurat vjetore 2024 dhe 2025 (plan dhe realizim), Bashkia Korçë



Burimi: Të dhënat Bashkia Korçë.

- *Analiza e treguesve të performancës sipas tabelës së mësipërme evidenton se në Bashkinë Korçë,*
  - ✓ Realizimi i planit të të *ardhurave vjetore gjithsej*, sipas treguesve të rakorduar me DTTV Korçë është 72% = {(891,101,462.67 / 1,238,189,865.5) × 100};
  - ✓ Diferenca ndaj planit ose mosrealizimi i të ardhurave të miratuara dhe programuara në kuadër të buxhetit vjetor dhe paketës fiskale është për - 347,088,402.83 lekë =(891,101,462.67 – 1,238,189,865.5), ose 28 % e panit vjetor të miratuar për vitin 2025.
  - ✓ Realizimi i vitit 2025 ndaj vitit 2024 është me një rritje prej + 17%, ose nivel realizimi 117 % = (891,101,462 / 760,437,623 × 100). Kjo rritja në vlerë ndërmjet faktit të dy viteve të analizuara nga grupi i auditimit është + 130,662,839 lekë.

Për vitin 2025, niveli i realizimit të të ardhurave në vlerën 891,101,462.67 lekë është ndikuar nga rritja e arkëtimeve në disa zëra, si taksa mbi tokën ndërtesën më një vlerë prej 24,955,040 lekë, taksa për ndërtimet e reja me një vlerë prej 16,459,161 lekë, të ardhurat e tjera me një vlerë prej 61,215,874.9 lekë, tatim mbi shitjen e pasurive të paluajtshme me një vlerë prej 6,016,133 lekë, tatimi mbi të ardhurat personale me një vlerë prej 7,990,190 lekë, etj. Gjithashtu kanë rezultuar dhe taksa apo tarifa të cilat kanë përformuar negativisht krahasuar me vitin 2024 siç janë; taksa mbi truallin me – 4,946,442.9 lekë, tarifa për zënien e hapësirave publike me një vlerë prej -2,724,053 lekë etj. Megjithatë, mosrealizimi i planit lidhet kryesisht me performancën më të ulët në disa tarifa dhe taksa vendore, duke bërë që realizimi total të mbetet nën nivelin e planifikuar.
Në përfundim, megjithëse të ardhurat e veta kanë shënuar rritje krahasuar me vitin paraardhës, niveli i realizimit prej 72% ndaj planit shpjegon nevojën për forcimin e masave administrative dhe përmirësimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm në lidhje me mbledhjen e të ardhurave vendore, me qëllim rritjen e eficiencës fiskale dhe përmbushjen e objektivave buxhetore të Bashkisë Korçë, në kundërshtim me Nenin 42 Administrimi i mjeteve monetare i Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".

- ***Analiza e të ardhurave sipas kategorive.***

I. Të ardhurat nga taksat vendore, janë realizuar në masën 52 % kundrejt planit *(realizuar* 320,319 *mijë lekë nga* 613,734 *mijë lekë të planifikuar);* dhe 114%, në krahasim me vitin e mëparshëm. Gjithashtu vërehet një mosrealizim kundrejt planit në vlerën 293,415 mijë lekë dhe një ulje e mosrealizimit krahasuar me vitin 2024 në vlerën 51,757 mijë lekë Mosrealizimi në krahasim me planin arsyetohet kryesisht:

- nga taksa e ndikimit ne infrastrukturë, është realizuar 34 % me nivel mosrealizimi prej 184,997 mijë lekë;
- taksa mbi ndërtesën është realizuar 79 % me nivel mosrealizimi prej -42,089 mijë lekë;
- taksa mbi truallin është realizuar 53 % me nivel mosrealizimi prej -13,450 mijë lekë;

- taksa mbi tokën bujqësore është realizuar 44 % me nivel mosrealizimi prej -32,118 mijë lekë;
- taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet është realizuar 28 % me nivel mosrealizimi prej -20,194 mijë lekë;
- taksa e fjetjes në hotel është realizuar 113 % me nivel tejkalimi prej +1,186 mijë lekë;
- taksa e tabelës është realizuar 85 % me nivel mosrealizimi prej -1,754 mijë lekë, siç tregohet në tabelën nr. 5;

Tabela 5: *Të ardhurat nga taksat vendore 2024-2025.*

Nr.	Lloji Taksës	Viti 2024			Viti 2025		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
	TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE	**626,963**	**281,791**		**614,434**	**321,257**	
1	TAKSË MBI NDËRTESËN	**207,129**	**131,333**	**63%**	**198,377**	**156,288**	**79%**
	a) taksë ndërtese për familje	109,932	62,110		98,553	69,955	
	b) taksë ndërtese për biznes	97,197	69,223		99,824	86,333	
2	TAKSË MBI TRUALLIN	**24,673**	**19,967**	**81%**	**28,470**	**15,021**	**53%**
	a) taksë trualli për familje	5,105	1,177		5,095	911	
	b) taksë trualli për biznes	19,568	18,790		23,375	14,110	
3	TATIM MBI TOKËN BUJQËSORE	57,863	26,432	46%	57,860	25,742	44%
4	TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN PËR BIZNESIN E VOGËL	2,500	1,552	**62%**	700	937	**134%**
5	TAKSË NDIK.INFRAST. NGA NDËRTIMET E REJA	280,000	78,544	**28%**	280,000	95,003	**34%**
6	TAKSË NDIK.INFRAST.NGA LEGALIZIMET	36,798	6,727	**18%**	28,000	7,806	**28%**
7	TAKSË HOTELI	8,000	8,901	**111%**	9,000	10,187	**113%**
8	TAKSË TABELE	10,000	8,335	**83%**	12,027	10,273	**85%**

Burimi: Bashkia Korçë

II. Të ardhurat jo tatimore, janë realizuar në masën 90 % kundrejt planit *(realizuar* 458,941 *mijë lekë nga* 509,055 *mijë lekë të planifikuar);* dhe 119%, në krahasim me vitin e mëparshëm. Gjithashtu vërehet një mosrealizim kundrejt planit në vlerën 50,114 mijë lekë dhe një ulje e mosrealizimit krahasuar me vitin 2024 në vlerën 59,315 mijë lekë.

Mosrealizimi në krahasim me planin arsyetohet kryesisht:

- nga tarifa e pastrimit, është realizuar 87 % me nivel mosrealizimi prej -24,370 mijë lekë;
- nga tarifa e ndriçimit, është realizuar 85 % me nivel mosrealizimi prej -8,790 mijë lekë;
- nga tarifa e gjelbërimit, është realizuar 86 % me nivel mosrealizimi prej -5,172 mijë lekë;
- nga tarifa e mirëmbajtjes së varrezave publike, është realizuar 83 % me nivel mosrealizimi prej -12,175 mijë lekë
- nga tarifa e zënies së hapësirës publike, është realizuar 66 % me nivel mosrealizimi prej -9,862 mijë lekë;
- nga tarifa e regjistrimit për leje transporti, është realizuar 83 % me nivel mosrealizimi prej -259 mijë lekë;
- nga tarifa e murit perimetral, është realizuar 39 % me nivel mosrealizimi prej -1,226 mijë lekë;
- nga tarifa e parkimit, është realizuar 80 % me nivel mosrealizimi prej -4,844 mijë lekë;
- nga të ardhura të tjera, është realizuar 305 % me nivel tejkalimi prej +49,490 mijë lekë;

Nga analizimi i këtij zëri rezultoi se totali i arkëtuar nga të ardhurat e tjera është në nivel shumë të lartë arkëtuar kundrejt planit. Krahasuar me vitin e kaluar këto të ardhura janë rritur me 494% të planit. Nga auditimi u vu re fakti që gjatë vitit 2025 janë arkëtuar 48,080,932 lekë kontribut në fondin publik të banesave sociale për të cilën në buxhet nuk ka pasur planifikim.

- certifikata mbrojtje nga zjarri, është realizuar 103 % me nivel tejkalimi prej +14 mijë lekë;
- miratim projekti, është realizuar 117 % me nivel tejkalimi prej +165 mijë lekë;
- shërbim zjarrfikëse ndaj të tretëve, është realizuar 88 % me nivel mosrealizimi prej -5 mijë lekë;
- marrje më qira pylli, kullota dhe tokë bujqësore, është realizuar 74 % me nivel mosrealizimi prej -2,228 mijë lekë;
- vërtetime transporti, është realizuar 70 % me nivel mosrealizimi prej -9 mijë lekë;

- nga gjobat e policisë bashkiake, është realizuar 30 % me nivel mosrealizimi prej -1,395 mijë lekë;
- nga gjoba për vonesë në pagesë, është realizuar 104 % me nivel tejkalimi prej +363 mijë lekë;
- nga gjoba inspektorati i ndërtimit, është realizuar 69 % me nivel mosrealizimi prej -763 mijë lekë;
- nga gjobat e DKT, është realizuar 60 % me nivel mosrealizimi prej -40 mijë lekë;
- nga gjobat e DTTV, është realizuar 64 % me nivel mosrealizimi prej -80 mijë lekë;
- qira objekti, trualli, tokë bujqësore është realizuar 53 % me nivel mosrealizimi prej -475 mijë lekë;
- tarifë për lejë ndërtimi është realizuar 33 % me nivel mosrealizimi prej -471 mijë lekë;
- të ardhura nga institucionet e varësisë është realizuar 61 % me nivel mosrealizimi prej -14,048 mijë lekë;
- të ardhura na qira banesa sociale është realizuar 97 % me nivel mosrealizimi prej -251 mijë lekë;
- të ardhura nga banesa shtetërore është realizuar 94 % me nivel mosrealizimi prej -4 mijë lekë;
- qira nga banesat në pronësi të bashkisë është realizuar 18 % me nivel mosrealizimi prej -427 mijë lekë;
- privatizim banese është realizuar 102 % me nivel tejkalimi prej +58 mijë lekë;
- kamatëvonesa qira objekti është realizuar 192 % me nivel tejkalimi prej +166 mijë lekë;
- tarifë për depozitim mbetje inerte është realizuar 51 % me nivel mosrealizimi prej -1,719 mijë lekë;
- tarifë vjetore SH.M.RR,&S.K është realizuar 41 % me nivel mosrealizimi prej -17,381 mijë lekë, siç tregohet në Aneksin 2.6.2, b/lidhur RPA;

III. Të ardhurat nga taksat e ndara, janë realizuar në masën 97 % kundrejt planit *(realizuar* 111,840 *mijë lekë nga* 115,400 *mijë lekë të planifikuar);* dhe 118%, në krahasim me vitin e mëparshëm. Gjithashtu vërehet një mosrealizim kundrejt planit në vlerën -3,559 mijë lekë dhe një ulje e mosrealizimit krahasuar me vitin 2024 në vlerën 27,614 mijë lekë.
Mos realizimi në krahasim me planin arsyetohet kryesisht:

- nga tatim shitje pasuri e paluajtëshme, është realizuar 91 % me nivel mosrealizimi prej -1,350 mijë lekë;
- nga taksë regjistrimi e përvitshme automjete, është realizuar 99 % me nivel mosrealizimi prej -559 mijë lekë;
- nga renta minerare, është realizuar 46 % me nivel mosrealizimi prej -213 mijë lekë;
- nga tatim mbi të ardhurat personale, është realizuar 97 % me nivel mosrealizimi prej -1,435 mijë lekë, siç tregohet ne tabelën nr. 6;

Tabela nr. 6, *Të ardhurat e tjera vendore 2024-2025*

Nr.	Lloji Taksës	Viti 2024			Viti 2025		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
	TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	**125,700**	**95,947**		**115,400**	**111,841**	
1	TATIM SHITJE PASURI E PALUAJTSHME	25,000	7,634	**31%**	15,000	13,651	**91%**
2	TAKSË REGJISTRIMI E PËRVITSHME (AUTOMJETE)	55,000	51,043	**93%**	55,000	54,440	**99%**
3	RENTA MINERARE	700	275	**39%**	400	186	**47%**
4	DIVIDENTI NGA U.K.KO	0	0	**0%**	0	0	**0%**
5	DIVIDENTI NGA KRËM	0	1,421	**0%**	0	0	**0%**
6	TATIMI MBI TE ARDHURAT PERSONALE	45,000	35,574	**79%**	45,000	43,564	**97%**

Burimi: *DTTV bashkia Korçë, përpunuar nga grupi i KLSH.*

- **Agjentët tatimorë dhe rakordimet me ta:**

Rregullorja e Brendshme e institucionit në fuqi për vitin 2025 Bashkia Korçë është miratuar me Vendimin nr. 142, datë 01.03.2021, të Këshillit të Bashkisë, ku ndër të tjera janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e DTTV (neni 59, pika 59.2.2), ku përcaktohet personi i cili mban rakordimet.

Të ardhurat nga Agjentët Tatimorë (Drejtorinë e Shërbimeve të Transportit Rrugor), Drejtoria e Doganave, Drejtoria e Doganave Korçë, Drejtori Rajonale e Tatimeve Korçë, ku nga DRT Korçë nuk janë kundërfirrmuar, kjo vetëm për TAP.

Tabela nr. 7, *Shkresa mbi informimin e pjesës takuese të Bashkisë, Korçë sipas agjenteve tatimore*

Agjenti Tatimor	Lloji i Taksës	Vlera e realizuar Viti 2024	Vlera e realizuar Viti 2025
Drejtoria Rajonale Tatimore	Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin	989,080	366,646
Drejtoria e Përgjith e Shërbim të Transport Rrugor, Drejtoria Rajonale Korçë	Taksa vjetore e mjeteve të përdorura	51,043,386	54,440,030
SH.R.U.K.KO	Taksa & Tarifa Vendore Familjare	180,496,615	199,362,750
D. R. T Korçë; D.R.T Tiranë Tatimpag e Mëdhenj e Drejtori e Përgjithshme e Dogana	Renta Minerare	275,079	185,941
Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Korçë	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë	7,634,432	13,650,565
	Totali	**240,438,592**	**268,005,932**

Burimi*: DTTV Bashkia Korçë*

Rakordimi analitik vjetor, i dokumentuar i të ardhurave të periudhës 1 Janar -31 Dhjetor 2025 është bërë duke nënshkruar NZ për vitin 2025 V.Z., NA për vitin 2025 zv/Kryetari i Bashkisë K.K., si dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Korçë, Përgjegjësi E.S. dhe specialistja e të ardhurave J.K..

Drejtoria e Financës përdor për veprimtarinë e saj rakordimin e kryer më Degën e Thesarit. DTTV përdor për veprimtarinë e saj rakordimin e kryer më Degën e Thesarit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Financës, e cila krijohet nga procesi i përpunimit në formatin *Excel* i informacionit të grumbulluar në regjistrin elektronik vjetor (me të dhëna mbi informacionin historik të detyrimeve të subjekteve tatimpaguese) si dhe nga informacionet që paraqesin drejtoritë/sektorët të cilat administrojnë taksa dhe tarifa vendore bazuar në paketën fiskale. Procesi i përpunimit kryhet manualisht.

Konstatim:

- Mungon rakordimi me kundërfirmmim i të ardhurave midis Drejtorisë së Financës dhe DTTV Bashkia Korçë apo dërgimi shkresor i të ardhurave vjetore nga kjo e fundit tek drejtoria përgjegjëse për financat vendore në këtë bashki. Në këtë rast Drejtoria e Financës mjaftohet vetëm me informacionin e marrë në mënyrë elektronike nga DTTV
- Ka një proces rakordimi të mbajtur nga DTTV Bashkia Korçë me NJA mbi të dhënat e ngarkuar nga ana e NJA-të për ngarkesën tatimore dhe likuidimet e kryera. Por kjo nuk dokumentohet në fund të vitit në zyrën e protokollit.

Këto veprime *janë në kundërshtim* me përcaktimet e dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi: Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 4 pika 26, neni 5, neni 11; Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 9, neni 35, neni 41; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika "ç"; Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, *"*Për procedurat tatimore në Republikës së Shqipërisë*",* i ndryshuar etj.

Në zbatim të Ligjit nr. 10458, datë 21.07.2011 për disa ndryshime në ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare", të ndryshuar dhe në mbështetje të germës "b", të pikës 2, në nenin 25 "*Të ardhurat nga taksat e ndara*", taksat kombëtare që ndahen me njësitë e vetëqeverisjes vendore janë:

a) 97 për qind e të ardhurave nga taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme për individë, personat fizikë dhe juridikë;

b) 25 për qind e të ardhurave nga taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura;

c) 5 për qind e të ardhurave nga renta minerare, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për taksat kombëtare;
ç) 2 për qind e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale.
Të ardhurat e arkëtuara nga taksat e ndara transferohen te njësitë e vetëqeverisjes vendore deri në fund të muajit pasardhës.
a- Për vitin 2025, ndërmjet Bashkisë Korçë dhe DRT- Korçë janë mbajtur akt-rakordime mujore në lidhje me tatimin e thjeshtuar të fitimit dhe rentës minerare. Nga auditimi i tyre rezultoi:

Periudha	D.R.T Shuma e arketuar gjate muajit	5% i Bashkisë	EVIDENCA 2025	Date nr.prot	DOGANA	Date nr.prot	Tatipag e medhenj	Date nr.prot
Nëntor 2024	498,982.0	24,949	reflektuar ne evidencën e muajit mars 2025	nr. 12234 prot. Dt/23.12.2024				
Dhjetor 2024	482,155.0	24,108	reflektuar ne evidencën e muajit mars 2025	nr. 432 prot. Dt/17.01.2025				
Janar 2025	202,526.0	10,126	reflektuar ne evidencën e muajit prill 2025	nr. 1473 prot. Dt/13.02.2025	4,899	nr. 970/1 dt 07.01.2025		
Shkurt 2025	41,335.0	2,067	reflektuar ne evidencën e muajit qershor 2025	nr. 2781 prot. Dt/20.03.2025				
Mars 2025	154,199.0	7,710	reflektuar ne evidencën e muajit qershor 2025	nr. 3541 prot. Dt/11.04.2025			13,387	nr. 11679 prot. Dt/06.12.2025
Prill 2025	234,070.0	11,704	reflektuar ne evidencën e muajit gusht 2025	nr. 4958 prot. Dt/26.05.2025			22,184	nr. 2788 prot. Dt/20.03.2025
Maj 2025	202,716.0	10,136	reflektuar ne evidencën e muajit gusht 2025	nr. 5892 prot. Dt/17.06.2025				
Qershor 2025	287,900.0	14,395	reflektuar ne evidencën e muajit shtator 2025	nr. 7165 prot. Dt/22.07.2025				
Korrik 2025	233,774.0	11,689	reflektuar ne evidencën e muajit tetor 2025	nr. 8034 prot. Dt/18.08.2025				
Gusht 2025	244,375.0	12,219	reflektuar ne evidencën e muajit nëntor 2025	nr. 9601 prot. Dt/19.09.2025				
Shtator 2025	327,425.0	16,371	reflektuar ne evidencën e muajit dhjetor 2025	nr. 10990 prot. Dt/21.10.2025				
TOTAL		**145,473**			**4,899**		**35,571**	
Tetor 2025	348,822.0	17,441	reflektuar ne evidencën e muajit shkurt 2026	nr. 12293 prot. Dt/20.11.2025				
Nëntor 2025	687,386.0	34,369	reflektuar ne evidencën e muajit mars 2026	nr. 13802 prot. Dt/29.12.2025				
Dhjetor 2025	433,804	21,690	reflektuar ne evidencën e muajit mars 2026	nr. 460 prot. Dt/16.01.2026				

Nga tabela më sipër konstatohet se megjithëse rakordimet mbahen në muajin pasardhës kalimi në llogari të Bashkisë kryhet jo brenda afateve. Deri në muajin dhjetor 2025 kanë kaluar në llogari të Bashkisë Korçë periudha Nëntor 2024 – Shtator 2025 ndërkohë që muajt Tetor dhe Nëntor të vitit 2025 nuk janë kryer pagesat për llogari të Bashkisë Korçë brenda vitit 2025 dhe muaji Dhjetor duhej të ishte kryer pagesa brenda muajit Janar 2026.

Muaj	vlera	Nr. subjekte	Akt rakordimi	Date nr. prot
Dhjetor-2024	25,000	4	reflektuar ne muajin janar 2025	nr.938 prot. Dt/29.01.2025
Janar 2025	10,000	2	reflektuar ne muajin mars 2025	nr. 2057 prot. Dt/28.02.2025

Muaj	vlera	Nr. subjekte	Akt rakordimi	Date nr. prot
Shkurt 2025	88,986	11	reflektuar ne muajin mars 2025	nr. 2911 prot. Dt/25.03.2025
Mars 2025	53,749	8	reflektuar ne muajin prill 2025	nr. 3542 prot. Dt/11.04.2025
Prill 2025	20,000	4	reflektuar ne muajin maj 2025	nr. 4791 prot. Dt/21.05.2025
Maj 2025	31,544	5	reflektuar ne muajin qershor 2025	nr. 6421 prot. Dt/02.07.2025
Qershor 2025	74,262	5	reflektuar ne muajin korrik 2025	nr. 6960 prot. Dt/15.07.2025
Korrik 2025	19,423	1	reflektuar ne muajin gusht 2025	nr. 7953 prot. Dt/13.08.2025
Gusht 2025	22,997	3	reflektuar ne muajin shtator 2025	nr. 9032 prot. Dt/09.09.2025
Shtator-Tetor-Nëntor 2025	20,685	31	reflektuar ne muajin dhjetor 2025	nr. 13505 prot. Dt18/12/2025
TOTALI	**366,646**			

Rakordimet për tatimi i thjeshtuar mbi fitimin nuk janë mbajtur për çdo muaj në muajin pasardhës. Nga auditimi rezultoi se rakordimi i muajit Maj është mbajtur në muajin Qershor dhe rakordimi i muajve Shtator – Tetor – Nëntor është mbajtur në muajin Dhjetor të vitit 2025. Ky rakordim i mbajtur me nr. protokolli 13505, datë 18.12.2025 ka qenë në vlerën: muaji shtator në vlerën 94,233 lekë nga 10 subjekte; muaji tetor në vlerën 107,473 lekë nga 17 subjekte dhe muaji nëntor në vlerën 52,650 lekë nga 4 subjekte me një vlerë totale prej 254,356 lekë. Me shkresën nr. 581 prot, datë 23.01.2026 protokolluar në Bashkinë Korçë me nr 766 prot, datë 26.01.2026 ka rezultuar se nga ana e DRT Korçë është bërë rimbursimi i një subjekti më vlerë 233,671 lekë (vlerë e cila duhej rakorduar midis DRT-Korçë dhe Bashkisë Korçë më muajin Mars dhe duhej kryer që në atë periudhë sistemimi i veprimit) dhe vlera totale që kaloi për llogari të Bashkisë Korçë për gjithë vitin 2025 rezultoi: (600,317-233,671=366,646 lekë) . Shuma prej 233,671 leke i është zbritur detyrimit që duhet ti kalonte Bashkisë Korçë i muajve Shtator – Tetor – Nëntor, i cili duhet të ishte në vlerën 254,356 lekë, pra për llogari të Bashkisë Korçë rezultoi që ka kaluar vetëm vlera prej 20,685 lekë.

Periudha	vlera	Nr. subjekte	Akt rakordimi	Date nr.prot
Shtator 2025	94,233	10	reflektuar ne muajin dhjetor 2025	nr. 13505 prot. Dt/18.12.2025
Tetor 2025	107,473	17	reflektuar ne muajin dhjetor 2025	nr. 13505 prot. Dt/18.12.2025
Nëntor 2025	52,650	4	reflektuar ne muajin dhjetor 2025	nr. 13505 prot. Dt/18.12.2025
	254,356			

Ndërmjet Bashkisë Korçë-së dhe DRT nuk janë mbajtur akt-rakordime mujore në lidhje tatimin mbi të ardhurat personale. Bashkia Korçë është mjaftuar vetëm me kalimet që janë bërë nëpërmjet degës së thesarit për 4-mujorët.

Ndërmjet Bashkisë Korçë-së dhe ASHK- Drejtoria Vendore Korçë janë mbajtur akt-rakordime mujore në lidhje taksën mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasurive të paluajtëshme, siç tregohet në tabelën nr. 8, si vijon:

Tabela nr. 8. *Rakordimet viti 2025 me ASHK Korçë*

Periudha/viti	Njësi Pronesore	taksa 3 %	taksa 97 %	Nr. Prot	Datë
Janar 2025	23	26,839.11	867,798.00	1323	10.02.2025
Shkurt 2025	7	3,888.84	125,739.00	2448	11.03.2025
Mars 2025	12	14,467.11	467,770.00	3304	07.04.2025
Prill 2025	22	166,499.32	5,383,474.43	4447	09.05.2025
Maj 2025	19	10,713.21	346,393.79	5530	10.06.2025
Qershor 2025	44	30,972.60	1,001,447.40	6580	07.07.2025
Korrik 2025	54	44,089.86	1,425,572.14	7842	11.08.2025
Gusht 2025	26	19,609.32	634,034.68	9034	09.09.2025
Shtator 2025	27	16,623.30	537,846.70	10466	09.10.2025
Tetor 2025	40	36,889.74	1,192,468.26	11902	12.11.2025
Nëntor 2025	20	12,146.18	392,727.78	13566	19.12.2025
Dhjetor 2025	35	29,688.46	961,543.54	188	09.01.2026
TOTAL	**329**	**412,427.05**	**13,336,815.72**		

Rakordimet janë mbajtur brenda afateve të përcaktuara dhe rezultoi se gjatë vitit 2025 objekt traksaksioni kanë qenë 329 njësi pronësore me vlerë totale 13,336,815.72 lekë. Nga auditimi i pasqyrave financiare ka rezultuar se taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasurive të paluajtëshme është në vlerën 13,650,566 lekë. Diferenca prej (13,650,566 – 13,336,815.72 = 313,782.3) figuron më tepër në llogarinë e Bashkisë Korçë. Kjo diferencë i takon muajit Maj ku vlera e rakorduar është 346,393.8 lekë dhe vlera 313,782.3 është tepër në këtë llogari.

c- Ndërmjet Bashkia Korçë-së dhe DRSHTR nuk janë mbajtur akt-rakordime mujore në lidhje taksën e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor. Nga auditimi rezultoi se nga ana e Bashkisë Korçë ka pasur komunikim zyrtar me këtë drejtori referuar këtu shkresën e Bashkisë Korçë me nr 644 prot, datë 23.01.2025 ku kërkohet të kryhet rakordimi për taksën e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor, për të cilën nuk ka përgjigje zyrtare nga DRSHTR. Është dërguar shkresa kërkesë e përsëritur për rakordim me nr. 644/1 prot, datë 08.08.2025 ku kërkohet të kryhet rakordimi për taksën e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor, për dijeni dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për të cilën nuk ka përgjigje. Në këto kushte Bashkia është mjaftuar vetëm me kalimet që DRSHTR ka bërë për llogari të saj. Në vitin 2026 sipas komunikimit zyrtar të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 1589/1 prot, datë 24.02.2026 Bashkia Korçë është vënë në dijeni se është ndryshuar proçedura e kalimit të TVMP për Bashkitë sipas Udhëzimit nr. 3, datë 19.01.2026 "Për disa ndryshime dhe një shtesë në Udhëzimin nr. 26, datë 04.09.2008 "Për taksat Kombëtare" ku shprehimisht thuhet se vlera takuese që shpërndahet për njësitë vendore do të bëhet nëpërmjet DRT sipas informacionit që DPSHTRR-Tiranë i dërgon Ministrisë së Financave.

- ***<u>Legalizimi dhe taksa e ndikimit ne infrastrukture (ALUIZNI-t)</u>***

Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga A.SH.K, Drejtoria Vendore Korçë janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi. Referuar listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimit të tyre me pagesat e kryera nga personat që kanë patur detyrime për taksën e ndikimit në infrastrukturë, u konstatua se:
- Nga legalizimet e bëra ndër vite kanë mbetur detyrime pa paguar deri në fund të vitit 2024, në vlerën 24,407,330 lekë.
- Në fillim të vitit 2025 janë trashëguar 373 debitorë në vlerën 24,407,330 lekë.
- Gjatë vitit 2025 janë paguar detyrimet për 84 objekte të legalizuara të cilat nuk i kishin likuiduar detyrimet për periudhën paraardhëse në vlerën 2,999,685 lekë
- Gjatë vitit 2025 janë krijuar debitorë 85 persona me vlerë progresive 2,953,821 lekë, detyrim ky i papaguar vetëm për vitin 2025.

Leje legalizimi 2025			**Paguar 2025**		**31.12.2025**	
Nr.	**Vlerë**	**Sip/m²**	**Nr.**	**Vlerë**	**Nr.**	**Vlerë**
178	8,016,029	38,731.55	93	5,062,208	85	2,953,821

Në mënyrë të përmbledhur debitorët e taksës së ndikimit në infrastrukturë paraqiten në tabelën e mëposhtme:

E m ë r t i m i	**Gjendja në fillim të vitit 01.01.2025 (trashëguar nga vitet e mëparshme 2011-2024)**		**Krijuar brenda vitit 2025**		**Arkëtuar debitorë për periudhen 2011-2024**		**Në fund të vitit 31.12.2025**	
	Nr.	**Vlerë**	**Nr.**	**Vlerë**	**Nr.**	**Vlerë**	**Nr.**	**Vlerë**
TNI (aluzini)	*373*	*24,407,330*	*85*	*2,953,821*	*84*	*2,999,685*	*374*	*24,361,466*
SHUMA	***373***	***24,407,330***	***85***	***2,953,821***	***84***	***2,999,685***	***374***	***24,361,466***

Në fund të vitit 2025 vlera e detyrimeve nga mospagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet rezultoi **24,361,466 lekë**, vlerë që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Korçë. Në gjendjen e llogarisë 468 "*Debitorë të ndryshëm*" në mbyllje të vitit 2025 është kontabilizuar vlera progresive prej 24,361,466 lekë nga 24,407,330 lekë që është vlera debitore në fund të vitit 2024, e cila përbëhet nga vlera e debitorëve prej 21,407,645 lekë debitorë për periudhën deri në vitin 2024 dhe nga vlera e debitorëve prej 2,953,821 lekë e krijuar gjatë vitit 2025.

Konkluzion: Nga auditimi i dokumentacionit financiar të pagesave për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet e ndërtimeve informale konstatohet se, në fillim të vitit 2025 është trashëguar vlerë progresive debitore prej 24,407,330 lekë. Gjatë vitit 2025 janë likuiduar detyrimet për 84 objekte të legalizuara të cilat nuk i kishin likuiduar detyrimet për periudhën paraardhëse në vlerën 2,999,685 lekë.
Gjatë vitit 2025 janë legalizuar 178 objekte me vlerë 8,016,029 lekë nga të cilat po brenda vitit 2025 janë likuiduar 93 objekte me vlerë 5,062,208 lekë dhe është shtuar vlerë debitore vetëm për vitin 2025 në vlerën 2,953,821 lekë, duke mbetur në fund të vitit 2025 vlerë debitore progresive prej 24,361,466 lekë nga 374 individë.
Në gjendjen e llogarisë 468 "*Debitorë të ndryshëm*" në mbyllje të vitit 2025 është kontabilizuar vlera progresive prej 24,361,466 lekë. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore gjatë vitit 2025 ka dërguar 326 njoftime dhe kërkesë për pagesë dhe 234 urdhra bllokimi. DTTV nuk ka marrë të gjitha masat e nevojshme për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë (legalizimet) për 374 individë debitorë në vlerën **24,361,466 lekë**, duke sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Korçë. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006,"Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim", pika 5, si dhe me VKB nr. 158, datë 26.11.2024 "Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore dhe kundërvajtjet administrative për vitin 2025".
Për sa sipër mban përgjegjësi: N.H. – Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave të Infrastrukturës.

- ***<u>Menaxhimi i të ardhurave nga gjobat për pagesa të vonuar (kamat vonesat).</u>***

Të ardhurat nga gjobat/kamatëvonesat për vitin 2025 janë planifikuar në vlerën 8,540,500 lekë, ndërsa realizimi është në vlerën 8,540,500 lekë ose 104% e planit. Krahasuar me vitit pasardhës, ky zë ka shënuar një rritje të ndjeshme prej 25% ose 1,787,817 lekë më shumë. Realizimi në vlerën 8,904,289 lekë është siguruar nga këto kategori:
Subjektet e biznesit të madhe në vlerën 3,230,154 lekë;
Subjekte të biznesit të vogël në vlerën 2,777,242 lekë;
Institucionet dhe OJF-të në vlerën 19,717 lekë, sipas listave që disponon DTTV bashkia Korçë.
Pronarët e ndërtesave/truallit dhe familjarët (përfshirë njësitë administratie), në vlerën 2,877,176 lekë.
Gjoba për pagesë të vonuar është parashikuar në paketën fiskale të miratuar me VKB nr. 158 datë 26.11.2024 "Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë e Korçë, si dhe penalitetet për shkeljet apo kundërvajtjet administrative për vitin 2025" në të cilën janë përcaktuar kamatëvonesat: taksa mbi ndërtesën pika 1.1/a faqe 18, taksa mbi tokën bujqësore pika 1.1/b faqe 19, taksa mbi truallin pika 1.1/c faqe 21, taksa e tabelës pika 1.4 faqe 26, tarifat vendore kapitullin IV pika 1 faqe 40, pika 5 faqe 43, pika 6 faqe 43; dhe për vitet paraardhëse sipas vendimeve respektive
Detyrimet e gjobave për pagesë të vonuar për detyrimet e taksave dhe tarifave vendore që plotësojnë afatin 1 vjeçar të maturimit si detyrim i pa likuiduar, për periudhën janë përllogaritur në tabelën e mëposhtme:

Periudha	Gjobe vonese ne pagese 0.06%/365 dite
31.12.2024	23,593,958
Shtesa+ KLSH (2015-2024)	22,890,619
Arkëtime 2025 periudha deri në vitin 2024	6,527,408
Viti 2025	5,762,985
SHUMA	**45,720,154**

Nga përllogaritjet rezulton se, gjoba për pagesë të vonuar deri në fund të vitit 2025 është në vlerën 45,720,154 lekë në të cilën janë përfshirë gjobat për vonesë në pagesë (vlera progresive) deri në fund të vitit 2024, shtesat e bëra gjatë vitit 2025 për periudhën paraardhëse në vlerën 549,330 lekë dhe shtesa e gjobave për vonesë në pagesë të gjetura nga auditi i KLSH për vitet 2023-2024 në vlerën 22,341,288 lekë (shtesa + KLSH (2015-2024): 549,330 lekë + 22,341,288 lekë = 22,890,618 lekë), arkëtimet e ndodhura gjatë vitit 2025 për periudhën paraardhëse dhe gjobat për vonesë në pagesë të përllogaritura deri në datë 31.12.2025.

Për të gjithë subjektet debitore nga ana e Bashkisë Korçë janë zbatuar përcaktimet e ligjit nr.9920, date 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në R.SH*"* neni 114 *"Mospagimi ne afat i detyrimit tatimor",* duke aplikuar gjobe te barabarte me 0.06% të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë gjatë së cilës nuk është kryer pagesa, por jo për një periudhë më të gjatë se 365 dite kalendarike.

Konstatim*:* Nga auditimi i detyrimeve debitore dhe detyrimeve vjetore për taksat dhe tatimet vjetore në Bashkinë Korçë për vitin 2025 rezultoi se: Nga ana e DTTV janë dërguar me shkresë zyrtare tek Drejtoria Financës, Buxhetit dhe MFK detyrimet debitorë vjetore dhe progresive me qëllim kontabilizimin dhe njohjen e tyre në kontabilitet në llog. 468 dhe në llogarit1 e klasën e 7-të. Për vitin 2025 vlera prej 3,051,300 lekë nuk është kontabilizuar pasi afati i maturimit në të cilin plotësoheshe cikli 365 ditë ishte data 30.06.2026 dhe vlera prej 3,051,300 duhet të konabilizohet në muajin korrik të vitit 2026.

- ***Mbi pagesën e autorizimit nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në tregtimin me pakicë të lëndëve djegëse. Subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve.***

Grupi i auditimit të KLSH-së auditoi dokumentacionin lidhur me pajisjen e subjekteve me autorizim për ushtrimin e aktivitetit në zbatim të legjislacionit në fuqi përkatësisht:

- Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999 *"*Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", neni 4, neni 20, pika 2.
- VKM nr. 344, datë 19.04.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 970, datë 02.12.2015, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", pika 2/9: "*Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3,000,000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1,000,000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera*".

Referuar dokumentacionit të paraqitur rezulton se, në territorin e Bashkisë Korçë për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë 30 (tridhjetë) subjekte të paraqitura në tabelën nr. 9 e mëposhtme:

Tabela nr. 9. *Subjektet që ushtrojnë aktivitet në shitjen e lëndëve djegëse me pakicë*

NR	SUBJEKTET	Aktiviteti	NR I LIÇENCËS PROT DATA	AFATI I PERIUDHES SE LIÇENCES	TARIFA E APLIKUAR NE LEKE
1	M...	Stacion Karburanti *(AKTIV)*	Nr.7590/1 Prot Dt:07/09/2022	18 /07/2022 - 17/07/2027	1.000.000
2	K...	Stacion Karburanti *(AKTIV)*	Nr.9161/1Prot,Dt:01/11/2022	24/10/2022 - 23/10/2027	1.000.000
3	I...	Stacion Karburanti *(AKTIV)*	Nr.253/1 Prot Dt:20/01/2022	05/01/2022 - 04/01/2027	1.000.000
4	K...	Stacion Karburanti *(AKTIV)*	Nr.1643/1Prot Dt: 04 /03/2022	04 /03/2022 - 03/03/2027	1.000.000
5	G...	Stacion Karburanti *(AKTIV)*	Nr.1040/1Prot,Dt:16/02/2023	31/01/2023 - 30/01/2028	1.000.000
6	2B...	Stacion Karburanti *(AKTIV)*	Nr.1403/1 Prot,Dt:28/02/2024	18/02/2024 - 17/02/2029	1.000.000
7	A...	Stacion Karburanti *(AKTIV)*	Nr.6789/1 Prot,Dt:29/07/2024	29/07/2024 - 28/07/2029	1.000.000

NR	SUBJEKTET	Aktiviteti	NR I LIÇENCËS PROT	AFATI I PERIUDHES	TARIFA E APLIKUAR
8	A...	Stacion Karburanti *(AKTIV)*	Nr.7520/1 Prot,Dt:30/08/2024	21/08/2024 - 20/08/2029	1.000.000
9	T...	Stacion Karburanti *(AKTIV)*	Nr.7978/1 Prot,Dt:06/09/2024	03/09/2024 - 02/09/2029	1.000.000
10	M...	Stacion Karburanti *(AKTIV)*	Nr.8416/1 Prot,Dt:20/09/2024	12/09/2024 - 11/09/2029	1.000.000
11	S...	Stacion Karburanti *(AKTIV)*	Nr.10883/1Prot,Dt:20/11/2024	14/11/2024 - 13/11/2029	1.000.000
12	A...	Stacion Karburanti *(AKTIV)*	Nr. 31/1 Prot,Dt: 06/01/2025	06/01/2025 - 05/01/2030	1.000.000
13	A...	Stacion Karburanti *(AKTIV)*	Nr.480/1 Prot,Dt:07/02 /2025	20/01/ 2025 - 19/01/2030	1.000.000
14	A...	Stacion Karburanti *(AKTIV)*	Nr.1922/1 Prot,Dt: 27/02/2025	25/02/ 2025 -24/02/ 2030	1.000.000
15	A...	Stacion Karburanti *(AKTIV)*	Nr.4318/1 Prot,Dt: 16/05/2025	06/05/2025 - 05/05/2030	1.000.000
16	K...	Stacion Karburanti *(AKTIV)*	Nr.4321/1 Prot,Dt: 20 /05 /2025	06/05/2025 - 05/05/2030	1.000.000
17	K...	Stacion Karburanti *(AKTIV)*	Nr.4320/1 Prot,Dt: 07/05/2025	06/05/2025 - 05/05/2030	1.000.000
18	K...	Stacion Karburanti *(AKTIV)*	Nr.4322/1 Prot,Dt: 10/06/2025	06/05/2025 - 05/05/2030	1.000.000
19	K...	Stacion Karburanti *(AKTIV)*	Nr.4319/1 Prot,Dt: 05 /06 /2025	06/05/2025 - 05/05/2030	1.000.000
20	S...	Stacion Karburanti *(AKTIV)*	Nr.4324/1 Prot,Dt: 29/05/2025	06/05/2025 - 05/05/2030	1.000.000
21	S...	Stacion Karburanti *(AKTIV)*	Nr.4325/1 Prot,Dt: 16/05/2025	06/05/2025 - 05/05/2030	1.000.000
	D...	Stacion Karburanti	Nr.4323/1 Prot,Dt: 05/06/2025	06/05/2025 - 05/05/2030	1.000.000
22	A...	Stacion Karburanti *(AKTIV)*	ZV. 16/10/2025 - 05/05/2030	16/10/2025 - 05/05/2030	
23	E...i	Stacion Karburanti *(AKTIV)*	Nr.4505/1 Prot,Dt: 13/05/2025	12/05/2025 - 11/05/2030	1.000.000
24	C...	Stacion Karburanti *(AKTIV)*	Nr.5359/1 Prot,Dt: 04/06/2025	04/06/2025 - 03/06/2030	1.000.000
25	M...	Stacion Karburanti *(AKTIV)*	Nr.6358/1 Prot,Dt: 01/07/2025	01/07/2025 - 30/06/2030	1.000.000
26	T...	Stacion Karburanti *(AKTIV)*	Nr.6564/1 Prot,Dt: 07/07/2025	07/07/2025 - 06/07/2030	1.000.000
27	T...	Stacion Karburanti *(AKTIV)*	Nr.7300/1 Prot,Dt: 28/07/2025	28/07/2025 - 27/07/2030	1.000.000
28	O...	Stacion Karburanti *(AKTIV)*	Nr.8905/1 Prot,Dt: 12/09/2025	04 /09/2025 - 03 /09/2030	1.000.000
29	I...	Stacion Karburanti *(AKTIV)*	Nr.11020/1 Prot,Dt: 27/10 /2025	23 /10/2025 - 22 /10/2030	1.000.000
30	O...	Stacion Karburanti *(AKTIV)*	Nr.11812/1 Prot,Dt: 20/11/2025	11/11/2025 - 10/11/2030	1.000.000

Burimi: Bashkia Korçë, DKT

Nga auditimi rezultoi se, në Bashkinë Korçë për vitin 2025 janë pajisur me autorizim/licencë 19 stacione në vlerë 19,000,000 lekë, siç tregohet në tabelën nr. 10..

Tabela nr. 10

NR	SUBJEKTET	PERIUDHA E LIÇENSES	TARIFA E LÇENSËS në lekë	NR I LIÇENCËS PROT DATA
1	A... SHPK	06/01/2025 - 05/01/2030	1,000,000	Nr. 31/1 Prot,Dt: 06/01/2025
2	A... SHPK	20/01/ 2025 - 19/01/2030	1,000,000	Nr.480/1 Prot,Dt:07/02 /2025
3	A... (Shpk)	25/02/ 2025 -24/02/ 2030	1,000,000	Nr.1922/1 Prot,Dt: 27 /02 /2025
4	A... (Shpk)	06/05/2025 - 05/05/2030	1,000,000	Nr.4318/1 Prot,Dt: 16 /05 /2025
5	K... (Shpk)	06/05/2025 - 05/05/2030	1,000,000	Nr.4321/1 Prot,Dt: 20 /05 /2025
6	K... (Shpk)	06/05/2025 - 05/05/2030	1,000,000	Nr.4320 /1 Prot,Dt: 07/05 /2025
7	K... (Shpk)	06/05/2025 - 05/05/2030	1,000,000	Nr.4322/1 Prot,Dt: 10 /06 /2025
8	K... (Shpk)	06/05/2025 - 05/05/2030	1,000,000	Nr.4319/1 Prot,Dt: 05 /06 /2025
9	S... (shpk)	06/05/2025 - 05/05/2030	1,000,000	Nr.4324/1 Prot,Dt: 29 /05 /2025
10	S...(shpk)	06/05/2025 - 05/05/2030	1,000,000	Nr.4325/1 Prot,Dt: 16 /05 /2025
11	D... SHPK	06/05/2025 - 05/05/2030	1,000,000	Nr.4323/1 Prot,Dt: 05 /06 /2025
12	E...I (Shpk)	12/05/2025 - 11/05/2030	1,000,000	Nr.4505/1 Prot,Dt: 13/05 /2025
13	C... (Shpk)	04/06/2025 - 03/06/2030	1,000,000	Nr.5359/1 Prot ,Dt: 04/06 /2025
14	M... (SHPK)	01/07/2025 - 30/06/2030	1,000,000	Nr.6358/1 Prot ,Dt: 01/07 /2025
15	T... SHPK	07/07/2025 - 06/07/2030	1,000,000	Nr.6564/1 Prot ,Dt: 07/07 /2025
16	T... SHPK	28/07/2025 - 27/07/2030	1,000,000	Nr.7300/1 Prot ,Dt: 28/07 /2025
17	O... (Shpk)	04 /09/2025 - 03 /09/2030	1,000,000	Nr.8905/1 Prot ,Dt: 12/09 /2025
18	I... SHPK	23 /10/2025 - 22 /10/2030	1,000,000	Nr.11020/1 Prot ,Dt: 27/10 /2025
19	O... (Shpk)	11/11/2025 - 10/11/2030	1,000,000	Nr.11812/1 Prot ,Dt: 20 /11 /2025

Burimi nga DKT

Nga auditimi rezultoi se, në Bashkinë Korçë për vitin 2025 janë zëvendësuar 2 autorizim/licencë në vlerë 40,000 lekë, siç tregohet në tabelën nr. 11.

Tabela nr. 11

NR	SUBJEKTET	NUIS	PERIUDHA E LIÇENSES	TARIFA E Zëvendësimit të licencës/ në lekë
1	**I... SHPK**	**M.....D**	04/02/2025 - 22/10/2025	20,000
2	A... SHPK	M.....T	16/10/2025 - 05/05/2030	20,000

Burimi nga DKT

Detyrimet janë mbajtur përpara momentit të pajisjes me autorizim/licencë dhe nga kontrrolli nuk figuroi asnjë subjekt i cili të ketë detyrime apo të ketë lidhur marrëveshje për pagim me këste. Veprimet e mësipërme janë në zbatim me përcaktimet ligjore në fuqi,

- Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar, neni 4;
- VKM nr. 970, datë 02.12.2015, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", Kreu II, pika.

- ***Nga auditimi për likuidimin e detyrimeve për taksat e tokës bujqësore:***

Taksa mbi tokën bujqësore **për vitin 2025** është planifikuar 57,859,514 lekë dhe është realizuar në masën 44% kundrejt planifikimit ose në vlerën 25,741,681 lekë. Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore për biznesin është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Korçë sipas parashikimeve të paketës fiskale. Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore për familjarët është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Korçë, administratorët e lagjeve (për njësinë administrative Korçë) kurse për njësitë e tjera administrative struktura e ngarkuar është njësia administrative sipas parashikimeve të paketës fiskale.

Nga të dhënat e vendosura në dispozicion për vitin 2025, gjithsej tokë bujqësore që mund të faturohen janë 12,603.25 Ha. Kjo sipërfaqe e ndarë sipas NJA dhe kategorive shumëzuar për nivelin e taksës së përcaktuar sipas kategorive në paketën fiskale, nga përllogaritja konstatohet se planifikimi i taksës së tokës bujqësore është në shumën 24,831,977 lekë, e cila pasqyrohet në tabelën nr. 12, si më poshtë vijon:

Tabela nr. 12: *Planifikimi i taksës së tokës bujqësore Bashkia Korçë për vitin 2025.*

Kategoria e Tokes	Sip/ha Bulgar	Sip/ha Voskop	Sip/ha Drenove	Sip/ha Mollaj	Sip/ha Vithkuq	Sip/ha voskopoje	Sip/ha Lekas	Sip/ha Korçë	Shuma ne/ha	Vlera ha	Plani
Kategoria I									0		-
Kategoria II									0		-
Kategoria III								12.68	12.68	2800	35,504.0
Kategoria IV	1031.3	776	1452	1790				142.52	5191.82	2300	11,941,186.0
Kategoria V	1698.5	1377	810		143			202.37	4230.87	1900	8,038,653.0
Kategoria VI	1002.32	145			731			28.74	1907.06	1600	3,051,296.0
Kategoria VII-X			60		395	540	259	6.82	1260.82	1400	1,765,148.0
Toka sip ha sipas planit	3732.12	2298	2322	1790	1269	540	259	393.13	**12603.25**		
Fondi gjithsej I tokes	4317.7	3248.28	2561.17	2704.51	2806.76	2477.11	1791.44	565.88	**20472.85**		
Toke shtet e pandare	54.7	837.28	94.06	854.51	1455.61	1254.11	1223.69	69.98	**5843.94**		
Tok dhen per familj bujqesor			2.32	15.6					**17.92**		

Në fakt fondi i tokës bujqësore gjithsej referuar vitit 1991 në Bashkinë Korçë është 20,472.85 Ha, duke përfshirë tokë të ndarë dhe të pandarë. Nga të cilat 12,603.25 Ha është tokë e shpërndarë që faturohet, 5,843.94 Ha është tokë shtet e pandarë, 17.92 Ha tokë e dhënë me qira për familje bujqësore dhe 2,007.74 Ha është sipërfaqe toke e tjetërsuar ndër vite. Kjo diferencë sipas Sektorit të Bujqësisë Bashkia Korçë justifikohet me faktin që nga fondi fillestar i vitit 1991 dhe deri më sot përgjatë gjithë kësaj periudhë ka pasur tjetërsim nga tokë bujqësore në truall, nga tokë bujqësore në rrugë parcelash dhe kanale vaditës dhe kullues.

Konkluzion: Taksa mbi tokën bujqësore **për vitin 2025** taksa e tokës është realizuar në shumën 25,741,681 lekë nga 57,859,514 lekë të planifikuara, ose në masën 44%. Referuar të dhënave për fondin e tokës, ndarjen dhe kategorizimin e saj sipas NJA të vëna në dispozicion nga Sektori i Bujqësisë dhe nga Sektori i mbledhjes dhe kontrollit të të ardhurave për NJA, nga përllogaritjet bazuar edhe në paketat fiskale rezulton se planifikimi i të ardhurave nga taksa e tokës vetëm për vitin 2025 është në vlerën 24,831,977 lekë, dhe vlera prej 33,027,537 lekë është planifikuar të mblidhet nga debitorët për vitet paraardhëse.

***Ndjekja e procedurave për arkëtimin e taksës së tokës bujqësore*.**

Në *fund të vitit 2025* gjendja e debitor është në shumën 95,861,361 lekë, e cila në krahasim me vitin 2024 është rritur me 13,202,562 lekë. Gjatë vitit 2025 janë krijuar gjithsej 10,641 familje debitore për vlerën 13,202,562 lekë, ku peshën më të madhe të familjeve debitore e ka Njësia Administrative Bulgarec, duke vijuar me Njësinë Administrative Drenovë, Voskop, Mollaj, Vithkuq, Voskopojë, Korçë, ndërsa peshën më të vogël e ka Njësia Administrative Lekas.

Arkëtimi i kësaj takse pavarësisht punës që kryhet paraqitet me problem në Bashkinë Korçë, për arsye se familjet të cilat taksohen për tokën bujqësore pavarësisht se njoftohen (referuar këtu njoftimeve të kryera nga zyra apo dhe në terren nga specialistët e njësive administrative) nuk kryejnë pagesat për shkak të mos marrjes dijeni, lëvizjeve demografike, mos përditësimit të bazës së të dhënave, emigracionit etj. Me qëllim arkëtimin e kësaj takse DTTV Bashkia Korçë nuk duhet të mjaftohet vetëm me bllokimin llogarive bankare por të ndiqen dhe hapat e tjerë me vendosjen e barrëve siguruese dhe hipotekore. Më poshtë pasqyrohet ecuria e debitorëve të rezultuar për taksën e tokës bujqësore, sipas tabelës nr. 13:

Tabela nr. 13:

Debitore per taksen e tokes bujqesore viti 2025				
Debitore te krijuar ne vitin 2025 (Lekë)				Ne fund te 2025
Njesi Administrative	**Debi e trasheguar fillim 2025**	**Familje debitor(Nr)**	**Familje debit vlere**	**Debia progresive**
Bulgareci	25,218,747	3,032	3,684,316	28,903,063
Voskopi	7,973,208	1,298	2,555,260	10,528,468
Drenove	21,292,756	3,119	2,642,377	23,935,133
Mollaj	13,250,448	1,334	1,706,883	14,957,331
Vithkuq	9,677,969	887	1,449,586	11,127,555
Voskopojë	1,748,340	491	453,829	2,202,169
Lekas	2,538,232	98	311,697	2,849,929
Korçë	959,098	382	398,614	1,357,712
Total	**82,658,799**	**10,641**	**13,202,562**	**95,861,361**

***Burimi**: DTTV, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

Nga Sektori i Bujqësisë së Bashkisë Korçë dhe nga Sektori i Mbledhjes dhe Kontrollit të të Ardhurave për Njësitë Administrative nuk është kryer punë e mjaftueshme për përditësimin e të dhënave si dhe për rritjen e arkëtimeve në NJ.A për uljen e borxhit për taksën e tokës. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, neni 6, neni 9 "Të drejtat dhe përgjegjësitë", pika 1.3, me Rregulloren e Bashkisë Korçë të miratuar me Urdhrin nr. 142 datë 01.03.2021, pika 59.2.1 dhe 59.2.11.

Përsa më sipër ngarkohet me përgjegjësi: *K.J. me detyrë Përgjegjës i Sektorit për Kontrollin dhe Mbledhjen e të Ardhurave për Njësitë Administrative, TH.K. me detyre Përgjegjës i sektorit të Bujqësisë.*

- ***Mbi pagesën e tarifës së parkimit*.**

Nga auditimi i administrimit të tarifës së parkimit në Bashkinë Korçë rezultoi se të ardhurat nga kjo tarifë sigurohen nga subjektet dhe institucionet që disponojnë vendparkime të rezervuara, subjektet e transportit të mallrave, rezidentët familjarë dhe parkimi me pagesë në rrugë.

Nga analiza e dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se në zonën me tarifë parkimi 20 lekë/orë janë rezervuar 17 vende parkimi nga 13 subjekte, ndërsa në zonat me tarifë 10 lekë/orë janë rezervuar 146 vende parkimi nga 98 subjekte.

Në verifikim të kontratave të lidhura me subjektet dhe në krahasim me përcaktimet e Paketës Fiskale të Bashkisë Korçë, miratuar me VKB nr. 158, datë 26.11.2024 "Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë Korçë, si dhe penalitetet për shkeljet apo kundërvajtjet administrative për vitin 2025", Kapitulli IV "Tarifat Vendore", pika 2 (faqe 42-43),

u konstatua se në 5 raste kontratat janë lidhur me orar rezervimi më të ulët se minimumi i parashikuar në aktin normativ.

Tabela 14

Subjekti	Nr. vendësh	Adresa	NUIS	Orari I rezervuar		Detyrimi sipas kontratës	Detyrimi sipas VKB	Të ardhura të munguara
S...	2	Bulevard "Fan Noli"		10.00 - 17.00 (H - D)	7 orë	51,100	58,400	7,300
F...	1	Bulevard "Fan Noli"		15.00 - 22.00 (H - D)	7 orë	25,550	29,200	3,650
V.A.	1	Rruga "Midhi Kostani"		08.00 - 14.00 (H - SH)	6 orë	18,780	25,040	6,260
I.L.	1	Rruga "Midhi Kostani"		08.00 - 14.00 (H - D)	6 orë	21,900	29,200	7,300
R.H.	1	Rruga "Viktimat e 7 Shkurtit"		08.00 - 14.00 (H - SH)	6 orë	18,780	25,040	6,260
Totali						**136,110**	**166,880**	**30,770**

Burimi: DKT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Sipas Paketës Fiskale, "Leja e vendparkimit të rezervuar jepet sipas kërkesës së subjektit, por në asnjë rast nuk mund të jetë më pak se 8 orë në ditë dhe jo më pak se 5 ditë në javë."

Megjithatë, për subjektet e paraqitura në Tabelën nr. 14 janë miratuar kontrata me rezervim prej 6 ose 7 orësh në ditë, në kundërshtim me këtë përcaktim. Si pasojë, detyrimet janë llogaritur dhe arkëtuar në vlera më të ulëta nga sa parashikon VKB-ja, duke shkaktuar të ardhura të munguara në shumën **30,770 lekë**.

Përllogaritja është kryer në përputhje me VKB nr. 158, datë 26.11.2024, ndërsa për subjektet që kanë kërkuar rezervim nga e hëna deri të shtunën është marrë si bazë një periudhë prej 313 ditësh në vit (365 ditë minus 52 ditët e diel).

Gjithashtu, nga auditimi rezultoi se një numër subjektesh që ushtrojnë aktivitet hotelerie disponojnë vendparkime të rezervuara me orar të kufizuar, ndërkohë që natyra e aktivitetit të tyre është e pandërprerë, 24 orë në ditë dhe 365 ditë në vit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit nuk rezultoi të jenë ushtruar kontrolle dhe verifikime periodike nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë për të vlerësuar përputhshmërinë ndërmjet përdorimit faktik të vendparkimeve dhe kushteve të kontratave.

Për pasojë, nuk janë identifikuar dhe arkëtuar plotësisht detyrimet që rrjedhin nga përdorimi real i vendparkimeve të rezervuara. Për subjektet e paraqitura në Tabelën nr. 15, diferenca ndërmjet detyrimit që do të duhej të paguhej për rezervim 24-orësh dhe detyrimit të arkëtuar sipas kontratave arrin në vlerën 1,295,300 lekë.

Tabela 15

Subjekti	Nr. Vendesh	Adresa	NUIS	Detyrimi për 24 orë	Detyrim sipas kontratës	Të ardhura të munguara
S.K.	2	Bulevard "Republika"	M04710003A	**350,400**	**115,200**	**235,200**
Z.T.	2	Bulevard "Republika"	L94511004P	**175,200**	**58,400**	**116,800**
P.	3	Rruga "29 Nëntori"	L74202001E	**262,800**	**87,600**	**175,200**
G. shpk	7	Sheshi i Teatrit		**613,200**	**255,500**	**357,700**
A.S.	3	Rruga "Konferenca e Labinotit"		**262,800**	**162,000**	**100,800**
T.sh.p.k.	6	Sheshi i Teatrit		**525,600**	**216,000**	**309,600**
Totali				**2,190,000**	**894,700**	**1,295,300**

Burimi: DKT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Kjo situatë evidencon mangësi në administrimin e tarifës së parkimit, në monitorimin e zbatimit të kontratave dhe në ushtrimin e kontrolleve administrative nga strukturat përgjegjëse, duke sjellë mosarkëtim të plotë të të ardhurave vendore dhe duke cenuar parimin e administrimit me efektivitet, eficiencë dhe ekonomi të të ardhurave publike.

Mos zbatim i plotë i përcaktimeve të Paketës Fiskale gjatë lidhjes së kontratave të rezervimit të vendparkimeve, mungesë e monitorimit dhe kontrollit periodik mbi përdorimin faktik të vendeve

të parkimit të rezervuara dhe mungesë e analizës së natyrës së aktivitetit të subjekteve (veçanërisht aktivitetet hoteliere) në përcaktimin e kohëzgjatjes së rezervimit, çon në *mosarkëtim i plotë i të ardhurave vendore në shumën totale prej 1,326,070 lekë (30,770 lekë + 1,295,300 lekë); Cënim i parimit të barazisë së trajtimit të subjekteve; Risk për krijimin e praktikave jo të unifikuara në administrimin e tarifës së parkimit dhe për humbje të mëtejshme të të ardhurave buxhetore*.
Veprime në kundërshtim me: VKB nr. 158, datë 26.11.2024 "Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë Korçë, si dhe penalitetet për shkeljet apo kundërvajtjet administrative për vitin 2025", Kapitulli IV "Tarifat Vendore", pika 2, e cila përcakton se leja e vendparkimit të rezervuar nuk mund të jetë më pak se 8 orë në ditë dhe jo më pak se 5 ditë në javë; Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenin 35, si dhe nenin 54; Ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"*;* Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 15, neni 16, neni 19.
Për sa sipër mban përgjegjësi: N.L. me detyrë Specialist Drejtorinë e Kontroll Territorit.

Në lidhje me ***parkimin rezident***, u konstatua se lejet e parkimit janë lëshuar mbi bazën e kërkesave të paraqitura nga banorët e zonave përkatëse dhe jo mbi bazën e një studimi të mirëfilltë të nevojave të zonës, kapacitetit të vendparkimeve dhe numrit të mjeteve në pronësi të banorëve. Gjithashtu, strukturat përgjegjëse nuk kanë ushtruar kontrolle periodike në bashkëpunim me Policinë Bashkiake për evidentimin e mjeteve të parkuara në lagjet respektive dhe verifikimin e vlefshmërisë së lejeve të parkimit rezident. Mungesa e këtyre kontrolleve ka ndikuar në mosadministrimin efektiv të kësaj tarife, duke rritur riskun e mospërfshirjes së subjekteve përfituese në skemën e pagesës dhe, për rrjedhojë, duke ndikuar negativisht në realizimin e të ardhurave të bashkisë.
Njësitë përgjegjëse të bashkisë duhet të administrojnë lejet e parkimit rezident mbi bazën e analizës së nevojave të zonës, kapacitetit të vendparkimeve, numrit të mjeteve në pronësi të banorëve dhe të ushtrojnë kontrolle periodike për verifikimin e përfituesve dhe administrimin korrekt të tarifës.
Mungesa e një metodologjie të dokumentuar për planifikimin dhe administrimin e lejeve të parkimit rezident, mos ushtrimi i kontrolleve periodike nga strukturat përgjegjëse dhe mungesa e koordinimit efektiv me Policinë Bashkiake për verifikimin në terren, çon në:
Rritjen e rrezikut të përfitimit të padrejtë të lejeve të parkimit rezident.
Dobësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm mbi administrimin e tarifës.
Krijohet mundësia për mos arkëtimin e plotë të të ardhurave që i takojnë bashkisë.
Në lidhje me **parkimin me pagesë (biletat),** u konstatua se kapaciteti i vendparkimeve sipas zonave të miratuara është 320 vende parkimi, për të cilat ishte planifikuar një nivel të ardhurash prej 14,000,000 lekë. Gjatë vitit janë arkëtuar 13,079,250 lekë, duke rezultuar një mosrealizim i planit në vlerën 920,750 lekë.
Nga verifikimi rezultoi se nuk disponohej dokumentacion kontrolli që të vërtetonte se arkëtimet janë kryer në përputhje me numrin e mjeteve të parkuara, zonën përkatëse dhe kohëzgjatjen e parkimit. Konkretisht, mungojnë akt-rakordimet, dokumentacioni mbi administrimin e koçankave të blloqeve të biletave, si dhe aktet e kontrollit periodik që dokumentojnë verifikimin e aktivitetit të parkimit me pagesë.
Sipas shpjegimeve të personit përgjegjës, mosrealizimi i planit të të ardhurave lidhet me faktin se gjatë ditëve të festave zyrtare nuk aplikohet tarifa e parkimit, si dhe me ndikimin e kushteve atmosferike dhe zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme në qytet. Megjithatë, këta faktorë nuk janë mbështetur me dokumentacion provues, si akt verifikime, evidenca të tjera zyrtare.
Gjithashtu, u konstatua se strukturat përgjegjëse nuk kanë ushtruar kontrolle periodike për të verifikuar punën e punonjësve që administrojnë parkimet me pagesë, nëpërmjet krahasimit të numrit të mjeteve të parkuara, biletave të prera dhe kohës së qëndrimit të mjeteve. Mungesa e këtij

sistemi kontrolli dobëson sigurinë mbi saktësinë e arkëtimeve dhe ndikon në realizimin e plotë të të ardhurave nga kjo tarifë.
Mungesa e kontrolleve periodike dhe e dokumentimit të tyre, si dhe mungesa e rakordimeve ndërmjet biletave të përdorura, arkëtimeve dhe vendparkimeve të administruara, çojnë në:
Dobësi në sistemin e monitorimit dhe kontrollit të brendshëm mbi administrimin e parkimeve me pagesë.
Nuk krijohet siguri e arsyeshme mbi saktësinë dhe plotësinë e të ardhurave të arkëtuara.
Rritet rreziku i mosarkëtimit të plotë të të ardhurave dhe i abuzimeve në administrimin e tarifës.
Dobësohet gjurmukturat përgjegjëse të bashkisë të hartojnë dhe zbatojnë procedura të dokumentuara kontrolli për administriminueshmëria dhe transparenca e procesit të administrimit të parkimeve me pagesë.
Për sa trajtuar në kundërshtim me Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar: Neni 8, Neni 54, Neni 64*;* Ligji nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, Neni 4; Neni 29, i LigjiT nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Neni 15, Neni 16.
Vendimi i Këshillit Bashkiak "Për miratimin e sistemit të parkimit dhe tarifave" (vendimi konkret i bashkisë përkatëse), lidhur me kriteret e pajisjes me leje parkimi rezident dhe administrimin e tyre, *duke ngarkuar me përgjegjësi: N.L. - Specialist për Transportin, Sektori i Kontrollit jo Ushqimor dhe Liçensimit pranë Drejtorisë së Kontroll Territorit, M.Q. - Mbikëqyrës për parkimin me pagesë, Zyra e shërbimit të parkimit me pagesë pranë Drejtorisë së Kontroll Territorit.*

- ***Tarifa për lejë transporti***

Nga informacioni i vënë në dispozicion rezulton që nga DKT- Bashkia Korçë të jenë lëshuar gjatë vitit 2025; 30 certifikata transporti, 1 licencë dhe 3 certifikata për transport mallrash për të tretë dhe 20 autorizime. Këto të gjitha lëshohen vetëm mbas kërkesës së subjekteve. Nuk rezultuan kontrolle të organizuara, kërkime apo shkëmbim informacioni nga struktura përkatëse DRSHTR apo QKB.
Në përcaktimin e të ardhurave, Bashkia Korçë bazohet vetëm në subjektet që kërkojnë lejë apo autorizim dhe nuk ka kërkuar informacion pranë DRSHTR në lidhje me mjetet të cilat plotësojnë kushtet të pajisen me leje apo autorizim. Gjithashtu DKT duhet të kontrollojë të dhënat e subjekteve të deklaruara në QKB në lidhje me mjetet të cilat janë të regjistruara dhe shërbejnë në funksion të aktivitetit të tyre. Kjo mungesë informacioni sjell të ardhura të munguara si në të ardhura nga lejet e transportit ashtu dhe në tarifën e parkimit.
Për sa sipër, mban përgjegjësi: N.L. me detyrë Specialist Drejtorinë e Kontroll Territorit.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 6776/16, datë 02.09.2026 *(prot KLSH nr. 735/4, dt. 08.09.2026)* "Mbi Projekt Raportin e Auditimit", nga ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:
Pretendimi i subjektit:*Lidhur me rekomandimet e Projekt Raportit të Auditimit sqaroj se:*
-Për subjektet të cilat kanë parkim të rezervuar me orar më të ulët se 8 orë në ditë është nisur procedura për lidhjen e një kontrate të re, e cila do të jetë në përputhje me vendimin e këshillit sipas përcaktimit 8 orë në ditë. Kjo sigurisht nëse subjekti është dakort për një rezervim të tillë. Në të kundërt subjektit do t'i hiqet parkimi i rezervuar.
-Për subjektet me aktivitet hotelerie, të cilat disponojnë vendparkime të rezervuara, sipas rekomandimit tuaj që rezervimi duhet të jetë 24 orë në ditë, sqaroj se duke mos pasur asnjë akt ligjor të miratuar sipas të cilit ky rezervim të jetë për 24 orë në ditë, nuk mund të veprohet pa u miratuar së pari me vendim të Këshillit të Bashkisë.
-Lidhur me parkimin me pagesë (biletat) risqaroj se nuk është detyra ime lidhur me sa trajtohet për këtë, sepse administrimin e tyre e kryen Zyra e shërbimit të parkimit me pagesë.

-Gjithashtu lidhur me parkimin e rezidentëve sqaroj nuk është detyra ime lidhur me sa trajtohet për funksionimin e këtij parkimi.
*-Lidhur me pajisjen e automjeteve të transportit të mallrave me çertifikata transporti, sqaroj se referuar rekomandimeve tuaja, nëpërmjet disponimit të informacionit për mjetet e çertifikuara dhe koordinimit me Drejtorinë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor të mund të arrihet më shumë. Ndërsa për pajisjen e automjeteve me autorizim risqaroj se ky dokument i nevojitet subjektit vetëm kur automjeti i cili ka masë maksimale me ngarkesë të plotë mbi 3,5 ton, kryen lëvizje në rrugët e qytetit. Pra pavarësisht peshës me ngarkesë të automjetit, për qarkullimin e tij kudo jashtë rrugëve të qytetit nuk nevojitet pajisja me autorizim. Pra ky dokument nuk është i detyrueshëm si çertifikata e transportit dhe për këtë janë kryer kontrolle në vijimësi nga Drejtoria e Kontrollit të Territorit***.***

Qëndrim i grupit të audtmit. Në lidhje me parkimet e rezervuara me kohëzgjatje më të ulët se 8 orë në ditë, pretendimi **nuk merret në konsideratë për ndryshimin e gjetjes**, pasi vetë subjekti pranon ekzistencën e kontratave me kohëzgjatje nën minimumin e përcaktuar në VKB nr. 158, datë 26.11.2024, si dhe konfirmon se ka nisur procedurat për lidhjen e kontratave të reja në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi. Për rrjedhojë, konstatimi i auditimit lidhur me moszbatimin e përcaktimit minimal prej 8 orësh në ditë mbetet i qëndrueshëm, ndërsa masa e të ardhurave të munguara prej **30,770 lekë** mbetet e argumentuar mbi bazën e përllogaritjeve të paraqitura në Tabelën nr. 14.
Në lidhje me subjektet që ushtrojnë aktivitet hotelerie, pretendimi **merret pjesërisht në konsideratë**, pasi, nëse VKB nr. 158 nuk përcakton shprehimisht një detyrim për rezervim 24 orë në ditë për këto subjekte, nuk mund të konsiderohet automatikisht si detyrim i përcaktuar ligjërisht diferenca e përllogaritur mbi bazën e 24 orëve. Për këtë arsye, **përllogaritja e të ardhurave të munguara prej 1,295,300 lekë duhet të rishikohet në funksion të bazës normative konkrete dhe të kushteve të kontratave**, duke mos e konsideruar natyrën 24-orëshe të aktivitetit hotelier si të vetme dhe të mjaftueshme për të përcaktuar detyrimin tarifor.
Megjithatë, pretendimi i subjektit **nuk rrëzon konstatimin mbi mungesën e kontrolleve dhe monitorimit periodik** nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë për të verifikuar përdorimin faktik të vendparkimeve dhe përputhshmërinë e tij me kushtet e kontratave. Ky konstatim mbetet i qëndrueshëm dhe duhet të reflektohet në rekomandimin përkatës.
Për sa i përket parkimit me pagesë dhe parkimit rezident, pretendimi se këto veprimtari nuk janë pjesë e detyrave të N.L. **merret në konsideratë vetëm për përcaktimin e përgjegjësisë individuale**. Kjo nuk prek gjetjet e auditimit mbi dobësitë e sistemit të kontrollit, monitorimit dhe administrimit të këtyre tarifave. Përgjegjësia duhet të përcaktohet ndaj strukturës dhe funksionarit që, sipas akteve të brendshme të Bashkisë, ka kompetencën përkatëse.
Në lidhje me tarifat për lejet/certifikatat e transportit, pretendimi **nuk e rrëzon gjetjen**, pasi vetë subjekti pranon se koordinimi me DRSHTRR dhe disponimi i informacionit për mjetet e certifikuara do të mundësonte një administrim më të plotë. Për sa i përket autorizimeve, sqarimi i dhënë mbi kushtet e përdorimit të tyre merret në konsideratë për saktësimin e gjetjes, por deklarimi për kryerjen e kontrolleve në vijimësi duhet të mbështetet me evidenca dokumentare. Në mungesë të dokumentacionit të tillë, mbetet konstatimi mbi nevojën për një sistematikë më të plotë të kontrolleve dhe shkëmbimit të informacionit me institucionet përkatëse. **Për rrjedhojë, gjetja mbetet në fuqi.**

- ***<u>Të ardhurat nga NSHP Bashkia Korçë</u>***

Nga informacioni i vënë në dispozicion të ardhurat që gjeneron NSHP gjatë vitit 2025 kanë qene në vlerën 2,963,233 lekë: të ardhura këto nga qira banese, qira mjeti, vërtetime, lejë punimesh, të ardhura sekondare, shitje lulefidanë, të ardhura nga ujitja, shitje bileta kulla panoramike, treni i fëmijëve, pista e patinazhit e,t,j. Vetëm të ardhurat nga Shitja e mallrave dhe Shërbimeve (ujitja) rezulton që për vitin 2025 të ketë gjeneruar 1,139,300 lekë ose 38% të totalit.

- ***<u>Nga auditimi për likuidimin e kontratave për Pyje- Kullota dhe qiratë e tokës bujqësore</u>***

Nga auditimi mbi administrimin dhe likuidimin e kontratave të qirasë për pyje-kullota dhe tokë bujqësore rezultoi se Bashkia Korçë dhe ish-komunat (aktualisht Njësitë Administrative) kanë

lidhur 10 kontrata për dhënien me qira të tokës bujqësore nga fondi i tokave të pandara, nga të cilat 9 kontrata me afat 99-vjeçar dhe 1 kontratë me afat 10-vjeçar, të lidhura duke filluar nga viti 2011.

Nr.	Emër Mbiemër	Datë fillimi	Datë mbarimi	Adresa	Sip m2/ha	Veprimtaria që realizohet	Debitor qeraje	Deb.Kamatvones	Detyrim sipas kontratës viti 2025	Arketime viti 2025	Debitore 31.12.2025
1	P.D.	22.02.2013	21.02.2112	Nj. Ad. Mollaj (Kamenice)	2.21	Kultivim			13260	13260	
2	S.A.	18.02.2013	17.02.2112	Nj. Ad. Mollaj (Kamenice)	1.336	Kultivim			8016	8016	
3	A.M.	10.01.2013	09.01.2112	Nj. Ad. Mollaj (Kamenice)	7.55	Bujqesor&Blegtoral			45300	45300	
4	A.S.	08.04.2013	07.04.2112	Nj. Ad. Mollaj (Kamenice)	1	Kultivim			6000	6000	
5	S.K.	08.04.2013	07.04.2112	Nj. Ad. Mollaj (Kamenice)	2.87	Kultivim	30,853	1,134,444			1165297
6	A.S.	29.03.2013	28.03.2112	Nj. Ad. Mollaj (Kamenice)	0.64	Kultivim			3840	3840	
7	J.S.	09.12.2011	09.12.2110	Nj. Ad. Drenove (Boboshtice)	2.17	Bujqesor&Blegtoral			21700	21700	
8	Y.M.	15.12.2011	15.12.2110	Nj. Ad. Drenove (Mborje)	0.1545	Bujqesor&Blegtoral			1545	1545	
9	D.H.	16.05.2012	15.05.2022	Nj. Ad. Vithkuq (Lubonje)	3.48	Bujqesor&Blegtoral	20,880	273,098			293978
							51,733	**1,407,542**	**99,661**	**99,661**	**1,459,275**

Gjithashtu, rezultoi se janë në fuqi 45 kontrata qiraje për pyje-kullota, nga të cilat:
11 kontrata rezultojnë debitore në vlerën totale 39,284,877 lekë;
2 kontrata janë likuiduar gjatë vitit 2026 në vlerën 254,154 lekë;
1 subjekt ka kryer pagesë të pjesshme në vlerën 86,375 lekë.
Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se një pjesë e konsiderueshme e detyrimeve të papaguara datojnë prej disa vitesh, ndërkohë që Bashkia Korçë është detyruar të ndjekë procedura gjyqësore për arkëtimin e detyrimeve dhe prishjen e kontratave.
Në veçanti rezulton se:
Për subjektin E,XH, detyrimi i papaguar prej 299,449 lekë është objekt gjykimi që prej vitit 2020 dhe çështja vijon në apel;
Për subjektet P.M. dhe G.X., detyrimi prej 574,933 lekë është fituar me vendim gjyqësor dhe është kaluar në fazën e ekzekutimit;
Për subjektin D.H., çështja vijon në proces gjyqësor pas ankimit të Bashkisë kundër vendimit për pushimin e gjykimit;
Për subjektin S.K., për detyrimin 1,165,297 lekë, Bashkia ka ushtruar ankim ndaj vendimit të shkallës së parë për pranimin e pjesshëm të padisë.
Veprime në kundërshtim me: Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 9, pika 1.2, shkronja "a", neni 9, pika 1.3, shkronja "a", si dhe pika 1.6, shkronja "a".
Për sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi: J.M. - Drejtor i Drejtorisë së Pyjeve dhe Kullotave dhe A.D., me detyrë Drejtore e drejtorisë së përgjithshme juridike dhe menaxhimit të burimeve njerëzore.

- ***Gjoba Policia Bashkiake***

Bazuar në informacionin e marrë nga Policia Bashkiake rezulton që për vitin 2025 të jenë vendosur në total 1,951,000 lekë gjoba (135,000 lekë në subjekte private dhe 1,816,000 lekë për kundërvajtje rrugore). Sipas analizës së arkëtimit të paraqitur nga Policia Bashkiake brenda vitit 2025 arkëtimi ka qenë 115,000 lekë nga subjektet private dhe 924,620 lekë nga kundërvajtjet rrugore.
Nga të dhënat e Sektorit të Financës, totali i detyrimeve (gjoba), të kontabiliauara është për vlerën 1,946,000 lekë. Çelej nga viti 2024 është për vlerën 71,000 lekë. Gjithsej vlera 2,017,000 lekë. Ndërsa referuar të dhënave të Policisë Bashkiake, vlera e penaliteteve (gjobave) të aplikuara për vitin 2025 është prej 1,951,000 lekë, pra me një mos rakordim për vlerën 5,000 lekë, për të cilën nuk jepet informacion.
Në lidhje me pagesat e vitit 2025, sipas Sektorit të Financës për vitin (kjo më e madhe në Sektorin e Policisë) është likuiduar vlera 973,000 lekë (për të dy kategoritë), të parashkruara nga lehtësirat në pagesë vlera 708,000 lekë, duke mbetur për pagesë vlera 336,000 lekë. Sipas të dhënave të

Policisë Bashkiake është likuiduar për vitin 2025 vlera 1,032,620 lekë ose më shumë se sa paraqet sektori i financës për vlerën 59,920 lekë (pagesa sipas financës 973,000 – pagesa sipas policisë 1,032,620). Gjithashtu, nga krahasimi i të dhënëve midis akt rakordimit të mbajtur midis Drejtorisë së Financës dhe Degës së Thesarit datë 31.12.2025 dhe likuidimeve sipas Sektorit të Financës, u konstatua mospërputhje për **vlerën 368,600 lekë**, pasi derdhjet për gjoba policie me kod 7115420 paraqitet për vlerën 604,400 lekë, ndërkohë që financa paraqet derdhje për vlerën 973,000 lekë, për të cilën nuk jepet argumentin përkatës.
Për sa sipër, mbajnë përgjegjësi: V.Z. me detyrë Drejt Financës dhe E. K. me detyrë Shef i Policisë Bashkiake.

- ***Komisioni i Apelimit Administrativ të Taksave dhe Tatimeve Vendore (KATTV):***

Nga auditimi rezultoi se në Bashkinë Korçë nuk është ngritur Komisioni (ose Struktura) e Apelimit Tatimor dhe kjo strukturë nuk është parashikuar në Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe nenit 7, si edhe nenit 22 pika 5, të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.
Si pasojë e mosngritjes së kësaj strukture, ankimet administrative të taksapaguesve ndaj akteve të administrimit të taksave dhe tarifave vendore janë shqyrtuar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe vendimet përkatëse janë miratuar nga Kryetari i Bashkisë. Kjo praktikë nuk garanton një shqyrtim administrativ të pavarur dhe objektiv, pasi ankimi shqyrtohet nga e njëjta strukturë administrative që ka nxjerrë aktin objekt ankimi, duke mos respektuar parimin e paanshmërisë në procedurat administrative.
Moszbatimi i kërkesave ligjore për ngritjen e strukturës së apelimit tatimor dhe mosreflektimi i saj në aktet e brendshme organizative të bashkisë, sjell:
- mungesë e një mekanizmi administrativ të pavarur për shqyrtimin e ankesave;
- cenim i të drejtës së taksapaguesve për një shqyrtim administrativ efektiv dhe të paanshëm;
- rritje e riskut për konflikte gjyqësore dhe pavlefshmëri procedurale të vendimeve administrative;
- dobësim i kontrollit të brendshëm dhe i transparencës në administrimin e taksave vendore.

- Arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore për biznesin.

Në Bashkinë Korçë subjektet tregtarë ngarkohen me detyrime vendore për taksën e regjistrimit, mbi truallin, pasuri, pastrim, ndriçim, tarifën e gjelbërimit, etj. i detajuar borxhi faktik neto për vitin 2025 sipas llojeve të taksave dhe tarifave paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.16: *Në lekë*

Nr.	PER SUBJEKTET FIZIK/JURIDIK/SHTETROR	Shuma progresive 31.12.2024		Borxh 2025		Shtesa gjatë vitit 2025		Arkëtuar gjatë vitit 2025 2024 edhe për vitet para 2024		Shuma progresive31.12.2025	
		Nr. Sub	Vlera	Nr. Sub	Vlera	Nr. Sub	Vlera	Nr. Sub	Vlera	Nr. Sub	Vlera
1	Regjistrim	221	2,756,500					14	100,000	207	2,656,500
2	Pasuri	2455	93,608,609	1228	16,699,722	2	12,563,786	1245	33,565,602	2,440	89,306,515
3	Truall	408	13,108,722	205	4,475,340	2	929,736	226	4,005,488	389	14,508,310
4	Toke bujqesore					2	46,020	2	46,020	0	0
5	Pastrim	2336	61,322,754	618	9,738,311			683	8,010,085	2,271	63,050,980
6	Ndriçim	2338	17,314,884	622	3,483,763			676	2,769,929	2,284	18,028,718
7	Gjelbërim	2139	12,092,925	550	2,554,484			607	2,000,122	2,082	12,647,287
8	Tabelë	664	443,339					27	2,860	637	440,479
9	Reklamë	66	13,702,684	5	3,081,150			5	543,000	66	16,240,834
10	Tavolina	31	1,295,950					5	35,400	26	1,260,550
11	H.P	165	9,257,413	74	1,907,369			76	1,130,063	163	10,034,719
12	Parkim	46	1,293,600	9	206,040			15	186,014	40	1,313,626
13	T. Hoteli	94	1,562,310	77	1,368,990			83	1,257,670	88	1,673,630
14	T.Vendore	369	23,107,449					29	552,892	340	22,554,557
15	Gjoba	3598	23,593,958	2028	5,762,985	1	22,890,618	2127	6,527,408	3500	45,720,153
16	E.M	7	74,000							7	74,000
17	Servituti	28	1,103,658	7	108,504			17	247,990	18	964,172

Nr.	PER SUBJEKTET FIZIK/JURIDIK/SHTETROR	Shuma progresive 31.12.2024		Borxh 2025		Shtesa gjatë vitit 2025		Arkëtuar gjatë vitit 2025 2024 edhe për vitet para 2024		Shuma progresive31.12.2025	
		Nr. Sub	Vlera	Nr. Sub	Vlera	Nr. Sub	Vlera	Nr. Sub	Vlera	Nr. Sub	Vlera
18	T.N.I	373	24,407,330	85	2,953,821			84	2,999,685	374	24,361,466
19	T.perd.Tubacioneve	2	5,610					2	5,610	0	0
	SHUMA		**300,051,695**		**52,340,479**		**36,430,160**		**63,985,838**		**324,836,496**

***Burimi**: DTTV, përpunuar nga grupi i auditimit*

Nga krahasimi i debitorëve në fund të vitit 2024 dhe në fund të vitit 2025 vihet re se kemi rritje të debitorëve të kategorisë "Biznes", për vlerën 24,784,802 lekë.

Në vitin 2025 në Bashkinë Korçë dhe NJA, janë krijuar 2,167 subjekte tregtare, pronarë pasurish të paluajtshme dhe individë debitorë për vlerën 52,340,479 lekë, e ndarë si më poshtë vijon:

- 233 subjekte "Biznesi i Madh" në vlerën 21,030,615 lekë
- 879 subjekte "Biznesi i Vogël" në vlerën 15,185,919 lekë
- 970 pronarë ndërtesash në vlerën 13,170,124 lekë
- 85 individë që kanë detyrim për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet në vlerën 2,953,821 lekë.

- ***Arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore për familjarët.***

Në Bashkinë Korçë familjarët ngarkohen me detyrime vendore për taksën e tokës, taksën e ndërtesës, taksën e truallit, tarifën e pastrimit, tarifën e ndriçimit, tarifën e gjelbërimit, tarifën e mirëmbajtjes së varrezave publike, tarifën e mirëmbajtjes së rrugëve të parcelave dhe sistemit kullues, si dhe aplikoheshin gjobë vonesa për familjarët deri në vitin 2018.

Detyrimet e kategorisë "Popullata" për vitin 2025.

- Mënyra e parashikimit të detyrimeve të familjarëve:

- *Tarifa e pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit, mirëmbajtjes së varrezave,* parashikohet në bazë të numrit të familjeve rezidente aktive të Bashkisë. Për këtë, nga DTTV përdoren kontratat e popullatës për furnizimin me ujë të pijshëm sipas SHRUKKO me përditësimet përkatëse si dhe informacionet e ZGJCV, informacionet e Rajoneve Administrative, Njësive Administrative, dhe evidentimeve në terren të familjeve efektive me kryetarët e fshatrave për çdo njësi administrative.
- *Taksa e ndërtesës* parashikohet në bazë të regjistrit të taksës së ndërtesës, të përditësuar me numër pasurie, zonë kadastrale, njësi pronësore të reja, saktësim dhe shtim sipërfaqesh, saktësim nr. katesh mbi dhe nën sipërfaqen e tokës.
- *Taksa mbi tokën bujqësore dhe tarifa mirëmbajtje rrugë parcela dhe sistem kullues* aplikohet në faturën e furnizimit më ujë të pijshëm për ato familje që kanë një kontratë me SHRUKKO dhe të gjithë të tjerat e marrin këtë shërbim pranë sportelit të Bashkisë apo në Njësitë Administrative.

- ***Njoftimet e bëra për familjarët, masat e mara dhe masat shtrënguese:***

Shërbimi për familjet ofrohet në sportelin me një ndalesë të Bashkisë Korçë nga specialisti i ngarkuar për taksat dhe tarifat vendore familjare, në sportelet e njësive administrative dhe ne zyrën e Shërbimit të Klientit të SHRUKKO. Paketa Fiskale e Bashkisë publikohet në faqen zyrtare të saj, ku të gjithë personat e interesuar mund të marrin informacion të gjerë në lidhje me taksat dhe tarifat vendore, nivelin e tyre, afatet e pagesave, përjashtimet përkatëse etj.

Shpërndarja e faturave dhe njoftimi i familjeve për detyrimet vendore, është bërë nëpërmjet njoftim vlerësimeve të dërguara me shërbim postar, nëpërmjet specialistëve për mbledhjen e të ardhurave në njësitë administrative, nëpërmjet rajoneve dhe njësive administrative.

Për shërbimet që qytetarët kërkojnë të kryejnë në bashkinë Korçë kërkohet dokumentimi i shlyerjes së detyrimeve, me synim ndërgjegjësimin e tyre për pagesën e taksave dhe tarifave vendore në mënyrë vullnetare.

Për vitin 2025 në mënyrë të progresive, detyrimet e familjeve për taksat dhe tarifat vendore sipas njësive administrative janë paraqitur në Aneks.

Familjet debitorë (përfshire SHRUKKO) për taksat dhe tarifat vendore në Bashkia Korçë viti 2025, në lekë/rast familje

Tabela:

Gjendje 31.12.2025		Gjendje 31.12.2025		Gjendje 31.12.2025		Gjendje 31.12.2025		Gjendje 31.12.2025	
Gjelberim		Takse Ndertese		Truall		Toke Bujqesore		Pastrim	
Nr	Vlere	Nr	Vlere	Nr	Vlere	Nr	Vlere	Nr	Vlere
19,549	8,852,989	28,994	83,390,108	8,286	5,972,773	13,180	95,861,362	29,210	75,122,401

Gjendje 31.12.2025		Gjendje 31.12.2025		Gjendje 31.12.2025		Gjendje 31.12.2025		Gjendje 31.12.2025	
Ndriçim		Varreza		Kanalizime		Gjobvonesa		Totali	
Nr	Vlere	Nr	Vlere	Nr	Vlere	Nr	Vlere	Nr	Vlere
29,219	23,114,234	28,989	16,308,184	11,173	28,896,833	5,460	6,086,726		343,605,609

***Burimi**: DTTV Bashkia Korçë, përpunuar nga grupi i auditimit.*

Për taksat dhe tarifat që faturohen dhe ndiqen për arkëtim nëpërmjet agjentit tatimor SHRUKKO dhe nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore aparati i bashkisë dhe njësive administrative në fund të vitit 2025 paraqiten me vlerë debitore prej **343,605,609 lekë**, e cila përbëhet nga detyrimet që kanë familjaret për faturimet nga agjenti tatimor SHRUKK në vlerën prej **137,355,371 lekë** për taksën e ndërtesës për tarifat e pastrim gjelbërim, ndriçim, dhe varreza dhe detyrimet e familjeve për taksat dhe tarifat vendore që faturohen nga DTTV për vlerën prej **206,250,238 lekë**.

- ***Kontrata me Agjentin Tatimor Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizime Korçë (SHRUKK)***

Të dhënat në lidhje me debitorët e taksave dhe tarifat vendore për familjarët të cilët kanë një kontratë të lidhur me SHRUKKO deri në fund të vitit 2025 janë në vlerën **137,355,371 lekë** dhe vetëm për vitin 2025 detyrimi është në vlerën **39,297,015 lekë**, detyrime këto të kontabilizuara nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Sektori i kadastrës Fiskale, Vlerësimit dhe Shërbimit të Taksapaguesve me shkresën Nr. 216 prot., datë 12.01.2026 drejtuar Drejtorisë së Financës, Buxhetit dhe M.F.K.

Bashkëpunimi për mbledhjen e taksave dhe tarifave nga agjenti (SHRUKKO) është kryer në bazë të marrëveshjes nr. 10216/1 datë 25.11.2022, aneks marrëveshjes me nr. 10216/3.prot., datë 13.04.2023 dhe aneks marrëveshjes me nr. 10216/4.prot., datë 21.03.2024. Nga shqyrtimi i kontratës dhe anekseve kontratës së lidhur me agjentin tatimor Shoqëri Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë nuk është parashikuar ndonjë përcaktim për vonesën në transferimin e detyrimeve të pa mbledhura nga familjarët për taksat dhe tarifat vendore. Në kontratë përcaktohet që, mosmarrëveshjet ndërmjet palëve zgjidhen sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë. Referuar Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë miratuar me Ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994, ndryshuar me ligjet nr. 8536, datë 18.10.1999; nr. 8781, datë 03.05.2001 dhe nr. 17/2012, datë 16.02.2012; 121/2013, datë 18.04.2013 neni 481 përcakton që "Debitori që nuk përmbush një detyrim të kërkueshëm në afatin e caktuar, quhet se është në vonesë, përveç kur mosekzekutimi është rrjedhim i rrethanave që nuk kanë lidhje me fajin e debitorit".

Tabela e borxhit progresiv për periudhën 2011-2025 SHRUKKO (*borxhi 2021 – 2025)*

BORXHI	nr.	Ndërtesa	nr.	Pastrim	Nr.	Ndriçim	Nr.	Gjelbërim	Nr.	Varreza	Nr.	Toke	Nr.	Kanale	Nr.	truall	Totali
Njësia Korçë	18,445	31,110,785	19,525	51,179,858	19,543	12,483,707	19,549	8,852,989	19,357	6,342,860	0	0	0	0	54	135,592	110,105,790
Njësitë administrative	5,857	9,640,960	6,587	8,062,483	6,594	3,097,815	0	0	6,589	2,749,418	3,793	2,397,699	3,542	1,301,206			27,249,581
Totali	**24,302**	**40,751,744**	**26,112**	**59,242,340**	**26,137**	**15,581,522**	**19,549**	**8,852,989**	**25,946**	**9,092,278**	**3,793**	**2,397,699**	**3,542**	**1,301,206**	**54**	**135,592**	**137,355,371**

Tabela e borxhit për vitin 2025 SHRUKKO

BORXHI	nr.	Ndërtesa	nr.	Pastrim	Nr.	Ndriçim	Nr.	Gjelbërim	Nr.	Varreza	Nr.	Toke	Nr.	Kanale	Nr.	truall	Totali
Qyteti	17,791	8,272,409	18,859	14,183,542	18,859	3,636,029	18,859	2,549,657	18,859	1,857,143	0	0	0	0	54	135,593	30,634,373
Njësi adm	5,195	2,526,564	5,759	1,883,568	5,759	870,203	0		5,759	627,856	3,782	1,782,842	3,531	971,609			8,662,642
Totali	**22,986**	**10,798,973**	**24,618**	**16,067,110**	**24,618**	**4,506,232**	**18,859**	**2,549,657**	**24,618**	**2,484,999**	**3,782**	**1,782,842**	**3,531**	**971,609**	**54**	**135,592**	**39,297,015**

Akt-rakordimet e mbajtura midis Bashkisë Korçë dhe SHRUKKO në lidhje me arkëtimet mujore

Akt Rakordimet Gjatë 2025										
2025 Qytet + Njesi										
Muaji	**Ndërtesa**	**Pastrim**	**Ndriçim**	**Gjelbërim**	**Varreza**	**Toke**	**Kanale**	**Totali**	**0.98**	**UKKO 2%**
Janar	4,751,438	7,042,594	1,930,800	1,122,640	1,074,765	1,247,052	687,730	17,857,019	17,499,879	357,140
shkurt	4,407,741	6,591,317	1,803,546	1,059,052	997,639	1,153,605	639,806	16,652,706	16,319,652	333,054
Mars	4,284,631	6,252,809	1,712,318	1,004,638	946,890	1,105,245	612,610	15,919,141	15,600,758	318,383
Prill	4,484,604	6,557,535	1,794,640	1,051,850	993,812	786,533	435,989	16,104,963	15,782,864	322,099
Maj	4,619,608	6,792,349	1,859,499	1,086,240	1,033,121	706,964	390,960	16,488,741	16,158,966	329,775
Qershor	4,490,760	6,570,991	1,801,820	1,057,045	995,865	692,785	381,327	15,990,593	15,670,781	319,812
Korrik	4,488,397	6,573,098	1,803,437	1,055,531	997,348	686,723	376,552	15,981,086	15,661,464	319,622
Gusht	4,821,998	6,856,129	1,888,284	1,096,657	1,046,785	718,731	396,651	16,825,235	16,488,730	336,505
Shtator	5,226,613	7,477,839	2,066,824	1,189,164	1,150,120	802,106	431,418	18,344,084	17,977,202	366,882
Tetor	4,754,330	6,655,857	1,831,073	1,063,768	1,016,288	710,722	388,876	16,420,914	16,092,496	328,418
Nentor	4,859,316	7,075,584	1,945,841	1,133,209	1,077,306	733,482	406,147	17,230,885	16,886,267	344,618
Dhjetor	4,414,955	6,390,436	1,755,430	1,031,465	965,991	632,514	356,592	15,547,383	15,236,435	310,948
Total	**55,604,391**	**80,836,538**	**22,193,512**	**12,951,259**	**12,295,930**	**9,976,462**	**5,504,658**	**199,362,750**	**195,375,495**	**3,987,255**

Bazuar në akt-rakordimet si dhe referuar marrëveshjes agjenti tatimor ka përfituar 3,987,255 lekë komision të përllogaritur nga 2% i totalit të arkëtimeve të deklaruara dhe paguara në llogarinë e Bashkisë Korçë.

Për vitin 2025 në mënyrë të përmbledhur, detyrimet e familjeve për taksat dhe tarifat vendore sipas njësive administrative vetëm për vitin 2025 janë paraqitur në tabelën nr. 17.

Tabela nr.17 (*në lekë)*:

Nr.	Bashkia/Nj.A	Takse mbi token Bujqësore		Takse Ndertës		Tarife Pastrimi		Tarife Ndriçimi		Tarife për mirëmbajtje e varrezave publike		Tarifë e mirëmbajtjes se parcelave dhe sistemit kullues		Takse Trualli		Tarife Gjelbërimi		Total
		Nr.	Vlere	Nr.	Vlere	Nr.	Vlere	Nr.	Vlere	Nr.	Vlere	Nr.	Vlere	Nr.	Vlere	Nr.	Vlere	
1	Voskopoje	491	453,829	379	331,413	358	177,750	358	82,950	358	59,250			51	4,291			1,109,483
2	Voskop	1,298	2,555,260	940	991,847	839	628,505	839	293,468	838	209,534	1,302	1,646,737	786	112,723			6,438,074
3	Mollaj	1,334	1,706,883	1,065	622,310	1,061	448,017	1,061	208,376	1,061	149,346	1,336	841,573	889	113,957			4,090,462
4	Drenova	3,119	2,642,377	2,397	2,467,009	2,166	1,294,439	2,166	596,430	2,166	431,562	3,056	1,469,919	2,060	334,921			9,236,657
5	Vithkuq	887	1,449,586	386	548,061	186	220,000	187	103,167	187	73,833			479	45,296			2,439,943
6	Bulgarec	3,032	3,684,316	2,700	2,347,914	2,749	1,496,357	2,749	697,900	2,749	498,786	3,031	2,346,216	2,462	404,916			11,476,405
7	Lekas	98	311,697	89	285,513	45	22,500	30	7,500					146	43,176			670,386
8	Korce	383	398,614	177,791	8,272,409	18,859	14,183,542	18,859	3,636,029	18,859	1,857,143	387	289,542	54	135,593	18,859	2,549,657	31,322,529
	Totali	**10,642**	**13,202,562**	**185,747**	**15,866,476**	**26,263**	**18,471,110**	**26,249**	**5,625,820**	**26,218**	**3,279,454**	**9,112**	**6,593,987**	**6,927**	**1,194,873**	**18,859**	**2,549,657**	**66,783,939**

Burimi: DTTV, përpunuar nga grupi i auditimit.

Në mënyrë të përmbledhur debitorët për vitin 2025 nga taksapaguesit subjektet tregtare dhe familjarë sipas llojeve të taksave/tarifave dhe viteve janë paraqitur në tabelën nr. 18.

Tabela nr.18 *(shprehur në lekë)*:

Nr.	Lloji i taksës	Subjekte biznes				Familje (jo UKKO)				Familjare (UKKO)				Total				
		Prog 31.12.2024	Shtesa 2025	Borxh 2025	Arktime 2025	Prog 31.12.2024	Shtesa 2025	Borxh 2025	Arktime 2025	Prog 31.12.2024	Shtesa 2025	Borxh 2025	Arktime 2025	Prog 31.12.2024	Shtesa 2025	Borxh 2025	Arktime 2025	Prog.31.12.2025
1	Regjistrim	2,756,500			100,000									2,756,500	0	0	100,000	2,656,500
2	Pasuri	93,608,609	12,563,786	16,699,722	33,565,602	39,753,069	10,217,007	5,067,503	12,399,214	38,410,362	110	10,798,973	8,457,700	171,772,040	22,780,903	32,566,198	54,422,516	172,696,625
3	Truall	13,108,722	929,736	4,475,340	4,005,488	5,911,099	654,703	1,059,279	1,787,899			135,593		19,019,821	1,584,439	5,670,212	5,793,387	20,481,085
4	Pastrim	61,322,754		9,738,311	8,010,085	14,464,571	2,497,247	2,404,000	3,485,757	55,651,307	175	16,067,110	12,476,251	131,438,632	2,497,422	28,209,421	23,972,093	138,173,382
5	Ndriçim	17,314,884		3,483,763	2,769,929	6,146,326	1,571,424	1,119,587	1,304,625	14,455,607	64	4,506,232	3,380,381	37,916,817	1,571,488	9,109,582	7,454,935	41,142,952
6	Gjelbërim	12,092,925		2,554,484	2,000,122					8,210,185	46	2,549,657	1,906,900	20,303,110	46	5,104,141	3,907,022	21,500,275
7	Tabelë	443,339			2,860									443,339	0	0	2,860	440,479
8	Reklamë	13,702,684		3,081,150	543,000									13,702,684	0	3,081,150	543,000	16,240,834
9	Tavolina	1,295,950			35,400									1,295,950	0	0	35,400	1,260,550
10	H.P	9,257,413		1,907,369	1,130,063									9,257,413	0	1,907,369	1,130,063	10,034,719
11	Parkim	1,293,600		206,040	186,014									1,293,600	0	206,040	186,014	1,313,626
12	T. Hoteli	1,562,310		1,368,990	1,257,670									1,562,310	0	1,368,990	1,257,670	1,673,630
13	T.Vendore	23,107,449			552,892									23,107,449	0	0	552,892	22,554,557
14	Gjoba	23,593,958	22,890,618	5,762,985	6,527,408	6,798,932	440,111		1,152,321					30,392,890	23,330,729	5,762,985	7,679,729	51,806,875
15	E.M	74,000												74,000	0	0	0	74,000
16	Servituti	1,103,658		108,504	247,990									1,103,658	0	108,504	247,990	964,172
17	T.N.I	24,407,330		2,953,821	2,999,685									24,407,330	0	2,953,821	2,999,685	24,361,466
18	T.P.Tubac	5,610			5,610									5,610	0	0	5,610	0
18	Varreza					5,943,350	1,630,274	794,455	1,152,173	8,561,908		2,484,999	1,954,629	14,505,258	1,630,274	3,279,454	3,106,802	16,308,184
19	Tokë		46,020		46,020	96,789,216	2,997,192	11,419,720	17,742,465	2,267,939		1,782,842	1,653,082	99,057,155	3,043,212	13,202,562	19,441,567	95,861,362
20	Kanalizime					28,200,321	876,746	5,622,377	7,103,817	1,237,914		971,609	908,317	29,438,235	876,746	6,593,986	8,012,134	28,896,833
	SHUMA	**300,051,695**	**36,430,160**	**52,340,479**	**63,985,838**	**204,006,884**	**20,884,704**	**27,486,921**	**46,128,271**	**128,795,222**	**395**	**39,297,015**	**30,737,260**	**632,853,801**	**57,315,259**	**119,124,415**	**140,851,369**	**668,442,106**

Burimi: DTTV, përpunuar nga grupi i auditimit.

- ***<u>Evidentimi i detyrimeve tatimore të paarkëtuara progresive dhe për vitin buxhetor 2025</u>***

Situata e vjeljes së të ardhurave dhe krijimi i borxhit tatimor për vitin 2025 paraqitet si me poshtë;

Nga ana e Bashkisë Korçë nuk janë marrë masat për mbledhjen e detyrimeve të prapambetura, që në fund të viti 2024 në mënyrë progresive janë në shumën 632,853 mijë lekë dhe për vitin 2025 progresivisht janë 668,442 mijë lekë si vijon:

Detyrimet tatimore sipas kategorisë së debitorëve (biznese/familjarë) për vitin 2024 (shprehur në lekë)

Nr.	Njësitë Administrative	Taksa e tokës Bujqësore	Takse Ndërtesë	Takse Trualli	Tarifa Pastrim, Ndriçim, Gjelbërim, e.t.j	Debitor Biznes I Vogël	Debitor Biznes i Madh	Debitor Aluizni	Totali
1	Bulgareci	33,156,852	16,186,432	1,806,287	26,556,270				**77,705,841**
2	Voskopi	10,819,086	4,409,991	348,756	9,473,843				**25,051,676**
3	Drenova	22,793,894	17,318,586	1,873,716	22,944,796				**64,930,993**
4	Mollaj	15,615,607	5,173,694	419,864	10,932,500				**32,141,666**
5	Vithkuq	10,759,643	3,300,204	230,786	3,584,505				**17,875,137**
6	Voskopojë	1,902,261	1,010,006	21,610	1,192,822				**4,126,698**
7	Lekas	2,837,065	1,245,300	1,210,080	754,283				**6,046,728**
8	Korçë	1,172,748	29,519,218		74,231,401				**104,923,368**
9	Bashkia Korçë		37,761,024	8,329,954	2,505,647	102,370,591	124,677,149	24,407,330	**300,051,695**
Totali		**99,057,156**	**115,924,455**	**14,241,053**	**152,176,068**	**102,370,591**	**124,677,149**	**24,407,330**	**632,853,801**

Burimi: *Bashkia Korçë, Raporti NJAB*

Për periudhën 01.01.2024 deri më 31.12.2024, DTTV ka regjistruar në evidencat e saj në Excel treguesin e detyrimeve progresive deri me dt. 31.12.2024 në shumë prej 632,853,801 lekë, i cili analitikisht sipas NJA-ve dhe kategorive të taksave e tatimeve detajohet në tabelat e mëposhtme:

Detyrimet e mbartura dhe progresive për taksat dhe tarifat vendore të Bashkisë deri në datën 31.12.2025 jepen në tabelën e mëposhtme.

Detyrimet tatimore sipas kategorisë së debitorëve (biznese/familjar) për vitin deri në datën 31.12.2025 (shprehur në lekë)

Nr.	Njësitë Administrative	Taksa e tokës Bujqësore	Takse Ndërtesë	Takse Trualli	Tarifë Pastrim, Ndriçim, Gjelbërim, e.t.j	Debitor Biznes I Vogël	Debitor Biznes i Madh	Debitor Aluizni	Totali
1	Bulgareci	28,914,679	15,223,224	1,996,291	25,449,081				**71,583,275**
2	Voskopi	10,528,468	4,956,342	409,762	9,721,343				**25,615,916**
3	Drenova	23,923,516	20,041,313	2,311,990	27,923,367				**74,200,187**
4	Mollaj	14,957,332	4,376,491	519,864	10,479,985				**30,333,671**
5	Vithkuq	11,127,556	3,429,454	243,720	3,470,380				**18,271,109**
6	Voskopojë	2,202,170	1,278,014	24,217	1,292,578				**4,796,978**
7	Lekas	2,849,929	2,974,486	331,338	355,376				**6,511,129**
8	Korçë	1,357,712	31,110,785	135,593	79,689,253				**112,293,343**
9	Bashkia Korçë		36,336,392	9,756,533	9,248,158	109,328,140	135,805,808	24,361,466	**324,836,497**
Totali		**95,861,362**	**119,726,502**	**15,729,307**	**167,629,521**	**109,328,140**	**135,805,808**	**24,361,466**	**668,442,106**

Burimi: *Bashkia Korçë, DTTV*

Gjendja debitore progresive më datë 31.12.2025, është në vlerën 668,442,106 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Korçë, niveli i këtyre detyrimeve në fund të viti 2025 është 35,588,305 lekë më i lartë se niveli i detyrimeve në datë 31.12.2024.

Detyrimet nga taksat dhe tarifat e bizneseve, në vlerën 324,836,496 lekë, ku 104,904,555 lekë është detyrim i 772 subjekteve të cilët rezultojnë me status Pasiv/Mbyllur (255 subjekte të cilat kanë aplikuar për çregjistrim me vlerë 17,501,350 lekë, 177 subjekte me status pezulluar me vlerë 21,565,297 lekë dhe 340 subjekte me status pasiv me vlerë 65,837,938 lekë), tabela 19.

Tabela nr. 19

NR	STATUSI	NR/SUBJEKTEVE	VLERA
1	Ap.Çregjistrim	255	17,501,350

NR	STATUSI	NR/SUBJEKTEVE	VLERA
2	Perzulluar	177	21,565,297
3	Pasiv	340	65,837,908
	Shuma	**772**	**104,904,555**

Detyrime nga taksat dhe tarifat vendore për familjet në vlerën 343,605,610 lekë.
Në fund të vitit 2025 gjendja e debitorëve progresiv për bizneset dhe familjarët është **668,442,106 lekë**, vlerë kjo që ka sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Korçë.
Nga auditimi u verifikuan subjektet të cilat kanë aplikuar gjatë vitit 2025 për çregjistrim aktiviteti apo kanë kaluar me status pasiv dhe pavarësisht se subjektet kanë aplikuar për çregjistrim aktiviteti apo kanë kaluar më status pasiv vlera debitore që këto subjekte kanë ndaj Bashkisë Korçë është në vlerën 1,797.022 lekë nga 62 subjekte të cilat nuk i kanë likuiduar këto detyrime përpara momentit të aplikimit. Gjithashtu 13 subjekte të cilat kishin aplikuar për pezullim kishin riaktivizuar aktivitetin gjatë vitit 2025.

- ***Dinamika e Borxhit***:

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se struktura e borxhit për subjektet e biznesit të madh, biznesit të vogël dhe pronarë të bizneseve, sipas moshës së tij paraqitet si më poshtë:
Tabela nr.38:

Mosha e Borxhit ne fund të vitit 2024	Vlera/lekë	Nr. Subjekte
1-3 vit	61,410,895	1,910
3-5 vjet	39,731,758	383
5-10 vjet	107,670,430	1,037
Mbi 10 vjet	116,023,414	731
Totali	**324,836,497**	**4,061**

Referuar të dhënave të pasqyrës, konstatohet se vlerën më të lartë të borxhit e zënë debitorët e moshës mbi 10 vjet në vlerën 116,023,414 lekë ose 35.7% e totalit, debitorët e moshës 5-10 vjet në vlerën 107,670,430 lekë ose 33.1% e totalit, debitorët e moshës 1-3 vjet në vlerën 61,410,895 lekë ose 18.9% e totalit dhe debitorët e moshës 3-5 vjet në vlerën 39,731,758 lekë ose 12.2% e totalit.

- ***Menaxhimi borxhit nga taksat e tarifat vendore. Auditimi i rasteve në lidhje me zbatimin e masave shtrëngese për arkëtimin e borxhit ndaj subjekteve debitorë.***

Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore (DTTV), Bashkia Korçë është përgjegjëse për të mbledhur detyrimet e papaguara në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Në zbatim të Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, hapat që duhet të ndërmerren me qëllim mbledhjen e detyrimeve të papaguara vijnë duke u përshkallëzuar si:

1. Njoftimi dhe kërkesa për të paguar;
2. Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit;
3. Masa e sigurimit të detyrimit tatimor;
4. Sekuestrimi i pasurisë.

- ***Masat e marra për arkëtimin e debitorëve për vitin 2025***

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion lidhur hapat që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet rezulton se, janë dërguar dhe njoftuar me njoftim vlerësimi tatimor të gjithë bizneset brenda afateve të përcaktuara në paketën fiskale konkretisht brenda datës 20.04.2025 janë dërguar njoftim vlerësimet për subjektet tregtare në lidhje me tarifat lokale, brenda datës 30.06.2025 janë dërguar njoftim vlerësimet për pronarët e pasurive të paluajtshme dhe për subjektet e krijuara rishtazi janë dërguar brenda afatit të përcaktuar dhe brenda vitit ushtrimor janë dërguar njoftim vlerësimet për të gjithë familjet të cilat nuk kanë një kontratë të lidhur me SHRUKKO.

INSTUTICIONI	SHKRESA		MASA BLLOKIM		ZBATUAR	
	NR/SUB	DATË	NR	VLERA	NR.	VLERA
Banka e nivelit te dyte	57		3342	231,384,172	908	41,873,279
ZRPP/ ASHK	4		35	5,769,128	4	600,213
DSHTRR						
Sekuestro			83	3,808,638	73	3,258,514
Njoftim kërkesë pagese	38		5,239	259,536,850		

Për vitin 2025, debitorëve familjarë për detyrimet e akumuluara, DTTV u ka dërguar 4,189 njoftime dhe kërkesë për pagesë në vlerën 75,532,615 lekë dhe ju është drejtuar edhe bankave të nivelit të dytë për bllokim të llogarive bankare, në total me 31 shkresa me numër total debitorësh prej 1,900 familjesh për vlerën 65,792,303 lekë, ku 334 familje kanë arritur të paguajnë vlerën prej 9,475,845 lekë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezultoi se për vitin 2025 drejt subjekteve tregtarë janë dërguar 1,050 njoftime dhe kërkesë për pagesë në vlerën 184,004,235 lekë. Veç njoftimeve për detyrimet e akumuluara, DTTV u është drejtuar edhe bankave të nivelit të dytë për bllokim të llogarive bankare, në total me 26 shkresa me 1,442 subjekte për vlerën 165,591,869 lekë, ku 574 subjekte kanë reaguar duke paguar vlerën prej 32,397,434 lekë.
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezultoi se për vitin 2025, debitorëve për TNI janë dërguar 326 njoftime dhe kërkesë për pagesë në vlerën 22,519,032 lekë, të dhëna të cilat paraqitën në tabelën nr. 20.

Tabela nr. 20 *(shprehur ne lekë)*

T.N.I		NJOFTIM	KERKESE
NR.SUB	NR.PROT	DATA	VLERA
316	9287	15.09.2025	12,879,800
10	12245	19.11.2025	9,639,232
326			**22,519,032**

Veç njoftimeve për detyrimet e akumuluara, DTTV u është drejtuar edhe bankave të nivelit të dytë për bllokim të llogarive bankare, në total me 2 shkresa me 234 tatimpagues për vlerën **18,775,767 lekë**, ku 38 tatimpagues kanë reaguar duke paguar vlerën prej **1,690,458 lekë,** siç tregohet në tabelën nr. 21**.**

Tabela nr. 21 *(shprehur ne lekë)*

T.N.I		Bllokim	Banke	Zbatuar	Banke
Nr. sub	Nr. prot	DATA	Vlera	Nr., Sub	Vlera
226	12183	19.11.2025	9,477,127	36	1,372,526
8	13556	19.12.2025	9,298,640	2	317,932
234			**18,775,767**	**38**	**1,690,458**

Gjithashtu DTTV ka komunikuar në mënyrë shkresore edhe me ZRPP/ASHK duke dërguar 4 shkresa me **35 tatim pagues** ku kanë reaguar dhe kanë paguar detyrimin 4 tatim-pagues me vlerë prej **600,213 lekë**.
Për vitin 2025 nuk janë dërguar njoftime për vendosjen e barrës siguruese RBS nga ana e Bashkisë Korçë, kjo për mungesë informacioni në lidhje me të dhënat specifike të mjeteve. Ekziston komunikim shkresor midis Bashkisë Korçë dhe DRSHTR-Korçë shkresa nr. 10924 prot, datë 21.10.2025, në të cilën kërkohet informacion i detajuar për 1529 subjekte debitore, prodhuesin, vitin e prodhimit të mjetit, emrin, atësinë, mbiemrin dhe NID të pronarit të mjetit; nëse do rezultonin mjete të regjistruara për këto subjekte. Nga DRSHTR-Korçë me shkresën nr. 8466/1prot, datë 27.10.2025 është kthyer përgjigje se : Bazuar në ligjin 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, nuk i lejohet kësaj të fundit dhënia apo shpërndarja e të dhënave personale që përmbajnë elementë identifikues të qytetarëve.
Nga dokumentacioni i paraqitur dhe të dhënat e vëna në dispozicion vihet re, se pavarësisht urdhrave të bllokimeve të lëshuara në vitin aktual ka patur arkëtime dhe nga urdhra bllokimesh të lëshuara në vitet paraardhëse konkretisht në **32 subjekte** për vlerën **3,284,968 lekë.**

Nga auditimi i procedurave të ndjekura për njoftimet e vendosjen e masave shtrënguese dhe ndjekjen e arkëtimit të borxhit konstatohet se, DTTV Bashkia Korçë për vitin 2025 masat shtrënguese i fillon në përfundim të afatit të pagesave. Në rastin konkret bllokimet e llogarive bankare, vendosja e barrëve hipotekore dhe siguruese për debitorët e vitit 2025 është bërë pas kalimit të afateve të përcaktuara dhe ndjekja e tyre ndiqet përgjatë vitit 2025, çka e bën efektive masat për rritjen e arkëtimeve dhe uljen e borxhit të krijuar brenda vitit ushtrimor.

Konkluzion: Në bazë përpunimit të të dhënave të regjistrit të taksave dhe tarifave si dhe informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Korçë, rezultoi se ka nivel të lartë debitorësh **për taksat dhe tarifat** në numër dhe në vlerë, për biznesin, taksat dhe tarifat vendore, i cili nga viti në vit ka ardhur duke u rritur, kështu në fillim të **vitit 2025** vlera borxhit është **632,853,801 lekë, vlera borxhit e krijuar gjatë vitit 2025 është 119,124,415 lekë** (52,340,479 lekë nga subjektet e biznesit + 27,486,921 lekë nga familjarët + 39,297,015 lekë nga familjarët me SHRUKKO), vlera e borxhit të identifikuar dhe shtuar për periudhën deri në vitin 2024 është 57,315,259 lekë si dhe duke zbritur arkëtimet e kryera gjatë vitit 2025 për periudhën deri në vitin 2024 që është në vlerën 140,851,369 lekë në fund të **vitit 2025** vlera progresive e borxhit tatimor është **668,442,106 lekë,** e cila përbëhet nga:

- *Detyrimet nga taksat dhe tarifat e bizneseve*, në vlerën 324,836,496 lekë, ku 104,904,555 lekë është detyrim i 772 subjekteve të cilët rezultojnë me status pasiv/mbyllur, vlerë kjo që ka sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Korçë.
- *Detyrime nga taksat dhe tarifat vendore për familjet*, në vlerën 206,250,238 lekë, vlerë kjo që ka sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Korçë.
- *Detyrime nga taksat dhe tarifat vendore për familjet me SHRUKKO*, në vlerën 137,355,372 lekë, vlerë kjo që ka sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Korçë.

Në vijim të punës për vjeljen e detyrimeve në vitin 2025 janë nxjerrë 1,050 njoftime dhe kërkesë për pagesë për subjektet e biznesit, 326 njoftime dhe kërkesë për pagesë për debitorët e TNI dhe 4,189 njoftime dhe kërkesë për pagesë për familjarët, urdhër për bllokime të llogarive bankare për 1,442 biznese, 234 urdhër për bllokime të llogarive bankare për debitorët TNI dhe 1,900 për familjarë dhe bllokime të pronave në ASHK për 35 taksapagues të biznesit. Si rezultat i këtyre masave të marra nga debitorët gjatë vitit 2025 kanë likuiduar detyrimet 574 subjekte në vlerën 32,397,434 lekë dhe 334 taksapagues familjarë në vlerën 9,475,845 lekë, por kjo nuk mjafton dhe për tatimpaguesit debitorë duhet të vijojë puna për masa të mëtejshme për arkëtimin e detyrimeve. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, nenet 89, 90, 91 dhe 93 dhe me VKB nr. 158, datë 26.11.2024 "Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore dhe kundërvajtjet administrative për vitin 2025".

Konstatim: Në lidhje me këtë situatë DTTV Bashkia Korçë për asnjë nga subjektet si biznes i vogël dhe i madh, ku megjithëse janë debitorë në vite, janë njoftuar dhe ri njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë nisur urdhër bllokimet e llogarive, vendosur barrë hipotekore apo dhe barrë siguruese, *por nuk është ngritur padi gjyqësore dhe nuk është kërkuar në rrugë ligjore*, në zbatim të Ligjit nr. 7895, datë 27.01.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 181 "Mos pagimi i taksës dhe tatimeve**".**

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 9 "Të drejtat dhe përgjegjësitë", pika 1.3; Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e qeverisjes vendore", neni 35 "Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore", si dhe Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", neni 3, pikat 9-10.

2.3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

Në zbatim të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.
Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.
Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës.
U shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- *Pasqyrat Financiare individuale dhe të konsoliduar për vitin ushtrimor 2025;*
- *Ditarët e kontabilitetit për vitin ushtrimor 2025;*
- *Listë pagesat me zgjedhje për vitin ushtrimor 2025;*
- *Dokumentet e bankës dhe të arkës për vitin ushtrimor 2025;*
- *Aktet e rakordimit me degën e thesarit Korçë, për vitin ushtrimor 2025;*
- *Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Financës dhe Drejtoritë e ngarkuara për administrimin e taksave dhe tarifave vendore sipas paketës fiskale të miratuar për vitin 2025.*

Në vijim, grupi i auditimit ka marrë në shqyrtim dokumentacionin përkatës, pyetësorët e adresuar pranë institucionit si dhe informacionin e grumbulluar nga intervistat zhvilluar me stafin e ngarkuar për procesin e përgatitjes, verifikimit, miratimit dhe konsolidimit të pasqyrave financiare. Për të verifikuar nëse institucioni ka vendosur masa të brendshme të dokumentuara *(rregullore, deklarime, kontrolle, rakordime, autorizime të dyfishta)* që sigurojnë se personat përgjegjës për raportimin financiar nuk ndikohen nga interesa personale gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare dhe me qëllim testimin nëse institucioni ka përmbushur *detyrimin ligjor për parandalim, jo vetëm reagim pas ngjarjes, nga grupi auditimit u* kërkua nga ky institucion të vihet në dispozicion informacion, konkretisht si më poshtë:

Hartimi, afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare:

Për të arritur në opinionin, nëse pasqyrat financiare për vitin 2025, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare, aktive neto dhe fluksit të parasë bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", Drejtoria e Financës , ka përpunuar informacionin kontabël të vitit 2025 për aparatin e Bashkisë Korçë dhe 7 Ndërmarrjet në varësi (Njësi shpenzuese).
Pasqyrat Financiare të Konsoliduar përfshijnë informacionin e depozituar nga njësitë shpenzuese sipas shkresave si më poshtë:
- Me shkresën nr. 4155 Prot., datë 24.04.2026, Bashkia Korçë ka depozituar pasqyrat financiare të konsoliduar në DTH Korçë, të cilat kanë marrë konfirmimin me praktikën nr. 398 Prot., datë 24.04.2026;
- Me shkresën nr. 425 prot., datë 31.03.2026, Shtëpia e Foshnjës "Lulet e vogla" ka depozituar pasqyrat financiare në DTH Korçë.
- Me shkresën nr. 3065 Prot., datë 27.03.2026, Bashkia Korçë ka depozituar pasqyrat financiare në DTH Korçë, të cilat kanë marrë konfirmimin me praktikën nr. 398, Prot., datë 27.03.2026;

- Me shkresën nr. 37 prot., datë 30.03.2026, Qendra Rezidenciale e Zhvillimit ka depozituar pasqyrat financiare në DTH Korçë, të cilat kanë marrë konfirmimin me praktikën nr. 407 prot., datë 30.03.2026;
- Me shkresën nr. 396 prot., datë 27.03.2026, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike ka depozituar pasqyrat financiare në DTH Korçë, të cilat kanë marrë konfirmimin me praktikën nr. 405 prot., datë 30.03.2026;
- Me shkresën nr.293 prot., datë 27.03.2026, Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse Arsimit dhe Çerdhes ka depozituar pasqyrat financiare në DTH Korçë, të cilat kanë marrë konfirmimin me praktikën nr. 392 prot., datë 27.03.2026;
- Me shkresën nr. 13 prot., datë 02.03.2026, Klubi Shumësportësh "Skënderbeu" ka depozituar pasqyrat financiare në DTH Korçë, të cilat kanë marrë konfirmimin me praktikën nr. 293 prot., datë 03.03.2026;
- Me shkresën nr. 113 prot., datë 24.03.2026, Qendra Ditore e Zhvillimit ka depozituar pasqyrat financiare në DTH Korçë, të cilat kanë marrë konfirmimin me praktikën nr. 406 prot., datë 30.03.2026;
- Me shkresën datë 27.03.2026, Qendra e Artit dhe Kulturës ka depozituar pasqyrat financiare në DTH Korçë, të cilat kanë marrë konfirmimin me praktikën e datës nr.401 prot., datë 30.03.2026.

-Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, janë përgatitur nga K.G. me detyrë Drejtoreshë e Sektorit Ekonomik dhe Financiar dhe janë konfirmuar nga Drejtori, I.D. në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, si dhe është depozituar në Degën e Thesit me shkresën nr. 396, datë 27.03.2026 dhe miratuar nga dega e thesarit Korçë në datën 30.03.2026, në përputhje me afatet e përcaktuara me ligj.

-Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse, Arsimit dhe Çerdhes, janë përgatitur nga J.T. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit Ekonomik dhe janë konfirmuar nga Drejtori, Y.M. në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, si dhe është depozituar në Degën e Thesit me shkresën nr. 293, datë 27.03.2026 dhe miratuar nga dega e thesarit Korçë në datën 27.03.2026, në përputhje me afatet e përcaktuara me ligj.

-Qendra e Artit dhe Kulturës, janë përgatitur nga M.R. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të FInancës dhe janë konfirmuar nga Drejtori, Z.K. në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, si dhe është depozituar në Degën e Thesit me shkresën, datë 27.03.2026 dhe miratuar nga dega e thesarit Korçë në datën 30.03.2026, në përputhje me afatet e përcaktuara me ligj.

-Klubi Shumësportesh dhe Kulturës, janë përgatitur nga A.L. me detyrë Përgjegjëse Finance dhe janë konfirmuar nga Drejtori, O.V. në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, si dhe është depozituar në Degën e Thesit me shkresën nr. . 13, datë 02.03.2026 dhe miratuar nga dega e thesarit Korçë në datën 03.03.2026, në përputhje me afatet e përcaktuara me ligj.

-Qendra Ditore e Zhvillimit, janë përgatitur nga J.T. me detyrë Specialiste Finance dhe janë konfirmuar nga Drejtori, Ç.C. në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, si dhe është depozituar në Degën e Thesit me shkresën nr. 113, datë 24.03.2026 dhe miratuar nga dega e thesarit Korçë në datën 30.03.2026, në përputhje me afatet e përcaktuara me ligj.

-Qendra Rezidenciale e Zhvillimit, janë përgatitur nga K.P. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe Shërbimeve të Brendshme dhe janë konfirmuar nga Drejtori, D.L. në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, si dhe është depozituar në Degën e Thesit me shkresën nr. 37, datë 30.03.2026 dhe miratuar nga dega e thesarit Korçë në datën 30.03.2026, në përputhje me afatet e përcaktuara me ligj.

-Shtëpia e Foshnjës "Lulet e Vogla, janë përgatitur nga P.SH. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe Shërbimeve të Brendshëm dhe janë konfirmuar nga Drejtori, K.GJ. në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, si dhe është depozituar në Degën e Thesit me datë 31.03.2026 dhe miratuar nga dega e thesarit Korçë me shkresë nr. 425 prot., në datën 31.03.2025, në përputhje me afatet e përcaktuara me ligj.

- **Nxjerrja e pasqyrave financiare të konsoliduar, për vitin 2025**.

Për vitin 2025, në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022, janë përgatitur pasqyrat financiare të konsoliduar, të përbëra si vijon:

Format nr. 1 –*Pasqyra e pozicionit financiar*.
Format nr. 2 –*Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).*
Format nr. 3 – *Pasqyra e flukseve monetare (Caush-Flou).*
Format nr. 4 –*Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto*.
Format nr. 5 –*Pyetësor dhe shënimet shpjeguese*.
Format nr. 6 –*Investimet dhe burimet e financimit*.
Format nr. 7/a –*Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).*
Format nr. 7/b –*Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).*
Format nr. 8 –*Numri i punonjësve dhe fondi i pagave*.

Pasqyrat financiare të konsoliduar janë të firmosura nga hartuesi i llogarive V.Z. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Financës, si nëpunës zbatues (NZ) dhe Kryetari S.F. si nëpunës autorizues (na), dërguar në Degën e Thesarit Korçë dhe Ministrinë e Financave me shkresën nr. 4155 prot., datë 24.04.2026, brenda afatit ligjorë.

- **Mbajtja e kontabilitetit VITI 2025.**

Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.

Regjistrimet kontabël nuk mbahen në programe financiare por në Excel dhe më pas hidhet me veprim ekstra-kontabël.

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore viti 2024, të pasqyrës së konsoliduar të pozicionit financiar Bashkia Korçë; Formati nr.1, paraqitet në pasqyrat e mëposhtme:

Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet= 12,158,098,717 lekë.

Aktivet 13,147,463,413 lekë
Pasivet 989,364,696 lekë

Aktivet afatshkurtra

Aktivet afatshkurtra më datë 31.12.2025 paraqiten në vlerën 1,455,305,008 lekë dhe përbëhen nga:
Llogaritë e Klasës 5 "*Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre*" në shumën 324,276,718 lekë,
Llogaritë e Klasës 3 "*Gjendje inventari qarkullues*" në shumën 205,868,265 lekë,
Llogaritë e Klasës 4 "*Llogari të arkëtueshme*" në shumën 925,160,025 lekë

Llogaritë e Klasës 5 "Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre" përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2025	Viti 2024	Diferenca 2025-2024
520	Disponibilitete në thesar	312,133,518	217,054,059	95,079,459
532	Vlera të tjera	12,143,200	9,952,638	2,190,562
	Totali	**324,276,718**	**227,006,697**	**97,270,021**

Gjendja e "Mjeteve monetare dhe ekuivalentet e tyre", në mbyllje të vitit ushtrimor 2025 paraqitet në vlerën 324,276,718 lekë, me shtesë nga viti paraardhës në vlerën 97,270,021 lekë.

Llogaria 520 "*Disponibiltete në thesar*", në vlerën 312,133,518 lekë përbëhet:

Nga të ardhurat e trashëguara në vlerën 263,112,048 lekë, të rakorduara me Degën e Thesarit dhe për gjendjen e llogarisë 466 "*Mjete në ruajtje*" në vlerën 49,021,470 lekë për vlerën e ngurtësimeve të punimeve të kryera në masën prej 5% të investimeve në proces (në rrugë, rrjete e kanalizime,

ndërtesa shkollore, etj., kryesisht nga Bashkia Korçë në vlerën 45,093,582 lekë e cila zë pjesën më të madhe të saj.

Llogaria 532 *"Vlera të tjera"* në vlerën prej 12,143,200 lekë e cila përfaqëson letrat me vlerë në arkë.

Nga auditimi ka rezultuar se gjendja e "*Mjeteve monetare dhe ekuivalentet e tyre*" e pasqyruar në mbyllje të vitit ushtrimor 2025, në vlerën 324,276,718 lekë rakordon me rubrikën VI "*Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor*" në Formatin nr.3 "*Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOŴ) sipas metodës direkte*".

Llogaritë e klasës 5, kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

Lëvizja gjatë vitit buxhetor e mjeteve monetareve dhe ekuivalenteve të tyre sipas njësive shpenzuese paraqitet si më poshtë:

Tabela 1: *Mjetet monetare dhe ekuivalente të tyre dhe lëvizjet e tyre për Njësitë shpenzuese, viti 2025*

Njësia shpenzuese	Gjendja me 31.12.2024	Shtesa	Pakësime	Gjendja me 31.12.2025
Bashkia Korçë	201,191,756	2,715,157,762	2,649,586,888	266,762,631
Ndërmarrja e Shërbimeve Publike	10,084,447	294,266,895	288,688,715	15,662,617
Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse, Arsimit dhe Çerdhes,	13,382,163	406,762,447	383,235,627	36,908,983
Qendra e Artit dhe Kulturës,	1,820,003	55,625,490	53,015,739	4,429,754
Klubi Shumësportesh dhe Kulturës,	148,986	14,899,216	14,568,662	469,540
Qendra Ditore e Zhvillimit	3,708	10,801,392	10,805,100	0
Qendra Rezidenciale e Zhvillimit,	14,648	42,977,398	42,955,555	36,491
Shtëpia e Foshnjës "Lulet e Vogla,	360,986	13,954,320	14,308,604	6,702
Totali	**227,006,697**	**3,554,434,910**	**3,457,164,890**	**324,276,718**

- Llogaritë e klasës 3 *"Gjendja e Inventarit qarkullues",* e cila analizon të gjitha elementet e inventarit të materialeve, inventarë i imët dhe produkte kjo gjendje paraqitet në mbyllje të bilancit të konsoliduar të vitit 2025 në vlerën 205,868,265 lekë dhe në mbyllje të bilancit të vitit 2024 në vlerën 212,959,067 lekë. Diferenca e tyre në ulje për vitin ushtrimor prej 7,090,802 lekë përfshihet në gjendjen e llogarisë 63 "*Ndryshimi i gjendjeve të inventarit*" në formatin Nr. 2 "*Pasqyra e Performancës Financiare*", dhe në mënyrë analitike sipas ndërmarrjeve të varësisë paraqiten tabelën 2, si më poshtë:

Tabela nr. 2: *Gjendja e inventarit qarkullues sipas ndërmarrjeve të varësisë dhe lëvizjet gjatë vitit.*

Njësia shpenzuese	Gjendja me 31.12.2024	Shtesa	Pakësime	Gjendja me 31.12.2025
Bashkia Korçë	21,897,876	41,046,695	40,273,255	22,671,316
Ndërmarrja e Shërbimeve Publike	109,497,893	131,930,281	132,864,090	108,564,084
Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse, Arsimit dhe Çerdhes,	54,995,680	53,280,122	62,184,310	46,091,492
Qendra e Artit dhe Kulturës,	8,155,824	10,707,757	6,930,735	11,932,846
Klubi Shumësportesh dhe Kulturës,	5,033,152	703,429	3,043,355	2,693,226
Qendra Ditore e Zhvillimit	2,803,090	1,638,294	1,914,280	2,527,164
Qendra Rezidenciale e Zhvillimit,	4,620,825	14,048,064	12,803,712	5,865,177
Shtëpia e Foshnjës "Lulet e Vogla,	5,954,727		431,707	5,523,020
Totali	**212,959,067**	**253,354,642**	**260,445,444**	**205,868,265**

Këto llogari janë të analizuara për gjendjen më datë 31.12.2025 me inventarin fizik për 7 njësitë shpenzuese përfshi Bashkinë Korçë.

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit" dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit".

Llogaritë e Klasës 4 "*Llogari të arkëtueshme*" përbëhet nga**:**

- Gjendja e llogarisë së Arkëtueshme pasqyron llogaritë e të drejtave që kanë të gjitha njësitë e Bashkisë Korçë për të arkëtuar në fund të periudhës raportuese (si: klientë, tatime dhe taksa, debitorë të ndryshëm, etj.), këto llogari paraqiten në bilancin e konsoliduar në vlerën prej 925,160,025 lekë, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët.

Llogaria 4342 *"Të tjera operacione me shtetin (të drejta)",* në fund të vitit 2025 paraqitet në vlerën 94,116,347 lekë e kuadron me Llogarinë 7206 "*Financim i pritshëm nga buxheti*" të Pasqyrës së Performancës Financiare.

Llogaria 468 *"Debitorë të ndryshëm",* e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, gjendje e cila në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 paraqitet në vlerën 788,158,926 lekë dhe në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 831,043,678 lekë, kjo llogari gjatë vitit 2025 ka pasur rritje në vlerën 42,884,752 lekë. Nga analiza e llogarisë 468 **"Debitorë të ndryshëm**" kemi detyrimet si paraqitet në Aneksin 3.1. b/lidhur RPA.

AKTIVET AFATGJATA përfaqësojnë shumat e:

- Aktiveve afatgjata jomateriale që përfshin: studime dhe kërkime, koncesione, patenta, licenca e të tjera të ngjashme;
- Aktiveve afatgjata materiale që përfshin: toka, pyje, ndërtesa, rrugë, mjete transporti etj.;
- Aktiveve afatgjata financiare që përfshin: huadhënie dhe pjesëmarrje në kapitalin e vet;
- Investimeve që përfshin: aktivet në proces për aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale.

Llogaritë e Klasës 20 *"Aktivet Afatgjata Jo materiale",* përbëhen nga llogaria 202 "*Studime dhe kërkime*" të cilat në formatin Nr. 7/a paraqiten me koston historike në vlerën 14,999,760 lekë. Për vitin 2025 janë blerë e krijuar me pagesë për vlerën 11,782,733 lekë për objekte sipas dhënave në tabelën nr. 3, si më poshtë:

Tabela nr. 3. *Të dhëna mbi llogarinë 2020*

Nr.	Objekti	Vlera e Kontabilizuar
1	Akt ekspertize për objektin "Kulla e Sahatit"	400,000
2	Hartim i projektit te përforcimit për "Rikonstruksionin e Pallatit te Sportit" Tamara Nikolla"	680,000
3	Hartim i projektit për "Rikonstruksionin e Pallatit te Sportit" Tamara Nikolla"	7,476,229
4	Hartim i projektit për objektin e ri te " Pallatit te Sportit" Tamara Nikolla"	1,599,060
5	Auditim energjik për projektin e përforcimit dhe rikonstruksionit i Pallatit te sportit "Tamara Nikolla"	912,675
6	Oponence teknike "Pallati i sportit" Tamara Nikolla" Shtese një kat mbi objektin ekzistues	451,612
7	Oponence teknike "Rikonstruksion i shkollës 9-vjecare "Sotir Gura" dhe ndërtim palestre	263,157
Total		**11,782,733**

Gjatë vitit 2025, kjo llogari është pakësuar për vlerën gjithsej 34,917,020 lekë si rezultat i nxjerrjes jashtë përdorimit (trajtuar në kapitullin e inventarizimit).

Nxjerrje për jashtë përdorimit për vlerën 31,616,877 lekë, të dhënat në tabelën nr. 4 si më poshtë:

Tabela nr. 4. *Nxjerrjet jashtë përdorimit llog. 202*

Nr.	Objekti	Vlera e Kontabilizuar
1	Studim .Projekt . Konstruksion i Shkollës "Sotir Gura"	396,000
2	Studim .Projektimi për bonifikimin e fushës ekzistuese te mbetjeve te ngurta Urbane	19,685,600
3	Studim për hedhje e rihedhje ne harte, krijimi dhe kërkesat e sinjalistikes për 2 shtigje ne rajonin e Korçes.Pg.Ilia Lara nga Projekti	632,250
4	Kërkime për burime, koporitike, shërbime dhe produkte.(Pakete turistike).Pg Orieta Glozheni nga Projekti	843,000
5	Hartim projekti "Rehab. Lulishtes Lendina e Loteve"	2,921,464
6	Hartim projekti "ndërtim I muzeut te Koherave te Harruara"	5,645,446
7	Hartim projekti "Ndërtim I klubit te muzeut te fotografisë Gj. Mili"	1,193,117

Nr.	Objekti	Vlera e Kontabilizuar
8	Hartim i projekteve të investimeve (Studim Gjeologjik i zonës për ndërtimin e urës mbi lumin Dunavec Voskop)	300,000
Total		**31,616,877**

Tabela 5: *Paksime të tjera në vlerë 3,300,143 lekë të dhënat në pasqyrën si më poshtë*:

Nr.	Objekti	Vlera e Kontabilizuar
1	Hartim projekti Ngrohja për shkollën 9 vjecare Sevasti Qirjazi	270,000
2	Oponence teknike "Rikonstruksion I shkollës 9-vjeare "Sevasti Qirjazi"	182,633
3	Hartim I projektit elektrik për objektin: "Rikonstruksion I shkollës 9-vjeare "Sevasti Qirjazi"	66,610
4	Hartim I projektit mekanik për objektin: "Rikonstruksion I shkollës 9-vjeçare "Sevasti Qirjazi"	81,000
5	Projekt Rik. i shkollës Ravonik	400,000
6	Projekt Rik. i shkollës dhe kopshti Drenove	398,000
7	Proj-zb shkolla e mesme Mollaj	140,000
8	Proj-zb rikonst i shkollës te mesme Mollaj	389,300
9	Proj zb rikons i shkollës 9-vjecare Pulahe	249,600
10	Proj Rrethim shkolla Bulgarec	60,000
11	Proj Rrethim shkolla Dishnice	40,000
12	Projekt shkolla Lekas	280,000
13	Projekt Rik shkolla fshati Panarit	150,000
14	Proj Shkolla Vincan	456,000
15	Proj Shkolla 8 vjeçare Gosk.poshte	57,000
16	Proj Shkolla Goskove	80,000
Total		**3,300,143**

Kjo llogari është e analizuar në kontabilitet për 14 artikuj me kosto historike në vlerën 14,999,760 lekë, të dhënat në tabelën 6, si vijon.

Nr.	Objekti	Vlera e Kontabilizuar
1	Vlerësim i ndikimit ne mjedis "vend depozitim i mbetjeve inerte"	187,944
2	Raport teknik objekt 5 kate me adrese Koli Ceku	400,000
3	Oponence teknike e akt ekspertizës te thelluar për objektin " Pallat I sportit " Tamara Nikolla"	100,000
4	Hartim I projektit te sistemit elektrik për objektin: "Rikonstruksion I Bibliotekës Thoma Turtulli	84,590
5	Hartim I projektit te sistemit te mbrojtjes kundër zjarrit dhe shpëtimit për objektin: "Rikonstruksion I Bibliotekës Thoma Turtulli	38,493
6	Hartim I projektit te sistemit ngrohje- ftohje për objektin: "Rikonstruksion I Bibliotekës Thoma Turtulli	60,000
7	Akt ekspertize e thelluar për pallatin e Sportit "Tamara Nikolla"	2,346,000
8	Akt ekspertize për objektin "Kulla e Sahatit"	400,000
9	Hartim i projektit te përforcimit për "Rikonstruksionin e Pallatit te Sportit" Tamara Nikolla"	680,000
10	Hartim i projektit për "Rikonstruksionin e Pallatit te Sportit" Tamara Nikolla"	7,476,229
11	Hartim i projektit për objektin e ri te " Pallatit te Sportit" Tamara Nikolla"	1,599,060
12	Auditim energjik për projektin e përforcimit dhe rikonstruksionit i Pallatit te sportit "Tamara Nikolla"	912,675
13	Oponence teknike "Pallati i sportit" Tamara Nikolla" Shtese një kat mbi objektin ekzistues	451,612
14	Oponence teknike "Rikonstruksion i shkollës 9-vjecare "Sotir Gurra" dhe ndërtim palestre	263,157
T O T A L I		**14,999,760**

- Llogaria 210 *"Toka, Troje, Terrene",* sipas Formatit 7/a "*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*" në mbyllje të vitit 2025 në vlerën prej 1,883,568,275 lekë dhe në vitin 2024 në vlerën 1,879,236,396 lekë. Janë blerë e krijuar me pagesë për vlerën 4,331,927 lekë për objekte sipas dhënave në tabelën 7, si më poshtë:

Tabela nr. 7

Nr.	Objekti	Vlera e Kontabilizuar
1	Shpronësim Zgjerim i varrezave publike Korçë	2,786,731

Nr.	Objekti	Vlera e Kontabilizuar
2	Shpronësim Rruga e Voskopojës (sistemim i rrugës Andrea Stathi)	1,545,196
Total		**4,331,927**

Kjo llogari me datë 31.12.2025, është e analizuar në kontabilitet për 67 objekte inventari me kosto historike në vlerën 1,883,568,275 lekë, të dhënat në Aneksin 3.2, b/lidhur RPA.

- Gjendja e llogarisë 211 "*Pyje, kullota plantacione"* sipas Formatit 7/a "*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*" në mbyllje të vitit 2025 në vlerën prej 110,930,754 lekë dhe në vitin 2024 në vlerën 110,930,754 lekë, për gjatë vitit 2025 nuk ka pësuar ndryshime.

Konstatimi 1: Sipas Formatit 7/a "*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*" në mbyllje të vitit 2025 llogaria 211 *"Pyje, kullota plantacione"* paraqitet në vlerën prej 110,930,754 lekë. Referuar analizës regjistrit të aktiveve rezulton se, në ketë llogari janë regjistruar aktive që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie por jenë aktive që i përkasin llogarisë 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"* për 84 objekte në vlerën 20,310,296.lekë (sipas aneksit 3.3, b/lidhur RPA), me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik dhe të llogaritjes së amortizimit, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin MFE nr. 08, datë 09.03.2018 *"*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar, Kreu II, pika 5, Kreu III pika 24 dhe 30 dhe Aneksi 1 klasa 2.

Kjo llogari është e analizuar në kontabilitet për 159 objekte inventari me kosto historike në vlerën 110,930,754 lekë, të dhënat në Aneksin 3.4, b/lidhur RPA.

- Gjendja e Llogarisë 212 *"Ndërtime konstruksione",* sipas Formatit 7/a "*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*", në mbyllje të vitit 2025 në vlerën prej 5,648,030,071 lekë dhe në vitin 2024 në vlerën 5,540,248,372 lekë, rezulton se kjo llogari është shtuar për vlerën gjithsej 107,781,699 lekë, siç tregohet në tabelën nr. 8.

Tabela nr. 8: *Llogaria 212"Ndërtesa konstruksione":*

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2025	5,540,248,372
Shtesa 2025	191,052,129
Pakesime 2025	83,270,430
Gjendja në 31.12.2025	**5,648,030,071**

Kjo llogari është e analizuar në kontabilitet për 268 objekte inventari me kosto historike në vlerën 5,648,030,071 lekë, të dhënat në Aneksin 3.6, b/lidhur RPA.

Gjendja e Llogarisë 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"* sipas Formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" në mbyllje të vitit 2025 në vlerën prej 6,230,694,402 lekë (siç tregohen në tabelën nr. 9) dhe në vitin 2024 në vlerën 6,106,936,755 lekë, rezulton se kjo llogari është shtuar për vlerën gjithsej 123,757,647 lekë.

Tabela nr. 9: *Llogaria 213 "Rrugë rrjete vepra ujore":*

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2025	6,106,936,755
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2025	199,278,898
Dalje Amort gjatë vitit 2025	75,521,252
Gjendja në 31.12.2025	**6,230,694,402**

Konstatimi 2: Llogaria 213 "*Rrugë rrjete vepra ujore*" sipas Formatit 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" në mbyllje të vitit 2025 paraqitet në vlerën

6,230,694,402 lekë. Referuar analizës së inventarit kontabël u konstatua se, nuk është zbritur vlera për 10 objekte për ujësjellës-kanalizimeve në vlerën 38,896,711lekë (sipas aneksit 3.7, b/lidhur), që duheshin transferuar Ujësjellës Kanalizime, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar, Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 24 dhe 30.

Kjo llogari është e analizuar në kontabilitet për 398 objekte inventari me kosto historike në vlerën 6,230,694,402 lekë, të dhënat në Aneksin 3.8, b/lidhur RPA.
pasqyrën Aneks nr. ....., bashkëlidhur.

- Gjendja e llogarisë 214 *"Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune"* sipas Formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" në mbyllje të vitit 2025 në vlerën prej 384,778,838 lekë (sipas tabelës nr. 10), dhe në vitin 2024 në vlerën 372,841,568 lekë.

Tabela nr. 10: *Llogaria 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune":*

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2025	372,841,567
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2025	48,481,367
Dalje gjatë vitit 2025	36,544,097
Gjendja në 31.12.2025	**384,778,837**

Lëvizjet e kësaj llogarie sipas njësive shpenzuese paraqitet në tabelën nr. 11, si më poshtë:

Tabela nr. 11.

Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune (kosto historike) **Objekte inventari**	**Gjendja 01.01.2025**	**Shtesa (D)**	**Pakësime (K)**	**Gjendja 31.12.2025**
Bashkia	81,881,978	7,965,647	14,724,372	75,123,253
NSHP	90,326,671	7,226,498	9,358,203	88,194,966
NSHMAC	139,756,435	31,213,822	11,884,637	159,085,620
Klubi Shumesportesh	3,555,825		555,885	2,999,940
Qendra e Artit dhe Kultures	40,555,347	2,045,400		42,600,747
Qendra Ditore e Zhvillimit	2,424,580	30,000		2,454,580
Qendra Rezidenciale e Zhvillimit	10,339,840			10,339,840
Shtëpia e Foshnjës "Lulet e Vogla"	4,000,891		21,000	3,979,891
TOTALI llogaria 214	**372,841,567**	**48,481,367**	**36,544,097**	**384,778,837**

Burimi*: Të dhëna nga bashkia, përpunuar nga grupi*

Llogaria 215 *"Mjete transporti",* sipas Formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" në mbyllje të vitit 2025 në vlerën prej 288,874,661 lekë (sipas tabelës nr. 12), dhe në vitin 2024 në vlerën 275,350,932 lekë.

Tabela 12. *Llogaria 215 "Mjete transporti":*

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2025	275,350,932
Hyrje gjatë vitit 2025	73,708,757
Dalje gjatë vitit 2025	60,185,028
Gjendja në 31.12.2025	**288,874,661**

Burimi*: Të dhëna nga bashkia, përpunuar nga grupi*

Kjo llogari është e analizuar në kontabilitet për 52 mjete me kosto historike në vlerën 288,874,661 lekë, të dhënat në Aneksin nr.3.9, b/lidhur RPA.

Llogaria kontabël 218 *"Inventar ekonomik".* Kjo llogari përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative, institucionet e Bashkisë. Sipas pasqyrave financiare të Bashkisë gjendja e llogarisë 218 "Inventari ekonomik" më datë 31.12.2025 paraqitet në vlerën 355,648,926 lekë, sipas tabelës nr. 13, si më poshtë:

Tabela nr. 13. *Llogaria 218 "Inventar ekonomik":*

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2025	360,281,986
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2025	21,606,688
Dalje nga magazina gjatë vitit 2025(amorizimi)	26,239,748
Gjendja në 31.12.2025	**355,648,926**

Burimi*: Të dhëna nga bashkia, përpunuar nga grupi*

Lëvizjet e kësaj llogarie sipas njësive shpenzuese paraqitet në tabelën nr. 14, si më poshtë:

Tabela nr. 14.

Inventar ekonomik (kosto historike) **Objekte inventari**	**Gjendja 01.01.2025**	**Shtesa (D)**	**Pakësime (K)**	**Gjendja 31.12.2025**
Bashkia	67,076,356	8,996,866	9,075,728	66,997,494
Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse te Arsimit dhe Çerdhes	242,933,286	9,919,306	12,596,229	240,256,363
Klubi Shumesportesh	2,251,115	125,724	637,731	1,739,108
Qendra e Artit dhe Kulturës	25,802,983	1,414,250		27,217,233
Qendra Ditore e Zhvillimit	1,422,725	182,142		1,604,867
Qendra Rezidenciale e Zhvillimit	9,004,051			9,004,051
Shtëpia e Foshnjës "Lulet e Vogla"	3,112,611		740,499	2,372,112
Ndërmarrja e Shërbimeve Publike	8,678,859	968,400	3,189,561	6,457,698
Totali	**360,281,986**	**21,606,688**	**26,239,748**	**355,648,926**

Burimi*: Të dhëna nga bashkia, përpunuar nga grupi*

Llogaria 24 *"Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara",* paraqitet sipas Formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" në vitit 2024 është raportuar në vlerën 0 lekë dhe në vitin 2025 në vlerën 28,268,325 lekë e cila përfaqëson vlerën e mjeteve të transportit të vlerësuara për nxjerrje jashtë përdorimit, të dhënat në tabelën nr. 15, si më poshtë:

Tabela nr. 15. *Llogaria 24 "Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara",*

Nr.	**Objekti**	**Vlera e Kontabilizuar**
	Land Rover Ko ... B	1,611,081
	Autoveture Volksëagen AA...0RG	995,889
	Autovet Mitsubish,sport AA...GR	1,652,415
	Autoveturë Audi AA...TL	1,541,460
	Automjet shpëtimi Furgon AA ... LN	2,757,220
	Autoshkalle Zjarri - ..	18,072,320
	Automjet Zjarrfikës Policia 0...0	638,140
	Motoçikletë KO...3A	49,800
	Volkëagen AB8...4KN QRZH	**950,000**
Total		28,268,325

Burimi*: Të dhëna nga bashkia, përpunuar nga grupi*

Llogaria 231 *"AAGJM Investime në proces",* paraqitet në mbyllje të vitit 2024, në vlerën 168,001,879 lekë dhe në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 54,700,946 lekë, të cilat përfaqësojnë investime për kontrata të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimorë 2025, lëvizjet për shtesa e paksime sipas njësive shpenzuese paraqiten në tabelën nr. 16, si më poshtë:

Tabela nr. 16

Njësia shpenzuese	Gjendja me 31.12.2024	Shtesa	Pakësime	Gjendja me 31.12.2025
Bashkia Korçë	166,148,700	47,305,379	158,753,133	54,700,946
Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse, Arsimit dhe Çerdhes,	615,000		615,000	0
Klubi Shumësportesh dhe Kulturës,	1,238,178		1,238,178	0
Totali	**168,001,879**	**47,305,379**	**160,606,311**	**54,700,946**

***Burimi**: Të dhëna nga bashkia, përpunuar nga grupi*

PASIVET (DETYRIMET)

Pasivet Afatshkurtra

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Korçë më 31.12.2025, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2025, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2025, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., tabela nr. 17, si më poshtë:

Tabela nr. 17.

Llogaritë		Viti 2025	Viti 2024	Diferenca/ndryshimi
	Llogari të pagueshme	**157,241,562**	**217,588,417**	**(60,346,855)**
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	4,357,068	43,513,278	(39,156,210)
42	Detyrime ndaj personelit	65,593,232	65,092,617	500,615
431	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	4,971,769	4,868,647	103,122
435	Sigurime shoqërore	19,490,340	19,424,995	65,345
436	Sigurime shëndetësore	2,691,451	2,685,069	6,382
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	49,021,470	48,640,843	380,627
467	Kreditorë të ndryshëm	234,488	22,568,300	(22,333,812)
4341	Operacione me shtetin Detyrime	10,881,744	10,794,670	87,074
	Të tjera pasive afatshkurtëra	**832,123,134**	**787,103,894**	**45,019,240**
470	Llogari në pritje të ardhura për tu marrë	832,123,134	787,103,894	45,019,240

***Burimi**: Të dhëna nga bashkia, përpunuar nga grupi*

Llogaria 401-408 *"Furnitor e llogari të lidhura me to",* paraqiten detyrimet për fatura të palikujduara për vitin 2025 të cilat janë raportuar në vlerën 4,357,068 lekë të krahasuara me vitin paraardhës janë ulur në vlerën 39,156,210 lekë, në mënyrë analitike paraqiten në pasqyrat anakes të bilancit viti 2025.

Llogaria 42, *"Detyrime ndaj personelit",* sipas pasqyrave financiare, paraqitet në vlerën 65,593,232 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t'u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

Llogaria 431, *"Detyrime ndaj shteti për tatim taksa",* paraqitet në vlerën 4,971,769 lekë dhe përfaqëson vlerën për t'u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor.

Llogaria 435, *"Sigurime shoqërore" dhe llogaria 436 "Sigurime shëndetësore",* paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor 2025, përkatësisht në vlerat 19,490,340 lekë dhe 2,691,451 lekë.

Llogaria 466 *"Kreditore për mjete nën ruajtje",* përfshin garancitë e ngurtësuara për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarie paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 48,640,843 lekë dhe në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 49,021,470 lekë. Për këtë gjendje të llog 466 është bërë raportimi në degën e Thesarit në mënyrë analitike paraqiten në pasqyrat anakes të bilancit viti 2025.

Nga auditimi i pasqyrave financiare të Bashkisë Korçë llogaria 466 *"Kreditorë për mjete në ruajtje"* në fund të vitit 2025 paraqitet në vlerë 49,021,470 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%. Ngurtësime të cilat i përkasin periudhës 2015-2025 janë në vlerën 19,309,991 lekë për të cilat nuk ka përfunduar periudha e garancisë. Nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik me shkresën me nr. 584 prot, datë 20.01.2026 adresuar Drejtorisë së PZHKT Bashkia Korçë është kërkuar marrjen e masave për ekzekutimin e garancisë së punimeve që ju ka

përfunduar afati, por që nga kjo e fundit nuk janë marrë masa asnjë masë për zhbllokimin e këtyre fondeve si dhe nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 19,309,991 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, "*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*" i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10.

Llogaria 467 *"Kreditorë të ndryshëm",* paraqiten detyrimet për fatura të palikujduara dhe vendime gjykate për vitin 2025 paraqiten në vlerën 234,488 lekë të krahasuara me vitin paraardhës janë ulur në vlerën 22,333,812 lekë, në mënyrë analitike paraqiten në Aneks të bilancit viti 2025.

Nr.	Subjekti	Emërtimi i investimit	Fatura		
			Nr.	Data	Vlera
1	Dr. Rajonale Tatime	Pulla te Gjendjes Civile			182,000
Total Bashkia					**182,000**
QDZH	**UKKO**	Fature uji	**452893**	**31.12.2025**	**7,896**
Total QRZH	**UKKO**	Fatura e ujit muaji dhjetor 2025		14.01.2026	**44,592**
Total llogaria 467					**234,488**

Llogaria 4341 *"Operacione me shtetin Detyrime",* për vitin 2025 paraqiten në vlerën 10,881,744 lekë, e cila përfaqëson detyrimin që Bashkia i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të paarkëtuara nga vitet e mëparshme, të cilët analizohen si në tabelën nr. 18 e mëposhtme:

Tabela nr. 18. *Llogaria 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)"*

Çelje e vitit 2025	10,794,670			
Shtesa (K)	678,514			
Pakësime (D)	591,440			
Gjendja debitore në 31.12.2025	**10,881,744**			
Lekë				
Operacion me shtetin (detyrime)	**Gjendja 01.01.2025**	**Shtesa (K)**	**Pakësime (D)**	**Gjendja 31.12.2025**
Firma "V." KLSH 2010	302,500			302,500
JV "H."dhe S.	1,484,500			1,484,500
K.	1,564,568			1,564,568
Shoqëria "O."	610,560			610,560
Shoqëria "R."	183,478			183,478
A.D.	1,199,226			1,199,226
N. & N. ShPK	383,349			383,349
Shërbimi I trajnimeve supervizimit, mentorimit	877,000			877,000
Hartimi I procedurave rregulloreve dhe manualeve te shërbimit	325,000			325,000
Pagesa për menaxhim shërbimi, oficer shërbimi, shofer	410,000			410,000
Akte ekspertize MZSH,	1,147,500			1,147,500
Qerate	40,405	678,514	591,440	127,479
Totali Bashkia	**8,530,056**	**678,514**	**591,440**	**8,617,130**
QAK	1,566,580			1,566,580
QDZH	65,928			65,928
Sh.Foshnjes	632,106			632,106
Total llogaria 4341	**10,794,670**	**678,514**	**591,440**	**10,881,744**

***Burimi**: Të dhëna nga bashkia, përpunuar nga grupi*

Llogaria 470 *"Llogari në pritje të ardhura për tu marrë",* për vitin 2025 paraqitet në vlerën 832,123,134 lekë, e cila përfaqëson llogaritë e aktiveve të pasqyrës së pozicionit financiarë llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm" në vlerën 820,096,934 lekë dhe vlerën e llogarisë 532 "Vlera të tjera" në vlerën 12,026,200 lekë.

Analizë: Formati nr.2 *"Pasqyra e performancës financiare"* paraqet llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike.
Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2025, të cilat në total janë në vlerën 4,051,169 lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarit Korçë paraqitet më poshtë:

Gjendja e llogarisë sintetike 70 *"Të ardhurat nga taksat dhe tatimet"* në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 397,793,521 lekë ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 510,613,785 lekë, me shtesë në vlerën 112,820,264 lekë.

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
70	**I. TË ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIME**	**510,613,785**	**397,793,521**
700	**1. Tatimi mbi të ardhurat**	**937,288**	**2,973,644**
7000	Tatimi mbi të ardhurat personale	192,000	563,175
7001	Tatimi mbi fitimin	0	1,421,389
7002	Tatim mbi biznesin e vogël	745,288	989,080
7009	Të tjera tatime mbi të ardhurat	0	0
702	**2. Tatimi mbi pasurinë**	**195,680,400**	**165,399,252**
7020	Tatim mbi pasurinë e paluajtshme	182,029,834	157,764,819
7021	Tatim mbi shitjen e pasurisë së paluajtshme	0	0
7029	Të tjera tatime mbi pasurinë	13,650,566	7,634,433
703	**3. Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit**	**313,958,548**	**229,373,075**
7030	Tatim mbi vlerën e shtuar (TVSH)	0	0
7031	Akciza	0	0
7032	Taksë mbi shërbimet specifike	0	0
7033	Taksë mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie	0	0
7035	Taksë vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	313,958,548	229,373,075
704	**4. Taksë mbi tregtinë dhe transaksionet ndërkombëtare**	**0**	**0**
7040	Taksë doganore për mallrat e importit	0	0
7041	Taksë doganore për mallrat e eksportit	0	0
7042	Tarifë shërbimi doganor e kolipostë	0	0
7049	Të tjera taksa mbi tregtinë e transaksionet ndërkombëtare	0	0
705	**5. Taksë e rrugës**	0	0
708	**6. Të tjera tatime e taksa kombëtare**	**37,550**	**47,550**
709	**7. Gjoba e kamatë vonesa**	**0**	**0**

Burimi*: Të dhëna nga bashkia, përpunuar nga grupi*

Referuar të dhënave të akt rakordimit të të ardhurave me Degën e Thesarit Korçë datë 02.02.2026 kemi informacioni si mëposhtë:
1) Sipas kodifikimit **700 *" Tatim mbi të ardhurat"*** e cila është kontabilizuar për vlerën 937,288 lekë janë përfshirë.
-Tatim mbi të ardhurat personale me vlerë 192,000 lekë
-Tatim mbi biznesin e vogël me vlerë 745,288 lekë.
Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit 700 *"Tatim mbi të ardhurat",* rakordojnë me taksat e përfshira në këtë kod sipas akt rakordimit me thesarin.

2) Sipas kodifikimit **702 *"Tatim mbi Pasuritë"*** e cila është kontabilizuar për vlerën 195,680,400 lekë janë përfshirë.
a)Tatim mbi pasuritë e paluajtshme (7020) me vlerë 182,029,834 lekë;
b) Të tjera tatime mbi pasuritë (7029) me vlerë 13,650,566 lekë;
Në taksat e kontabilizuara me kodifikim 7020 *"Tatim mbi Pasuritë e Paluajtshme"* dhe 7029 "*Të tjera tatime mbi pasuritë*" janë përfshirë taksat si mëposhtë:
-Taksa e ndërtesës me vlerë 156,288,153 lekë;
-Taksë mbi tokën bujqësore me vlerë 25,741,681 lekë;
-Taksë e kalimit e të drejtës së pronësisë me vlerë 13,650,566 lekë.
Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit 7020 *"Tatim mbi Pasuritë e Paluajtshme"* rakordojnë me taksat e përfshira në këtë kod sipas akt rakordimit me thesarin.

3) Sipas kodifikimit **703 *"Tatim mbi mallrat dhe shërbimet brenda vendit"*** e cila është kontabilizuar për vlerën 313,958,548 lekë janë përfshirë.

a)Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave (7035) me vlerë 313,958,548 lekë.

Në taksat e kontabilizuara me kodifikim 7035 *"Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie"* janë përfshirë taksat si mëposhtë:

-Tarife për shërbim tavolina me vlerë 9,000 lekë;
-Takse vendore regjistrim biznesi me vlerë 120,000 lekë;
-Takse e ndikimit ne infrastrukturë nga ndërtimet e reja me vlerë 95,003,436 lekë;
-Takse e ndikimit ne infrastrukturë nga legalizimet me vlerë 7,806,417 lekë;
- Takse vendore për fjetjen ne hotel me vlerë 10,186,615 lekë;
- Takse vendore për reklamat me vlerë 1,450,750 lekë;
- Takse vendore e tabelës me vlerë 8,821,773 lekë;
- Tarife perimetrale – vendore me vlerë 773,204 lekë;
- Tarife gjelbërimi me vlerë 32,589,965 lekë;
- Tarife,license për shitjen me pakice te lendeve djegëse me vlerë 19,040,000 lekë;
- Tarife vendore ndriçimi me vlerë 50,781,120 lekë;
- Takse vendore për truallin me vlerë 15,020,670 lekë;
- Kontribut ne fondin publik te banesave sociale me vlerë 48,080,932 lekë;
- Tarife vendore për çertifikaten e përdorimit me vlerë 3,450,324 lekë;
- Tarife vendore për urbanistiken (ndriçim & gjelbërim) me vlerë 864,000 lekë;
- Tarife vendore për shqyrtim leje zhvillimi me vlerë 525,000 lekë;
- Tarife vendore për lëshime vërtetimi me vlerë 390,000 lekë;
- Tarife vendore për konfirmime hartash me vlerë 2,430 lekë;
- Tarife vendore për leje ndërtimi me vlerë 228,500 lekë;
- Tarife vendore pastrimi për leje ndërtimi me vlerë 4,960,000 lekë;
- Tarife vendore për varreza me vlerë 13,854,412 lekë;

Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit 7035 *"Tatim mbi mallrat dhe shërbimet brenda vendit"* rakordojnë me taksat e përfshira në këtë kod sipas akt rakordimit me thesarin.

2. Të ardhurat jo tatimore:

Llogaria 71 *"Të ardhura jo tatimore",* në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 278,385,537 lekë ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 281,883,044 lekë ose me shtesë në vlerën 3,497,507 lekë.

Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat jo tatimore paraqitet në tabelën nr. 19, në vijim:

Tabela nr. 19.

lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
71	**III. TË ARDHURA JO TATIMORE**	**281,883,044**	**278,385,537**
710	1. Nga ndërmarrjet dhe pronësia	**24,976,220**	**24,609,598**
7100	Nga ndërmarrjet publike jo financiare	0	0
7101	Nga ndërmarrjet publike financiare	0	0
7109	Të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia	24,976,220	24,609,598
711	2. Shërbimet Administrative dhe të Ardhura Sekondare	**256,814,102**	**253,775,939**
7110	Tarifa administrative dhe rregullatorë	201,028,373	197,843,972
7111	Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh	36,277,336	39,408,677
7112	Taksë për veprime gjyqësore e noteriale	0	0
7113	Të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve	2,979,933	3,044,709
7114	Të ardhura nga biletat	3,701,840	3,145,600
7115	Gjoba, kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime	12,826,620	10,332,981
7116	Të ardhura nga transferimi i pronës, legalizimi i ndërtimeve pa leje	0	0
719	3. Të tjera të ardhura jo tatimore	**92,722**	**0**

***Burimi**: Të dhëna nga bashkia, përpunuar nga grupi*

1) Sipas kodifikimit **710 *"Tatim nga ndërmarrjet dhe pronësia",*** e cila është kontabilizuar për vlerën 24,976,220 lekë janë përfshirë.
a)Të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia (7109) me vlerë 24,976,220 lekë;
Në taksat e kontabilizuara me kodifikim 7109 *"Të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia"* janë përfshirë taksat si mëposhtë:
-Të ardhura për qira tokë bujqësore me vlerë 99,661 lekë;
-Qira trualli me vlerë 61,080 lekë;
-Qira trualli mbi 200 m^2 me vlerë 4,635,053 lekë;
-Qira objekti me vlerë 1,800,885 lekë;
-Qira objekti mbi 200 m^2 me vlerë 2,691,060 lekë;
-Qera apartamente të EKB me vlerë 96,500 lekë;
-Qera banesa sociale me vlerë 8,261,221 lekë;
-Qira objekti me vlerë 75,000 lekë;
-Qira fondi pyjore kullosore me vlerë 6,327,908 lekë
-Qira banese me vlerë 120,000 lekë
-Qira mjeti me vlerë 10,500 lekë;
-Qira salle me vlerë 25,000 lekë
-Qira ndërtesë me vlerë 155,000 lekë
Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit 710 *"Tatim nga ndërmarrjet dhe pronësia"* rakordojnë me taksat e përfshira në këtë kodi sipas akt rakordimit me thesarin.

2) Sipas kodifikimit **711*"Shërbime administrative dhe të ardhura sekondare"*** e cila është kontabilizuar për vlerën 256,814,102 lekë janë përfshirë.
a)Tarifa administrative dhe rregullatorë (7110) me vlerë 201,028,373 lekë;
b)Të ardhura sekondare dhe pagesa shërbimesh (7111) me vlerë 36,277,336 lekë;
c) Të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve (7113) me vlerë 2,979,933 lekë;
d) Të ardhura nga biletat (7114) me vlerë 3,701,840 lekë;
e) Gjoba kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime (7115) me vlerë 12,826,620 lekë;
Në taksat e kontabilizuara me kodifikim **7110 *"Tarifa administrative dhe rregullatorë"*** janë përfshirë taksat si mëposhtë:
-Tarifa për leje transporti me vlerë 1,295,520 lekë;
-Tarifë administrative dhe rregullatore të NJQV me vlerë 44,950 lekë;
-Tarifë pastrimi me vlerë 165,526,442 lekë;
-Tarifë ujitje dhe mirëmbajtje kanalesh me vlerë 11,884,652 lekë
-Tarifë servituti me vlerë 879,575 lekë;
-Tarifë për zënie hapësira publike me vlerë 17,998,177 lekë;
-Tarifë për dhënie në përdorim të tubacioneve nëntokësore me vlerë 40,560 lekë
-Tarifë për depozitim mbetje inerte me vlerë 1,781,136 lekë;
-Të ardhura nga tregu i gjësë së gjalla me vlerë 1,000,650 lekë;
-Të ardhura nga vërtetimet me vlerë 21,000 lekë;
-Leje punimesh me vlerë 554,611 lekë;
-Të ardhura të tjera në vlerën 1,100 lekë.
Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit 7110 *"Tarifa administrative dhe rregullatorë"* rakordojnë me taksat e përfshira në këtë kodi sipas akt rakordimit me thesarin.
Në taksat e kontabilizuara me kodifikim 7111 *"Të ardhura sekondare dhe pagesa shërbimesh"* janë përfshirë taksat si mëposhtë:
-Të ardhurat nga parkimi me vlerë 19,125,500 lekë;

-Të ardhura sekondare nga kthimet e pagesave me vlerë 823,286 lekë;
-Të ardhurat nga kopshtet çerdhet, konviktet me vlerë 16,328,550 lekë;
Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit 7111 *"Të ardhura sekondare dhe pagesa shërbimesh"* rakordojnë me taksat e përfshira në këtë kodi sipas akt rakordimit me thesarin.
Në taksat e kontabilizuara me kodifikim 7113 *"Të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve"* janë përfshirë taksat si mëposhtë:
-Të ardhura nga tenderat me vlerë 30,434 lekë;
-Certifikatë për mbrojtje nga zjarri me vlerë 559,000 lekë;
-Miratim Projekti me vlerë 1,165,000 lekë;
-Lule e fidanë me vlerë 49,500 lekë;
-Të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve me vlerë 1,139,300 lekë;
-Të tjera nga shitja e mallrave me vlerë 36,700 lekë.
Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit 7113 *"Të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve"* rakordojnë me taksat e përfshira në këtë kodi sipas akt rakordimit me thesarin.
Në taksat e kontabilizuara me kodifikim 7114 *"Të ardhura nga biletat"* janë përfshirë taksat si mëposhtë:
-Të ardhura nga shitja e biletave me vlerë 3,701,840 lekë
Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit 7114 *"Të ardhura nga biletat"* rakordojnë me taksat e përfshira në këtë kodi sipas akt rakordimit me thesarin.
Në taksat e kontabilizuara me kodifikim 7115 *"Gjoba. Kamatëvonesa, sekuestrime dhe zhdëmtime"* janë përfshirë taksat si mëposhtë:
-Gjobat e biznesit të vogël me vlerë 8,904,289 lekë;
-Gjobat e IMTV me vlerë 1,796,343 lekë;
-Gjobat policisë bashkiake me vlerë 604,000 lekë;
-Gjobat e drejtorisë së Taksave dhe Tarifave me vlerë 140,000 lekë;
-Kamatëvonesa me vlerë 868,642 lekë;
-Kthim nga ndihma ekonomike me vlerë 512,946 lekë.
Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit 7115 *"Gjoba. Kamatëvonesa, sekuestrime dhe zhdëmtime"* rakordojnë me taksat e përfshira në këtë kodi sipas akt rakordimit me thesarin.
Në taksat e kontabilizuara me kodifikim 7119 *"Të tjera të ardhura jo tatimore "* janë përfshirë taksat si mëposhtë:
- Të ardhura nga dëmshpërblimet e përfituara nga Instituti i Sigurimeve me vlera 92,722 lekë.
Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit 7119 *"Të tjera të ardhura jo tatimore "* rakordojnë me taksat e përfshira në këtë kodi sipas akt rakordimit me thesarin.

3. Grante korente:

-Llogaria 72 "*Grante korente*", në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 3,076,683,117 lekë ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie ka qenë në vlerën 3,135,736,414 lekë ose me një rritje në vlerën 59,053,297 lekë.
Analiza e detajuar e llogarisë grante korente paraqitet në tabelën nr. 20, si më poshtë:

lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
72	V. GRANTE KORENTE	**3,135,736,414**	**3,076,683,117**
720	1. Grant korent i brendshëm	**3,130,755,840**	**3,066,112,437**
7200	Nga Buxheti për NJQP (Qendrore)	62,734,177	63,852,467
7201	Nga Buxheti për NJQP (Vendore)	2,324,206,114	2,194,572,576
7202	Nga Buxheti për pagesa të posaçme te ISSH	0	0
7203	Nga Buxheti për mbulim deficiti (ISSH e ISKSH)	0	0

7204	Pjesëmarrje e institucioneve në tatime nacionale	98,190,365	86,892,669
7205	Financim shtesë për të ardhurat e krijuara brenda sistemit	441,172,965	455,133,813
7206	Financim i pritshëm nga buxheti	94,116,347	134,796,778
7207	Sponsorizime të brendshme (nga të tretët)	3,870,000	2,800,000
7209	Të tjera grante korente të brendshme	106,465,873	128,064,135
721	2. Grant korent i huaj	**4,980,574**	**10,570,680**

Burimi i të dhënave: Bashkia Korçë

- Analiza e shpenzimeve në vitin 2025 , të cilat në total janë në vlerën 3,788,057,895 lekë paraqitet më poshtë:

1. Shpenzimet për pagat, përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore:

-Llogaria 600 "*Pagat dhe përfitimet e punonjësve*" në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 839,497,466 lekë, ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 949,076,920 lekë ose me një rritje në vlerën 109,579,454 lekë.

-Llogaria 601 "*Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore*", në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 139,941,540 lekë, ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 157,366,475 lekë ose me një rritje në vlerën 17,424,935 lekë.

Analiza për llogaritë e pagave dhe kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore paraqitet në tabelën nr. 21, si më poshtë:

Tabela nr. 21:

lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
6001	Paga, personel i përhershëm	944,995,720	839,061,705
602	Paga personel i përkohshëm	0	435,761
603	Shpërblime	4,081,200	0
609	Shpenzime të tjera të personelit	0	0
6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	**0**	**0**
6011	Kontribut i Sigurimeve Shëndetësore	141,413,729	125,668,673

Burimi i të dhënave: Bashkia Korçë

Blerje mallra dhe shërbime:

Llogari e cila përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së institucionit.

-Llogaria 602 "Blerje mallra dhe shërbime", në datë 31.12.2024, ka qenë në vlerën 726,423,992 lekë ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie është në vlerën 660,329,216 lekë ose me ulje në vlerën 66,094,776 lekë.

Analiza e llogarisë blerje mallra dhe shërbime paraqitet në tabelën nr. 22 në vijim:

Tabela nr. 22, *shprehur ne lekë*

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
602	III. BLERJE MALLRA E SHËRBIME	**660,329,216**	**726,423,992**
602	Mallra dhe shërbime të tjera	76,010	99,828
6020	Materiale zyre e të përgjithshme	28,895,414	46,719,267
6021	Materiale dhe shërbime speciale	121,671,792	178,575,496
6022	Shërbime nga të tretë	288,185,492	281,385,611
6023	Shpenzime transporti	56,682,517	59,687,400
6024	Shpenzime udhëtimi	15,398,160	16,322,802
6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	39,221,592	50,086,022
6026	Shpenzime për qiramarrje	12,373,353	8,511,343
6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale	1,033,986	2,227,724
6028	Shpenzime të lidhura me huamarrjen për hua	0	0
6029	Shpenzime të tjera operative	96,790,901	82,808,499

Burimi i të dhënave: *Bashkia Korçë*

Analiza e llogarisë subvencione paraqitet në pasqyrën në vijim:

603	IV.SUBVECIONE	10,080,923	10,200,795
6030	Subvencione për diference çmimi	9,998,910	9,998,610
6031	Subvencione për te nxitur punësimin	0	0
6032	Subvencione për te mbuluar humbjet	0	0

603	**IV.SUBVECIONE**	**10,080,923**	**10,200,795**
6033	Subvencione për sipërmarrjet individuale	0	0
6039	Subvencione te tjera	82,013	202,185

Burimi i të dhënave: Bashkia Korçë

Transferime korente:

Gjendja e llogarisë 604 "*Transferime korente të brendshme*" paraqitet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 1,342,302,941 lekë dhe Gjendja e llogarisë së fondeve 606 "Transferime për Buxhetet familjare e Individë" paraqitet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 564,763,339 lekë e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

lekë

	V.TRANSFERIME KORENTE	**1,907,066,280**	**1,870,494,162**
604	**1.Transferime korente te brendshme**	**1,342,302,941**	**1,250,864,505**
6040	Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise	25,575,639	27,078,893
6041	Transferime korente tek institucione qeveritare te ndryshme	1,198,367,985	1,093,305,267
6042	Transferime korente tek Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore	0	0
6044	Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurse	118,359,317	130,480,345
605	**2.Transferime korente me jashtë**	**0**	**0**
6051	Transferime Për Organizatat Ndërkombëtare	0	0
6052	Transferime Për Qeveritë e Huaja	0	0
6053	Transferime Për institucionet jo fitimprurese te huaja	0	0
6059	Transferime Te tjera korrente me jashtë shtetit	0	0
606	**3.Transferime për Buxhetet familjare e Individe**	**564,763,339**	**619,629,657**
6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH	0	5,790,000
6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	564,763,339	613,839,657
	VI.SHPENZIME FINANCIARE	**0**	**868,449**
65	**1.Shpenzime Financiare te brendshme**	**0**	**868,449**
650	Interesa për bono thesarit dhe kredi direkte	0	0
651	Interesa për huamarrje te tj. Brendshme	0	868,449
652	Interesa Letra tjera vlere Qeverise	0	0
656	Shpenz.nga këmbimet valutore	0	0

Burimi i të dhënave: *Bashkia Korçë*

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
63	Ndryshimi i gjendjeve të inventarit	7,090,802	18,237,892
	Shpenzime të tjera	97,047,279	88,645,758

Për vitin 2025 totali i të ardhurave në vlerë është 4,051,169,943 lekë dhe totali shpenzimeve është 3,788,057,895 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 263,112,048 lekë e cila kuadron me gjendjen e llogarisë 85 "Rezultat i veprimtarisë së vitit ushtrimor" në vlerën 263,112,048 lekë.

- **<u>Në lidhje me pronat e kaluara me VKM në përdorim/pronësi bashkia Korçë</u>.**

Nga verifikimi i dokumentacionit dhe i regjistrit të pronave rezultoi se Bashkia Korçë ka nën administrim gjithsej **2,222 prona** të llojeve të ndryshme, *nga të cilat:* në përdorim 257 prona dhe në pronësi 1965 prona. Nga pronat në pronësi, **279 prona janë pajisur me certifikatë pronësie**, ndërsa **47 prona janë në proces certifikimi**.

Megjithëse 279 prona janë regjistruar ligjërisht në emër të njësisë vendore, ato **nuk janë kontabilizuar në aktivet afatgjata materiale**, me argumentin se nuk disponojnë një vlerë financiare të përcaktuar.

Mos vlerësimi dhe mos regjistrimi kontabël i këtyre pronave ka sjellë si pasojë që pasqyrat financiare të mos paraqesin në mënyrë të plotë dhe të drejtë aktivet e njësisë, duke cenuar besueshmërinë dhe plotësinë e informacionit financiar.

Njësia nuk ka kryer procedurat e vlerësimit të pronave të certifikuara dhe, për rrjedhojë, nuk ka bërë regjistrimin e tyre në kontabilitet, duke e kushtëzuar regjistrimin vetëm me ekzistencën e një vlere monetare të përcaktuar, për rrjedhojë aktivet afatgjata materiale rezultojnë të nënvlerësuara, Pasqyrat financiare nuk paraqesin një pamje të plotë dhe të drejtë të pasurisë së njësisë, krijohen

mangësi në administrimin, monitorimin dhe mbrojtjen e pasurisë publike, rritet rreziku për mospërputhje ndërmjet regjistrit të pronave dhe regjistrave kontabël.
Për sa sipër, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Neni 16, "Përgjegjësitë e titullarit", përcakton se titullari është përgjegjës për administrimin e rregullt, ekonomik, efektiv dhe efikas të aktiveve publike, si dhe për sigurimin e një sistemi të besueshëm të raportimit financiar; Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, kërkon që në pasqyrat financiare të evidentohen dhe raportohen të gjitha aktivet e njësisë në përputhje me dokumentacionin justifikues dhe regjistrat kontabël.

BASHKIA KORÇË/NJ.A.	VKM		Në (në përdorim numër)	Në (në pronësi numër)	Paisje me Çertifikatë Pronësie	Paisje me Çertifikatë Përdorimi	Aplikime për pajisje me Çertifikatë Pronësie për vitin 2025 (NË TOTAL)	Prona për përditësim/kalim në pronësi (ASHK)			Sa janë kontabilizuar
	Numër	Datë						Për përditësim	Ndryshim transferimi nga përdorimi në pronësi	Prona miratuar me VKM	
Bashkia Korçë	1532	19.11.2008	3	739	216		18	49	10	VKM Nr. 377, datë 10.07.2025, transferuar në pronësi të Bashkisë Korçë **(5 prona)**	0
Ish-Komuna Voskop	1641	17.12.2008	7	60	5						
Ish-Komuna Bulgarec	276	18.03.2009	27	163	12						
Ish-Komuna Drenovë	742	08.09.2010	68	88	31	47					
Ish-Komuna Vithkuq	455	06.05.2009	116	578	1						
Ish-Komuna Lekas	699	21.05.2008	15	146							
Ish-Komuna Voskopojë	1155	13.08.2008	6	54	5						
Ish-Komuna Mollaj	1057	16.07.2008	15	137	9						
			257	**1965**	**279**	**47**	**18**	**49**	**10**		

- **Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës:**

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët. Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklarimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj.,. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve. Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore konstatohet se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

- ***Veprimet nëpërmjet magazinës****:*

- Mbajtja e kontabilitetit për hyrjet dhe daljet e materialeve bëhej në ditarin e magazinës, në formë dokumentare dhe informatike. Çdo regjistrim kontabël bëhej sipas dokumentacionit bazë si fletë-hyrjeve dhe fletë-daljeve të magazinës dhe faturave të shitësit. Dokumentacioni bazë ishte i konfirmuar nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim. Nga verifikimi i disa veprimeve me zgjedhje konstatohet se veprimet ishin kontabilizuar saktë.
- Fletë daljet e magazinës janë hartuar dhe firmosur nga magazinieri, ku për mallra të ndryshëm ishin të shoqëruara me autorizim e plan-shpërndarje të miratuara nga titullari i institucionit.
- Janë mbajtur të dhëna për aktivet për një pjesë të tyre ekziston viti i krijimit si dhe janë evidentuar shtesat dhe pakësimet për to, por nuk është mbajtur një libër i mirëfilltë historik me të gjitha të dhënat e aktiveve të trupëzuara sipas modelit klasik të trajtuar më lart, domosdoshmëri kjo për të patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit në përputhje me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 30.
- Janë hapur kartela e zyrave inventarin ekonomik dhe objektet e inventarit të tërhequr nga magazina, në mënyrë që sektori ekonomik të sigurojë kontrollin e këtyre vlerave materiale gjatë kohës, që ata i kanë në ngarkim dhe të evidentojë nxjerrjen e përgjegjësisë në çdo rast të lëvizjeve, të shpërdorimeve, të dëmtimeve apo humbjeve.

- ***Auditim mbi zbatimin e dispozitave ligjore në kryerjen e pagesave për pagat e punonjësve, shtesat mbi to, shpërblimeve:***

Nga Bashkia Korçë është mbajtur dhe përditësuar libri dhe ditari i pagave. Ato hartoheshin sipas standardeve të kontabilitetit, ku plotësoheshin pagat me të gjithë elementet dhe shtesa të ndryshme të përfituara deri tek shuma bruto. Po kështu pasqyroheshin llojet e ndalesave deri tek paga neto. Përmbledhëset janë të kuadruar me listë pagesat dhe me urdhër pagesat respektive, të nënshkruara nga punonjësi i financës dhe titullari. Për të gjithë periudhën e kontrolluar, janë përllogaritur, ndaluar dhe xhiruar detyrimet për kontributin e sigurimeve shoqërore dhe tatimin mbi të ardhurat. Janë respektuar strukturat organike të miratuara përsa i përket numrit të punonjësve si dhe janë respektuar dispozitat ligjore për kohëzgjatjen e punës.

- **Inventarizimi i aseteve.**
- **Bashkia Korçë.**

Në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 11, pika 4, si dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, neni 74, njësitë publike kanë detyrimin të kryejnë të paktën një herë në vit verifikimin e ekzistencës, gjendjes dhe vlerësimit të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet procesit të inventarizimit dhe dokumentacionit mbështetës.
Auditimi i procesit të inventarizimit në Bashkinë Korçë është kryer duke u bazuar në dokumentacionin financiar dhe administrativ përkatës, konkretisht:

- pasqyrën nr. 7/a "Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)";
- pasqyrën nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)";
- kartelat e aktiveve sipas personave përgjegjës;
- urdhrat për ngritjen e komisioneve të inventarizimit, vlerësimit dhe asgjësimit;
- relacionet dhe raportet e komisioneve;
- procedurat për nxjerrjen jashtë përdorimit;
- dokumentacionin hyrës dhe dalës të magazinave.

Zhvillimi i procesit të inventarizimit

Me urdhër nr. 1245, datë 03.11.2025 (prot. nr. 11464), të Kryetarit të Bashkisë Korçë, është ngritur komisioni për inventarizimin e aktiveve afatgjata, afatshkurtra dhe materialeve për periudhën 01.11.2024 – 31.10.2025. Ngritja dhe veprimtaria e komisionit është mbështetur në:

- Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar;
- Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar;
- Udhëzimin nr. 20, datë 17.11.2024, për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik;

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se komisioni ka kryer:

- verifikimin fizik dhe cilësor të aktiveve në përdorim nga strukturat e Bashkisë dhe njësitë administrative;
- krahasimin e gjendjes fizike me të dhënat e inventarizimeve të mëparshme;
- hartimin e raporteve për gjendjen, kushtet e ruajtjes dhe përdorshmërinë e aktiveve.

Evidentimi i aktiveve të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit

Gjatë procesit të inventarizimit është konstatuar se një pjesë e aktiveve, për shkak të amortizimit fizik, konsumimit, dëmtimeve dhe pamundësisë ekonomike të riparimit, kanë humbur funksionalitetin e tyre dhe nuk mund të përdoren më për qëllimin fillestar. Komisioni ka propozuar kalimin e këtyre aktiveve për shqyrtim nga komisioni i vlerësimit. Gjithashtu janë evidentuar disa mjete të transportit jashtë funksionit, konkretisht:

- *Automjet shpëtimi tip furgon, me targë AA...6LN, viti prodhimi 1987, me vlerë fillestare 2,757,220 lekë dhe vlerë të mbetur 129,059 lekë;*
- *Auto shkallë zjarri Mercedes Benz, me targë AA...6LN, viti prodhimi 1976, me vlerë fillestare 18,072,320 lekë dhe vlerë të mbetur 88,440 lekë;*
- *Automjet zjarrfikës Skoda RT...6, me targë 0181, viti prodhimi 1963, me vlerë fillestare 638,140 lekë dhe vlerë të mbetur 39,540 lekë.*

Këto mjete janë klasifikuar për nxjerrje jashtë përdorimit pasi: kanë përfunduar afatin ekonomik të përdorimit; riparimi rezulton ekonomikisht i pajustifikueshëm; dëmtimet nuk lejojnë rikthimin në gjendje pune; kostoja e riparimit është e barabartë ose më e madhe se vlera e tregut për një aktiv të ngjashëm.

Vlerësimi i aktiveve për nxjerrje jashtë përdorimit

Vlera totale e aktiveve të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit është:

- Inventar ekonomik: 36,625,360 lekë;
- Inventar i imët: 7,800 lekë.

Në total: 36,633,160 lekë.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se për një pjesë të materialeve të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit nuk evidentohet viti i blerjes në kartelat përkatëse. Gjithashtu, për disa zëra të evidentuar në procesverbalet e inventarit, veçanërisht për projekte dhe instalime të tjera, përshkrimi i aktivit nuk është i plotë dhe nuk identifikon qartë natyrën e investimit apo përbërjen e tij.

Veprimtaria e komisionit të vlerësimit

Me urdhër nr. 1437, datë 22.12.2025 (prot. nr. 13640), të Kryetarit të Bashkisë, është ngritur komisioni për vlerësimin e aktiveve afatshkurtra dhe afatgjata të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit.

Komisioni, me procesverbalin datë 23.12.2025, ka vlerësuar se: projektet e regjistruara në llogarinë 202 nuk kanë më vlerë funksionale për shkak të amortizimit të plotë, ndryshimit të kushteve teknike dhe pamundësisë së zbatimit; aktivet e regjistruara në llogaritë 214, 2015, 2018 dhe 327 janë të amortizuara, të dëmtuara dhe të papërshtatshme për përdorim.

Aktivet e klasifikuara për nxjerrje jashtë përdorimit janë:

- aktive afatgjata materiale: 36,594,748 lekë;

- aktive afatgjata materiale për riciklim: 30,612 lekë;
- aktive afatshkurtra (inventar i imët): 7,800 lekë;
- automjete: vlerë fillestare 21,467,680 lekë, me vlerë të mbetur 257,039 lekë.

Procedura për tjetërsimin dhe asgjësimin.

Me urdhër nr. 1459, datë 29.12.2025, është ngritur komisioni për dhënien në përdorim, tjetërsimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të panevojshme. Komisioni ka vendosur:

- nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjësimin e aktiveve me vlerë 36,625,360 lekë dhe inventarit të imët me vlerë 7,800 lekë;
- kalimin për vlerësim të mëtejshëm të materialeve të ricikluеshme me vlerë 30,612 lekë;
- kalimin për vlerësim të mëtejshëm të automjeteve jashtë funksionit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se për asgjësimin e disa aktiveve mungon dokumentacioni fotografik apo dokumentacion tjetër justifikues që provon mënyrën e realizimit të procedurës së asgjësimit.

Konkluzion auditimi.

Nga auditimi i procedurave të inventarizimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve në Bashkinë Korçë rezulton se procesi është zhvilluar në përgjithësi në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi, pasi janë ngritur komisionet përkatëse, është kryer verifikimi fizik i aktiveve dhe janë hartuar dokumentet bazë të procesit.

- **Klubi Shumësportësh "Skënderbeu".**

Në zbatim të kërkesave ligjore për administrimin, kontrollin dhe inventarizimin e aktiveve të njësive të sektorit publik, me urdhër të brendshëm nr. 1 (prot. nr. 47), datë 28.08.2025, të Drejtoreshës së Klubit Shumësportësh V.O., është ngritur komisioni për inventarizimin e aktiveve afatgjata materiale dhe aktiveve afatshkurtra për periudhën 01.01.2025 – 31.08.2025, me përbërje: Eriona Gejko (kryetare), Elona Tiko dhe Kristaq Bica (anëtarë). Për vlerësimin e aktiveve është përcaktuar si kryetare e komisionit NZ A.L.

Nga ana e komisionit, në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve afatgjata materiale e jomateriale në njësitë e sektorit publik", Kreu IV, pika 83, është mbajtur procesverbali për rakordimin dhe evidentimin e dokumentacionit të hyrje-daljeve ndërmjet përgjegjësit material Pirro Kolaci dhe komisionit të inventarizimit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se me shkresën nr. 47/2 prot., datë 19.05.2025, komisioni i inventarizimit, përgjegjësi material dhe NZ kanë hartuar raportin përmbledhës për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve/materialeve për llogaritë kontabël 214, 218, 312 dhe 327, me vlerë totale 2,663,167 lekë, si më poshtë:

- Llogaria 327 në vlerën 1,936,471 lekë, për materiale të konsumuara moralisht dhe të papërdorshme;
- Llogaria 214 në vlerën 423,885 lekë, me amortizim të akumuluar 230,551 lekë dhe vlerë neto 193,334 lekë;
- Llogaria 218 në vlerën 281,971 lekë, me amortizim të akumuluar 242,640 lekë dhe vlerë neto 39,331 lekë;
- Llogaria 312 në vlerën 20,840 lekë.

Më datë 30.09.2025 është hartuar relacioni përfundimtar për nxjerrjen jashtë përdorimit.

Me urdhër nr. 2 (prot. nr. 47/3), datë 01.10.2025, është ngritur komisioni për dhënien në përdorim/tjetërsimin e aktiveve të panevojshme dhe/ose të nxjerra jashtë përdorimit.

Nga komisioni është mbajtur procesverbali datë 17.10.2025 (prot. nr. 47/7) për asgjësimin e materialeve me groposje, por në dokumentacion nuk rezultojnë të administruara prova të plota mbështetëse mbi mënyrën e asgjësimit (dokumentacion fotografik, dokumentacion për vendin e asgjësimit, dokumente shoqëruese për eliminimin fizik të materialeve).

Për artikujt prej hekuri, me shkresën nr. 47/5 prot., datë 19.11.2025, Klubi Shumësportësh i është drejtuar Drejtorisë Juridike të Bashkisë Korçë për orientim mbi procedurën e vijimit, duke kërkuar vlerësim lidhur me zhvillimin e procedurës së ankandit publik.
Me urdhër nr. 1363, datë 03.12.2025, të Kryetarit të Bashkisë Korçë, është ngritur grupi i punës për vlerësimin e materialeve që dalin jashtë përdorimit në njësinë vartëse KSHS.
Nga DPTMKI Bashkia Korçë, me shkresën nr. 13735 prot., datë 24.12.2025, është kryer vlerësimi i materialeve për skrap, duke përcaktuar vlerën 22,320 lekë (930 kg x 24 lekë/kg).
Nga auditimi, rezultoi se:

- *Dokumentim jo i plotë i procesit të inventarizimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit.*

Nga dokumentacioni i administruar nuk rezulton të jetë dokumentuar në mënyrë të plotë: gjendja fizike e çdo aktivi/materiali; kriteret konkrete të vlerësimit si i amortizuar, i papërdorshëm ose jashtë funksionit; evidenca fotografike ose teknike për dëmtimet; procesi i verifikimit të përdorshmërisë së aktiveve.

- *Mungesë dokumentacioni provues për asgjësimin fizik të materialeve.*

Procesverbali i datës 17.10.2025 për asgjësimin me groposje nuk shoqërohet me dokumentacion të mjaftueshëm që të provojë eliminimin real të materialeve. Mungesa e provave mbështetëse krijon risk për mosverifikueshmëri të veprimeve dhe cenon gjurmën e auditimit.

- *Mungesë evidence për përfundimin e procedurës së tjetërsimit/shitjes së materialeve prej hekuri*

Megjithëse është bërë vlerësimi i materialeve për skrap, nga dokumentacioni i paraqitur nuk rezulton të jetë kryer zhvillimi i procedurës së ankandit; dokumentimi i shitjes; arkëtimi i të ardhurave; çregjistrimi përfundimtar nga evidencat kontabël.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 8 – Përgjegjshmëria menaxheriale dhe sistemi i kontrollit të brendshëm. Nuk është siguruar në mënyrë të plotë funksionimi efektiv i kontrolleve të brendshme për dokumentimin, gjurmueshmërinë dhe verifikueshmërinë e procesit të inventarizimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit, neni 10 – Veprimtaria e kontrollit. Nuk rezulton të jenë zbatuar plotësisht procedurat e kontrollit për garantimin e dokumentimit të plotë të veprimeve mbi aktivet publike, Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011, Kreu IV, pika 83. Kërkon që procesi i inventarizimit të dokumentohet, të kryhet verifikimi fizik i aktiveve dhe rezultatet të pasqyrohen në dokumentacionin përkatës, Ligji nr. 9874, datë 14.02.2008 "Për ankandin publik" (nëse aplikohet për materialet e nxjerra për shitje). Për materialet me vlerë ekonomike të realizueshme duhet të ndiqet procedura përkatëse e shitjes/tjetërsimit dhe të dokumentohet përfundimi i saj.
Për sa më lart mbajnë përgjegjësi:
V.O. me detyrë Drejtor i Klubit Shumësportësh, në cilësinë e nëpunësit autorizues.
A.L, me detyrë Drejtore Financës, në cilësinë e nëpunësit zbatues.

- **Qendra e Artit dhe Kulturës**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se, me urdhër nr. 317 prot., datë 17.11.2025 të Drejtorit të institucionit, është ngritur komisioni për inventarizimin e aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra për vitin 2025. Nga komisioni është mbajtur procesverbali i datës 10.12.2025, ku evidentohet se para fillimit të inventarizimit është bërë fiksimi i numrit të FU dhe FD.
Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se institucioni ka ndërmarrë veprime për fillimin e procedurës së inventarizimit, nëpërmjet nxjerrjes së urdhrit dhe ngritjes së komisionit. Megjithatë, procesi i inventarizimit paraqet mangësi në drejtim të dokumentimit të plotë të kontrolleve të kryera dhe garantimit të gjurmueshmërisë së rezultateve të inventarizimit.

Konkretisht, procesverbali i mbajtur nga komisioni evidenton vetëm faktin e fiksimit të numrit të dokumenteve hyrëse dhe dalëse (FU dhe FD), por nuk rezulton të jetë dokumentuar në mënyrë të plotë kryerja e verifikimit fizik të aktiveve, krahasimi i gjendjes faktike me evidencat kontabël, evidentimi i diferencave, gjendja teknike e aktiveve, aktivet e dëmtuara, të amortizuara apo jashtë përdorimit. Mungesa e këtyre elementeve kufizon aftësinë e institucionit për të provuar se inventarizimi është realizuar në përputhje me kërkesat për kontrollin fizik dhe administrimin efektiv të aktiveve publike.
Këto mangësi bien në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, i cili kërkon që njësitë publike të kryejnë inventarizimin periodik të aktiveve, duke garantuar rakordimin ndërmjet gjendjes faktike dhe evidencave të mbajtura në kontabilitet, si dhe dokumentimin e plotë të rezultateve të inventarizimit. Gjithashtu, mangësitë në dokumentimin e kontrollit fizik të aktiveve cenojnë kërkesat e nenit 16 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, lidhur me përgjegjësinë e menaxhimit për ngritjen dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, përfshirë kontrollin mbi ruajtjen dhe administrimin e aktiveve.
Nga dokumentacioni i paraqitur nuk rezulton informacion nëse gjatë inventarizimit janë identifikuar aktive të dëmtuara, të amortizuara plotësisht ose të papërdorshme dhe nëse për këto aktive është ndjekur procedura për vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit. Në rast se ekzistojnë aktive të tilla dhe nuk është ndjekur procedura përkatëse e miratimit, vlerësimit dhe çregjistrimit, kjo përbën moszbatim të kërkesave të Udhëzimit nr. 30/2011 për administrimin, transferimin, nxjerrjen jashtë përdorimit dhe çregjistrimin e aktiveve të njësive të sektorit publik.
Gjithashtu, duhet të verifikohet nëse përbërja e komisionit të inventarizimit ka respektuar parimin e ndarjes së detyrave dhe shmangien e konfliktit të interesit, në mënyrë që personat përgjegjës për mbajtjen ose administrimin fizik të aktiveve të mos jenë njëkohësisht persona që kryejnë kontrollin e tyre. Mosrespektimi i këtij parimi do të cenonte kërkesat e kontrollit të brendshëm të përcaktuara në nenin 16 të ligjit nr. 10296/2010, lidhur me ndarjen e përgjegjësive dhe funksioneve kontrolluese.
Për sa më sipër, konkludohet se procesi i inventarizimit është iniciuar nëpërmjet procedurave formale, por dokumentimi i tij nuk është i plotë për të provuar realizimin e të gjitha kontrolleve të kërkuara nga kuadri rregullator. Mangësitë kryesore lidhen me mungesën e dokumentimit të verifikimit fizik të aktiveve, mungesën e evidentimit të diferencave dhe mungesën e informacionit mbi trajtimin e aktiveve jashtë përdorimit.
*Për sa më lart, mbajnë përgjegjësi**:** M.R. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe janë konfirmuar nga Drejtori, Z.K. në cilësinë e Nëpunësit Autorizues*

- **<u>Qendra Rezidenciale e Zhvillimit Korçë</u>.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion lidhur me procesin e inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale (AGJ/ASH), rezulton se Drejtoresha e institucionit ka ndërmarrë veprime administrative për ngritjen e komisioneve përkatëse, konkretisht:

- *Me urdhrin nr. 1 (prot. nr. 126), datë 15.12.2025, është ngritur Komisioni i Inventarizimit të aktiveve AGJ/ASH.*
- *Me urdhrin nr. 3 (prot. nr. 126/2), datë 15.12.2025, është ngritur Komisioni për Vlerësimin e aktiveve AGJ/ASH.*
- *Me urdhrin nr. 2 (prot. nr. 126/1), datë 15.12.2025, është ngritur Komisioni për Nxjerrjen Jashtë Përdorimit të aktiveve AGJ/ASH.*

Nga dokumentacioni rezulton se Komisioni i Inventarizimit ka hartuar procesverbalin datë 30.12.2025, në të cilin janë evidentuar diferenca në inventar, konkretisht mungesa dhe teprica, si

dhe është evidentuar se nuk janë përfshirë në procesin e inventarizimit llogaritë kontabël 212, 214, 215 dhe 218.
Mosmbulimi i të gjitha kategorive të aktiveve afatgjata materiale përbën mangësi në realizimin e procesit të inventarizimit, pasi inventarizimi duhet të shtrihet mbi të gjitha aktivet në pronësi ose administrim të njësisë publike, me qëllim verifikimin e ekzistencës fizike, gjendjes, vlerës dhe përputhshmërisë së tyre me regjistrat kontabël, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet detyrimi i njësive publike për organizimin dhe kryerjen e inventarizimit të plotë të aktiveve, evidentimin e gjendjes fizike dhe rakordimin e saj me evidencën kontabël.
Gjithashtu, evidentimi i mungesave dhe tepricave në procesverbalin e inventarizimit nuk është shoqëruar me një analizë të mëtejshme për përcaktimin e shkaqeve të diferencave, përgjegjësive konkrete, mënyrës së sistemimit kontabël apo masave për rikuperimin e dëmit, kur është rasti.
Mosndjekja e procedurave për trajtimin e diferencave të inventarit cenon kërkesat e nenit 9 dhe nenit 16 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, lidhur me përgjegjësinë e titullarit të njësisë publike për ngritjen dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, si dhe menaxhimin me efektivitet, eficiencë dhe ligjshmëri të burimeve publike.
Për sa i përket aktiveve të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit, nga inventarizimi janë evidentuar aktivet si më poshtë:

- *Frigorifer i madh me vlerë 275.000 lekë;*
- *Frigorifer i vogël me vlerë 250.000 lekë;*
- *Lavatrice me vlerë 35.000 lekë;*
- *Lavatrice me vlerë 44.990 lekë.*

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se këto aktive janë propozuar për nxjerrje jashtë përdorimit, por dokumentacioni duhet të përmbajë në mënyrë të plotë argumentimin teknik dhe ekonomik të pamundësisë së përdorimit të tyre, gjendjen fizike, mundësinë e riparimit, vlerën kontabël neto dhe modalitetin e eliminimit apo valorifikimit. Ne mungesë të këtyre elementeve, procedura e nxjerrjes jashtë përdorimit nuk konsiderohet e plotë, pasi vendimmarrja për heqjen nga administrimi të pasurisë publike duhet të mbështetet në dokumentacion justifikues dhe të verifikueshëm.
Kjo lidhet me detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, për administrimin, vlerësimin, nxjerrjen jashtë përdorimit dhe çregjistrimin e aktiveve afatgjata materiale, si dhe me parimet e përgjegjshmërisë dhe ruajtjes së pasurisë publike të përcaktuara në Ligjin nr. 10296/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".
Gjithashtu, gjatë shqyrtimit të përbërjes së komisioneve duhet të garantohet respektimi i parimit të ndarjes së detyrave dhe shmangies së konfliktit të interesit. Në rast se persona që kanë përgjegjësi direkte për administrimin, ruajtjen ose përdorimin e aktiveve janë përfshirë në procesin e kontrollit të këtyre aktiveve, krijohet risk për cenimin e objektivitetit të procesit të inventarizimit.
Në përfundim, procesi i inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve AGJ/ASH paraqet mangësi procedurale dhe dokumentare, konkretisht:

1. Inventarizimi nuk ka përfshirë të gjitha kategoritë e aktiveve afatgjata materiale, pasi nuk janë trajtuar llogaritë 212, 214, 215 dhe 218.
2. Diferencat e evidentuara (mungesa dhe teprica) nuk janë analizuar dhe nuk rezulton dokumentacion për mënyrën e trajtimit të tyre.
3. Procesi i nxjerrjes jashtë përdorimit nuk rezulton i argumentuar plotësisht me dokumentacion teknik dhe ekonomik.
4. Nuk evidentohet në dokumentacionin e paraqitur rakordimi përfundimtar ndërmjet inventarit fizik, regjistrave të aktiveve dhe kontabilitetit.

Ekziston nevoja për të garantuar ndarjen e qartë të përgjegjësive ndërmjet personave që përdorin, administrojnë dhe kontrollojnë aktivet, *për të cilën mbajnë përgjegjësi: K.P. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe Shërbimeve të Brendshme dhe janë konfirmuar nga Drejtori, D.L. në cilësinë e Nëpunësit Autorizues.*

- **Qendra Ditore e Zhvillimit**

Me urdhër nr. 30, datë 18.12.2025 (prot 304), të Drejtorit Ç.C. është nxjerrë urdhri për kryerjen e inventarizimit të aktiveve viti 2025, nga komisioni i krijuar me urdhër nr. Nr. 26, datë 31.12.2024. Sipas PV datë 31.12.2025 me nr. 304/41 prot, gjendja inventariale paraqitet si vijon:
Llogaria 212 me vlerë 11,809,598 lekë;
Llogaria 214 me vlerë 2,454,580 lekë;
Llogaria 215 me vlerë 800,000 lekë;
Llogaria 218 me vlerë 1,604,867 lekë;
Llogaria 312 me vlerë 897,943 lekë;
Llogaria 34 me vlerë 1,074,600 lekë;
Llogaria 327 me vlerë 554,561 lekë
Totali me vlerë 19,196,149 lekë. Mungesa dhe teprica nuk ka.
Nga auditimi i procedurës së inventarizimit të aktiveve, u konstatua se:
- Komisioni i inventarizimit fizik *nuk ka hartuar* Relacionin përmbledhës mbi procedurën e inventarizimit fizik, në mos përmbushje të Udhëzimin nr. 30/2011 datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" i ndryshuar, Kreu IV, pika 85/c. *Mungesa e Relacionit përmbledhës* përbën dokumentim jo të plotë të procedurës së inventarizimit, pasi mungojnë: analiza përshkruese që shpjegon rezultatet, veprimet e propozuara dhe interpretimi i informacionit të tabelave. Kjo sjell vështirësi në të kuptuarit e situatës reale të aktiveve.
- Nga ana e komisionit në zbatim të UMF nr. 30, datë 27.12.2011, kreu IV pika 83 nuk është mbajtur procesverbali për fiksimin e nr. Rendor të fletëhyrjes dhe fletë daljes midis përgjegjësit material dhe komisioni të inventarizimit;
- *Nuk ka krijuar* një regjistër aktivesh sipas kërkesa ligjore, në moszbatim të Udhëzimit e MF nr. 30/2011 datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" i ndryshuar, Kreu III, pika 26,27,28,29,30 dhe 31;
- *Nuk ka miratuar* regjistrin e unifikuar të aktiveve, në mos përmbushje të Udhëzimin e MF nr. 30/2011 datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" i ndryshuar, Kreu III, pika 26,27,28 etj. Mungesa e një regjistri të unifikuar bën që Njësia publike të mos ketë një pasqyrë të saktë dhe të konsoliduar të aktiveve, duke riskuar përdorimin jo efektiv të tyre apo të dhëna jo të sakta e të plota në pasqyrat financiare.
Për sa më lart, veprimet apo mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore: Neni 8 *"*Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit", si dhe nenet 9, 10, 11 të Ligjit nr.10296/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar dhe Manualit MFK i ndryshuar, kapitulli II, paragrafi 2.4; Udhëzimi nr. 21/2016 "Për nëpunësit zbatues të gjitha niveleve" ; Udhëzimi nr. 16, datë 20.07,2016, "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike"; Udhëzimi e MF nr.30 datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" i ndryshuar, ***për të cilën mbajnë përgjegjësi***: *J.T. me detyrë Specialiste Finance dhe janë konfirmuar nga Drejtori, dhe Ç.C. në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, si dhe komisionet e inventarizimit.*

- **Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes Korçë**

Me urdhër me nr. 20, datë 5.3.2025 (194), të Drejtorit Y.M. është kërkuar kryerja e inventarizimit të aktiveve viti 2025, si vijon:
Me urdhër nr. 353 prot, datë 14.5.2025 komisioni për inventarizim "Gjimnazi Raqi Qirinxhi".

Me urdhër nr. S'ka, datë 14.5.2025 është ngritur komisioni për jashtë përdorimit.
Me urdhër nr. S'ka, datë 20.5.2025 është ngritur komisioni i vlerësimit.
Me urdhër me nr. S'ka, datë 15.12.2025 është ngritur komisioni i asgjesimit.
Sipas procesverbal konstatimi mbajtur nga komisioni inventarizimit, është konstatuar se disa material në llog 214 për vlerën 1,683,193 lekë e kanë humbur vlerën e tyre, si: kaldajë, pompë qarku, buqët, filtra nafte, pompë qarkullimi, beqe kaldaje, ventil rediatori;
Llog 212 dhe 327 me vlerë 1,369,766 lekë për artikuj: UPS, kabinë informatike, magnetofon, televizor, fotokopje, aparat fotografik, makinë llogaritës.
Pra në total janë vlerësuar për jashtë përdorimit vlera 17,952,959 lekë nga llog 214/218/327
Sipas PV ka datë, mbajtur nga komisioni i asgjesimit, të materialeve llog 327,214,218 me vlerë 766,636 lekë.
Me urdhër nr. 369 prot, datë 22.5.2025 komisioni për inventarizim "Gjimnazi Themisloki Germenji".
Me urdhër të veçantë për çdo shkolla nga drejtori janë ngritur komisionet e inventarizimit, vlerësimit dhe asgjësimit të materialeve jashtë përdorimit. Nga njësia janë inventarizuar llogaritë 214/218/327.
Në përfundim të procesit nga komisionet është hartuar relacioni përfundimtar mbi inventarizimin e aktiveve, ku ndertë tjera thuhet se:
Në përfundim të procesit të inventarizimit disa për materialeve e kanë humbur funksionin e tyre dhe janë klasifikuar për jashtë përdorimit, të cilat trajtohen si vjetërsinë/mbeturina/ materiale të riciklushme, dhe duhet të hiqen nga regjistri i aktiveve në përdorim. Për këto materiale NSHMAC ka njoftuar Këshillin Bashkiak Korçë me shkresën me nr. 1595 prot, datë 16.2.2026, gjithsej në vlerën 5,653,675 lekë, *nga e cila:* llogaria 214 me vlerë kontabël 804,185 lekë; llogaria 218 me vlerë kontabël 2,409,039 lekë dhe llogaria 327 me vlerë kontabël 2,800,451 lekë.
Nga këto:

a- Materiale të riciklushme hekuri me vlerë 3,619,698 lekë, *nga e cila: nga e cila:* llogaria 214 me vlerë kontabël 3,488,546 lekë; llogaria 218 me vlerë kontabël 96,352 lekë dhe llogaria 327 me vlerë kontabël 34,800 lekë;
b- Pjesë kompjuteri për vlerësim me vlerë 3,023,557 lekë, *nga e cila: nga e cila:* llogaria 214 me vlerë kontabël 74,424 lekë; llogaria 218 me vlerë kontabël 2,949,133 lekë.

Për aktivet e nxjerra jashtë përdorimit sipas relacioni janë mbajtur procesverbalet e asgjësimit, nënshkruar nga I.L. me detyrë spec finance (inventarizuese), V.P. me detyrë spec finance (inventarizuese), përgj finance J.T. dhe Drejtori Y.M.
Me urdhër nr. S'ka, datë 14.5.2025 është ngritur komisioni për jashtë përdorimit.
Me urdhër nr. S'ka, datë 20.5.2025 është ngritur komisioni i vlerësimit.
Me urdhër me nr. S'ka, datë 15.12.2025 është ngritur komisioni i asgjësimit.
Sipas procesverbal konstatimi mbajtur nga komisioni inventarizimit, është konstatuar se disa material e kanë humbur vlerën e tyre, si: llogaria 327 me vlerë 2,835,251 lekë, llogaria 214 me vlerë 4,367,155 lekë, llogaria 218 me vlerë 5,454,524 lekë, gjithsej për vlerën 12,650,930 lekë.
Sipas PV ka datë, mbajtur nga komisioni i asgjësimit të materialeve llog 327,214,218 me vlerë 766,636 lekë.
Me shkresën me nr. 169 prot, datë 18.2.2026, adresuar Drejtorisë Juridike dhe PZHKT, për vijimin e procedurave të ankandit të materialeve për jashtë përdorimit, si sipërcituar. Nga kjo e fundit nuk është vijuar me procedurën e ankandit ose shitje për skrap.
Konstatimi: Nga auditimi i procedurave të inventarizimit dhe administrimit të aktiveve u konstatua se, megjithëse janë ngritur komisionet përkatëse dhe është kryer inventarizimi i aktiveve, procesi paraqet mangësi në dokumentimin, kontrollin dhe finalizimin e procedurave. Konkretisht, u evidentuan mospërputhje në vlerat e aktiveve të raportuara në dokumentacionin e inventarizimit, mungesë e rakordimit ndërmjet procesverbaleve, relacionit përfundimtar dhe regjistrave kontabël,

si dhe urdhra për ngritjen e disa komisioneve pa numër protokolli. Gjithashtu, u konstatua se të njëjtët punonjës kanë qenë pjesë e disa komisioneve (inventarizimi, nxjerrja jashtë përdorimit dhe asgjësimi), duke mos garantuar ndarjen e funksioneve sipas kërkesave të kontrollit të brendshëm. Procesi nuk është finalizuar me zhvillimin e procedurave të ankandit ose shitjes së materialeve të ricklueshme dhe nuk rezulton të jetë kryer çregjistrimi kontabël i aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit.
Për sa sipër, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, neni 16, për përgjegjësinë e titullarit në administrimin e aktiveve, neni 19, për aktivitetet e kontrollit, ndarjen e detyrave dhe dokumentimin e proceseve; Ligjin nr. 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", për regjistrimin e saktë dhe të plotë të aktiveve dhe mbështetjen e tyre me dokumentacion justifikues; VKM nr. 500, datë 14.05.2008 "Për administrimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", lidhur me procedurat e inventarizimit, vlerësimit, nxjerrjes jashtë përdorimit, shitjes/asgjësimit dhe çregjistrimit të aktiveve, *për të cilën mbajnë përgjegjësi*: *J.T. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit Ekonomik dhe janë konfirmuar nga Drejtori, Y.M. në cilësinë e Nëpunësit Autorizues.*

- **Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Korçë.**

Me urdhër nr. 374 (prot 1417), datë 17.10.2025 të Drejtorit të NSHP I.D. është ngritur komisioni për inventarizimin e aktiveve për periudhën 2024 – 17.10.2025.
Nga ana e komisioni është bërë inventarizim i llogarive 32/2014/2015/2018, për të cilën janë nënshkruar të gjitha fletët e inventarit.
Nga komisioni është mbajtur procesverbali datë 10.11.2025 në të cilën janë evidentuar materiale për jashtë përdorimit, si: llogaria 32-*Inventari imët në vlerën 8,240,542 lekë; llogari 214 në vlerën 9,198,203 lekë, llogaria 215 në vlerën 8,324,020 lekë dhe llogaria 218 në vlerën 413,140 lekë, gjithsej për vlerën 26,175,906 lekë.*
Gjithashtu nga komisioni është hartuar dhe raporti përmbledhës mbi inventarizimi e aktiveve në zbatim të urdhrit të titullarit (nr. 374 (prot 1417), datë 17.10.2025), ku ndertë tjera është theksuar nxjerra jashtë përdorimit e disa materialeve të cilat kanë humbur funksionin e tyre *(*llogaria 32-*Inventari imët në vlerën 8,240,542 lekë; llogari 214 në vlerën 9,198,203 lekë, llogaria 215 në vlerën 8,324,020 lekë dhe llogaria 218 në vlerën 413,140 lekë, gjithsej për vlerën 26,175,906 lekë).*
Me shkresën me nr. 207 prot, datë 16.2.2026 *(prot bashkia nr. 1554, dt. 16.2.2026),* është njoftuar Këshilli Bashkia mbi nxjerrjen jashtë përdorimit.
Me urdhër nr. 422 (prot 1417/1), datë 21.11.2025 nga Drejtori i NSHP është ngritur komisioni i vlerësimit të materialeve për jashtë përdorimit.
Nga ana e komisioni është mbajtur PV verifikimi nr. 1417/2 prot, datë 15.12.2025, ku është theksuar se:

a- Për materialet me vlerë 5,620,901 lekë llog. 31, llog 214 = 486,563 lekë dhe llog. 218 = 87,720 lekë, komisioni ka venduar asgjesim me groposje;
b- Për materialet me vlerë 2,161,961 lekë llog. 31, llog 214 = 5,190,000 lekë dhe llog. 218 = 31,800 lekë, ka vendosur për riciklim;
c- Për materialet me vlerë 457,680 lekë llog.31, llog 214 = 3,521,639 lekë dhe llog. 218 = 293,62 lekë, do rivlerësohen nga specialistja Ariola Cela me profil ing. Gjeodet vlerësues pasurive;
d- Për materialet e llog. 215 = 8,324,020 lekë do rivlerësohen nga specialistja Ariola Cela me profil ing. Gjeodet vlerësues pasurive

Nga komisioni është hartuar dhe relacion vlerësimi me shkresën nr. 1417/3 prot, datë 15.12.2025.
Me urdhër të Drejtorit të NSHP nr. 463 (prot 1417/4), datë 19.12.2025 është ngritur komisioni për dhënien në përdorim/tjetërsim dhe ose nxjerrje jashtë përdorimi të aktiveve të llogarive 214/218/215, i cili ka detyrimin për të përcaktuar destinacionin përfundimtar të materialeve. Më

pas është hartuar dhe PV nr. 1417/5 prot, datë 31.12.2025 për dhënien në përdorim/tjetërsim dhe ose nxjerrje jashtë përdorimi të aktiveve të llogarive 214/218/215.
Me shkresën nr. 1417/7 prot, datë 30.4.2026, NSHP i është drejtuar Drejtorisë Juridike bashkia Korçë, për vijimin e procedurave për nxjerrje jashtë përdorimit të aktiveve të llogarive 214/218/215 për vlerat e sipërcituara, por që nga kjo e fundit nuk është vepruar.
Me urdhër të Kryetarit të bashkisë me nr. 570 (prot 5120), datë 19.5.2026 është ngritur grupi i punës për rivlerësimin e aktiveve për jashtë përdorimit të NSHP.
Nga ana e komisioni është hartuar relacion shpjegues
Konstatimi: Nga auditimi konstatohet se Njësia ka ndërmarrë veprimet e inventarizimit në zbatim të urdhrit të titullarit, duke ngritur komisionin e inventarizimit, komisionin e vlerësimit dhe komisionin për përcaktimin e destinacionit të aktiveve, si dhe janë hartuar procesverbalet dhe relacionet përkatëse.
Megjithatë, procedura nuk rezulton të jetë përfunduar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, pasi nuk evidentohet miratimi përfundimtar dhe realizimi i nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve, megjithëse dokumentacioni është përcjellë pranë Bashkisë Korçë. në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë së Financave për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike (udhëzimi në fuqi mbi administrimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve).
Megjithëse janë kryer inventarizimi, vlerësimi teknik dhe rivlerësimi i aktiveve, nuk rezulton të jetë nxjerrë akti administrativ përfundimtar për miratimin e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe as të jenë realizuar procedurat për asgjësim, riciklim ose tjetërsim, pasi aktive të amortizuara vijojnë të mbeten në regjistrat kontabël; pasqyrat financiare nuk paraqesin në mënyrë të saktë gjendjen reale të aktiveve; krijohen aktive fiktive në bilanc; rritet rreziku i humbjes ose keqadministrimit të pasurisë publike
Sa sipër në kundërshtim me Ligji nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", I ndryshuar, Neni 7 – Parimi i ligjshmërisë; Neni 15 – Parimi i miradministrimit; Neni 91 – Afati për përfundimin e procedurës administrative; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Neni 8 – Përgjegjësitë e titullarit të njësisë publike; Neni 16 – Përgjegjësitë e menaxherëve të njësive vartëse; Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" (i ndryshuar), Kreu III – Administrimi dhe përgjegjësitë për aktivet, Pikat mbi inventarizimin periodik të aktiveve, Pikat mbi komisionin e inventarizimit, Pikat mbi nxjerrjen jashtë përdorimit dhe çregjistrimin e aktiveve, Pikat mbi përgjegjësitë e nëpunësve materialisht përgjegjës dhe drejtuesve të njësive.
Nga dokumentacioni rezulton se me shkresën nr.1417/7 prot., datë 30.04.2026, dokumentacioni është përcjellë pranë Drejtorisë Juridike për vijimin e procedurës, por nuk rezulton të jenë ndërmarrë veprime.
Ky mosveprim bie ndesh me Ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", I ndryshuar, Neni 7 – Parimi i ligjshmërisë, sipas të cilit organi publik është i detyruar të ushtrojë kompetencat dhe të përmbushë detyrat e tij në përputhje me ligjin; Neni 15 – Parimi i miradministrimit, i cili detyron organet publike të veprojnë me efektivitet, efikasitet dhe brenda një afati të arsyeshëm; Neni 91 – Afati për përfundimin e procedurës administrative, sipas të cilit procedurat administrative duhet të përfundojnë brenda afatit të parashikuar nga ligji ose, në mungesë të tij, brenda një afati të arsyeshëm; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Neni 8 – Përgjegjësitë e titullarit të njësisë publike, që përcakton se titullari është përgjegjës për krijimin dhe funksionimin e një sistemi efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke përfshirë administrimin e aktiveve; Neni 16 – Menaxherët e njësive vartëse, që përcakton përgjegjësinë e drejtuesve të strukturave për zbatimin e kontrolleve dhe administrimin korrekt të burimeve publike dhe Udhëzimi e MF nr. 30, datë

27.12.2011 të Ministrit të Financave "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" (i ndryshuar),
Vonesa në përfundimin e procesit**.** Inventarizimi është përfunduar në nëntor 2025, ndërsa edhe në muajin maj 2026 procedura nuk rezulton e përfunduar, kjo nuk përmbush kërkesat e menaxhimit efektiv të aktiveve publike, *për të cilën ngarkohen me përgjegjësi**;** K.G. me detyrë Drejtoreshë e Sektorit Ekonomik dhe Financiar dhe janë konfirmuar nga Drejtori, I.D.. në cilësinë e Nëpunësit Autorizues.*

- **Shtëpia e Foshnjës "Lulet e Vogla**

Gjatë auditimit u konstatua se Shtëpia e Foshnjës "Lulet e Vogla nuk ka filluar procesin e inventarizimit të pasurisë dhe detyrimeve për periudhën raportuese, në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit në fuqi që rregullon menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe procedurat e kontabilitetit publik. Mos fillimi i inventarizimit pengon verifikimin fizik dhe dokumentar të ekzistencës, gjendjes dhe vlerës së aktiveve dhe detyrimeve, duke rritur rrezikun e pasaktësive në pasqyrat financiare, mosidentifikimit të mungesave ose tepricave të pasurisë dhe dobësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, veprime në kundërshtim me Ligjit nr. 10296/2010 'Për menaxhimin financiar dhe kontrollin', i ndryshuar, veçanërisht nenet 8 dhe 9, si dhe me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 'Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik', të ndryshuar, konkretisht pikat 2, 5, 7, 8, 21/c dhe 26, të cilat kërkojnë administrimin, dokumentimin, kontrollin fizik dhe mbajtjen e evidencës së plotë të aktiveve publike.".
Mos marrja e masave organizative nga drejtuesi i njësisë, mos ngritja e komisionit të inventarizimit dhe mungesa e planifikimit të procesit, çon në mungesë sigurie mbi ekzistencën dhe saktësinë e aktiveve dhe detyrimeve, rrezik i lartë për pasqyrim jo të drejtë të pasqyrave financiare, rritje e mundësisë për humbje, dëmtime ose keqpërdorim të pasurisë publike pa u identifikuar në kohë, dobësim i sistemit të kontrollit të brendshëm dhe i llogaridhënies financiare, *për të cilën ngarkohen me përgjegjësi: P.SH. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe Shërbimeve të Brendshme dhe janë konfirmuar nga Drejtori, K.GJ. në cilësinë e Nëpunësit Autorizues.*
(Në fazën e Projekt raport auditimit, nga subjekti Bashkia Korçë për këtë pikë nuk u paraqitën observacione)

2.4. Mbi zbatimin e rekomandimeve nga auditimi fundit**.**

I- Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimet e mëparshme, dërguar në Bashkinë Korçë me shkresën nr. 974/8, dt.17.02.2026, miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH nr. 26 Prot., datë 13.02.2026 (*Prot bashkia Korçë me nr. 1576/13, dt. 19.02.2026*), me qëllim vlerësimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të lëna: statusin e zbatimit të rekomandimeve, afateve dhe niveli i zbatueshmërisë së tyre, koherencën e tyre dhe përgjegjshmërinë menaxheriale referuar standardeve të auditimit.

a. Mbi hartimin dhe miratimin e "Planit të veprimit".
Me Urdhrin e Kryetarit të bashkisë Nr. 10576/14 Prot, datë 27.2.2026 është miratuar plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, paraqitur me shkresën nr. 974/8, dt.17.02.2026, për periudhën e vitit 2024, në të cilën janë përcaktuar afatet dhe personat përgjegjës që do merren me zbatimin e tyre, ku janë ngarkuar Drejtoria e Financës; Sektori i prokurimeve publike; Drejtoria e PZHKT; Drejtoria e Taksave e tarifave vendore.

b. Mbi raportimin në KLSH brenda afatit 20 ditor:
Bashkia Korçë ne shkresën me nr. 10576/4 Prot, datë 27.02.2026, ka dërguar në KLSH, planin e veprimit *"Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH të lëna në raportin përfundimtar të auditimit"* dërguar me shkresën nr.974/8, dt.17.02.2026, *brenda afatit 20 ditor*, gjë që ka ndikuar edhe në

angazhimin në afat të strukturave ngarkuar me përgjegjësi, në marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna, kjo në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit ".*

c. Mbi raportimin në KLSH brenda afatit 6 mujor:

Në zbatim të ligjit nr.154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 30 pika 2, njësia e vetëqeverisjes vendore duhet të raportojë brenda afatit 6 mujor nga data e mbërritjes së RPA shkresërisht me objekt "Raportim mbi zbatimin e Rekomandimeve të lëna nga KLSH në Raportin Përfundimtar të Auditimit", dërguar me shkresën nr. 974/8, dt.17.02.2026. Nga verifikimi rezultoi se nuk është plotësuar afati për kthim përgjigje në zbatim të afatit 6 mujor.

Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

***a.** Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar **13 masa organizative**, të pranuar plotësisht nga subjekti. Nga të pranuarat janë zbatuar 10 masa dhe në proces zbatimi janë 3 masa.*

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve paraqitet si vijon:

A. Masa organizative

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Bashkisë Korçë nuk ka ngritur një sistem funksional dhe të dokumentuar të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, pasi: Mungon një kuadër i plotë rregullash dhe procedurash të shkruara; Nuk është hartuar Kodi Etik; Në rregulloren e brendshme evidentohen mbivendosje të detyrave dhe kompetencave të Sektorit të Inspektimit dhe Mbrojtjes së Pyjeve; Nuk kanë hartuar dhe miratuar plane dhe programe vjetore efektive për trajnimin e detyrueshëm të punonjësve; Nuk ka miratuar plan pune vjetor lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik; Nuk është hartuar një strategji për trajnimin e personelit apo për menaxhimin e riskut, ndërsa regjistri i riskut është i paplotë dhe jo në përputhje me formatet standarde, për më tepër nuk ka hartuar strategjinë e riskut; Nuk evidentohet puna e anëtarëve të GMS, përfshirë dokumentimin e mbledhjeve dhe takimeve për hartimin e planit strategjik dhe PBA-së. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar, neni 4, pikat 19-20, neni 8, gërma *"a"*, neni 16, pikat 1-3, nenet 20-22, Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, *"Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike"*, pika 2.2.1, gërmat *"a-d"*, pika 2.3.1, pika 3.2.1, pika 5.2.3, pika 5.2.7, dhe *"Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"* i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108/2016, datë 17.11.2016, Kapitulli III. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 13-27, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Korçë të marrë masa konkrete për analizimin dhe adresimin e mangësive të konstatuara, si dhe të sigurojë ngritjen dhe funksionimin e një sistemi të përshtatshëm të rregullave dhe procedurave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, në funksion të përmirësimit të veprimtarisë institucionale.

Nga verifikimi i dokumentacionit, rezultoi se: Ky rekomandim vijon të mbetet në vëmendje të punës dhe po punohet për zbatimin e tij nga çdo drejtori apo strukturë në varësi të bashkisë, gjatë vitit 2026.

Statusi: *Në proces zbatimi. Nga grupi nuk do kërkohet, pasi do kërkohet në auditimin e radhës*

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi funksionimin dhe veprimtarinë e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm pranë Bashkisë Korçë përgjatë vitit 2024, u konstatua se:

- Për periudhën 2024, konstatohet se, nuk janë mbuluar me auditim të gjitha sistemet, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë;

- Është përfshirë në auditim një punonjëse, e cila nuk ka qenë pjesë e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm;
- Nuk është realizuar plani i auditimeve, nga 7 auditime të planifikuara janë realizuar 5 prej tyre;
- Dosjet e auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njësisë vendore;
- Nuk është kryer auditim me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos ofruar siguri dhe këshilla objektive për titullarin e njësisë publike nëse ky sistem është ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar. Këto veprime janë në kundërshtim me gërmën *"a"* në pikën 1, të nenit 10, gërmën *"a"* të nenit 12, gërmën *"a"* të nenit 14, të Ligjit nr. 114/2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" i ndryshuar, pikën 3 të nenit 43 në Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, Urdhrin nr. 4, datë 10.01.2020, të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë "Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016"; Udhëzimin nr. 42, datë 27.10.2020, "Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik", Kreun IV paragrafi 4.1.13.1 të Manualit për Auditimin e Brendshëm. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 13-27, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Korçë, të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditime në fushat e veprimtarisë së institucionit që paraqesin rrisk të lartë, si: Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, administrimi i taksave dhe tarifave vendore, zbatimin e rekomandimeve etj., në mënyrë që t'i ofrojë mbështetje titullarit të njësisë vendore në arritjen e objektivave institucional.

Nga verifikimi i dokumentacionit, rezultoi se: Në planin strategjik 2026-2028 dhe në planin vjetor 2026 janë planifikuar për auditim fusha me risk të lartë si Prokurimet; Vlerësimi i sistemit të MFK në subjektet e parashikuara për auditim; Burimet Njerëzore; Detyrimet në drejtorinë e financës; Asetet e bashkisë në drejtorinë juridike; Drejtoria e Kontroll territorit; Inspektorati i mbrojtjes së territorit; etj.

Kryetari i bashkisë me Urdhrin nr.168, dt.15.10.2025 ka urdhëruar zbatimin e planit vjetor 2026 dhe Planit strategjik 2026-2028, të cilët janë dërguar në DHAB në ministrinë e Financave me shkresën nr.9541/1, dt.15.10.2025.

Statusi: *Në proces zbatimi. Nga grupi nuk do kërkohet, pasi do kërkohet në auditimin e radhës*

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të konsoliduar për vitin 2024 të Bashkisë Korçë, në të cilën si pjesë përbërëse të tyre përfshihen edhe pasqyrat financiare të Njësisë Shpenzuese Shtëpia e Foshnjës "Lulet e Vogla", ku me shkresën nr. 104 Prot., datë 28.04.2025, i ka depozituar në Degën e Thesarit Korçë, të cilat kanë marrë konfirmimin me praktikën nr. 104, datë 30.04.2025, jashtë afatit ligjor. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, Kapitulli V, pika 118. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 27-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Nga Sektori i Financës të Shtëpisë së Foshnjës "Lulet e Vogla" të merren masa që hartimi dhe depozitimi i pasqyrave financiare vjetore, pranë degës së thesarit, të kryhet brenda afatit të përcaktuar në dispozitat ligjore përkatëse.

Nga verifikimi i dokumentacionit, rezultoi se: Në zbatim të Udhëzimit të MF nr. 8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, pasqyrat financiare për periudhën 01.01.2025-

31.12.2025 janë dorëzuar pranë Degës së Thesarit Korçë me shkresë përcjellëse nr.425 Prot., datë 31.03.2025.

Statusi: *Zbatuar*

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të inventarizimit të Njësisë Shpenzuese Shtëpia e Fonjës "Lulet e Vogla" u konstatua se, në pasqyrat financiare nuk janë kryer veprimet sistemuese për pakësimin e vlerës totale prej 1,055,907 lekë që i përket llogarive 214 *"Instalime teknike, makineri e pajisje"* në vlerën 21,000 lekë, 218 *"Inventar ekonomik"* në vlerën 740,499 lekë dhe 327 *"Inventar i imët"* në vlerën 294,408 lekë që i përket aktiveve të asgjesuara, të cilat ndodhen ende në inventarin fizik të institucionit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, pikat 89-90. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 27-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Bashkia Korçë në bashkëpunim me Njësinë Shpenzuese Shtëpia e Fonjës "Lulet e Vogla" të marrë masa që, në pasqyrat financiare të vitit 2025 të kryejë sistemimin e vlerës totale prej 1,055,907 lekë, që i përket aktiveve të asgjësuara në procesin e inventarizimit të vitit 2024, duke i pakësuar nga gjendja e inventarit kontabël.

Nga verifikimi i dokumentacionit, rezultoi se: Nga auditimi i pasqyrave financiare (të konsoliduar), të vitit 2025, rezultoi se është kryer sistemimi i vlerës 1,055,907 lekë, e cila përfaqëson aktivet e nxjerra jashtë përdorimit duke i pakësuar nga gjendja e inventarit kontabël.

Statusi: *Zbatuar*

5. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 4342 *"Operacione me shtetin (të drejta)"* më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 75,078,510 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, në vlerën 134,796,778 lekë me një rritje në vlerën 59,718,268 lekë e cila përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, për detyrime paga, tatime taksa dhe sigurime shoqërore dhe furnitorë e llogari të lidhura me to. Kjo llogari nuk kuadron me përmbledhësen e llogarive 401-408 *"Furnitorë e llogari të lidhura me to"* 43,513,278 lekë; 42 *"Detyrime ndaj personelit"* në vlerën 65,092,617 lekë; 431 *"Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa"* në vlerën 4,868,646 lekë; 435 *"Sigurime shoqërore"* në vlerën 19,424,995 lekë; 436 *"Sigurime shëndetësore"* në vlerën 2,685,069 lekë dhe 467 *"Kreditorë të ndryshëm"* në vlerën 22,615,430 lekë, ku totali shkon në vlerën 158,200,035 lekë me një diferencë në vlerën 23,403,257 lekë. Sipas informacionit kontabël llogaria 4342 *"Operacione me shtetin (të drejta)"* është nënvlerësuar në vlerën 23,403,257 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, Aneksi 1, Kapitulli 3.3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 27-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Bashkia Korçë, Drejtoria e Financës Buxhetit, Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në bashkëpunim me NShMAC, QDZh të marrë masa që në pasqyrat financiare të konsoliduar të vitit 2025 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 4342 *"Operacione me shtetin (Të drejta)"* me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

Nga verifikimi i dokumentacionit, rezultoi se: Nga auditimi i pasqyrave financiare (të konsoliduar) viti 2025, rezultoi se vlerat e llogarisë 4342 "*Operacione me shtetin (të drejta)"* janë paraqitur me vërtetësi, me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë, në zbatim të Udhëzimit të MF nr. 8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar.

Statusi: *Zbatuar*

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, në gjendjen e llogarisë 212 *"Ndërtesa e konstruksione"* ku më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 4,215,948,779 lekë është përfshirë një aktiv me emërtimin *"Dhomë Serverash"* me vlerë 710,580 lekë për të cilën OE *"F. E."* ShPK ka lëshuar faturën tatimore nr. 5/2024, datë 11.01.2024, në vlerën 710,580 lekë me TVSh likuiduar me Urdhër Shpenzimin nr. 149, datë 28.02.2024, ku janë të përfshira pajisje elektronike me emërtimet kamera, sëich, aspiratorë profesional etj., që i përkasin llogarisë 218 *"Inventar ekonomik"*. Regjistrimet e mësipërme kanë mbivlerësuar llogarinë 212 *"Ndërtesa e konstruksione"* në vlerën 710,580 lekë dhe kanë nënvlerësuar llogaritë 218 *"Inventar ekonomik"* në vlerë 710,580 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Nomeklaturën e Llogarive të Planit Kontabël Publik, Llogaritë e Klasës 20. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 27-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: Bashkia Korçë, Drejtoria e Financës Buxhetit, Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të marrë masa për sistemimin e vlerës 710,580 lekë që i përket aktivit me emërtimin *"Dhomë Serverash"* së bashku me vlerën e amortizimit të përllogaritur, duke e pakësuar si aktiv nga llogaria 212 *"Ndërtesa e konstruksione"* dhe duke e kontabilizuar në llogarinë 218 *"Inventar ekonomik"* në zbatim të dispozitave ligjore përkatëse.

Nga verifikimi i dokumentacionit, rezultoi se: Nga auditimi i pasqyrave financiare (të konsoliduar) viti 2025, rezultoi se nga ana e Drejtorisë së Financës Buxhetit dhe MFK është kryer sistemimi i vlerës 710,580 lekë, që i përket aktivit me emërtimin "Dhomë Serverash" së bashku me vlerën e amortizimit të përllogaritur, duke e pakësuar si aktiv nga llogaria 212 "*Ndërtesa konstruksione*" dhe duke e kontabilizuar në llogarinë 218 "*Inventar ekonomik*" në zbatim të dispozitave ligjore përkatëse.

Statusi: *Zbatuar*

7. Gjetje nga auditimi: Për llogarinë 215 "*Mjete transporti*" në pasqyrat financiare është kontabilizuar vlera 275,350,932 lekë. Në kartelat analitike të kësaj llogarie është përfshirë edhe automjeti i llojit Ẅolsvagen Furgon me targë AB...40 që i përket gjendjes së inventarit të Qendrës Rezidenciale të Zhvillimit, me vlerë kosto historike 950,000 lekë i cili nuk ndodhet në gjendje pune, konstatuar edhe në procesin e vlerësimit të aktiveve të institucionit. Në zbatim të Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, Aneksi nr. 1, "Analiza, përbërja sipas klasave dhe trajtimi kontabël i llogarive të kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme (NJQP)", 2.1, *"Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2"*, vlera 950,000 lekë e cila i përket kostos historike të mjetit të dëmtuar duhej të debitohej në llogarinë 24 "*Aktive afatgjata të dëmtuara*".

Pra nga llogaria 215 "*Mjete transporti*", duhet të zbritet vlera e automjetit të dëmtuar dhe të regjistrohet në llogarinë 24 "*Aktive afatgjata të dëmtuara*".

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, *"*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, pika 36. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 27-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1. Rekomandimi: Bashkia Korçë, Drejtoria e Financës Buxhetit, Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në bashkëpunim me Qendrën Rezidenciale të Zhvillimit në pasqyrat e vitit 2025 të bëjë sistemimin e vlerës 950,000 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin dhe paraqitjen e gabuar të 1 automjeti të dëmtuar në llogarinë 215 *"Mjete transporti"*, sistemi të kryhet referuar trajtimit kontabël në llogarinë 24 *"Aktive afatgjata të dëmtuara"*.

Nga verifikimi i dokumentacionit, rezultoi se: Nga auditimi i pasqyrave financiare (të konsoliduar) viti 2025, rezultoi se Drejtoria e Financës Buxhetit dhe MFK në bashkëpunim me Qendrën Rezidenciale të Zhvillimit, ka kryer veprimin kontabël për sistemimin e veprimit sipas rekomandimit të KLSH-së, ku vlera 950,000 lekë, që i përket kostos historike të këtij mjeti është çregjistruar nga llogaria 215 "*Mjete transporti*" dhe ka kaluar te llogaria 24 "*Aktive afatgjatë të dëmtuara*" duke u reflektuar korrekt në pasqyrat financiare të vitit 2025. Ndërsa për automjetin e dëmtuar të llojit Ẅolksëagen Furgon, me targë AB0840, do të ndiqet procedura përkatëse e nxjerrjes nga përdorimi, në përputhje me aktet ligjore në fuqi në periudhën ne vijim.

Statusi: *Zbatuar*

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)" për llogarinë 218 "Inventar ekonomik" është përllogaritur normë amortizimi i akumuluar deri më datë 31.12.2024, në vlerën 25,787,766 lekë (kosto historike) ose në masën 20%. Ndërkohë që nuk ka një ndarje të llogarisë 218/6 "Pajisje kompjuterike" nga aktivet e llogarisë bazë 218 "Inventar ekonomik" e cila ka normë amortizimi të aplikueshme në masën 25%. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, pika 36. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 27-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1. Rekomandimi: Bashkia Korçë, Drejtoria e Financës Buxhetit, Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të marrë masat për të klasifikuar veçmas llogarinë 218/6 *"Pajisjet kompjuterike"* brenda llogarisë 218 *"Inventar ekonomik"* në regjistrin e aseteve të njësive dhe në pasqyrat financiare, konform kërkesave të nomenklaturës së llogarive, duke aplikuar amortizimin sipas normës përkatëse për çdo aktiv.

Nga verifikimi i dokumentacionit, rezultoi se: Nga auditimi i pasqyrave financiare (të konsoliduar) viti 2025, rezultoi se llogaria 218 është përshkruar në formatin e shënimeve shpjeguese për çdo njësi të varësisë, si dhe në bilancin e konsoliduar me vlerat totale të:

- llogarisë 2186100 "*pajisje kompjuterike*" dhe vlerën e amortizimit të aplikuar në masën 25%
- llogarisë 218 "*inventar ekonomik*" dhe vlerën e amortizimit në masën 20%.
- Në regjistrin e aktiveve është pasqyruar në mënyrë analitikë norma e amortizimit për secilin aktiv.

Statusi: *Zbatuar*

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, në gjendjen e llogarive 202 *"Studime dhe kërkime"* në vlerën 57,852,130 lekë kosto historike është përfshirë vlera 1,166,300 lekë; 212 *"Ndërtesa e konstruksione"* në vlerën 4,348,849,060 lekë kosto historike, është përfshirë vlera 414,379,276 lekë; 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"* në vlerën 4,544,741,034 lekë kosto historike është përfshirë vlera 767,685,964 lekë dhe 215 *"Mjete transporti"* në vlerën 219,912,236 lekë kosto historike është përfshirë vlera 8,833,400 lekë, të cilat janë të paanalizuara si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Këto vlera janë të trashëguara nga bilanci i ish-komunave Korçë të paanalizuar dhe ndikojnë në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, dhe Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 08, datë 09.03.2018, *"Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme"*, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 27-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1. Rekomandimi: Bashkia Korçë, Drejtoria e Financës Buxhetit, Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Nga verifikimi i dokumentacionit, rezultoi se: Nga auditimi i pasqyrave financiare (të konsoliduar) viti 2025, rezultoi se Drejtoria e Financës Buxhetit dhe MFK po vazhdon punën për detajimin e dokumentacionit financiar dhe ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar dhe analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare dhe në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet dhe në inventarin fizik.

Statusi: *Në proces zbatimi. Nga grupi nuk do kërkohet, pasi do kërkohet në auditimin e radhës*.

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 26 *"Pjesëmarrje në kapitalet e veta"*, u konstatua se kjo llogari është nënvlerësuar në vlerën 722,601,823 lekë. Vlera e aksioneve të *"Tregu i shitjes me shumicë fruta e perime"* Sh.A është 275,000,000 lekë për të cilën Bashkia Korçë është 100% Aksionare. Vlera e aksioneve të *"Korça"* Sh.A është për të cilën Bashkia Korçë është 100% Aksionare. Vlera e aksioneve të *"Qendra Sportive Korçë"* 407,129,000 lekë Sh.A është 36,110,000 lekë për të cilën Bashkia Korçë është 100% Aksionare. Vlera e aksioneve të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë me është 10,000,000 lekë sipas Marrëveshjes për krijimin e SHRUKK me nr. 5767 Prot., datë 28.09.2022, është 2,829,300 lekë ose në masën 28.29%. Vlera e aksioneve të *"KRËM"* Sh.A është 3,740,300 lekë për të cilën Bashkia Korçë është Aksionare në masën 41% ose në vlerën 1,533,523 lekë. Ndërkohë që llogaria 26 *"Pjesëmarrje në kapitalet e veta"* më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 0 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, pika 31. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 27-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Korçë, Drejtoria e Financës Buxhetit, Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të merren masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 *"Pjesëmarrje në kapitalet e veta"* dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrje në kapitalin e vet.

Nga verifikimi i dokumentacionit, rezultoi se: Nga auditimi i pasqyrave financiare (të konsoliduar) viti 2025, rezultoi se është pasqyruar vlera e aksioneve që i përket pjesëmarrjes së Bashkisë në shoqëri tregtare dhe publike duke kryer veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 *"Pjesëmarrje në kapitalet e veta"* dhe kredi të llogarisë 101 "*Fonde të veta*" për vlerën 722,590,907 lek.

Statusi: *Zbatuar*

11. Gjetje nga auditimi: Llogaria 231 *"Për aktivet afatgjata materiale"* më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 170,137,677 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 114,087,086 lekë dhe pakësime në vlerën 111,951,288 lekë, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 168,001,879 lekë. Nga testimi i kontratave të investimeve konstatohet se, për vitin 2024 është një kontratë që ende nuk kanë përfunduar punimet për të cilën është lëshuar Situacioni i Punimeve nr. 1, në vlerën 18,419,712 lekë sipas faturës tatimore nr. 1055, datë 08.11.2024, për të cilën është kryer likuidimi në vlerën totale pre 15,419,712 lekë, sipas Urdhër Shpenzimeve nr. 435, datë 05.12.2024, në vlerën 5,419,712 lekë, nr. 470, datë 24.12.2024, në vlerën 5,000,000 lekë dhe nr. 473 Prot., datë 27.12.2024, në vlerën 5,000,000 lekë që i përket kontratës së punimeve me nr. 699 Prot., datë 22.08.2024, me objekt *"Meremetimi i institucioneve*

arsimore", me vlerë kontrate 28,397,436 lekë me TVSh dhe me afat 10 muaj nga nënshkrimi i kontratës, e cila nuk është kontabilizuar në gjendjen e kësaj llogarie. Sipas informacionit kontabël llogaria 231 *"Për aktivet afatgjata materiale"* është nënvlerësuar në vlerën 15,419,712 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, Aneksi 1, Klasa 23. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 27-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Korçë, Drejtoria e Financës Buxhetit, Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të merren masa për kontabilizimin e vlerës 15,419,712 lekë në llogarinë 231 *"Për aktive afatgjata materiale"* që i përket likuidimeve të situacioneve pjesore të kontratave të investimeve të cilat janë në proces zbatimi punimesh.

Nga verifikimi i dokumentacionit, rezultoi se: Nga auditimi i pasqyrave financiare (të konsoliduar) viti 2025, rezultoi se në pasqyrat financiare të NSHMAC-së, rrjedhimisht edhe në pasqyrat financiare të konsoliduar të vitit 2025 është kryer sistemimi i vlerës 15,419,712 lekë në llogarinë 231 "investime për aktive afatgjata materiale".

Statusi: *Zbatuar*

12. Gjetje nga auditimi: Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, llogaria 230 *"Investime për aktive afatgjata jo materiale"* paraqiten në vlerën 0 lekë dhe llogaria 231 *"Investime për aktive afatgjata materiale"* në vlerën 168,001,879 lekë ku totali i tyre shkon në vlerë 168,001,879 lekë, nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 *"Nga fondet e veta të investimeve"* e cila paraqitet në vlerën 17,164,315 lekë dhe llogarinë 105 *"Teprica e grandeve kapitale të brendshme"* në vlerën 127,694,438 lekë, me një diferencë në vlerën 23,143,126 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, Aneksi 1, gërma *"c". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 27-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1. Rekomandimi: Bashkia Korçë, Drejtoria e Financës Buxhetit, Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në bashkëpunim me NShMAC-në të evidentojë pagesat pjesore për krijimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, në llogaritë 230 - 231 *"Investime në proces"* me kundërparti llogaritë 105 *"Teprica e grandeve kapitale të brendshme"*, 115 *"Nga fondet e veta të investimeve"* dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t'i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivit të kapitalizuar dhe në llogarinë 101 *"Fondi Bazë"*.

Nga verifikimi i dokumentacionit, rezultoi se: Nga auditimi i pasqyrave financiare (të konsoliduar) viti 2025, rezultoi se janë paraqitur me vërtetësi vlerat e llogarisë 231 "I*nvestime për aktive afatgjata materiale*" me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë, kjo në zbatim të Udhëzimit të MFE nr. 8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar.

Statusi: *Zbatuar*

13. Gjetje nga auditimi: Çelja e llogarisë 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar"* më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 11,640,591,748 lekë. Llogaria 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar"* kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b *"Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)"* në vlerën 1,707,011,296 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 58,582,426 lekë sipas llogarisë 63 *"Ndryshimi i gjendjes së inventarit"*. Llogaria 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar"* debitohet për pakësimit e vitit në vlerën 1,580,107,864 lekë dhe amortizimin e vitit ushtrimor 2024 në vlerën 944,236,273 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b *"Gjendja dhe*

ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)". Sipas informacionit kontabël llogaria 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar"* është nënvlerësuar në vlerën 390,414,015 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, pika 17. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 27-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1. Rekomandimi: Bashkia Korçë, Drejtoria e Financës Buxhetit, Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në bashkëpunim me NShMAC, QDZh, SHFLV, QRZh, NShP, QAK, KSh të merren masa që në pasqyrat financiare të vitit 2025 të kryej kontabilizimin e saktë të llogarisë 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/deficiti i akumuluar"* me qëllim dhënien e informacionit kontabël.

Nga verifikimi i dokumentacionit, rezultoi se: Ky rekomandim është observuar nga bashkia Korçë me shkresën nr.10576/12, dt.15.01.2026 dhe është marrë në konsideratë nga grupi i auditimit i KLSh-së, duke e pasqyruar në Raportin Përfundimtar të KLSH-së nr.974/8, dt.17.02.2026, faqe 73-74.

Statusi: *Zbatuar*

Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuara nga ana e Bashkisë Korçë

Masat	Rekomanduar	Rek. Të Zbatuara	Në Proces Zbatimi	Rek. Të Pa Zbatuara	Shprehur ne vlere në 000/lekë		
					Vl. Rekomandim	Vl. Arkëtuar	Vl. Mbetur
Masa Organizative	**13**	10	3				
Masa Për Shpërblim Dëmi							
Masa mungesë të ardhurash							
Masa 3-E							
Masa Disiplinore							
Masa Administrative							
Kompetence e IMTV							
Totali leke	**13**	**10**	**3**				

Konstatimi: Në përfundim të procesit të auditimit për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, paraqitur me shkresën nr. 974/8, dt.17.02.2026, miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH nr. 26 Prot., datë 13.02.2026 (*Prot bashkia Korçë me nr. 1576/13, dt. 19.02.2026*), ka rezultuar se nga 13 masa organizative, të pranuara plotësisht nga subjekti janë zbatuar 10 masa dhe 3 masa janë në proces zbatimi.

(Në fazën e Projekt raport auditimit, nga subjekti Bashkia Korçë për këtë pikë nuk u paraqitën observacione)

II- Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimet e mëparshme, dërguar me shkresën nr.1348/16 Prot, datë 13.10.2025, miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH me nr. 180, datë 09.10.2025, me qëllim vlerësimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të lëna: statusin e zbatimit të rekomandimeve, afateve dhe niveli i zbatueshmërisë së tyre, koherencën e tyre dhe përgjegjshmërinë menaxheriale referuar standardeve të auditimit.

a. Mbi hartimin dhe miratimin e "Planit të veprimit"

Me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 1230, datë 27.10.2025 është miratuar plani i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën me nr. 1348/16 Prot, datë 13.10.2025, në të cilën janë përcaktuar afatet dhe personat përgjegjës që do merren me zbatimin e tyre, ku janë ngarkuar Drejtoria e Financës; Sektori i prokurimeve publike; Drejtoria e PZHKT; Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore, Drejtoria Juridike, Drejtoria e Auditit, IMT.

b. Mbi raportimin në KLSH brenda afatit 20 ditor:
Bashkia Korçë me shkresën nr.10636/73 Prot, datë 03.11.2025 ka dërguar në KLSH planin e verimeve mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH sipa shkresës me nr. 1348/16 Prot, datë 13.10.2025, *brenda afatit 20 ditor*, gjë që ka ndikuar edhe në angazhimin në afat të strukturave ngarkuar me përgjegjësi, në marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna, kjo në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit ".

c. Mbi raportimin në KLSH brenda afatit 6 mujor:
Në zbatim të nenit 30 të ligjit nr.154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Bashkia Korçë me shkresën nr. 10636/74 Prot,. datë 10.04.2026 ka dërguar në KLSH raportimin për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga KLSH në auditimin financiar dhe përputhshmërisë për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2024, duke përmbushur detyrimin ligjor e subjektit të audituar për raportim brenda 6 muajve nga data e Raportit Përfundimtar.

Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:
a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar *37 masa organizative* (me vlerë 77,048 mijë lekë). Janë zbatuar 16 masa (me vlerë 250 mijë lekë), janë në proces zbatimi 8 masa dhe nuk janë zbatuar 13 masa (me vlerë 76,800 mijë lekë);
b. *Për masa shpërblim dëmi***,** janë rekomanduar 15 masa me vlerë 5,198 mijë lekë. Janë zbatuar 13 masa me vlerë 4,683 mijë lekë, janë në proces zbatimi 2 masa me vlerë 515 mijë lekë;
c. *Për masa 3-E dhe mungesë të ardhurash***,** janë rekomanduar gjithsej 5 masa me vlerë 712,653 mijë lekë, të cilat janë pranuar nga subjekti. Nga të pranuarat është zbatuar 1 (një) masë me vlerë 22,341 mijë lekë dhe në proces zbatimi 4 masa me vlerë 690,312 mijë lekë.

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve paraqitet si vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE
1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se disa koncepte që lidhen me komponentët e MFK-së vazhdojnë të mos kuptohen dhe të mos zbatohen në përputhje me kërkesat ligjore si: *Mjedisi i kontrollit"* Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime në moszbatim të Ligjit nr. 139/2015 "P*ër Vetëqeverisjen Vendore*", neni 64, pika h, Ligjit nr. 10296 /2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar dhe "*Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", Kapitulli III, pika 3.1. *"Menaxhimi i Riskut"* Nga auditimi, rezultoi se gjurmët standarde të auditimit nuk janë hartuar dhe miratuar nga titullari i njësisë, si një dokument i unifikuar për të gjitha proceset e Bashkisë Korçë, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, neni 16, pika 2; kapitulli V; UMF nr. 30 datë 27.12.2011, "*Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik*", i ndryshuar, nenet 121 dhe122;
-Bashkia Korçë nuk ka hartuar listën (hartën)/manualin e proceseve të punës, në moszbatim të Ligjit nr. 10296 /2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" dhe "*Manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit*", Kapitulli III, pika 3.3; *"Aktivitetet e Kontrollit"* Nga Bashkia Korçë nuk është hartuar/miratuar një Plan i Kontrollit të Brendshëm periodik apo vjetor, kjo në moszbatim të nenit 22, pika 1 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", "Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin". *"Informimi dhe komunikimi"* -Komunikimi i brendshëm. Punonjësit nuk njihen sa duhet me sistemin e komunikimit të brendshëm dhe të kuptojnë rolin e tyre, detyrimet dhe përgjegjësitë që çdonjëri ka në këtë sistem. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar. Manuali i MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108,

datë 17.11.2016. Kapitulli III. pika 3.4. *"Monitorimi"* - Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar neni 24. Manuali i MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Korçë, si dhe drejtorët e drejtorive dhe përgjegjësit e sektorëve, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza, kontrolli dhe përditësimi 2 herë në vit i risqeve që mund të kenë efekt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

Drejtori i Burimeve Njerëzore të marrë masa për:

-Kryerjen e ndryshimeve të nevojshme në rregulloren e brendshme të institucionit me qëllim përcaktimin e qartë të detyrave për çdo pozicion pune, si dhe hartimin e dokumentit "Harta e proceseve të punës".

-Hartimin dhe zbatimin e programit të trajnimit të stafit të bashkisë, me qëllim zhvillimin profesional të tyre.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Bashkia Korçë ka përgatitur strategjinë e vlerësimit dhe parandalimit të riskut, në përputhje me kërkesat e MFK, duke angazhuar strukturat përgjegjëse në identifikimin e risqeve dhe evidentimin e sektorëve me risk të lartë me nr. Prot, 70 datë 25.1.2024. Duke filluar që nga viti 2024 identifikimi, analiza, kontrolli dhe përditësimi i risqeve u hartua 2 herë në vit.

Statusi: *Zbatuar*

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Njësia e Auditimit të Brendshëm në planet vjetore të auditimit nuk ka programuar auditimin e fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë duke mos dhënë mbështetjen e duhur Titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 5 dhe 6 të Ligjit nr. 114/2015 "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*".

-Në dosjet koherente të NJAB për auditimet e realizuara për periudhën objekt auditimi nuk janë të plotësuara në përputhje me tërësinë e kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli VI.

-Nga auditimi rezultoi se struktura e NJAB Bashkia Korçë nuk është e plotësuar me numrin maksimal të punonjësve sipas urdhrit nr.26 të Kryetarit. Konkretisht një prej pozicioneve si specialist auditi rezultoi vakant. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1.1, faqe 24-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Korçë, të marrë masa për plotësimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm me numrin e nevojshëm të audituesve të certifikuar, për të përmbushur misionin e saj në arritjen e objektivave.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Nga ana e Bashkisë Korçë, bazuar në strukturën e miratuar për vitin 2026, do të shqyrtohet mundësia për plotësimin e strukturës së Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm me punonjës të certifikuar, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. Gjithashtu një nga punonjësët aktuale ka filluar në muajin qershor 2026 procesin e certifikimit, në DHAB në Ministrinë e Financave.

Statusi: *Pa zbatuar*

2.2. Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Korçë, të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditime në fushat e veprimtarisë së institucionit që paraqesin risk të lart, si: Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, administrimi i taksave dhe tarifave vendore, zbatimin e rekomandimeve etj, në mënyrë që t'i ofrojë mbështetje titullarit të njësisë vendore në arritjen e objektivave institucional.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Në planin vjetor për vitin 2026 të miratuar nga kryetari i bashkisë me Urdhrin nr. 1168, dt.15.10.2025, Protokolluar me nr.10706 Prot, dt.15.10.2025, duke marre parasysh rekomandimin e KLSH, janë planifikuar për auditim fusha e prokurimeve, zbatimi i rekomandimeve për auditimet e kryera ne vitin 2024, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore.

Statusi: *Zbatuar, referuar programit të auditime viti 2026*

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit tekniko-ligjor të kontratave të shërbimit në 3 (tre) raste, përkatësisht:

- "Kryerja e shërbimit të pastrimit në qytetin e Korçës" me nr. 3582/2 Prot, datë 12.06.2018, të lidhur mes AK Bashkisë Korçë, përfaqësuar nga Kryetari S.F. dhe sipërmarrësit të shërbimeve shoqërisë K. SHPK, e përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor M.F. me vlerë 398,088,920 lekë me TVSH me afat zbatim 5 vjeçare,
- "Kryerja e shërbimit të pastrimit në qytetin e Korçës (emergjencës)" me nr. 4746/2 Prot, datë 21.06.2023, të lidhur mes AK Bashkisë Korçë, përfaqësuar nga Kryetari S.F. dhe sipërmarrësit të shërbimeve shoqërisë K. SHPK, e përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor M.P., me vlerë 37,204,871 lekë me TVSH me afat zbatim tre muaj,
- "Kryerja e shërbimit të pastrimit në qytetin e Korçës" me nr. 5474/2 Prot, datë 01.08.2023, të lidhur mes AK Bashkisë Korçë, përfaqësuar nga Kryetari S.F. dhe sipërmarrësit të shërbimeve shoqërisë K. SHPK, e përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor M.P., me vlerë 458,937,291 lekë me TVSH me afat zbatim 3 vjeçare, mbi veprimtarinë për periudhën e auditimit 2023-2024, u konstatuan problematikat si vijon:

1. Mbikëqyrësi i zbatimit të kontratës së shërbimit të pastrimit, nuk ka vepruar në zbatim të "Specifikimeve Teknike dhe Metodologjisë", *pasi mungojnë grafikët e punimeve të cilët duhet të zbatohen rigorozisht nga shoqëria e realizimit të shërbimit*. Në zbatimi të Specifikimeve Teknik, shoqëria e shërbimit nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.
2. Edhe pse janë hartuar planet mujore të punës dhe janë miratuar nga Kryetari i Bashkisë, *nuk janë shoqëruar me grafikët e shërbimit për secilën zë punimi/shërbimi*.

Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit duhet të përgatiten nga shoqëria e sipërmarrjes së shërbimeve dhe miratohet çdo muaj dhe çdo vit nga AK.

Nuk është përcaktuar numri i punëtorëve që do të punojë në çdo operacion punimesh sipas planit të punës si dhe nuk janë përcaktuar makineritë që do të punojë në çdo operacion punimesh.

3. Nuk është *paraqitur listëprezenca për çdo ditë pune* nga shoqëria e shërbimit të kontratës që detyrimisht duhet të ketë çdo ditë/natë në punë, minimalisht numrin e punëtorëve dhe pajisjeve sipas numrit të deklaruar në ofertën e prokurimit për të garantuar kryerjen në kohë dhe me cilësi të shërbimit.
4. *Nuk janë mbajtur procesverbale apo akte të tjera* nga mbikëqyrësi i punimeve që të pasqyrojë inspektimin e realizimit të shërbimit në çdo kohë apo në përfundim të kryerjes së shërbimeve të kontratës, respektimin e standardeve, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kontratat e sipërcituara, si dhe për të vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa për mospërmbushjen e tyre.

-Sa më sipër trajtuar, nga komisioni/supervizori për monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kushteve të kontratave të shërbimit publik për kontratat e mësipërme, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në: Dokumentet e Tenderit; Specifikimet Teknike; Urdhrat e

Kryetarit të Bashkisë Korçë, përkatësisht: nr. 12, datë 02.03.2017, nr. 566, datë 31.05.2023, nr. 566, datë 31.05.2023, nr. 566, datë 31.05.2023 si dhe, KPK dhe KVK të kontratave të sipërcituara. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 88-279, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Grupi/supervizori i monitorimit dhe mbikëqyrjes së kushteve të kontratës së shërbimit me objekt: "*Kryerja e shërbimit të pastrimit në qytetin e Korçës*", të marrë masa që në vazhdimësi t'i kërkojë sipërmarrësit të shërbimeve K. SHPK, të plotësojë dokumentet për:

- Hartimin e grafikëve të shërbimeve të cilat, të miratohen nga titullari i AK Bashkia Korçë. Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit duhet të përgatiten nga shoqëria e sipërmarrjes së shërbimeve dhe miratohet çdo muaj dhe çdo vit nga AK.
-Përcaktimit e numrit të punëtorëve që do të punojë në çdo operacion punimesh sipas planit të punës si dhe të deklarojë makineritë që do të punojë në çdo operacion punimesh.
- Hartimin e listë prezencës për çdo ditë pune nga shoqëria e shërbimit të kontratës që detyrimisht duhet të ketë çdo ditë/natë në punë, minimalisht numrin e punëtorëve dhe pajisjeve sipas numrit të deklaruar në ofertën e prokurimit për të garantuar kryerjen në kohë dhe me cilësi të shërbimit të pastrimit.
- Shtimin e kontrolleve dhe mbajtjen e procesverbaleve nga supervizori i punimeve për pasqyrimin e saktë të realizimit të zërave të shërbimeve në zbatim të kushteve të kontratës për pastrimin e Bashkisë Korçë.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Grafikët për heqjen e mbetjeve në zonat urbane apo zonat rurale kryhen në mënyrë sistematike dhe përgatiten çdo fillim muaji sipas kontratës së lidhur me shoqërinë K....

Në lidhje me pikën e dytë me përcaktimin e numrit të punonjësve dhe listprezencës, nga subjekti sipas dokumenteve kryhen në mënyrë periodike, çdo fillim muaji dhe në rast se ka lëvizje të numri të punonjësve ose ndryshime bëhet ndryshimi në list-organikën e punonjësve dhe shoqëria K... na risjell listën organike me ndryshimet e kryera.

Në lidhje me pikën e tretë, ku kërkohet deklarimi i makinerive që punojnë në momentin e shërbimit, sipas dokumentacionit, nga subjekti kryhet monitorim i përditshëm dhe nuk ka pasur problematika për grumbullimin e mbetjeve në zonat urbane dhe rurale sipas grafikëve të përcaktuar.

Për sa i përket pikës 4 e cila ka lidhje me shtimin e kontrolleve Procesverbalet janë ditore dhe mbahen nga mbikëqyrësi të cilat pasqyrohen në relacionin e përditshëm mujor.

Statusi: *Në proces zbatimi, dhe lihet për verifikim në auditimin e përputhshmërisë*

4. Gjetje nga auditimi: **N**ga auditimi i procedurave të prokurimit publik dhe zbatimit të kontratave për punë publike, në 3 (tre) raste u konstatua se, nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Korçë, nuk është kryer oponenca teknike për projektet e zbatimit me objekte:

- "Ndërtim Lere Plasmasi "Sheshi i Rungajes", "Deko", "Sheqe" dhe "Pandelimoni", Ekonomia Kullosore Rungajë" Korçë",
- "Sistemimi i Përrenjve brenda territorit të Bashkisë Korçë",
- "Shpenzime për mirëmbajtjen me asfalt të rrugëve në Njësitë Adm, Bashkia Korçë",

Për sa më sipër, është në mospërputhje me Ligjin nr. 120/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", neni 6 si dhe, VKM nr. 610, datë 22.9.2022 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të Përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe Mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të Punimeve", neni 41, pika 1, germa (c), si dhe Vendimin nr. 9, datë 11.01.2024 "Për miratimin e rregullave për projektet që duhet t'i nënshtrohen oponencës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 88-279, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Bashkia Korçë të marrë masa që të pajisë me ***Oponencë Teknike*** çdo projekt zbatimi, për të siguruar hartimin e projekteve të zbatimit me cilësi, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Nga të dhënat e marra nga Drejtoria e PZHKT Bashkia Korçë, në lidhje me investimet publike, pas testeve të kryera rezultoi se po vijohej me miratimin e oponencave teknike, kjo për të gjitha llojet e investimeve, por në veçanti objektet publike.

Statusi: *Zbatuar*

5. Gjetje nga auditimi. Në Bashkinë Korçë, gjatë vitit 2023 janë zhvilluar gjithsej 52 procedura prokurimi me vlerë të lartë, nga të cilat u audituan gjithsej 22 procedura, me fond limit 742,241,173 lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate 682,834,057 lekë pa TVSH.
Gjatë vitit 2024 janë zhvilluar gjithsej 49 procedura prokurimi me vlerë të lartë, nga të cilat u audituan gjithsej 14 procedura, me fond limit 334,651,447 lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate 268,177,295 lekë pa TVSH. Nga auditimi u konstatuan parregullsi në hartimin e fondit limit, përzgjedhjen e procedurës së auditimit, kritere jo në përputhje me volumin dhe natyrën e objektit që prokurohet dhe se OE të shpallur fitues nuk plotësojnë kriteret e DT, të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, si më poshtë:
- Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik;
- Në 19 procedura nga 36 procedura të audituara, me vlerë kontrate 355,606,763 lekë pa TVSH, u konstatuan parregullsi në hartimin e fondit limit, përzgjedhjen e procedurës së prokurimit, mosrespektimin e metodave të përcaktuara për hartimin e fondit limit, projekt-preventivat e punimeve janë hartuar nga punonjës të cilët nuk janë të pajisur me licencat përkatëse profesionale në fushën e projektimit, mungesa e personelit të kualifikuar/ specialistë të fushës apo caktimi i vetëm një personi për hartimin e fondit limit, në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, neni 34, neni 12, neni 74, pikat 2 dhe 4, neni 76; Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998, "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, neni 5;
- Në 24 procedura nga 36 procedura të audituara, me vlerë kontrate 951,011,349 lekë pa TVSH, u konstatua se janë aplikuar kritere të paargumentuara dhe specifikime teknike të pa argumentuara, jo në lidhje të ngushtë me tipologjinë e procedurës që zhvillohet. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 1, neni 2, pikat 1 dhe 2 në nenin 3, neni 21, neni 39, neni 40, pika 3 në nenin 41, neni 77, pikat 1, 2 dhe 5 në nenin 82, pika 1 në nenin 87 dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar, pikat 1 dhe 6 në nenin 26, neni 36, pika 5 në nenin 39, pika 4 në nenin 78 etj.;
- Në 20 procedura nga 36 procedura të audituara, me vlerë kontrate 661,654,835 lekë pa TVSH, u konstatua se, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kritereve të DT të miratuara nga AK Bashkia Korçë, pasi në dokumentacionin e paraqitur prej tyre u konstatuan mangësi dhe mosplotësimin e kritereve të vendosura në DT.
Duke shpallur fitues OE/BOE të cilët nuk i plotësojnë të gjitha kriteret e vendosura në DT. KVO ka vepruar në mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*" i ndryshuar dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.
-Në lidhje me procedurat "blerje me vlerë të vogël nga grupi i auditimit të KLSH-së u konstatua se:
- Në 1 rast procesverbali i mbajtur nga KVO mbi arsyet e s'kualifikimit të OE të mbajtur nga KVO nuk përputhet me arsyet e vërteta të s'kualifikimit, trajtuar më gjerësisht në materialin e auditimit.

- Në 1 rast hartimi i specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta të pranimit", nuk janë vendosur kriteret teknike që lidhen me kërkesat e veçanta.
- Në 1 rast kemi mosplanifikim të saktë të përllogaritjes së fondit limit, trajtuar më gjerësisht në materialin e auditimit.
- Në 4 raste është shpallur fitues OE në mospërputhje me plotësimin e të gjitha kritereve të kërkuara nga AK. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 2, pika 2 në nenin 3, me nenin 25, me pikat 4, 5 dhe 6 të nenit 39, pikën 3 në nenin 74 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 88-279, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Korçë, të marrë të gjithë masat që nga komisionet e ngritura për dokumentet e tenderit të argumentohet vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim dhe se këto kritere të jenë në përpjesëtim dhe të lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

-Kryetari i Bashkisë Korçë, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, të vlerësohen objektivisht kriteret e DT të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE që nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DT, përbën shkelje të procedurave të prokurimit publik dhe risk real për mosrealizimin me sukses të kontratës.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Ky rekomandim do lihet për verifikim në auditimin e radhës, kur të auditohet përputhshmëria, për të parë nëse është zbatuar ose jo në lidhje me kriteret kualifikuese.

Statusi: *Pa zbatuar*

5.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Korçë, të marrë masa në të ardhmen që në komisionet e ngritura për hartimin e fondit limit të vendosen specialistë të fushës të pajisur me licencat përkatëse, duke përdorur eksperiencat më të mira të fushës, me qëllim mirëpërdorimin e fondeve publike.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Ky rekomandim do lihet për verifikim në auditimin e radhës, kur të auditohet përputhshmëria, për të parë nëse është zbatuar ose jo në lidhje me kriteret kualifikuese.

Statusi: *Pa zbatuar*

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i programimit, realizimit dhe përformancës së buxhetit për vitet 2023-2024 *u konstatua se*:

Planifikimi i të ardhurave në disa zëra të ardhurash nuk është mbi baza reale dhe realizimi i viteve të mëparshme nuk është marrë në konsideratë, pasi planifikimi të ardhurave për vitet 2023 dhe 2024 nuk ka asnjë bazë krahasimi me dy vitet e mëparshme 2021 dhe 2022, sepse është rreth 42 % më i lartë. Gjithashtu edhe realizimi i të ardhurave është në nivel jo të kënaqshëm në të njëjtën masë prej 61% për të dy vitet 2023 dhe 2024, duke mos arritur objektivat e përcaktuara në planifikimet vjetore.

Nga kryqëzimi i treguesve të realizimit në fakt të ardhurave sipas raportit të konsolidimit financiar dhe akt-rakordimit final me Degën e Thesarit, duke zbritur të ardhurat që nuk i takojnë taksave dhe tarifave vendore që menaxhohen nga DTTV rezultoi që, për vitin 2023 janë raportuar më shumë të ardhura në vlerën 7,489,201 lekë në raportin e konsoliduar financiar se në akt-rakordimin me Thesarin, ku ky dokument i fundit është i plotë dhe i saktë.

-Detyrimet të papaguara në fund të vitit 2023 paraqiten në shumën 61,092,093 lekë, e cila përbëhet nga vlera e mbetur për shlyerje e kredive të marra në 2 banka nga Bashkia në shumën prej 53,611,220 lekë, që i takojnë transheve pas vitit 2023, nga vlera e pa likuiduar prej 7,342,020 lekë,

detyrim i mbetur nga MIE (pagesa e TVSH) për objektin: "Shfrytëzimi Inteligjent i Energjisë" dhe vlera prej 138,853 lekë, është detyrim i Shtëpisë së Foshnjës, të cilat kanë mbetur pa u shlyer për mungesë dokumentacioni dhe mbyllje aktiviteti.

Për vitin 2024 detyrimet e prapambetura paraqiten në shumën 27,127,744 lekë, që përbëhet nga vlera e mbetur prej 12,223,659 lekë për shlyerjen e kredisë bankës CEB, nga vlera prej 10,571,376 lekë e 3 faturave detyrim i mbetur nga MIE (pagesa e TVSH) për objektin: "Shfrytëzimi Inteligjent i Energjisë" dhe nga vlera prej 4,332,709 lekë e 2 faturave për mbetjet e përziera të financuar nga të fondet e Bashkisë. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 9, pika 1.3, germa (ç), me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.4.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, nenet 2/3, 5/a, c, 34/1, 3, 40, 42, 44, 51, me Udhëzimin e MFE nr. 09, datë 20.07.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, pikat 48/b, 101,106,130, 198, 266, me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", i ndryshuar, me Udhëzimin nr. 8, datë 28.02.2022 "Për Përgatitjen e PBA Vendor 2023-2025" Shtojca 2, pika 3/1 dhe Udhëzimit plotësues të MF nr. 21, datë 07.07.2023 "Për përgatitjen e PBA 2024-2026". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, në faqet 27-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Korçë, nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe në bashkëpunim me Menaxherët e Programeve, të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit me qëllim që, programimet e të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore të vitit ushtrimor të jenë të argumentuara, duke mbajtur në konsideratë realizimet e viteve të mëparshme dhe prioritet të kenë detyrimet e papaguara për shlyerjen në kohë të tyre. Raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit duhet të jetë i saktë dhe të bazohet në aktrakordimet me Thesarin, raportet e monitorimit vjetor të buxhetit dhe PF, si dhe të jetë i krahasueshëm me planin e buxhetit të vitit ushtrimor.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Menaxherët e Programeve, ka marrë në konsideratë këtë rekomandim dhe ka filluar zbatimi i tij në hartimin e buxhetit të vitit 2026.

Statusi: *Zbatuar*

7. Gjetje nga auditimi: Taksa mbi tokën bujqësore **për vitin 2023** është planifikuar 65,886 mijë lekë dhe është realizuar në masën 34% kundrejt planifikimit ose në vlerën 22,155 mijë lekë. **Për vitin 2024** taksa e tokës është realizuar në shumën 26,432 mijë lekë nga 57,863 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 46%. Referuar të dhënave për fondin e tokës, ndarjen dhe kategorizimin e saj sipas NJA të vëna në dispozicion nga Sektori i Bujqësisë dhe nga Sektori i mbledhjes dhe kontrollit të të ardhurave për NJA, u kryen përllogaritje bazuar edhe në paketat fiskale, nga ku rezultoi se planifikimi i të ardhurave nga taksa e tokës është në vlerën 24,681 mijë lekë, ndërkohë që në fakt planifikimi si për vitin 2023 dhe për vitin 2024 është në vlera të dyfishuara e më shumë, duke e rritur planifikimin e të ardhurave nga taksa e tokës në mënyrë jo të saktë dhe të pa argumentuar, pasi është marrë në përllogaritje i gjithë fondi i tokës i ndarë dhe i pa ndarë dhe vlerësuar jo sipas kategorisë dhe tarifave përkatëse, por me tarifën më të lartë të kategorisë III të tokës. Duke qenë se, planifikimi i të ardhurave nga taksa e tokës është larg vlerave reale, ka sjellë diferenca të mëdha si me faturimin dhe me realizimin e taksës së tokës. Gjithashtu në fund të vitit 2023 rezultoi se vlera debitore për taksën e tokës bujqësore është në shumën 83,635 mijë lekë dhe në fund të vitit 2024 në shumën 99,057 mijë lekë, e cila në krahasim me vitin 2024 është rritur me 15,421 mijë lekë. Nga Sektori i Bujqësisë së Bashkisë Korçë dhe nga Sektori i Mbledhjes dhe Kontrollit të të Ardhurave për Njësitë Administrative nuk janë marrë veprimet e mjaftueshme për përditësimin e të dhënave, si dhe për rritjen e arkëtimeve në NJA për uljen e borxhit për taksën e tokës. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"* i ndryshuar, nenet 6 dhe 9 pika 1.3. dhe me Rregulloren e Bashkisë Korçë

të miratuar Urdhër nr. 142, datë 01.03.2021, pika 59.2.1 dhe 59. 2 dhe 11. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, në faqet 27-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nëpërmjet Sektorit të Mbledhjes dhe Kontrollit të të Ardhurave për NJA të marrë masa që, në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë të saktësojë të dhënat për planifikim real e të argumentuar të të ardhurave nga taksa e tokës, të përditësojë të dhënat mbi regjistrin e taksapaguesve fermerë, si dhe të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve debitore për taksën e tokës bujqësore.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Drejtoria e Taksave dhe tarifave Vendore i ka kërkuar me shkresën nr. 1148 Prot, datë 04.02.2025 Sektorit të Bujqësisë që në zbatim të detyrave funksionale të tij të përditësojë periodikisht informacionin në lidhje me fondin e tokës bujqësore. Me shkresën nr. 7118 Prot, datë 21.07.2025 Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore i ka rikërkuar Sektorit të Bujqësisë të përditësojë të dhënat.

Statusi: *Në proces zbatimi*

8. Gjetje nga auditimi: Teprica e *llogarisë 4342 "Të tjera operacione me shtetin (të drejta)"* në aktiv të pasqyrës së pozicionit financiar paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në shumën 20,789,952 lekë, e cila përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për mbulimin me fonde në vitin pasardhës të shpenzimeve të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore por ende të papaguara, ku sipas analizës janë përfshirë gjendjet e llogarive në pasivin e bilancit: llog.42 "Detyrime ndaj personelit" për vlerën 14,624,880 lekë, llogaria 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa" për vlerën 1,086,930 lekë, llogaria 435 "Sigurime shoqërore" për vlerën 4,472,441 lekë, llogaria 436 "Sigurime shëndetësore" për vlerën 605,701 lekë, duke përjashtuar detyrimet ndaj të tretëve për fatura të palikujduara të klasës 4 të gjendjeve të llog.401-404 "Furnitorë dhe llogari të lidhura me to" në vlerën 87,693,013 lekë dhe llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm" në vlerën 8,680,193 lekë. Vlera prej 184,065,219 lekë e detyrimeve për fatura të palikujduara nuk është kontabilizuar as në llogarinë kundërparti 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme" në aktiv të pasqyrës së pozicionit financiar. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022, pika 3.2, faqe 30, 32. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, në faqet 65-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Buxhetit, Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Bashkinë Korçë në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit ushtrimor të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuara.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Gjatë përpilimit të pasqyrave financiare të vitit 2024 në llogarinë 4342 "operacione me shtetin", e cila në bilancin e vitit 2024 paraqitet në vlerën 40,185,643 lekë, janë përfshirë të gjitha detyrimet e konstatuara për llogaritë respektive:

42 "detyrime ndaj personelit"	19,664,734 lekë
431 "detyrime për tatim taksa"	1,987,968 lekë
435 "sigurime shoqërore"	6,064,986 lekë
436 "sigurime shëndetësore"	833,018 lekë
467 "kreditorë të ndryshëm"	11,634,937 lekë
401 "furnitorë dhe llogari të lidhura me to"	0 lekë
TOTAL	**40,185,643 lekë.**

Statusi: *Zbatuar*

9. Gjetje nga auditimi: Teprica e llogarisë *85 "Rezultati i ushtrimit"* në pasiv të pasqyrës së pozicionit financiar në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 163,799,067 lekë, ndërsa në Formatin nr.2 "Pasqyra e performancës financiare" paraqitet në vlerën 151,893,066 lekë, duke mos rakorduar për vlerën 11,906,000 lekë. Kjo diferencë është keqklasifikuar në shpenzimet korrente të periudhës, duke u debituar në llogaritë e shpenzimeve. Ky veprim kontabël ka sjellë nënvlerësimin në shumën 11,906,000 lekë të rezultatit të periudhës, ndërkohë që kjo shumë është debituar në llogaritë e klasës 2 në aktive afatgjata në pasqyrën e pozicionit financiar. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022, pika 3.3 faqe 39, Aneksi 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, në faqet 65-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Buxhetit, Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Bashkinë Korçë në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit ushtrimor të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë në llogarinë 85 "Rezultat i ushtrimit" dhe të kryejë evidentimin e saktë kontabël të të ardhurave të konstatuara për letrat me vlerë në arkë.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Në zbatim të rekomandimit sipas gjetjes 9 lidhur me riklasifikimin e llogarisë për vlerën 11,906,000 lekë në llogarinë 470 "të ardhura për t'u marrë në vitet pasardhëse" është kryer sistemimi i veprimit sipas rekomandimit të lënë nga KLSH.

Statusi: *Zbatuar*

10. Gjetje nga auditimi: Nga testet e transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës, rezultoi se janë kryer pagesa në vitin 2023 me urdhër-shpenzime në **64** raste faturash me vlerë 94,213,554 lekë, *mbi afatin 30 ditor të faturave* për shpenzime mallra e shërbime/ investime të mbërritura në Bashkinë Korçë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, i ndryshuar, neni 52, me Ligjin nr. 68/2017 datë 27.04.2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar, neni 44 "Kontrolli i shpenzimeve" *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, në faqet 65-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1. Rekomandimi: Bashkia Korçë të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve, me qëllim për likuidimin në kohë të faturave, shmangien e krijimit të detyrimeve të prapambetura dhe ruajtjen e aftësisë paguese.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Numri i faturave të cilave u ka kaluar afati 30 ditor për vitin 2023 ka qenë 54. Bashkia Korçë është përpjekur të ulë numrin e faturave që u ka kaluar afati 30 ditor dhe konkretisht për vitin 2024 numri i faturave që u ka kaluar afati 30 ditor ka qenë 42 dhe për periudhën janar-shtator 2025 ka qenë 31.

Statusi: *Në proces zbatimi*

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe lejeve të zhvillimit, u konstatua se në njëmbëdhjetë raste, dokumentacioni teknik dhe shoqërues i projektit ndërtimor, si dhe ai i kërkuar me ligj, nuk është i plotë. Gjithashtu, janë konstatuar vonesa në shqyrtimin e aplikimeve, tej atyre të parashikuar në dispozitat ligjore dhe nënligjore. Më konkretisht, këto parregullsi kanë të bëjnë me: **i.** mungesën e certifikatave të regjistrimit në QKB për hartuesit e projekteve ndërtimore *(rastet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11)*; **ii.** mangësi në projektin arkitektonik (mungesa e planvendosjes sipas formatit të miratuar, planit të piketimit , të organizimit të punimeve, të sistemimeve, detajeve të elementëve konstruktivë, fasadat nuk janë të

dimensionuara, nuk janë paraqitur kullimet në planin e mbulimit) *(rastet 1, 2, 3, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11)*; **iii.** mangësi në projektin hidrosanitar (mungojnë planimetritë dhe detajet e lidhjes me rrjetin K.U.Z., plani për largimin e ujërave të shiut, planimetri dhe detaje të lidhjes me rrjetin K.U.B.) *(rastet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 8)*; **iv.** mangësi në projektin elektrik (mungojnë detajet e montimit të sistemit rrufe-pritës dhe të instalimeve elektrike) *(rastet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 10,)*; **v.** mungesën e studimit sizmiko-inxhinierik dhe gjeologo-inxhinierik *(rastet 1, 2, 3, 4, 5, 8, 9)*; **vi.** mungesën e dokumenteve të rifraskuar të pronësisë, si dhe problematika në plotësinë e *tyre (rastet 1, 3, 6, 9)*; **vii.** mangësi në dokumentacionin e detyrueshëm në praktikën e aplikimit për pajisje me leje zhvillimi *(rastet 2, 3, 6, 8, 9, 11)*; **viii.** mangësi në projektin konstruktiv (mungojnë të dhëna në lidhje me mbrojtjen e objekteve përreth objektit që do të ndërtohet, mungojnë armimet e themeleve) *(rastet 3, 8)*; **ix.** mungonte polica e sigurimit të përgjegjësisë / deklarata profesionale / licenca profesionale për hartuesit e projekteve ndërtimore *(rastet 5, 6, 7, 8, 10)*; **x.** shqyrtimin me afate të tejzgjatura *(rasti 10).*

(Numrat rendor të rasteve të sipërcituar korrespondojnë me numrat rendor në tabelën përmbledhëse të lejeve të ndërtimit të audituara). Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin 107/2014 "Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, neni 44, pika 2; Ligjin nr. 7829, datë 01.06.1994 "Për noterinë", i ndryshuar, neni 54; VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar, neni 10, pika 1, nënpika c), d), dh); neni 15, pika 1, nënpika b), e), ë), g); pika 1/1, nënpika i), ii), iii); neni 20; neni 21, pika 3); VKM-në nr. 1162, datë 24.12.2020, "Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi / ndërtimi", shtojca II. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.5, faqe 279-295 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

11.1 Rekomandimi: Nga ana e Këshillit Bashkiak, Bashkia Korçë, sipas kompetencave të tij, të merren të gjitha masat për të analizuar situatat në lidhje me miratimin e lejeve të zhvillimit dhe ndërtimit me mangësi në dokumentacionin e nevojshëm dhe të detyrueshëm, respektimin e afateve për shqyrtimin e aplikimeve, evidentimin e personave përgjegjës, si dhe marrjen e masave ndaj tyre sipas përcaktimeve ligjore, me qëllim sigurimin e një metodologjie të unifikuar për shqyrtimin e aplikimeve, në përputhje me dokumentet e planifikimit dhe dispozitat ligjore në fuqi.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Ky rekomandim do lihet pa zbatuar (për verifikim në auditimin e radhës), kur të auditohet përputhshmëria, për të parë nëse lejet e ndërtimit/zhvillimit janë në zbatim të dispozitave ligjore ose jo.

Statusi: *Pa zbatuar*

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se në tetë raste, objektet e miratuara nuk respektojnë kondicionet urbane, siç janë lartësia e lejuar për katin përdhe me përdorim shërbim, numrin minimal të vend-parkimeve, distancat nga kufiri i pronës, nga trupi i rrugës, si dhe nga objektet kufitare. Më konkretisht, këto parregullsi kanë të bëjnë me: i. mosrespektimin e lartësisë së katit përdhe (dy raste); ii. mosrespektimin e minimal të vend-parkimeve (tre raste); iii. mosrespektimin e distancave urbane (gjashtë raste).

(Numrat rendor të rasteve të sipërcituar korrespondojnë me numrat rendor në tabelën përmbledhëse të lejeve të ndërtimit të audituara).

Më konkretisht:

1. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 4590/23, datë 19/07/2023, për objektin *"Banesë kolektive 1 kat + podrum + 1 kat dyqan + 7 kate banim"*, me adresë në lagjen nr. 18, rruga "Petraq Shomo", K.P. 6002, Korçë, me zhvillues "A." ShPK, me problematika si më poshtë vijon:

- Nuk respekton lartësinë e katit përdhe me përdorim shërbim;
- Nuk respekton numrin minimal të vend-parkimeve (faktike: 23; do të duhej të ishin: 49)

- Nuk respekton distancat nga kufiri i pronës. Distanca që objekti do të duhej të ruante nga kufiri i pronës është 8 m. Distanca faktike e miratuar nga kufiri perëndimor është 2.82 m, ndërsa nga kufiri jugor është 1 m.

2. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 5341/23, datë 07/09/2023, për objektin *"Objekt banimi dhe shërbimesh (8 kat + podrum)"*, me adresë në lagjen 18, rruga "1 Maji", K.P 7002, Korçë, me zhvillues "K." ShPK, me problematika si më poshtë vijon:

- Nuk respekton distancat urbane nga kufiri i pronës në pjesën jug-lindore dhe veri-lindore. Distanca që objekti do të duhej të ruante nga kufiri i pronës është 9 m. Distanca faktike e miratuar nga kufiri jug-lindor dhe veri-lindor është 1 metër.

3. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 4468/23, datë 03/08/2023, për objektin *"Objekt banimi dhe shërbimesh (6 kat + podrum)"*, me adresë në lagjen nr. 7, rruga "28 Nëntori", K.P. 7003, Korçë, me zhvillues "L." ShPK, me problematika si më poshtë vijon:

- Distanca e miratuar nga trupi i rrugës është 1 metër, ndërkohë që do të duhej të ishte 3 (tre) metra;
- Distanca që objekti do të duhej të ruante nga kufiri i pronës është 7 m. Distanca faktike e miratuar nga kufiri verior është 1 metër;
- Në veri të objektit të miratuar gjendet një objekt pesë katësh. Distanca e miratuar nga ky objekt është 6.7 m., ndërkohë që do të duhej të ishte 12 m;

4. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 2265/23, datë 15/05/2023, për objektin *"Godinë ekonomike dhe banimi 7 kate dhe 1 kat nën tokë"*, me adresë në lagjen nr. 18, rruga "Dhora Leka", K.P. 7002, Korçë, me zhvillues "V." ShPK, me problematika si më poshtë vijon:

- Nuk respekton numrin minimal të vend-parkimeve (faktike: 13; do të duhej të ishin: 18);

5. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 615/23, datë 16/03/2023, për objektin *"Godinë banimi dhe shërbimi 6 dhe 7 kate me podrum"*, me adresë në lagjen 18, rr. "Petraq Shomo", K.P. 7002, Korçë, me zhvillues "J." ShPK, me problematika si më poshtë vijon:

- Nuk respekton lartësinë e katit përdhe me përdorim shërbim;
- Nuk respekton numrin minimal të vend-parkimeve, (faktike: 0; do të duhej të ishin: 18)
- Nuk respekton distancat urbane nga kufiri i pronës në pjesën jug-lindore. Struktura është një objekt me 6 dhe 7 kate, si rrjedhim, distanca që duhet të ruhet nga kufiri është 7 dhe 8 metra. Distanca faktike e miratuar nga kufiri jug-lindor është 0.5 metra;

6. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 11102/22, datë 14.02.2023, për objektin *"Kompleks agroturistik 1-2 kate"*, me adresë në fshatin Voskopojë, Korçë, me zhvillues "V." ShPK, me problematika si më poshtë vijon:

- Nuk respekton distancat nga objektet e tjera, pjesë përbërëse e kompleksit. Distanca e miratuar midis objekteve që përbëjnë kompleksin (minimale) është 4 m., ndërkohë që do të duhej të ishte 6 m.;

7. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 155/24, datë 05.02.2024, për objektin *"Godinë banimi dhe shërbimi 6 dhe 7 kate me podrum"*, me adresë në lagjen 18, rruga "Petraq Shomo", K.P. 7002, Korçë, me zhvillues "J." ShPK, me problematika si më poshtë vijon:

- Nuk respekton distancat urbane nga kufiri i pronës në pjesën jug-lindore. Për objektet që zhvillohen në nënnjësitë strukturore të urbanizuara, në proces konsolidimi urban, distanca minimale nga kufiri i pronës duhet të jetë jo më pak se 5 metra. Distanca faktike e miratuar nga kufiri jug-lindor është 4 metra;
- Nuk respekton lartësinë e katit përdhe me përdorim shërbim;

8. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 1916/24, datë 04.04.2024, për objektin *"Godinë banimi 2 dhe 3 kat, plus 1 kat podrum "Green Villas"*, me adresë në lagjen nr. 10, bulevardi "Rilindasit", K.P. 7002, Korçë, me zhvillues "B." ShPK, me problematika si më poshtë vijon:

- Nuk respekton distancat urbane nga kufiri i pronës në pjesën veri-perëndimore. Distanca që objekti do të duhej të ruante nga kufiri i pronës është 4 m (për pjesën me 3 kate). Distanca faktike e miratuar nga kufiri veri-perëndimor është 1 m;

- Nuk respekton distancat nga objektet kufitare. Së pari, objekti i shënuar "1 kat", i bashkëlidhur me objektin 5 kate në jug të parcelave në zhvillim, faktikisht është 4 kate dhe jo 1 kat. Së dyti, objekti në zhvillim në skajin lindor të parcelës, duhet të respektonte distancën 9 metra nga objekti 5 katësh. Distanca e miratuar është 5.8 metra. Së treti, objekti në zhvillim në skajin perëndimor të parcelës, duhet të respektonte distancën 9 metra nga objekti 4 katësh. Distanca e miratuar është 3.7 metra. Këto veprime janë në kundërshtim me Rregulloren e Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Korçë, neni 55; neni 56; VKM nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit",* i ndryshuar, neni 34, pika 2; neni 35; neni 36, pika 3, nënpika b); *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.5, faqe 279-295 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1 Rekomandimi: Nga ana e Këshillit Bashkiak, Bashkia Korçë, sipas kompetencave të tij, të merren të gjitha masat për të analizuar situatat në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit që nuk kanë respektuar kondicionet urbane, evidentimin e personave përgjegjës, si dhe marrjen e masave ndaj tyre sipas përcaktimeve ligjore, me qëllim sigurimin e një metodologjie të unifikuar për shqyrtimin e aplikimeve, në përputhje me dokumentet e planifikimit dhe dispozitat ligjore në fuqi.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Ky rekomandim do lihet për verifikim në auditimin e radhës, kur të auditohet përputhshmëria, për të parë nëse lejet e ndërtimit/zhvillimit janë në zbatim të dispozitave ligjore ose jo. Nuk evidentohet të jenë marra masa ndaj personave përgjegjës nga Kryetari i Bashkisë.

Statusi: *Pa zbatuar*

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se në të gjitha rastet, pra në njëmbëdhjetë raste, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Bashkia Korçë jo gjithmonë ka kërkuar/respektuar mendimin e të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Referuar nenit 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"*, i ndryshuar, pika 6, DPZHT ka detyrimin të kërkojë dhe respektojë mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen përpara miratimit të lejeve të ndërtimit. Gjithashtu, në dispozitat nënligjore të sipërcituara, specifikohet gjithashtu se informacioni, që mundësojnë DR ASHK, nuk duhet të kufizohet me dhënien e dakordësisë apo miratimin e heshtur, por, në çdo rast, duhet të përmbajë statusin e pronësisë apo kartelën e pasurisë/kartelat e pasurive, si dhe hartën/hartat kadastrale për pronën/pronat e aplikimit, në përputhje me legjislacionin sektorial për kadastrën. Gjithashtu, referuar përcaktimeve të Vendimit nr. 41, datë 03.12.2020 të Këshillit Kombëtar të Territorit *"Për shqyrtimin e kërkesave për leje zhvillimi dhe ndërtimi brenda zonave të mbrojtura dhe zonave me përparësi zhvillimin e turizmit"*, si dhe hartës bashkëlidhur, qyteti i Korçës bën pjesë në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit malor dhe natyror. Referuar përcaktimeve të pikës 3 të këtij vendimi, aplikimet për pajisje me leje ndërtimi miratohen vetëm pas marrjes së mendimit pozitiv nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për Zonat me Përparësi Zhvillimin e Turizmit dhe aktit të përputhshmërisë nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit për Zonat e Mbrojtura, si dhe për Zonat me Përparësi Zhvillimin e Turizmit. Në zbatim të pikës 4 të këtij vendimi, çdo leje e miratuar nga autoritetet vendore të zhvillimit të territorit, në kushtet e mungesës, apo dhënies së një përgjigje negative, në secilën prej pikave të akteve të përmendura në shkronja "a", "b" dhe "c", të pikës 3, do të konsiderohet nul dhe e pavlefshme. Nga auditimi janë konstatuar tetë raste që nuk kanë respektuar përcaktimet e Vendimit nr. 41, datë 03.12.2020 të Këshillit Kombëtar të Territorit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.5, faqe 279-295 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

13.1 Rekomandimi: Nga ana e Këshillit Bashkiak, Bashkia Korçë, sipas kompetencave të tij, të merren të gjitha masat për:

- Të analizuar situatat në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, pa kërkuar / respektuar mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e tyre;

- Të analizuar situatat në lidhje vlefshmërinë e lejeve të miratuar, kur nuk është marrë mendimin pozitiv nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe akt përputhshmërie nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit (për rastet që përfshihen në Vendimin nr. 41, datë 03.12.2020 të Këshillit Kombëtar të Territorit);
- Evidentimin e personave përgjegjës dhe marrjen e masave ndaj tyre sipas përcaktimeve ligjore, me qëllim sigurimin e një metodologjie të unifikuar për shqyrtimin e aplikimeve, në përputhje me dokumentet e planifikimit dhe dispozitat ligjore në fuqi.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Ky rekomandim do lihet për verifikim në auditimin e radhës, kur të auditohet përputhshmëria, për të parë nëse lejet e ndërtimit/zhvillimit janë në zbatim të dispozitave ligjore ose jo. Nuk evidentohet të jenë marra masa ndaj personave përgjegjës nga Kryetari i Bashkisë.

Statusi: *Pa zbatuar*

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në të gjitha rastet e audituara, pra në njëmbëdhjetë raste, zhvilluesi dhe aplikanti nuk kanë aplikuar dhe nuk janë pajisur me dokumentin "Njoftim për fillimin e punimeve". Ky dokument lëshohet vetëm pasi sigurohet që zhvilluesi ka plotësuar të gjithë dokumentacionin dhe ka përmbushur kushtet e nevojshme për nisjen e punimeve, dhe gjithashtu përcakton datën zyrtare të fillimit të tyre. Kjo datë është referenca për monitorimin e respektimit të grafikut të punimeve dhe afatit të përfundimit. Sipas pikës 8 të vetë lejes së ndërtimit dhe nenit 40, pika 1, të Ligjit nr. 107/2014 *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"*, i ndryshuar, punimet duhet të fillojnë brenda një viti nga data e miratimit të lejes. Mos pajisja me dokumentin përkatës në rastet e konstatuara, të cilat janë të detajuara në Aneksin nr. 4, përbën shkelje të procedurës ligjore dhe administrative. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 279-295 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

14.1 Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Korçë dhe Këshillit Bashkiak, të merren të gjitha masat për të përfshirë në praktikën e punës, shqyrtimin e aplikimeve për pajisje me dokumentin e "Njoftimit të Fillimit të Punimeve" vetëm nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Bashkia Korçë dhe Këshilli Bashkiak ka marrë në konsideratë dhe ka marrë masat e nevojshme për rekomandimet e KLSH-së në lidhje me shqyrtimin e aplikimeve për pajisje me dokumentin e "Njoftimit të Fillimit të Punimeve", vetëm nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve.

Statusi: *Zbatuar*

14.2 Rekomandimi: Nga ana e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Korçë, të merren të gjitha masat për kryerjen e inspektimeve në objektet në zhvillim, për të verifikuar nëse këta zhvillues janë pajisur ose jo me dokumentin e "Njoftimit për Fillimin e Punimeve", të emetuar nga sistemi elektronik e lejeve.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Nga ana e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, nga verifikimi me zgjedhje i disa praktikave, u konstatua se janë bërë kontrolle periodike për inspektimin dhe verifikimin e zhvilluesve, nëse janë pajisur apo jo me dokumentin e "Njoftimit për Fillimin e Punimeve", të emetuar nga sistemi elektronik e lejeve dhe zbatimin e projektit të miratuar.

Statusi: *Zbatuar*

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në një rast, objekti i miratuar nuk respekton përcaktimet e Ligjit 22/2018 *"Për strehim social"*, datë 03.05.2018, në lidhje me kontributin që subjektet private që aplikojnë për leje zhvillimi dhe

ndërtimi për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2 000 metra katrorë, kanë ndaj fondit publik për strehim social. Kjo problematikë është evidentuar në lejen e ndërtimit të miratuar me Vendim nr. 2265/23, datë 15.05.2023, për objektin *"Godinë ekonomike dhe banimi 7 kate dhe 1 kat nën tokë"*, me adresë në lagjen nr. 18, rruga "Dhora Leka", K.P. 7002, Korçë, me zhvillues "V." ShPK. Nga auditimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin *e-lejet*, është konstatuar se në asnjë moment nuk i është bërë me dije zhvilluesit dhe aplikantit se kanë detyrimin e kalimit pa shpërblim të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale, në favor të fondit publik të banesave sociale. Sipërfaqja ndërtimore me funksion banim për objektin e miratuar është 2185.5 m^2 (1730 m^2 apartamente dhe korridore të brendshme; 343.5 m^2 ballkone; 112 m^2 verandë), nga të cilat 65.5 m^2 do të duhej t'i kalonin fondit publik të banesave sociale. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.5, faqe 279-295 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1. Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtorisë Juridike, Bashkia Korçë, të merren të gjitha masat për të njoftuar zhvilluesin, i cili ka përfituar lejen e ndërtimit të cituara më sipër, në lidhje me detyrimin që ka ndaj fondit publik për strehim social. Nga Bashkia Korçë të ndiqen të gjitha hapat deri në refuzimin e aplikimeve për pajisje me certifikatë përdorimi, nëse zhvilluesi nuk dakordësohet, për hartimin e akt-marrëveshjes, si dhe përcaktimin e sipërfaqeve që do të përfitohen.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Nuk është bërë njoftimi, pasi sipas matjeve objekti nuk e kalon 2000 m^2, pra Bashkia Korçë (DPZHKT), nuk ka marrë në konsideratë dhe nuk ka marrë masat e nevojshme për rekomandimet tuaja në lidhje me detyrimin e përfituesve të lejeve të ndërtimit për strehimin social.

Statusi: *Pa zbatuar*

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, në lidhje me respektimin e distancave nga kufiri i pronës, në dokumentin e Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Korçë, miratuar me Vendim nr. 07, datë 08.02.2017 të Këshillit Kombëtar të Territorit, ka dy përcaktime të ndryshme, të cilat nuk japin të njëjti rezultat për distancat që objektet duhet të respektojnë nga kufiri i pronës. Më konkretisht, në nenin 58 të rregullores së sipërcituar, përcaktohet se:
- pika 10: *"Distancat e ndërtimeve nga kufiri i pronës sipas rregullores së zhvillimit të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave"*;
- pika 14: *"Distanca nga kufiri i pronës llogaritet sipas formulës së mëposhtme:* ***d = Hst x 0.4 (ku d*** *– është distanca minimale nga kufiri i pronës, hst – lartësia e ndërtimit të strukturës që propozohet të ndërtohet)"*.

Nëse i referohemi nenit 35 *"Distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës"* të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit",* i ndryshuar, pika 1, marrim informacionin se distanca minimale e lejuar e ndërtimit nga kufiri i pronës përcaktohet, si gjatësia e vijës pingule nga faqja e strukturës së ndërtimit me kufirin e pronës dhe është e barabartë me numrin e kateve mbi tokë të ndërtimit plus 1m (d= nr.k +1m), ku: d – distanca minimale e ndërtimit nga kufiri i pronës dhe nr.k – numri i kateve. Pra, formula e llogaritjes sipas pikës 10 të nenit 58 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Korçë, nuk jep të njëjtin rezultat me atë të pikës 14 të po kësaj rregulloreje. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 279-295 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Korçë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, si dhe me Drejtorinë Juridike, të marrin masa për të përdorur të gjitha rrugët institucionale për të saktësuar përcaktimet e Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, në lidhje me llogaritjen e distancës minimale të lejuar nga kufiri i pronës.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Këto ndryshime kryhen nga AZHT-ja në bashkëpunim me AKPT në momentin e ndryshimit të VKM-ve. Gjithsesi, kjo procedurë është

bërë dhe është miratuar me Vendim Nr. 60, datë 26.03.2025 të Këshillit të Ministrave, hyrë në fuqi në datë 30.10.2025, pasi është botuar në regjistrin kombëtar të Planifikimit të Territorit.

Statusi: *Zbatuar*

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në një rast, taksa e ndikimit në infrastrukturë nuk është llogaritur e saktë. Në lidhje me përllogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për:

1. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 11102/22, datë 14.02.2023, për objektin *"Kompleks agroturistik 1-2 kate"*, me adresë në fshatin Voskopojë, Korçë, me zhvillues "V." ShPK, u konstatua se, referuar përcaktimeve të pikës 1.4 *"Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë"* të Vendimit nr. 168, datë 24.11.2022 *"Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë e Korçës, si dhe penalitetet për shkeljet apo kundërvajtjet administrative për vitin 2023"*, nënpika 7, marrim informacionin se investimet e subjekteve, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si "agroturizëm", janë të përjashtuara nga pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Nga dokumentacioni i ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve, është konstatuar se aplikantit dhe zhvilluesit i është dërguar fatura për arkëtim nr. 100, datë 02.02.2023, ku është përllogaritur vlera e TNI-së prej 1,075,537 lekë. Kjo vlerë është paguar nga subjekti "V." ShPK, pranë "Fibank", në datë 09.02.2023. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.5, faqe 279-295 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

17.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Bashkia Korçë, Drejtorisë së Financës dhe Drejtorisë Juridike, të merren të gjitha masat për të njoftuar përfituesin e lejes së ndërtimit mbi vendim-marrjen e gabuar në lidhje me llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë, si dhe kompensimin e tij për vlerën e paguar.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Nga ana e Bashkisë Korçë janë kryer verifikimet si dhe është kryer dëmshpërblimi me shkresën nr. 10698 Prot, datë 15.10.2025 me urdhër shpenzimesh nr. 1082, dt. 23.10.2025.

Statusi: *Zbatuar*

18. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi mbi administrimin e pronave të Bashkisë Korçë për periudhën objekt auditimi, rezultoi se sipas VKM-ve i janë transferuar kësaj njësie vendore gjithsej 1742 prona, nga të cilat 1549 prona në pronësi dhe 193 prona në përdorim. Për vitin 2023 janë bërë 81 aplikime nga të cilat, 18 janë pajisur me certifikatë pronësie, ndërsa për vitin 2024 janë bërë 62 aplikime nga të cilat 15 janë pajisur me certifikatë pronësie. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3.4, faqe 65-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

18.1. Rekomandimi: Bashkia Korçë, nëpërmjet strukturave përgjegjëse të marrë të gjitha masat për përgatitjen e dosjeve me dokumentacionin e duhur tekniko-ligjor dhe regjistrimin e tyre në ASHK. Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Sektorin e Menaxhimit dhe Administrimit të Aseteve, të llogarisë në buxhetin e PBA dhe buxhetin vjetor fondet e nevojshme për regjistrimin e pasurive në pronësi dhe në përdorim të Bashkisë Korçë.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Sektorin e Menaxhimit dhe Administrimit të Aseteve, ka planifikuar në buxhetin e PBA dhe buxhetin vjetor fondet e nevojshme për regjistrimin e pasurive në pronësi dhe në përdorim të Bashkisë Korçë dhe konkretisht për vitin 2024 në vlerën 3,500,000 lekë.

Statusi: *Zbatuar*

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve përcjellë me shkresën 862/12 Prot, datë 16.04.2024, rezultoi se:

- Nga subjekti është respektuar afati 20 ditor për kthimin e përgjigjes për marrjen e masave në zbatimin e rekomandimeve, përcjellë me shkresën nr. 862/15 Prot, datë 13.02.2024, në zbatim të shkronjës "j" të nenit 15 të Ligjit nr. 154/2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së*".
- Nga subjekti është respektuar afati 6 - mujorë për të raportuar lidhur me plotësimin e përcaktimeve të Ligjit nr. 154/2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", neni 30, pika 2, përcjellë me shkresën nr. 862/16, datë 21.10.2024.
- Në lidhje me verifikimin e zbatimit të rekomandimeve, kemi si vijon:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 28 masa organizative të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuara 12 masa janë zbatuar plotësisht, 1 masë është zbatuar pjesërisht, 10 masa janë në proces zbatimi dhe 5 masa janë të pa zbatuara.

b. Masa shpërblim dëmi janë rekomanduar 4 masa në vlerën 1,416,997 lekë të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuara 2 masa janë zbatuar plotësisht dhe 2 masa janë zbatuar pjesërisht.

b. Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia - (të ardhura të munguara) janë rekomanduar 8 masa në vlerën 101,384,161 lekë, të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 1 masë është zbatuar plotësisht, është në proces zbatimi 1 masë, 3 masa janë zbatuar pjesërisht dhe janë në proces zbatimi 3 masa.

c. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike
janë rekomanduar 7 masa, të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuara 3 masë janë zbatuar plotësisht, 3 masa janë zbatuar pjesërisht, 1 masë është e pazbatuar.

c. Masa disiplinore janë rekomanduar 22 masa të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuara 22 masa janë zbatuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 302-324 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

19.1. Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrolli të Lartë të Shtetit", për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përshpejtimin e atyre në proces zbatimi, si më poshtë:

A. Masa organizative

6.1. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Korçë, të merren masa të menjëhershme për ngritjen një grupi pune i cili të kryejë verifikimet dhe rakordimet ndërmjet gjendjes faktike dhe atë të kontabilizuar në pasqyrat financiare për vlerën totale 11,946,705 lekë që i përket aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit pa dokumentacion justifikues nga Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse Arsimit dhe Çerdhes dhe Qendrës Rezidenciale të Zhvillimit. Në rast se nga procesi i verifikimit konstatohen diferenca ndërmjet gjendjes faktike dhe atë të kontabilizuar në pasqyrat financiare të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, të diferencave në inventar nga personat përgjegjës.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Korçë nr. 584 datë 13.06.2024 "për ngritjen e grupit të punës për kryerjen e verifikimeve dhe rakordimeve ndërmjet gjendjes faktike dhe atë të kontabilizuar në pasqyrat financiare për vlerën totale 11,946,705 lekë që i përket aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit pa dokumentacion justifikues nga ndërmarrja e shërbimeve mbështetëse arsimit dhe çerdhes dhe qendrës rezidenciale të zhvillimit" është ngritur grupi i punës i cili ka hartuar raportin me nr. Prot. 5305/1 datë 21.06.2024.

Statusi: *Zbatuar*

11.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Financës Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të marrë masa që në pasqyrat financiare të vitit 2023 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 4342 "*Operacione me shtetin (të drejta)*" me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2025, rezultoi se sistemet janë kryer në zbatim të Udhëzimit të MFE nr. 5 datë 21.2.2022 "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018".

Statusi: *Zbatuar*

16.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Korçë, të marrë masa që lejet e ndërtimit të miratuara të jenë më përputhje me të gjitha kriteret dhe kondicionet urbane, që përfshijnë intensitetin e ndërtimit, koeficientin i shfrytëzimit të territorit, lartësinë e ndërtimit, sipërfaqen e gjelbërimit dhe numrin e parkimeve, të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Në lidhje me ndryshimin e sipërfaqes së ndërtimit duke llogaritur edhe sipërfaqet e ballkoneve konsol, sqarohet se bazuar në VKM nr. 626, datë 15.7.2015 "Për miratimin e normativave të projektimit të banesave", Kapitulli I, pika 2, përcakton përkufizimet si me poshtë:

2.16 Intensiteti i ndërtimit (I), për një ndërtim ose parcelë, është raporti i sipërfaqes së përgjithshme të ndërtimit në një parcelë të ndërtueshme, me sipërfaqen e parcelës së ndërtueshme. Ku sipërfaqja e ndërtimit përcaktohet si me poshtë :

2.11 Sipërfaqja e ndërtimit, është tërësia e sipërfaqeve të shfrytëzimit të banesave, të shkallëve e të muraturave të matura në planimetritë e kateve, ku sipërfaqja e muraturave përcaktohet si më poshtë:

2.9 Sipërfaqja e muraturës, tërësia e sipërfaqeve në plan të muraturave mbajtëse dhe ndarëse (përfshirë dyer dhe dritare) të matura në planimetri. Në këto kushte meqenëse në fjalorin e gjuhës shqipe ka përcaktim të saktë për termin "llozhë" dhe termin "ballkon" ku "Llozhë" është "Ballkon i futur në ndërtese" dhe "Ballkon" është "Shesh i vogël, zakonisht katër këndësh dhe i ngushtë, i rrethuar me parmakë, që del jashtë murit të një ndërtese dhe që lidhet me pjesën e brendshme të saj nëpërmjet një dere".

Si përfundim, sipërfaqet e llozhave bëjnë pjesë brenda sipërfaqeve të muraturave mbajtëse, ndërsa ballkonet nuk mund të konsiderohen sipërfaqe ndërtimi në llogaritjen e Intensitetit të ndërtimit.

Duke u nisur nga sa më lart, janë respektuar të gjitha kushtet e përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, të tilla si intensiteti i ndërtimit, koefiçienti i shfrytëzimit të territorit, lartësia e ndërtimit etj.

Gjithashtu sqarojmë se në bazë të sipas Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Rregulloren e Planit, të miratuara me vendim të KKT-së nr. 9, datë 25.01.2017, nenet 54 hapësirat e gjelbërta llogariten për njësi strukturore dhe jo për parcelë ndërtimi. Gjithashtu edhe parkimet llogariten për njësi strukturore.

Ky rekomandim do lihet për verifikim në auditimin e radhës, kur të auditohet përputhshmëria, për të parë nëse lejet e ndërtimit/zhvillimit janë në zbatim të dispozitave ligjore ose jo. Nuk evidentohet të jenë marra masa ndaj personave përgjegjës nga Kryetari i Bashkisë.

Statusi: *Pa zbatuar*

17.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Korçë, të marrë masa për të ndryshuar Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 114, datë 30.09.2021, sipas pikës 7 dhe të realizohet kalimi pa shpërblim i të paktën 3% të sipërfaqes funksionale për strehimin social, përpara miratimit të certifikatës së përdorimit. Gjithashtu në aktmarrëveshjet që

janë lidhur ndërmjet bashkisë dhe subjektit zhvillues, të përcaktohen të dhëna të sakta e specifike në lidhje me sipërfaqen që duhet të kalojë në favor të bashkisë për strehimin social, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Në datën 29.05.2024 ka dalë Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 325 datë 29.05.2024 "Për përcaktimin e rregullave për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik të banesave sociale". Në këto kushte Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 114, datë 30.09.2021 do të ngelet pa veprim, sepse do të ndiqen përcaktimet sipas VKM-së.

Statusi: *Zbatuar*

18.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Korçë, të marrë masa për të verifikuar në sistemin e-Leje paraqitjen e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm, përpara miratimit të certifikatës së përdorimit.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Ky rekomandim do lihet për verifikim në auditimin e radhës, kur të auditohet përputhshmëria, për të parë nëse lejet e ndërtimit/zhvillimit janë në zbatim të dispozitave ligjore ose jo. Nuk evidentohet të jenë marra masa ndaj personave përgjegjës nga Kryetari i Bashkisë.

Statusi: *Pa zbatuar*

23.1. Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes Territorit në Bashkinë Korçë, të marrë masa për të ekzekutuar vendimet e prishjes të marra prej tyre sipas afateve ligjore.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Nga testet e kryera, në dokumentacionin e veprimtarisë së IMTV në Bashkinë Korçë ka masat për ekzekutimin e vendimeve për prishje sipas afateve ligjore.

Statusi: *Zbatuar*

B. Masa shpërblim dëmi

1.1. Rekomandimi: Drejtorinë e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të marrë masa, për arkëtimin e shumës **383,349 lekë** pa TVSh, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit nga **BOE N. & "N." ShPK**, sipas kontratës së lidhur me nr. 8282/3 Prot, datë 14.11.2022 për realizimin e punimeve civile.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Me urdhër nr. 476 datë 22.05.2024 "Për kontabilizimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH 2023 për bilancin e vitit 2024" është kryer kontabilizimi për vlerën **383,349 lekë** pa TVSH nga BOE "N. & N." ShPK**,** sipas kontratës së lidhur me nr. 8282/3 Prot, datë 14.11.2022 për realizimin e punimeve civile. Subjekti është njoftuar në lidhje me detyrimin, por nuk është përmbushur nga ana e tij. Për këtë arsye përmbushja e detyrimit do ndiqet në rrugë gjyqësore.

Statusi: *Në proces zbatimi*

4.1. Rekomandimi: Drejtorinë e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të marrë masa për arkëtimin e shumës **249,807 lekë** pa TVSh, e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit dhe njësisë vendore, në rast se punimet e pakryera nuk realizohen, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit nga OE "**A." SHPK**, sipas kontratës së lidhur me nr. 2520/3 Prot, datë 05.04.2023 për realizimin e punimeve civile.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Me urdhër nr. 476 datë 22.05.2024 "Për kontabilizimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH 2023 për bilancin e vitit 2024" është

kryer kontabilizimi për vlerën **249,807 lekë pa TVSH** nga **OE "A." SHPK,** sipas kontratës së lidhur me nr. 2520/3 Prot, datë 05.04.2023 për realizimin e punimeve civile.
Subjekti është njoftuar në lidhje me detyrimin, por nuk është përmbushur plotësisht nga ana e tij dhe me shkresën nr. 15 Prot, datë 10.06.2024 ka njoftuar së do të kryejë punimet.
Në përfundim të punimeve, sipas proces verbalit nr. 9441/1, dt.16.09.2025 ka rezultuar që nuk janë kryer punimet në vlerën e kërkuar 249,807 lekë. Nga kjo shumë kanë mbetur punime të parealizuara për shumën 63,690 lekë, shumë e cila është mbajtur nga 5% i garancisë së punimeve. Dokumenti justifikues është Urdhër shpenzimi nr.960, dt.24.09.2025 me vlerë 63,690 lekë, sipas të cilit fondet kanë kaluar në favor të Degës së thesarit, llogari e bashkisë Korçë. Sistemimet në kontabilitet për vlerën 249,807 lekë, janë reflektuar në bilancin e vitit 2025.

Statusi: *Zbatuar*

C. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike.

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Financës Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të evidentojë të gjitha rastet të cilat janë objekt i Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", për të cilat nuk është zhvilluar procedurë prokurimi dhe për rastet që nuk janë nënshtruar procedurës së prokurimit të merren masat e nevojshme për ndërprerjen e tyre referuar akteve ligjore në fuqi.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Ky rekomandim do lihet për verifikim në auditimin e radhës, kur të auditohet përputhshmëria, për të parë nëse është zbatuar ose jo.

Statusi: *Pa zbatuar*

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Korçë të analizojë këto procedura dhe të marrë masa për titullarin e Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse për Arsimin dhe Çerdhet, i cili në cilësinë e titullarit të AK dhe në cilësinë e miratuesit të këtyre procedurave, ka vepruar në mospërputhje me kuadrin ligjor në fushën e prokurimeve publike, duke rritur shpenzimet pa efektivitet të buxhetit të Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdheve në shumën **771,228 lekë.**

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Sipas shkresës nr. Prot. 847 datë 11.10.2024 është bërë kontabilizimi i detyrimit për A.K. ShPK, për blerje kompjuter printer në vlerën 440,268 lekë dhe blue print technologies për blerje bojëra printeri fotokopje në vlerën 330,960 lekë. Subjektet janë njoftuar në lidhje me detyrimin. Në qoftë se nga ana e tyre nuk përmbushet detyrimi në mënyrë vullnetare, atëherë do të kërkohet përmbushja e detyrimit në rrugë ligjore. Nga ana e Kryetarit të Bashkisë nuk është marrë asnjë masë për titullarin e Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse për Arsimin dhe Çerdhet.

Statusi: *Pa zbatuar*

5.1. Rekomandimi: Titullari i AK (Kryetari i Bashkisë Korçë ose Drejtori i Njësisë Shpenzuese, sipas rastit), të analizojë arsyet e skualifikimit/kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë dhe të marrë masa për eliminimin e këtyre praktikave të parregullta, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten veprime të tilla. Të vlerësohen në maksimum kriteret e DT të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e DT, përbën shkelje të procedurave të prokurimit publik dhe risk real për mosrealizimin me sukses të kontratës.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Ky rekomandim do lihet për verifikim në auditimin e radhës, kur të auditohet përputhshmëria, për të parë nëse është zbatuar ose jo në lidhje me shpalljen fitues të OE.

Statusi: *Pa zbatuar*

D. <u>Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara).</u>

<u>1.1. Rekomandimi:</u> Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore duhet të kryejë faturimet sipas ditëve të muajve, referuar tarifave të përcaktuara në paketën fiskale, si dhe të kërkojë në rrugë administrative vlerën e pataksuar prej 226,963 lekë

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Janë njoftuar të gjitha subjektet dhe ka filluar arkëtimi i detyrimeve përkatëse.

Statusi: *Në proces zbatimi*

<u>2.1. Rekomandimi:</u> Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë dhe Drejtorinë Juridike të marrin masa për:
- Ndjekjen e të gjithë hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës **57,917,505 lekë** nga 11 qiramarrësit që nuk kanë paguar detyrimet për objektet/tokën e marrë me qira.
- Në çdo rast të mospagesës së detyrimeve kontraktore të kërkojë prishjen e kontratës ose të mos nënshkruajë kontratën e re për objektet/tokën e lëshuar me qira, si dhe të llogarisë penalitetet, sipas rastit.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Situata e debitorëve nga kontratat e qirasë është si më poshtë:
E.K., ndodhemi në fazë ekzekutimi;
F. ShPK, pasi është pranuar kërkesëpadia, ndodhemi në fazë ekzekutimi;
S.K., aktualisht ndodhemi në proces gjyqësor;
D.H., aktualisht ndodhemi në proces gjyqësor në apel administrativ *(Gjykata administrative e Apelit Tiranë)*
E.XH, aktualisht ndodhemi në proces gjyqësor në apel administrativ *(Gjykata administrative e Apelit Tiranë)*
V.V, u pranua kërkesëpadia, presim të marrë vendimi formë të prerë
N.P. dhe TH.P., një nga palët e paditura ndërroi jetë gjatë gjykimit. U cel dëshmia e trashëgimisë dhe çështja është në gjykim;
P.M. dhe G.X., u pranua kërkesëpadia, presim të marrë vendimi formë të prerë;
L.SH., është dorëzuar kërkesëpadi në Gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm të Shkallës së Parë Korçë;
E.D., është likuiduar;
A.R., gjykimi është në proces në Gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm të Shkallës së Parë Korçë. Gjykata me vendim datë 05.06.2023 ka vendosur pezullimin e gjykimit deri në zgjidhjen e çështjes administrative në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë që i përket palës paditëse A.R. dhe palës paditur S. B. me objekt "pavlefshmëri leje legalizimi".

Statusi: *Në proces zbatimi*

<u>5.1. Rekomandimi:</u> Kryetari i Bashkisë, Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, të miratojnë lejet e ndërtimit pasi të sigurohen që subjektet i kanë shlyer të gjitha detyrimet e prapambetura në Bashkinë Korçë, si dhe të ndjekin të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **2,127,093 lekë ndaj 25 subjekteve** të pajisur me leje ndërtimi, sipas Aneksit A11, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit ka marre masat e nevojshme që kjo situatë të mos përsëritet. Lejet e

ndërtimit miratohen pasi subjektet pajisen me vërtetim për taksat. Ndërkohë që për çdo debitorë janë bërë njoftimet dhe po ndiqet pjesa e arkëtimit.

Statusi: *Në proces zbatimi dhe do rikërkohet për vlerën e paarkëtuar prej 2,127,093 lekë*

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave e Tarifave Vendore dhe specialistin e buxhetit Bashkia Korçë të marrin masa që të arkëtojnë diferencat e shkaktuara nga përllogaritjet e gabuara për taksën e ndikimit në infrastrukturë për **6 leje ndërtimi në shumën 13,847,443 lekë**, përkatësisht si më poshtë:

- **vlera 11,914,178 lekë** me pronar dhe zhvillues **L.L. dhe O.L.** për **5** leje ndërtimi.
- **vlera 1,933,265 lekë** me zhvillues dhe pronar trualli **B.K.**.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Me urdhër nr. 500 datë 27.05.2024 "Për kontabilizimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH 2023 për bilancin e vitit 2024" është kryer kontabilizimi për vlerën **13,847,443 lekë,** përkatësisht si më poshtë:

- **vlera 11,914,178 leke** me pronar dhe zhvillues **L.L. dhe O.L.** për 5 leje ndërtimi.
- **vlera 1,933,265 lekë** me zhvillues dhe pronar trualli **B.K..**

Nga ana e znj. O.L. janë paguar detyrimet përkatëse sipas faturave bashkëngjitur.

Në lidhje me procedurën e ndjekur për arkëtimin e vlerës **1,933,265 lekë** po ju vendosim bashkëngjitur dokumentacionin përkatës. Është kërkuar në mënyrë të përsëritur përmbushja e detyrimit, pas administrimit të informacionit nga UKKO. Në rast mos përmbushje të detyrimit brenda afatit kohor 10 ditor Bashkia Korçë do të kërkojë përmbushjen e detyrimit në rrugë gjyqësore.

Statusi: *Në proces zbatimi*

7.2. Rekomandimi: Nga Bashkia Korçë të merren masa për të monitoruar destinacionin e përdorimit të objektit "*V. Resort - Kompleks Turistik 3 Kate + 1 Kat Nëntokë (Zona 2)*", miratuar me vendimin nr. 8590/22, datë 09.12.2022, me zhvillues shoqërinë "S." SHPK, në adresën: Fshati Voskopojë, Korçë dhe, nëse ndryshon destinacioni i objekteve të zhvilluar në lejen e ndërtimit, të përllogaritet taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe të likuidohet diferenca e taksës për vlerën **1,525,253 lekë**.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Për objektin " V. Resort – Kompleks Turistik 3 Kate +1 Kat Nentokë (Zona 2)", Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit do të kryejë verifikimet përpara dhënies së Certifikatës së Përdorimit, dhe do të verifikojë destinacionin, në rast se do të ketë ndryshim destinacioni nga leja, do të kryhet procedura për likuidimin e diferencave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Statusi: *Pa zbatuar*

C. Masa për shpërblim dëmi.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me nr. 3553/3 Prot, datë 10.05.2023 me objekt: "Investime në infrastrukturën rrugore" (Marrëveshje Kuadër – Faza II), Bashkia Korçë" të lidhur mes AK Bashkisë Korçë dhe sipërmarrësit të punimeve shoqërisë "A." SHPK me NIPT J.....P dhe Lic. nr. NZ.2...6/17, me vlerë të kontratës 41,059,400 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës tre muaj nga data e nënshkrimit të kontratës, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve (Shtresë binderi me makineri 4 cm; Shtresë asfaltobetoni me makineri 4 cm; Spërkatje me emulsion bituminoz 1 l/m2; Mbulim kanali; Shtresë rëre, etj.), me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Korçë, në vlerën 1,718,360 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe*

Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3553/3 Prot, datë 10.05.2023 të lidhur ndërmjet AK Bashkisë Korçë dhe shoqërisë "A." SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4 faqe 88-279 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për zbritjen nga garancisë e punimeve të vlerës **1,718,360 lekë** përfituar padrejtësisht nga Kontraktori "A." SHPK, për punime të certifikuara, por të pa realizuara.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Është kryer kontabilizimi i detyrimit të subjektit "Almo Konstruction" me urdhër nr.1284, datë 17.11.2025 të Kryetarit të Bashkisë për vlerën **1,718,360 lekë.** Kjo vlerë do të mbahet nga fondi 5% garancia e punimeve, e cila e ka datën e përfundimit të periudhës së garancisë së cilësisë së punimeve 03.11.2025. Subjekti është njoftuar me shkresën nr. Prot. 12842 datë 02.12.2025 për përmbushjen e detyrimit në mënyrë vullnetare duke i lënë një afat kohor prej 15 ditëve. Për shkak se nuk e ka përmbushur detyrimin shuma do të mbahet nga garancia e punimeve. Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore me shkresën nr. Prot. 30 datë 05.01.2026 është njoftuar Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK që asnjë nga subjektet nuk ka vijuar me pagesat përkatëse dhe është kërkuar vazhdimi i procedurës sipas Planit të Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të KLSH-së 2023-2024.

Kërkesa për pagesën e fondit 5% të garancisë të punimeve është dorëzuar në Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe MFK në datë 12.03.2026 me nr. Prot 2570.

Gjatë kryerjes së procedurës të pagesës të fondit 5% të garancisë së punimeve është zbritur detyrimi i subjektit "Almo Konstruction" për vlerën 1,718,360 lek. Dokumenti justifikues është Urdhër Shpenzimi nr. 274, dt. 09.04.2026 sipas të cilit shuma 1,718,360 lek ka kaluar në degën e thesarit, llogaria e bashkisë. Sistemimet në kontabilitet do të reflektohen në bilancin e vitit 2026.

Statusi: *Zbatuar*

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me nr. 6428/2 Prot, datë 30.08.2023 me objekt: "Rikonstruksion shkolla e mesme e përgjithshme "Ymer Dishnica", të lidhur mes AK Bashkisë Korçë dhe sipërmarrësit të punimeve shoqërisë N. me NIPT J....U dhe Lic. nr. NZ2..., me vlerë të kontratës 17,273,473.6 lekë me TVSH dhe, afat të realizimit të kontratës gjashtë muaj nga data e nënshkrimit të kontratës, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve/zëra pune jo në përputhje me specifikimet teknike/zëra punë të librezuara dhe të situacionuar jo në përputhje e faktin, përkatësisht për zërat: (Rrethimi i fushës me rrjetë teli (h=6 ml), F.V. Tuba xingato e rakorderi 4", F.V. Tuba xingato e rakorderi 1 1/2", F.V. Tuba xingato e rakorderi 1", F.V. Tuba xingato e rakorderi 3/4",), me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Korçë, në vlerën 216,105 lekë pa TVSH, specifikisht si vijon:

-Vlera 28,080 lekë pa TVSH, përfaqëson punime të pakryera në volumet e situacionuara, për zërin "Zëri (3.837/a). Rrethimi i fushës me rrjetë teli (h=6 ml)".

-Vlera 188,025 lekë pa TVSH, përfaqëson punime ndërtimi për zëra pune të realizuara jo në përputhje me specifikimet teknike dhe kushtet e kontratës me nr. 6428/2 Prot, datë 30.08.2023 të lidhur mes AK Bashkisë Korçë dhe sipërmarrësit të punimeve shoqërisë N...". Këto veprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve me nr. 6428/2 Prot, datë 30.08.2023 të lidhur mes AK Bashkisë Korçë dhe, sipërmarrësit të punimeve OE N.. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4 faqe 88-279 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Bashkia Korçë në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve, nisur nga fakti që kontrata për punë publike me objekt: "Rikonstruksion shkolla e mesme e përgjithshme "Ymer

Dishnica" është në periudhë garancie deri me datë 20.07.2026, të marrë masa për verifikimin e realizimit të zërave të punimeve "F.V. Tuba xingato e rakorderi 4", F.V. Tuba xingato e rakorderi 1 1/2", F.V. Tuba xingato e rakorderi 1", F.V. Tuba xingato e rakorderi 3/4"" në përputhje me specifikimet teknike.
Në rast të mos përputhshmërisë me përcaktimet kontraktore dhe specifikimet teknike, të merren masa për zbritjen nga garancia e punimeve të vlerës **216,105 lekë pa TVSH**, përfituar padrejtësisht nga Kontraktori N..., për punime të certifikuara, por të pa realizuara kushteve të kontratës.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Është kryer kontabilizimi i detyrimit të subjektit N..." me urdhër nr.1284, datë 17.11.2025 të Kryetarit të Bashkisë për vlerën **216,105 lekë,** e cila do të mbahet nga garancia e punimeve. Subjekti është njoftuar me shkresën nr. Prot. 12839 datë 02.12.2025 për përmbushjen e detyrimit në mënyrë vullnetare duke i lënë një afat kohor prej 15 ditëve. Për shkak se nuk e ka përmbushur detyrimin shuma do të mbahet nga garancia e punimeve. Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore me shkresën nr. Prot. 30 datë 05.01.2026 është njoftuar Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK që asnjë nga subjektet nuk ka vijuar me pagesat përkatëse dhe është kërkuar vazhdimi i procedurës sipas Planit të Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të KLSH-së 2023-2024.

Statusi: *Zbatuar referuar kundërshtive të subjektit*

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me nr. 5580/2 Prot, datë 24.07.2023 me objekt: "Terrenet sportive dhe punime të tjera shkolla "Themistokli Gërmenji"" të lidhur mes AK Bashkisë Korçë dhe sipërmarrësit të punimeve shoqërisë N. me NIPT J....U dhe Lic. nr. NZ2..., me vlerë të kontratës është 18,340,134 lekë me TVSH dhe, afat të realizimit të kontratës dy muaj nga data e nënshkrimit të kontratës, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve të parashikuara në projekt – preventiv, përkatësisht (Transport materiale ndërtimi; Shtresë asfaltobetoni me makineri 4 cm; Shtresë binderi me zall lavatrice, 8 cm, me makineri; Shtresë e gomuar Rezinë (Polieratin + rezinë) e përbërë për fushën e basketbollit; Këpucë plastike dyshemeje), me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Korçë, në vlerën 325,150 lekë pa TVSH. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 5580/2 Prot, datë 24.07.2023 të lidhur ndërmjet AK Bashkisë Korçë dhe shoqërisë I.. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4 faqe 88-279 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për zbritjen nga garancia e punimeve të vlerës **325,150 lekë pa TVSH** përfituar nga shoqëria N..., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 5580/2 Prot, datë 24.07.2023, për punime të certifikuara dhe të situacionuara, por të pa realizuara në objekt.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Është kryer kontabilizimi i detyrimit të subjektit N..." me urdhër nr.1284 datë 17.11.2025 të Kryetarit të Bashkisë për vlerën **325,150 lekë,** e cila do të mbahet nga garancia e punimeve.
Subjekti është njoftuar me shkresën nr. 12839 Prot. datë 02.12.2025 për përmbushjen e detyrimit në mënyrë vullnetare duke i lënë një afat kohor prej 15 ditëve. Për shkak se nuk e ka përmbushur detyrimin shuma do të mbahet nga garancia e punimeve. Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore me shkresën nr. Prot. 30 datë 05.01.2026 është njoftuar Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK që asnjë nga subjektet nuk ka vijuar me pagesat përkatëse dhe është kërkuar vazhdimi i procedurës sipas Planit të Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të KLSH-së 2023-2024.

Statusi: *Zbatuar referuar kundërshtive të subjektit*

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë me nr. 6981/2 Prot, datë 19.09.2023 me objekt: "Rikonstruksion i shkollës 9 –vjeçare Vithkuq" të lidhur mes AK Bashkisë Korçë dhe sipërmarrësit të punimeve shoqërisë "V." SHPK me NIPT K5...C dhe Lic. nr. NZ2..., me vlerë të kontratës 3,473,369 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës dy muaj nga data e nënshkrimit të kontratës, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve të parashikuara në projekt – preventiv, përkatësisht (Nënshtresë zhavorri; Shtresë betoni niveluese në themel; Ulluk shkarkimi horizontal dhe vertikal; Kaseta shkarkimi), me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Korçë, në vlerën 306,605 lekë pa TVSH. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 6981/2 Prot, datë 19.09.2023 të lidhur ndërmjet AK Bashkisë Korçë dhe shoqërisë "V." SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4 faqe 88-279 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për zbritjen nga garancisë e punimeve të vlerës **306,605 lekë** përfituar padrejtësisht nga Kontraktori "V." SHPK, për punime të certifikuara, por të pa realizuara.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Është kryer kontabilizimi i detyrimit të subjektit "V. ShPK" me urdhër nr.1284 datë 17.11.2025 të Kryetarit të Bashkisë për vlerën **306,605 lekë,** e cila do të mbahet nga garancia e punimeve. Subjekti është njoftuar me shkresën nr. Prot. 12844 datë 02.12.2025 për përmbushjen e detyrimit në mënyrë vullnetare duke i lënë një afat kohor prej 15 ditëve. Për shkak se nuk e ka përmbushur detyrimin shuma do të mbahet nga garancia e punimeve. Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore me shkresën nr. Prot. 30 datë 05.01.2026 është njoftuar Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK që asnjë nga subjektet nuk ka vijuar me pagesat përkatëse dhe është kërkuar vazhdimi i procedurës sipas Planit të Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të KLSH-së 2023-2024.

Statusi: *Zbatuar pjesërisht, pasi nga vlera 306,605 lekë është likujduar vlera 173,668 lekë, duke mbetur për likujdim vlera 132,937, referuar kundërshtive të subjektit*

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë me nr. 4359/2 Prot, datë 12.06.2023 dhe objekt: "Qendra e kreativitetit faza II" Bashkia Korçë të lidhur mes AK Bashkisë Korçë dhe sipërmarrësit të punimeve shoqërisë "Z." SHPK me NIPT L...O dhe Lic. Nr. NZ7..., me vlerë të kontratës 14,847,737.7 lekë me TVSH dhe, afat të realizimit të kontratës dy muaj nga data e nënshkrimit të kontratës, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara dhe specifikimet teknike, për zërat e punimeve të parashikuara në projekt – preventiv, përkatësisht (Tendë e motorizuar me ndriçim, Vetratë Alumin me xham triplex), me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Korçë, në vlerën 670,394 lekë pa TVSH. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 4359/2 Prot, datë 12.06.2023 të lidhur ndërmjet AK Bashkisë Korçë dhe shoqërisë "Z." SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4 faqe 88-279 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Korçë në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve, nisur nga fakti që kontrata për punë publike me objekt: "Qendra e kreativitetit faza II" është në periudhë garancie deri me datë 05.12.2025, të marrë masa për verifikimin e realizimit të zërave të punimeve "Tendë e motorizuar me ndriçim, Vetratë Alumin me xham triplex" në përputhje me specifikimet teknike.

Në rast të mos përputhshmërisë me përcaktimet kontraktore dhe specifikimet teknike, të merren masa për zbritjen nga garancia e punimeve të vlerës **670,394 lekë pa TVSH**, përfituar padrejtësisht

nga Kontraktori "Z." SHPK, për punime të certifikuara, por të pa realizuara kushteve të kontratës dhe specifikimet teknike.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Është kryer kontabilizimi i detyrimit të subjektit "Z." me urdhër nr.1284 datë 17.11.2025 të Kryetarit të Bashkisë për vlerën **670,394 lekë,** e cila do të mbahet nga garancia e punimeve.
Subjekti është njoftuar me shkresën nr. Prot. 12843 datë 02.12.2025 për përmbushjen e detyrimit në mënyrë vullnetare duke i lënë një afat kohor prej 15 ditëve. Për shkak se nuk e ka përmbushur detyrimin shuma do të mbahet nga garancia e punimeve. Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore me shkresën nr. Prot. 30 datë 05.01.2026 është njoftuar Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK që asnjë nga subjektet nuk ka vijuar me pagesat përkatëse dhe është kërkuar vazhdimi i procedurës sipas Planit të Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të KLSH-së 2023-2024.

Statusi: *Zbatuar referuar kundërshtive të subjektit*

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë me nr. 6173/2 Prot, datë 15.08.2023 me objekt: "Ndërtim i palestrës së shkollës "Sevasti Qiriazi" të lidhur mes AK Bashkisë Korçë dhe sipërmarrësit të punimeve shoqërisë N. me NIPT J....U dhe Lic. nr. NZ2..., me vlerë të kontratës 9,240,783.12 lekë me TVSH dhe fat të realizimit të kontratës 92 ditë kalendarike nga data e lidhjes së kontratës, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara dhe specifikimet teknike, për zërat e punimeve të parashikuara në projekt – preventiv, përkatësisht (Gërmim themele e plinta b>2m; Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 10 km; Mure b/a t=21-30 cm, h-4m C 20/25; Konstruksione metalike të përbëra; F.V. Panele sfungjeri 8 cm për rrethimin e fushës së basketbollit, e pajisur me elementë mbajtës dhe bashkues. H=1.8 metër; F.V. Derë metalike e blinduar), me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Korçë, në vlerën 207,600 lekë pa TVSH, specifikisht si vijon:
- Vlera 138,750 lekë pa TVSH, përfaqëson punime ndërtimi të realizuar jo në përputhje me librezën e masave, ku volumi i situacionuar nuk përputhet me volumin e pasqyruar në librezën e masave, për zërat e punëve "(Gërmim themele e plinta b>2m; Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 10 km; Mure b/a t=21-30 cm, h-4 m C 20/25; Konstruksione metalike të përbëra; F.V. Derë metalike e blinduar".
- Vlera 68,850 lekë pa TVSH, përfaqëson punime ndërtimi për zëra pune të realizuara jo në përputhje me specifikimet teknike për zërin "F.V. Panele sfungjeri 8 cm për rrethimin e fushës së basketbollit, e pajisur me elementë mbajtës dhe bashkues. H=1.8 metër". Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve me nr. 6173/2 Prot, datë 15.08.2023 të lidhur mes AK Bashkisë Korçë dhe, sipërmarrësit të punimeve OE N.. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4 faqe 88-279 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për zbritjen nga garancia e punimeve të vlerës **138,750 lekë pa TVSH** përfituar nga shoqëria N..., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 6173/2 Prot, datë 15.08.2023, për punime të certifikuara dhe të situacionuara, por të pa realizuara në objekt në përputhje me volumet sipas projektit të zbatimit.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Është kryer kontabilizimi i detyrimit të subjektit N..." me urdhër nr.1284 datë 17.11.2025 të Kryetarit të Bashkisë për vlerën **138,750 lekë,** e cila do të mbahet nga garancia e punimeve.
Subjekti është njoftuar me shkresën nr. Prot. 12839 datë 02.12.2025 për përmbushjen e detyrimit në mënyrë vullnetare duke i lënë një afat kohor prej 15 ditëve. Për shkak se nuk e ka përmbushur

detyrimin shuma do të mbahet nga garancia e punimeve. Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore me shkresën nr. Prot. 30 datë 05.01.2026 është njoftuar Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK që asnjë nga subjektet nuk ka vijuar me pagesat përkatëse dhe është kërkuar vazhdimi i procedurës sipas Planit të Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të KLSH-së 2023-2024.

Statusi: *Zbatuar referuar kundërshtive të subjektit*

6.2. Rekomandimi: Bashkia Korçë në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve, nisur nga fakti që kontrata për punë publike me objekt: "Ndërtim i palestrës së shkollës "Sevasti Qiriazi" është në periudhë garancie deri me datë 19.12.2025, të marrë masa për verifikimin e realizimit të zërit të punimeve "F.V. Panele sfungjeri 8 cm për rrethimin e fushës së basketbollit, e pajisur me elementë mbajtës dhe bashkues. H=1.8 metër" në përputhje me specifikimet teknike.
Në rast të mos përputhshmërisë me përcaktimet kontraktore dhe specifikimet teknike, të merren masa për zbritjen nga garancia e punimeve të vlerës **68,850 lekë pa TVSH**, përfituar padrejtësisht nga Kontraktori N..., për punime të certifikuara, por të pa realizuara kushteve të kontratës dhe specifikimeve teknike.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Është kryer kontabilizimi i detyrimit të subjektit N..." me urdhër nr.1284 datë 17.11.2025 të Kryetarit të Bashkisë për vlerën **68,850 lekë,** e cila do të mbahet nga garancia e punimeve.
Subjekti është njoftuar me shkresën nr. Prot. 12839 datë 02.12.2025 për përmbushjen e detyrimit në mënyrë vullnetare duke i lënë një afat kohor prej 15 ditëve. Për shkak se nuk e ka përmbushur detyrimin shuma do të mbahet nga garancia e punimeve. Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore me shkresën nr. Prot. 30 datë 05.01.2026 është njoftuar Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK që asnjë nga subjektet nuk ka vijuar me pagesat përkatëse dhe është kërkuar vazhdimi i procedurës sipas Planit të Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të KLSH-së 2023-2024.

Statusi: *Zbatuar referuar kundërshtive të subjektit*

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë me nr. 8287/2 Prot, datë 27.10.2023 me objekt: "Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara" të lidhur mes AK Bashkisë Korçë dhe sipërmarrësit të punimeve bashkimit të përkohshëm të shoqërive "A." SHPK (58.5%) & K... (41.5%), përfaqësuar nga shoqëria "A." SHPK, me NIPT M...H, me vlerë të kontratës 25,465,502 lekë me TVSH dhe, afat të realizimit të kontratës 6 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve të parashikuara në projekt – preventiv, përkatësisht [Kasetë llamarine; F.V. Impjuve llamarinë në oxhak; Ulluk shkarkimi vertikal me PVC d=120 mm (Ndërtim çatie, P. 15 (5 KT) Rr. "Xhafer Cenko Lubonja" L. 17)], me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Korçë, në vlerën 113,200 lekë pa TVSH. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 8287/2 Prot, datë 27.10.2023 të lidhur ndërmjet AK Bashkisë Korçë dhe BOE "A." & K. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4 faqe 88-279 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
7.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për zbritjen nga garancisë e punimeve të vlerës **113,200 lekë** përfituar padrejtësisht nga BOE "A. & K., për punime të certifikuara, por të pa realizuara.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Është kryer kontabilizimi i detyrimit të BOE "A. & K." me urdhër nr.1284 datë 17.11.2025 të Kryetarit të Bashkisë për vlerën **113,200 lekë,** e cila do të mbahet nga garancia e punimeve.

Subjekti është njoftuar me shkresën nr. Prot. 12845 datë 02.12.2025 për përmbushjen e detyrimit në mënyrë vullnetare duke i lënë një afat kohor prej 15 ditëve. Për shkak se nuk e ka përmbushur detyrimin shuma do të mbahet nga garancia e punimeve. Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore me shkresën nr. Prot. 30 datë 05.01.2026 është njoftuar Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK që asnjë nga subjektet nuk ka vijuar me pagesat përkatëse dhe është kërkuar vazhdimi i procedurës sipas Planit të Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të KLSH-së 2023-2024.

Statusi: *Zbatuar referuar kundërshtive të subjektit*

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë me nr. 5745/2 Prot, datë 31.07.2023 të lidhur mes AK Bashkisë Korçë dhe sipërmarrësit të punimeve shoqërisë N. me NIPT J....U dhe Lic. nr. NZ2..., me vlerë të kontratës 7,697,930.94 lekë me TVSH dhe, afat të realizimit të kontratës 3 (tre) muaj nga data e nënshkrimit të kontratës, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve të parashikuara në projekt – preventiv, përkatësisht [Gërmim dheu me ekskavator zinxhir, 0.5 m^3 në kanale me gjerësi >2m, tok zak, kategoria IV, me shk në tokë; Transport dheu dalë nga gërmimet e kanalit të hapur deri në 5 km; Mbushje me çakëll e gur gurorre në trupin e kanalit të gërmuar; Shtresë çakelli mbeturinë kave t=20 cm, përhapur e ngjeshur me makineri], me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Korçë, në vlerën 110,250 lekë pa TVSH. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së 5745/2 Prot, datë 31.07.2023 të lidhur ndërmjet AK Bashkisë Korçë dhe shoqërisë N.. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4 faqe 88-279 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për zbritjen nga garancisë e punimeve të vlerës **110,250 lekë** përfituar padrejtësisht nga shoqëria N..., për punime të certifikuara, por të pa realizuara.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Është kryer kontabilizimi i detyrimit të subjektit N." me urdhër nr.1284 datë 17.11.2025 të Kryetarit të Bashkisë për vlerën **110,250 lekë,** e cila do të mbahet nga garancia e punimeve.

Subjekti është njoftuar me shkresën nr. Prot. 12839 datë 02.12.2025 për përmbushjen e detyrimit në mënyrë vullnetare duke i lënë një afat kohor prej 15 ditëve. Për shkak se nuk e ka përmbushur detyrimin shuma do të mbahet nga garancia e punimeve. Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore me shkresën nr. Prot. 30 datë 05.01.2026 është njoftuar Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK që asnjë nga subjektet nuk ka vijuar me pagesat përkatëse dhe është kërkuar vazhdimi i procedurës sipas Planit të Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të KLSH-së 2023-2024.

Statusi: *Zbatuar referuar kundërshtive të subjektit*

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me nr. 6550/2 Prot, datë 29.07.2024 me objekt: "Rikonstruksion i pjesshëm i degës Dunavec - Ventok në zonën e fshatit Lumalas Nj. A. Bulgarec" të lidhur mes AK Bashkisë Korçë dhe sipërmarrësit të punimeve bashkimit të përkohshëm të shoqërive XH. me NIPT J...M dhe Lic. nr. NZ10..., dhe OE I. me NIPT J...W me vlerë të kontratës 9,167,508 lekë me TVSH dhe, afat të realizimit të kontratës 80 ditë kalendarike nga data e lidhjes së kontratës, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve të parashikuara në projekt – preventiv, përkatësisht [Struktura monolite betoni C 16/20, Hekur betoni për pusetat], me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Korçë, në vlerën 162,000 lekë pa TVSH. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e*

Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve 6550/2 Prot, datë 29.07.2024 të lidhur ndërmjet AK Bashkisë Korçë dhe shoqërisë BOE "XH & I.". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4 faqe 88-279 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për zbritjen nga garancisë e punimeve të vlerës **162,000 lekë** përfituar padrejtësisht nga BOE "XH. & I.", për punime të certifikuara, por të pa realizuara.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Është kryer kontabilizimi i detyrimit të BOE "XH. & I." me urdhër nr.1284 datë 17.11.2025 të Kryetarit të Bashkisë për vlerën **162,000 lekë,** e cila do të mbahet nga garancia e punimeve. Subjekti është njoftuar me shkresën nr. Prot. 12846 datë 02.12.2025 për përmbushjen e detyrimit në mënyrë vullnetare duke i lënë një afat kohor prej 15 ditëve. Për shkak se nuk e ka përmbushur detyrimin shuma do të mbahet nga garancia e punimeve. Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore me shkresën nr. Prot. 30 datë 05.01.2026 është njoftuar Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK që asnjë nga subjektet nuk ka vijuar me pagesat përkatëse dhe është kërkuar vazhdimi i procedurës sipas Planit të Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të KLSH-së 2023-2024.

Statusi: *Zbatuar referuar kundërshtive të subjektit*

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me nr. 7736/2 Prot, datë 09.09.2024 me objekt "Ndërtimi i pritave malore dhe mbrojtjeve lumore në Njësitë Administrative, Bashkia Korçë" dhe të lidhur mes AK Bashkisë Korçë dhe sipërmarrësit të punimeve shoqërisë F. me NIPT K...C dhe Lic. nr. NZ4..., me vlerë të kontratës 10,903,914 lekë me TVSH dhe, afat të realizimit të kontratës 28 ditë kalendarike nga data e lidhjes së kontratës, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, për zërin e punimeve "Mbushje me gur kave" me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Korçë, në vlerën 76,453 lekë pa TVSH. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes të sipërcituar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4 faqe 88-279 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për zbritjen nga garancisë e punimeve të vlerës **76,453 lekë** përfituar padrejtësisht nga shoqëria F., për punime të certifikuara, por të pa realizuara në objekt.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Është kryer kontabilizimi i detyrimit të subjektit F... me urdhër nr.1284 datë 17.11.2025 të Kryetarit të Bashkisë për vlerën **76,453 lekë,** e cila do të mbahet nga garancia e punimeve. Subjekti është njoftuar me shkresën nr. Prot. 12841 datë 02.12.2025 për përmbushjen e detyrimit në mënyrë vullnetare duke i lënë një afat kohor prej 15 ditëve. Për shkak se nuk e ka përmbushur detyrimin shuma do të mbahet nga garancia e punimeve. Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore me shkresën nr. Prot. 30 datë 05.01.2026 është njoftuar Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK që asnjë nga subjektet nuk ka vijuar me pagesat përkatëse dhe është kërkuar vazhdimi i procedurës sipas Planit të Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të KLSH-së 2023-2024.

Statusi: *Zbatuar referuar kundërshtive të subjektit*

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me nr. 11330/2 Prot, datë 27.11.2024 me objekt "Rikonstruksioni i Muzeut Oriental "Bratko"" të lidhur mes AK Bashkisë Korçë dhe sipërmarrësit të punimeve shoqërisë N. me NIPT J....U dhe Lic. nr. NZ2..., me vlerë të kontratës 4,146,897 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 30 ditë kalendarike nga data e lidhjes së kontratës, rezultuan punime ndërtimi të pakryera

në volumet e situacionuara, për zërin e punimeve "Vetrao xhami i temperuar", me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Korçë, në vlerën 120,000 lekë pa TVSH. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes të sipërcituar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4 faqe 88-279 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për zbritjen nga garancisë e punimeve të vlerës **120,000 lekë** përfituar padrejtësisht nga shoqëria N..., për punime të certifikuara, por të pa realizuara në objekt.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Është kryer kontabilizimi i detyrimit të subjektit N..." me urdhër nr.1284 datë 17.11.2025 të Kryetarit të Bashkisë për vlerën **120,000 lekë,** e cila do të mbahet nga garancia e punimeve. Subjekti është njoftuar me shkresën nr. Prot. 12839 datë 02.12.2025 për përmbushjen e detyrimit në mënyrë vullnetare duke i lënë një afat kohor prej 15 ditëve. Për shkak se nuk e ka përmbushur detyrimin shuma do të mbahet nga garancia e punimeve. Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore me shkresën nr. Prot. 30 datë 05.01.2026 është njoftuar Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK që asnjë nga subjektet nuk ka vijuar me pagesat përkatëse dhe është kërkuar vazhdimi i procedurës sipas Planit të Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të KLSH-së 2023-2024.

Statusi: *Zbatuar referuar kundërshtive të subjektit*

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike nr. 5742/3 Prot, datë 16.07.2024 me objekt: "Rehabilitim i Qendrës Rinore Korçë" të lidhur mes AK Bashkisë Korçë dhe sipërmarrësit të punimeve shoqërisë I. me NIPT L...A dhe Lic. nr. NZ7..., me vlerë të kontratës 7,642,698 lekë me TVSH dhe, afat të realizimit të kontratës 90 ditë kalendarike nga data e lidhjes së kontratës, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, për zërin e punimeve "Veshje fasade me polisterol kompakt jeshil t=5 cm + rrjetë + suva, F.V Gaz për sistemin VRF tip R 410 A" me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Korçë, në vlerën 86,480 lekë pa TVSH. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes të sipërcituar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4 faqe 88-279 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për zbritjen nga garancisë e punimeve të vlerës **86,480 lekë** përfituar padrejtësisht nga shoqëria shoqërisë I..., për punime ndërtimi të certifikuara, por të pa realizuara në objekt.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Është kryer kontabilizimi i detyrimit të subjektit I... me urdhër nr.1284 datë 17.11.2025 të Kryetarit të Bashkisë për vlerën **86,480 lekë,** e cila do të mbahet nga garancia e punimeve. Subjekti është njoftuar me shkresën nr. Prot. 12837 datë 02.12.2025 për përmbushjen e detyrimit në mënyrë vullnetare duke i lënë një afat kohor prej 15 ditëve. Për shkak se nuk e ka përmbushur detyrimin shuma do të mbahet nga garancia e punimeve. Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore me shkresën nr. Prot. 30 datë 05.01.2026 është njoftuar Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK që asnjë nga subjektet nuk ka vijuar me pagesat përkatëse dhe është kërkuar vazhdimi i procedurës sipas Planit të Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të KLSH-së 2023-2024.

Statusi: *Zbatuar referuar kundërshtive të subjektit*

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës së shërbimit me nr. 3582/2 Prot, datë 12.06.2018 me objekt: "Kryerja e shërbimit të pastrimit në qytetin e Korçës" të lidhur mes AK Bashkisë Korçë dhe sipërmarrësit të shërbimeve shoqërisë K. SHPK, me NUIS J...G dhe vlerë

totale të kontratës për periudhën 5 vjeçare 398,088,920 lekë me TVSH, rezultoi se është përfituar në vlerën 714,096 lekë pa TVSH, për zërin e shërbimit "Depozitim inerte dhe roje v. Depozitim i vjetër" në mënyre të pajustifikuar dhe të paargumentuar me dokumentin përkatës mbi përcaktimin e volumit, veprime këto në kundërshtim me Kontratën e shërbimit me nr. 3582/2 Prot, datë 12.06.2018 me objekt: "Kryerja e shërbimit të pastrimit në qytetin e Korçës", si dhe VKM-në nr. 319 datë 31.05.2018 "*Për miratimin masave për koston e menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4 faqe 88-279 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për arkëtimin e vlerës **714,096 lekë pa TVSH,** përfituar padrejtësisht nga shoqëria shoqërisë K. SHPK, për zërin e shërbimit "Depozitim inerte dhe roje vend depozitim i vjetër" në mënyre të pajustifikuar dhe të paargumentuar me dokumentin përkatës mbi përcaktimin e volumit.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Është kryer kontabilizimi i detyrimit të subjektit "K. ShPK" me urdhër nr.1284 datë 17.11.2025 të Kryetarit të Bashkisë për vlerën **714,096 lekë.**

Subjekti është njoftuar me shkresën nr. Prot. 12837 datë 02.12.2025 për përmbushjen e detyrimit në mënyrë vullnetare duke i lënë një afat kohor prej 15 ditëve. Është kryer pagesa këtij detyrimi nga ana e subjektit "K. ShPK" në datë 16.12.2025 me faturë për arkëtim nr. 937 datë 10.12.2025 në "Pro Credit Bank.

Statusi: *Zbatuar*

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me nr. 9953/2 Prot, datë 31.10.2024 me objekt: "Rehabilitimi i digës së ujëmbledhësit të Gjonomadhit" të lidhur mes AK Bashkisë Korçë dhe sipërmarrësit të punimeve shoqërisë "A." SHPK, me NIPT M...H dhe lic. NZ.8..., me vlerë të kontratës 10,792,798 lekë me TVSH dhe, afat të realizimit të kontratës 2 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve të parashikuara në projekt – preventiv, përkatësisht [Shtresë zhavorr lumi t=20cm, Shtresë kalldëmi 20-25 cm, Mbushje me material të gërmuar në trupin e rrugës III, me shk në tokë, FV Gjeotekstil 165 g/m2, Mbushje me argjilë pas mureve], me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Korçë, në vlerën 260,415 lekë pa TVSH. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes të sipërcituar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4 faqe 88-279 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për zbritjen nga garancisë e punimeve të vlerës **260,415 lekë** përfituar padrejtësisht nga shoqëria "A." SHPK, për punime të certifikuara, por të pa realizuara në objekt.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Është kryer kontabilizimi i detyrimit të subjektit "A. ShPK" me urdhër nr.1284 datë 17.11.2025 të Kryetarit të Bashkisë për vlerën **260,415 lekë,** e cila do të mbahet nga garancia e punimeve. Subjekti është njoftuar me shkresën nr. Prot. 12836 datë 02.12.2025 për përmbushjen e detyrimit në mënyrë vullnetare duke i lënë një afat kohor prej 15 ditëve. Për shkak se nuk e ka përmbushur detyrimin shuma do të mbahet nga garancia e punimeve. Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore me shkresën nr. Prot. 30 datë 05.01.2026 është njoftuar Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK që asnjë nga subjektet nuk ka vijuar me pagesat përkatëse dhe është kërkuar vazhdimi i procedurës sipas Planit të Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të KLSH-së 2023-2024.

Statusi: *Zbatuar referuar kundërshtive të subjektit*

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë me nr. 7735/2 Prot, datë 09.09.2024 me objekt: "Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfra dhe të pa favorizuara" të lidhur mes AK Bashkisë Korçë dhe sipërmarrësit të punimeve shoqërisë "V." SHPK me NIPT K5...C dhe Lic. nr. NZ2..., me vlerë të kontratës 7,780,667 lekë me TVSH dhe, afat të realizimit të kontratës 3 (tre) muaj nga data e nënshkrimit të kontratës, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërin e punimeve të parashikuara në projekt – preventiv, përkatësisht (Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 5.0 km), me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Korçë, në vlerën 110,750 lekë pa TVSH. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes të sipërcituar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4 faqe 88-279 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për zbritjen nga garancisë e punimeve të vlerës **110,750 lekë** përfituar padrejtësisht nga shoqëria "V. SHPK, për punime të certifikuara, por të pa realizuara në objekt.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Është kryer kontabilizimi i detyrimit të subjektit "V. ShPK" me urdhër nr.1284 datë 17.11.2025 të Kryetarit të Bashkisë për vlerën **110,750 lekë,** e cila do të mbahet nga garancia e punimeve. Subjekti është njoftuar me shkresën nr. Prot. 12844 datë 02.12.2025 për përmbushjen e detyrimit në mënyrë vullnetare duke i lënë një afat kohor prej 15 ditëve. Për shkak se nuk e ka përmbushur detyrimin shuma do të mbahet nga garancia e punimeve. Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore me shkresën nr. Prot. 30 datë 05.01.2026 është njoftuar Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK që asnjë nga subjektet nuk ka vijuar me pagesat përkatëse dhe është kërkuar vazhdimi i procedurës sipas Planit të Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të KLSH-së 2023-2024.

Statusi: *Zbatuar referuar kundërshtive të subjektit*

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 6776/16, datë 02.09.2026 *(prot KLSH nr. 735/4, dt. 08.09.2026)* "Mbi Projekt Raportin e Auditimit" nga ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: *Lidhur Rekomandimin 2.1, me detyrimin e subjektit N... për vlerën **216,105 lekë** pa TVSh është kryer ndalesa nga garancia e punimeve (5%) sipas urdhër shpenzimit nr. 799, datë 21.8.2026 për investimin me objekt "Rikonstruksion shkolla e mesme Ymer Dishnica".*

*Lidhur Rekomandimin 3.1, me detyrimin e subjektit N. për vlerën **325,150 lekë** pa TVSh është kryer ndalesa nga garancia e punimeve (5%) sipas urdhër shpenzimit nr. 800, datë 21.8.2026 për investimin me objekt "Terenet sportive dhe punimeve të tjera shkolla Themistokli Gërmenji".*

*Lidhur Rekomandimin 4.1, me detyrimin e subjektit "V." ShPK për vlerën **173,668 lekë** pa TVSh është kryer ndalesa nga garancia e punimeve (5%) sipas urdhër shpenzimit nr. 800, datë 21.8.2026 për investimin me objekt "Rikonstruksion i shkollës Vithkuq".*

*Lidhur Rekomandimin 5.1, me detyrimin e subjektit "Z." ShPK për vlerën **670,394 lekë** pa TVSh është kryer ndalesa nga garancia e punimeve (5%) sipas urdhër shpenzimit nr. 800, datë 21.8.2026 për investimin me objekt "Qendra e Kreatvitit faza II".*

*Lidhur Rekomandimin 6.1, me detyrimin e subjektit N. për vlerën **207,600 lekë** pa TVSh (138,750 + 68,850)është kryer ndalesa nga garancia e punimeve (5%) sipas urdhër shpenzimit nr. 800, datë 21.8.2026 për investimet me objektin "Ndërtim i palestrës së shkollës Sevasti Qirjazi".*

*Lidhur Rekomandimin 7.1, me detyrimin e subjektit "A. & K. për vlerën **113,200 lekë** pa TVSh është kryer ndalesa nga garancia e punimeve (5%) sipas urdhër shpenzimit nr. 631, datë*

16.7.2026, për investimin me objekt "Përmisim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të paforizuara".
*Lidhur Rekomandimin 8.1, me detyrimin e subjektit N... për vlerën **110,250 lekë** pa TVSh është kryer ndalesa nga garancia e punimeve (5%) sipas urdhër shpenzimit nr. 799, datë 21.8.2026, për investimin me objekt "Rehabilitim dhe veshje me beton kanali Drenovë ndërtim tombino fshati Hrumujas dhe rikonstruksion i rrugës autopyjore Denas".*
*Lidhur Rekomandimin 9.1, me detyrimin e subjektit XH.... për vlerën **162,000 lekë** pa TVSh është kryer ndalesa nga garancia e punimeve (5%) sipas urdhër shpenzimit nr. 799, datë 21.8.2026 për investimin me objekt "Rikon i pjesshëm i degës Dunavec-Ventrok në zonën e fshatit Lumalas NJA Bulgarec".*
*Lidhur Rekomandimin 10.1, me detyrimin e subjektit F... për vlerën **76,453 lekë** pa TVSh është kryer ndalesa nga garancia e punimeve (5%) sipas urdhër shpenzimit nr. 799, datë 21.8.2026 për investimin me objekt "Ndërtim i pritave malore dhe mbrojtjeve lumore në NJA".*
*Lidhur Rekomandimin 11.1, me detyrimin e subjektit N... për vlerën **120,000 lekë** pa TVSh është kryer ndalesa nga garancia e punimeve (5%) sipas urdhër shpenzimit nr. 799, datë 21.8.2026 për investimin me objekt "Rikonstruksion i Muzeut Oriental Bratko".*
*Lidhur Rekomandimin 12.1, me detyrimin e subjektit I. ShPK për vlerën **86,480 lekë** pa TVSh është kryer ndalesa nga garancia e punimeve (5%) sipas urdhër shpenzimit nr. 799, datë 21.8.2026 për investimin me objekt "Rehabilitim i qendrës Rinore Korçë".*
*Lidhur Rekomandimin 14.1, me detyrimin e subjektit "A." ShPK për vlerën **260,415 lekë** pa TVSh është kryer ndalesa nga garancia e punimeve (5%) sipas urdhër shpenzimit nr. 799, datë 21.8.2026 për investimin me objekt*
"Rehabilitim i digës së ujësjellësit të Gjonomadhi".
*Lidhur Rekomandimin 15.1, me detyrimin e subjektit "V." ShPK për vlerën **110,750 lekë** pa TVSh është kryer ndalesa nga garancia e punimeve (5%) sipas urdhër shpenzimit nr. 799, datë 21.8.2026 për investimin me objekt "Përmisim i banesave ekzistuese për komitetin të varfëra dhe të paforizuara".*
Qëndrim i grupit të auditimit. Referuar dokumentacionit të paraqitur në fazën e Projektraportit, shoqeuar me dokumentacion mbështetës, pretendimet merren në konsideratë dhe nuk gjejnë pasqyrim në fazën finale të RPA.

D. <u>Masa për elimimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, me pasojë mungesë të ardhurash</u>.

1. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2023 rezultojnë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Korçë në shumën 230,950 lekë për tarifën e zënien e hapësirave publike *"Për shërbim me tavolina jashtë lokalit"* si pasojë e përllogaritjes së pasaktë të kësaj tarife nga Sektori i Kontrollit jo Ushqimor dhe Licencimit. Ndërsa për vitin 2024 tarifën e zënien e hapësirave publike është përllogaritur dhe aplikuar saktë në muajt me 31 ditë për datat 31 të muajve të vitit. Këto veprime janë në kundërshtim me paketën fiskale të miratuar me VKB-në nr. 168 datë 24.11.2022 "Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në bashkinë e Korçës, si dhe penalitetet për shkeljet apo kundërvajtjet administrative për vitin 2023", Kapitulli IV pika 7, me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", neni 9 pika 1, nënpika 1.3 germat a, b, ç; me Ligjin nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" nenet 10, 11 dhe 14, pika 5; me Rregulloren e Bashkisë Korçë miratuar me Urdhër nr. 142, datë 01.03.2021, pika 59.3.1 dhe 59.3.4. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, në faqet 27-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
<u>1.1. Rekomandimi</u>: Drejtoria e Kontrollit të Territorit, Sektori i Kontrollit jo Ushqimor dhe Licencimit në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrin masa për

faturimin e tarifës se zënies së hapësirave publike për vlerën 230,950 lekë, sipas subjekteve përkatëse, për të cilat nuk është kryer përllogaritja e saktë e tarifës.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Nga ana e Drejtorisë së Kontroll Territorit, Sektori i Kontrollit Jo Ushqimor dhe Licencimit, në muajin shkurt 2025, është dërguar materiali i plotë tek Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për të vazhduar procedurën e vjeljes së të ardhurave. Nga DTTV është bërë ngarkimi në sistem i vlerës, dhe po vijohet me arkëtimin e detyrimit.

Statusi: *Në proces*

2. Gjetje nga auditimi: Referuar të dhënave të DTTV detyrimet e gjobave për pagesë të vonuar për detyrimet e taksave dhe tarifave vendore që plotësojnë afatin 1 vjeçar të maturimit si detyrim i pa likuiduar, sipas viteve, për periudhën 2015-2023 janë përllogaritur në vlerën prej 35,291,275 lekë, vlerë e pa arkëtuar si rrjedhojë e mosarkëtimit të vlerave debitore deri në fund të vitit 2024. Gjithashtu kjo vlerë nuk është kontabilizuar, pavarësisht se në sistemin informatik të taksave dhe tarifave këto kamatëvonesa gjenerohet në mënyrë automatike dhe faturohet bashkë me detyrimin e papaguar. Në Bashkinë Korçë ka filluar aplikimi i gjobës për vonesë në pagesë prej vitit 2015 referuar ndryshimeve të akteve ligjore dhe nënligjore. Këto veprime janë në kundërshtim me UMFE nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të PF vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar Kap. III, pika 3.2; me VKB-në nr. 168 datë 24.11.2022 "Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë e Korçës, si dhe penalitetet për shkeljet apo kundërvajtjet administrative për vitin 2023" pika 1.2/b. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, në faqet 27-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkëpunojë me Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit për marrjen e masave për kryerjen e veprimeve për kontabilizimin e vlerës prej **35,291,275 lekë** për gjobat për pagesë të vonuar dhe të njoftojë debitorët për kryerjen e pagesës së detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore së bashku me gjobën për pagesë të vonuar.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Bashkia Korçë ka përllogaritur gjobë për vonesë në pagesë të subjekteve debitorë progresivë në vlerën 22,341,288 lekë dhe me shkresën nr. 7119 Prot, datë 18.07.2025 më lëndë: Dërgohen të dhëna për kontabilizim, i ka dërguar drejtorisë së financës listën progresive me subjektet të cilat duhet të shtohet detyrimi për gjobë për vonesë në pagesë të përllogaritura deri në datë 30.06.2025. Në lidhje me diferencën është për faktin se gjoba në sistem ka filluar nga viti 2015 dhe jo në 2011, dhe pjesa tjetër rezultonte e likuiduar ndërvite sipas dokumentacionit.

Statusi: *Zbatuar*

E. Masa për rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat e tarifat vendore dhe qiradhëniet.

1. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nuk ka ruajtur gjurmën e auditimit për regjistrin e tarifave dhe taksave vendore për vitin 2023, gjë e cila e bëri të pamundur auditimin e faturimeve të taksave dhe tarifave vendore dhe ngjarjeve ekonomike, që kanë ndodhur gjatë vitit 2023. Ndërsa për vitin 2024 gjurma e auditimit është materializuar nëpërmjet arshivimit nga DTTV me shkresën nr. 12572 Prot, datë 31.12.2024 të regjistrit të printuar gjeneruar nga sistemi informatik i të ardhurave nga taksat dhe tarifat. Në bazë të përpunimit të të dhënave të dokumentacionit dhe informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore (DTTV) në Bashkinë Korçë, rezultoi nivel i lartë debitorësh në numër dhe në vlerë, për biznesin, taksat dhe tarifat vendore, i cili nga viti në vit ka ardhur duke u rritur, kështu në **fund të**

vitit 2022 vlera debitorëve është 547,619,161 lekë, ndërsa **vlera borxhit të krijuar gjatë vitit 2023 është 32,504,507 lekë** dhe **në fund të vitit 2023 vlera debitorëve është 580,123,668 lekë,** vlerë e cila është pjesë e gjendjes së llogarisë 468 *"Debitorë të ndryshëm"*. **Gjatë vitit 2024** vlera **borxhit të krijuar** është **38,205,156 lekë** dhe **në fund** të **vitit 2024 vlera progresive** e borxhit tatimor është **618,328,823 lekë,** e cila përbëhet nga:

- Detyrimet nga taksat dhe tarifat e bizneseve, në vlerën 284,804,848 lekë, ku 69,378 mijë lekë është detyrim i 368 subjekteve të cilët rezultojnë me status pasiv/mbyllur.
- Detyrime nga taksat dhe tarifat vendore për familjet në vlerën **333,523,975 lekë**, vlerë kjo që ka sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Korçë.

Në vijim të punës për vjeljen e detyrimeve:

- **Në vitin 2023** janë nxjerrë 7652 njoftime për pagesë të detyrimeve për bizneset dhe familjarët, masa shtrëngese të bllokimit të llogarive bankare për 539 biznese dhe bllokime të pronave në ASHK për 48 taksapagues të biznesit, si dhe njoftime për vendosjen e barrës siguruese RBS për 105 subjekte. Nga këto masa kanë paguar 208 subjekte biznesi në vlerën 20,931,437 lekë.
- **Në vitin 2024** janë nxjerrë 2,732 njoftime për biznesin dhe 7,642 për familjarët, urdhër për bllokime të llogarive bankare për 362 biznese dhe 1419 për familjarë dhe bllokime të pronave në ASHK për 10 taksapagues të biznesit. Si rezultat i këtyre masave të marra nga debitorët gjatë vitit 2024 kanë likuiduar detyrimet 194 subjekte në vlerën 18,335,303 lekë dhe 254 taksapagues familjarë në vlerën 6,452,574 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, nenet 89, 90, 91 dhe 93 dhe me VKB-në nr. 153, datë 07.12.2023 "Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore dhe kundërvajtjet administrative për vitin 2024". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 27-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimeve tatimore për debitorët dhe në vijim të ndjekë të gjitha rrugët ligjore në rend shterues, për arkëtimin e detyrimeve debitore në vlerën **618,328,823 lekë** nga subjektet e biznesit dhe taksapaguesit familjarë.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ka vijuar me nxjerrjen e njoftim vlerësimeve tatimore, njoftimeve dhe kërkesave për pagesë për 5564 subjekte biznesi dhe taksa pagues familjare (1375 biznese+4189 taksa pagues familjare). Gjithashtu, janë nxjerr urdhra për vendosjen e sekuestro së llogarive bankare, gjithsej 2974 subjekte (1671 biznese+1303 taksa pagues familjare). Në vazhdimësi është vendosur barrë hipotekore për 35 subjekte të biznesit.

Statusi: *Në proces zbatimi*

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit financiar të pagesave për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet e ndërtimeve informale (TNI) u konstatua se, në fillim të vitit 2023 është trashëguar vlerë progresive debitore prej 23,392,162 lekë. Gjatë vitit 2023 është shtuar vlerë debitore në vlerën 3,245,759 lekë, duke mbetur në fund të vitit 2023 vlerë debitore progresive prej 26,637,921 lekë nga 311 individë. Gjatë vitit 2024 vlera debitore është shtuar me 4,966,607 lekë, duke mbetur në fund të vitit 2024 vlera debitore progresive **prej 31,604,528 lekë nga 422 individë për TNI** nga legalizimet, duke sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Korçë. Në gjendjen e llog. 468 "Debitorë të ndryshëm" në mbyllje të vitit 2023 është kontabilizuar vlera progresive prej 23,392,162 lekë, pra 8,212,366 lekë më pak, diferencë e cila përbëhet nga vlera e debitorëve prej 3,245,759 lekë e krijuar gjatë vitit 2023 (e pa kontabilizuar), nga vlera e debitorëve prej 4,966,607 lekë e krijuar gjatë vitit 2024 (e pa kontabilizuar pasi nuk janë mbyllur PF). Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të

zbatueshme për legalizim", pika 5, në Udhëzimin e MFE nr. 8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të PF vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, Kap. III, pika 3.2, si dhe me VKB-në nr. 153, datë 07.12.2023 "Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore dhe kundërvajtjet administrative për vitin 2024". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 27-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Korçë të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë dhe nëpërmjet Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 422 debitorë në vlerën **31,604,528 lekë** dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen, duke u shoqëruar me një evidentim të saktë edhe në kontabilitet.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ka vijuar me nxjerrjen e njoftimeve dhe kërkesave për pagesë, si dhe do ndjekë të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet sipas përcaktimeve ligjore. Theksojmë se A.SH.K njofton periodikisht Bashkinë Korçë në lidhje me legalizimet e reja që kryhen dhe mbi bazën e këtyre njoftimeve Bashkia Korçë identifikon, njofton dhe ndjek arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet. Në lidhje me këtë pikë theksojmë se me shkresën nr. 7116 Prot, datë 18.07.2025 me lëndë: Kërkesë për bashkëpunim, drejtuar A.SH.K, Drejtorisë Vendore Korçë i është kërkuar mos ofrimi i shërbimeve personave që figurojnë debitorë për TNI si dhe për personat të cilët janë pajisur me çertifikatë pronësie pavarësisht se ata figurojnë debitore për TNI të na vihet në dispozicion të dhënat e pronës në mënyrë që të vazhdojmë me vendosjen e masave shtrënguese.

Me shkresën nr. 7117. Datë18.07.2025, me lëndë: Kërkim informacioni, drejtuar A.SH.K, Drejtorisë Vendore Korçë i është kërkuar të na vendosë në dispozicion adresat dhe NID të të çdo personi që ka legalizuar apo është në proces legalizimi në mënyrë që të kemi të dhëna të sakta në lidhje me debitorët.

Statusi: *Në proces zbatimi*

3. Gjetje nga auditimi: Bashkia Korçë në zbatim të përcaktimeve ligjore në fuqi për administrimin e aseteve në pronësi apo në përdorim, dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qira të tyre për vitin 2023 kanë qenë të lidhura **138 kontrata/marrëveshje** për dhënien me qira të aseteve që ka në pronësi (ndërtesa, truall, toka bujqësore, qira pyjore). Këto kontrata/marrëveshje janë lidhur bazuar në legjislacionin përkatës me subjekte të ndryshëm fizik/juridik që kanë shprehur interes. Nga auditimi u konstatua se janë gjithsej **14 subjekte** debitore në vlerën **47,796,113 lekë** në marrëdhëniet kontraktore me Bashkinë Korçë, për marrjen me qira të objekteve/sipërfaqeve të ndryshme, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Korçë.

- Për vitin 2024 kanë qenë të lidhura **136 kontrata/marrëveshje** për dhënien me qira të aseteve që ka në pronësi (ndërtesa, truall, toka bujqësore, qira pyjore). Këto kontrata/marrëveshje janë lidhur bazuar në legjislacionin përkatës me subjekte të ndryshëm fizik/juridik që kanë shprehur interes. Nga auditimi u konstatua se janë gjithsej **18 subjekte** debitore në vlerën **40,147,956 lekë** në marrëdhëniet kontraktore me Bashkinë Korçë, për marrjen me qira të objekteve/sipërfaqeve të ndryshme, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Korçë.

Sa më sipër është në kundërshtim me Kodin Civil në Republikën e Shqipërisë, nenet 826-840. Ligjin nr. 139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*", neni 36, etj. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3.4, faqe 65-88, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Drejtoria Juridike në bashkëpunim me Drejtorinë e Pyjeve dhe Kullotave dhe me Drejtorinë e Financës të marrin masa për:

- Ndjekjen e të gjithë hapave ligjorë për arkëtimin e vlerës **40,147,956 lekë** nga 18 subjekte qiramarrëse që nuk kanë paguar detyrimet për objektet/tokën e marrë me qira.
- Në çdo rast të mospagesës së detyrimeve kontraktore të kërkojë prishjen e kontratës ose të mos nënshkruajë kontratën e re për objektet/tokën e lëshuar me qira, si dhe të llogarisë penalitetet, sipas rastit.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se: Drejtoria Juridike ka ndjekur hapat ligjore, duke hapur procese gjyqësore, për arkëtimin e vlerës 40,147,956 lekë nga 18 subjekte qiramarrëse debitore, të cilat nuk kanë përmbushur detyrimet përkatëse të parashikuara në kontratat e qirave, pasi janë në procese gjyqësore.

Statusi: *Në proces zbatimi*

F. <u>Masa disiplinore</u>.

F.1 Për punonjësit në marrëdhënie pune

F.1.1 Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil

Mbështetur në nenin 15 "*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së*", shkronja (c), të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", nenin 58 "*Llojet e masave disiplinore*", të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "*Për nëpunësin civil*" i ndryshuar, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 "*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*", **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Korçë**, që të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

a. "Vërejtje" në zbatim të germës "a" të nenit 58, për 17 punonjës;

1. I.D, me detyrë Drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, në cilësinë e Titullarit të AK;
2. Y.M, me detyrë Drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse, Arsimit dhe Çerdhes në cilësinë e Titullarit të AK;

a. Në cilësinë e Anëtarit/Kryetarit të Njësisë së Prokurimit për hartimin e DST.

1. M.S, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Prokurimeve, në cilësinë e Kryetar i Njësisë së Prokurimit, pasi në 16 raste ka miratuar kritere kualifikuese që nuk lidhen drejtpërdrejt me objektin e prokuruar dhe kanë mangësi në hartimin e fondit limit;
2. B.M, me detyrë Specialist Preventivues në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e Anëtarit të Njësisë së Prokurimit, Specialist i fushës, pasi në 10 raste ka miratuar kritere të veçanta kualifikuese që nuk lidhen drejtpërdrejt me objektin e prokuruar dhe kanë mangësi në hartimin e fondit limit;
3. M.B, me detyrë Inxhiniere Agro Ushqimor, në cilësinë e Anëtarit të Njësisë së Prokurimit, pasi në 16 raste ka miratuar kritere të veçanta kualifikuese që nuk lidhen drejtpërdrejt me objektin e prokuruar, ka bërë ndryshime të paargumentuara teknikisht në preventiva dhe specifikimet teknike, si dhe për mangësi në hartimin e fondit limit;
4. V.T, me detyrë Jurist, në cilësinë e Kryetarit të Njësisë së Prokurimit në Ndërmarrjen e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, pasi në 3 raste ka miratuar kritere kualifikuese që nuk lidhen drejtpërdrejt me objektin e prokuruar dhe për mangësi në hartimin e fondit limit;
5. S.Z, me detyrë Ekonomiste, në cilësinë e Anëtarit të Njësisë së Prokurimit në Ndërmarrjen e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, pasi në 3 raste ka miratuar kritere kualifikuese që nuk lidhen drejtpërdrejt me objektin e prokuruar dhe për mangësi në hartimin e fondit limit;
6. O.D, me detyrë Ekonomiste, Përgjegjës i Sektorit të Mirëmbajtjes në cilësinë e Anëtarit të Njësisë së Prokurimit në Ndërmarrjen e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, pasi në 3 raste ka miratuar kritere kualifikuese që nuk lidhen drejtpërdrejt me objektin e prokuruar dhe për mangësi në hartimin e fondit limit;
7. P.N, me detyrë Përgjegjëse Prokurimesh, në cilësinë e Anëtarit të Njësisë së Prokurimit në

Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike, pasi në 4 raste ka miratuar kritere kualifikuese që nuk lidhen drejtpërdrejt me objektin e prokuruar dhe për mangësi në hartimin e fondit limit.

b. Në cilësinë e kryetarit/anëtarit të KVO, për vlerësimin e procedurave të zhvilluara.

8. B.TH, me detyrë Zëvendëskryetare e Bashkisë Korçë, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit për Vlerësimin e Ofertave në 12 procedura, në të cilat vlerësimi i ofertave dhe i dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë nuk është bërë në përputhje me kuadrin rregullator të prokurimit publik;

9. E.DH, në cilësinë e Anëtarit të Komisionit për Vlerësimin e Ofertave në 4 procedura, në të cilat vlerësimi i ofertave dhe i dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë nuk është bërë në përputhje me kuadrin rregullator të prokurimit publik;

10. A.D, në cilësinë e Anëtarit të Komisionit për Vlerësimin e Ofertave në 6 procedura, në të cilat vlerësimi i ofertave dhe i dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë nuk është bërë në përputhje me kuadrin rregullator të prokurimit publik;

11. E.V, në cilësinë e Anëtarit të Komisionit për Vlerësimin e Ofertave në 1 procedurë, në të cilat vlerësimi i ofertave dhe i dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë nuk është bërë në përputhje me kuadrin rregullator të prokurimit publik;

12. R.H, në cilësinë e Anëtarit të Komisionit për Vlerësimin e Ofertave në 3 procedura, në të cilat vlerësimi i ofertave dhe i dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë nuk është bërë në përputhje me kuadrin rregullator të prokurimit publik;

13. I.M, në cilësinë e Anëtarit të Komisionit për Vlerësimin e Ofertave në 5 procedura, në të cilat vlerësimi i ofertave dhe i dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë nuk është bërë në përputhje me kuadrin rregullator të prokurimit publik;

14. GJ.P, në cilësinë e Anëtarit të Komisionit për Vlerësimin e Ofertave në 4 procedura, në të cilat vlerësimi i ofertave dhe i dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë nuk është bërë në përputhje me kuadrin rregullator të prokurimit publik;

15. P.X, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit për Vlerësimin e Ofertave në 4 procedura të zhvilluara nga Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, në të cilat vlerësimi i ofertave dhe i dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë nuk është bërë në përputhje me kuadrin rregullator të prokurimit publik;

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjekt, rezultoi se:

1. Në lidhje me procedurën për I.D., me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 1353/2 datë 27.11.2025 është ndërprerë ecuria disiplinore.
2. Në lidhje me procedurën për Y.M**.**, me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 1353/3 datë 27.11.2025 është ndërprerë ecuria disiplinore.
3. Në lidhje me procedurën për M.S, ju sqarojmë së nuk është punonjëse pranë Bashkisë Korçë apo institucioneve në varësi.
4. Në lidhje me procedurën e B.M, me vendimin nr. 5 datë 27.11.2025 është marr masa disiplinore "vërejtje".
5. Në lidhje me procedurën për M.B me vendimin nr. 9 datë 27.11.2025 është ndërprere ecuria disiplinore.
6. Në lidhje me procedurën për V.T, ju sqarojmë së nuk është punonjës pranë Bashkisë Korçë apo institucioneve në varësi.
7. Në lidhje me procedurën për S.Z, me urdhrin nr. 94/1 datë 27.11.2025 është ndërprerë ecuria disiplinore.
8. Në lidhje me procedurën për O.D me urdhrin nr. 94/3 datë 27.11.2025 është pezulluar ecuria disiplinore për shkak të lejes së lindjes.
9. Në lidhje me procedurën për P.N me urdhrin nr. 451 datë 15.12.2025 është ndërprerë ecuria disiplinore.

10. Në lidhje me procedurën për B.TH me urdhrin nr. 1353/1 datë 27.11.2025 është ndërprerë ecuria disiplinore.
11. Në lidhje me procedurën për E.L.DH me vendimin nr. 8 datë 27.11.2025 është ndërprerë ecuria disiplinore.
12. Në lidhje me procedurën për A.D, ju sqarojmë së nuk është punonjës pranë Bashkisë Korçë apo institucioneve në varësi.
13. Në lidhje me procedurën për E.V me vendimin nr. 6 datë 27.11.2025 është ndërprerë ecuria disiplinore.
14. Në lidhje me procedurën për R.H, ju sqarojmë së në atë kohë nuk ka qenë punonjëse pranë Bashkisë Korçë apo institucioneve në varësi.
15. Në lidhje me procedurën për I.M me vendimin nr. 10 datë 27.11.2025 është ndërprerë ecuria disiplinore.
16. Në lidhje me procedurën për GJ.P me vendimin nr. 7 datë 27.11.2025 është ndërprerë ecuria disiplinore.
17. Në lidhje me procedurën për P.X me urdhrin nr. 94/2 datë 27.11.2025 është marrë masa disiplinore "vërejtje".

Statusi: *Zbatuar*

Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuara nga ana e Bashkisë Korçë

Masat	Rekomanduar	Rek. Të Zbatuara	Në Proces Zbatimi	Rek. Të Pa Zbatuara	Shprehur ne vlere në 000/lekë		
					Vl. Rekomandim	Vl. Arkëtuar	Vl. Mbetur
Masa Organizative	**37**	16	8	13	77,048	250	76,800
Masa Për Shpërblim Dëmi	**15**	13	2	-	5,198	4,683	515
Masa mungesë të ardhurash	**5**	1	4	-	712,653	22,341	690,312
Masa 3-E							
Masa Disiplinore	**17**	17					
Masa Administrative							
Kompetence e IMTV							
Totali leke	**74**	**48**	**13**	**13**	**794,899**	**27,274**	**767,625**

2.5. Të ndryshme (shqyrtim ankese).

Verifikimit në lidhje me ankesën e paraqitur nga R.T.

- Përmbajtja e ankesës:

R.T, banuese ne Michigan, nëpërmjet postës elektronike të KLSH, ka kërkuar si më poshtë vijon: *"Zyra e Përmbarimit Shtetërorë Korçë i dërgoj urdhër ekzekutimi degës së thesarit për bllokimin dhe ekzekutimin e fondit në llogari të ish-pronarëve, ku jam edhe unë. Zyra e thesarit i dërgoi përgjigje se fondi është bllokuar, por ekzekutimi duhet të bëjë urdhër xhirim bashkia Korçë, që t'ja kalojë përmbarimit. Nuk di të ketë vendim gjykate të formës së prerë për zbatimin e këtij vendimi dhe të ketë urdhër ekzekutimi nga Zyra e Përmbarimit Shtetërorë Korçë".*

***- Kërkesat për dokumentacion*:**

Grupi i auditimit kërkoi sqarim nga Bashkia Korçë (Drejtoria Juridike dhe Financës), duke informuar se:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë me vendim nr. 150 datë 19.01.2010 ka disponuar duke detyruar të paditurin Bashkia Korçë të paguajë në favor të paditësit R.T, M.P, L.A. (si subjekte të shpronësuar) si çmim qiraje të truallit në pronësi, dhënë në përdorim të tretëve prej të paditurit, shumën prej 2,315,400 lekë (6,344 lekë/ditë), shlyerja e detyrimit fillon nga dita që pala e paditur ka ardhur në dijeni të kërkesës së paditësit (datë 28.08.2008), duke vazhduar deri në momentin e

privatizimit të objekteve në pronësi të Bashkisë Korçë. Vendim ka marrë formë të prerë dhe është vendosur në ekzekutim nga pala kreditore.
Bashkia Korçë ka shlyer detyrimin sipas vendimit gjyqësor nr. 150 datë 19.01.2010 dhe ka paguar qiranë ditore R.T. deri me datë 21.10.2016, datë kur Këshilli i Bashkisë Korçë me Vendimin të KB nr. 108 datë 21.10.2016 ka disponuar për privatizimin e pronës të njohur kreditorit.
Në zbatim dhe përmbushje të detyrimeve ligjore referuar VKM nr. 926 datë 29.12.2014 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes" i ndryshuar dhe Udhëzim Nr. 5222, datë 26.6.2015 "Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes" i ndryshuar, me shkresë Nr. 6837 prot datë 28.12.2016 i është kërkuar Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik Turizmit Tregtisë dhe Sipërmarrjes (sot Ministria e Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit) të vijojë me procedurën e privatizimit për objektin ish- Ndërmarrja e Gjelbërimit Korçë, sipas vendimmarrjes të Këshillit të Bashkisë Korçë nr. 108 datë 2.06.2016.
Nga ministria është kërkuar saktësimi i sipërfaqes dhe objekteve që do të privatizohen, kjo e konkluduar me vendimmarrjen e Këshillit Bashkiak nr. 60 datë 25.02.2017 e cila i është përcjellë ministrisë me shkresën nr. 6837/4 prot datë 13.06.2017.
Nga Drejtoria e Shoqërive Publike, Qarku Korçë me shkresë nr. 44 prot datë 15.02.2018, protokolluar në Bashkinë Korçë me nr.759 prot datë 19.02.2018 është kërkuar regjistrimi i objekteve në emër të Bashkisë Korçë. Gjithashtu dhe Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit Drejtoria e Privatizimit ka kërkuar informacion për objektet Kapanon ndërtesë 1 kati dhe kapanon ndërtesë 2 kat te ish- Ndërmarrjes te Gjelbërimit. Nga Bashkia Korçe me shkrese nr. 4760/2 Prot datë 15.05.2026 dhe shkresës nr. 4760/1 Prot datë 15.05.2026 i është bërë më dije si më poshtë vijon:
Në zbatim të VKM-së nr. 28, datë 27.01.2023, "Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve", Bashkia Korçë me shkresën nr. 9376 datë 15.09.2025 ka dërguar dokumentacionin ligjor dhe hartografik pranë Drejtorisë së Pronave Shtetërore, ASHK, Tiranë, për përditësim të pronave transferuar në pronësi të saj, përfshirë këtu dhe pasurinë nr.10/70 zk.8564 (brenda së cilës përfshihet një pjesë e pronës së z.R.T).
Për këtë proces jemi në korrespondenca të vazhdueshme me këtë institucion deri në finalizimin e daljes së VKM-së dhe regjistrimit të këtyre pronave. Theksojmë se institucioni i ngarkuar me ligj për ndjekjen dhe përfundimin e procedurës së privatizimit është Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi dhe konkretisht VKM-së nr.926 datë29.12.2014"Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes" e ndryshuar dhe udhëzimin nr.5222 datë 26.06.2015 "Për zbatimin e vendimit të këshillit të Ministrave nr.926 datë29.12.2014"Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes" i ndryshuar.
Për sa më lart, referuar VKM-së nr. 926 datë29.12.2014, Kreut 1 pika 1 dhe 2, mund të vijohet me procedurën e privatizimit nga Ministria edhe kur pronat janë në administrim ose në pronësi të njësive të qeverisjes vendore.
Nga Bashkia Korçë është iniciuar procesi gjyqësor me objekt "Pavlefshmëri titulli ekzekutiv, vendimi nr. 150 datë 19.01.2010 i Gjykatës të Shkallës së Parë Korçë". Nga Gjykata e Shkallës së Parë Korçë me Vendim Nr. 780 datë 11.11.2022 është vendosur rrëzimi i padisë së Bashkisë Korçë, si i pambështetur në ligj dhe prova. Nga Bashkia Korçë në datë 30.11.2022 është depozituar ankim në Gjykatën e Apelit Korçë. Ankimi i Bashkisë ende nuk është shqyrtuar nga kjo gjykatë.
Nga ana e Zyrës Përmbarimore Korçë është kërkuar zbatimi i titullit ekzekutiv vendimit gjyqësor nr. 150 datë 19.01.2010 duke likuiduar dhe shumën që i korrespondon periudhës 21.10.2016 deri në datë 31.12.2016, në vlerën 450,424 lekë sipas kërkesës së kreditorit R.T.

Bashkia Korçë me urdhër shpenzimi respektive (dokumentacioni b/lidhur RPA), deri korrik 2026 është kryer pagesa me vlerë 17,318,259 lekë. Ndërsa detyrimi për periudhën 01.01.2017 deri me 31.12.2025 mbetet për likuidim për periudhën në vijim vlera 21,403,240 lekë.

-Vlerësimi i grupit të auditimit**.**

Nga përmbajtja e vendimit nr. 150, datë 19.01.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë rezulton se:

- Bashkia Korçë është detyruar të paguajë *çmim qiraje për përdorimin e truallit në pronësi të subjekteve të shpronësuara.*
- Detyrimi është përcaktuar të vazhdojë *"deri në momentin e privatizimit të objekteve në pronësi të Bashkisë Korçë"*.
- Vendimi ka marrë formë të prerë dhe përbën *titull ekzekutiv*.

Fakti që Bashkia Korçë ka ndërmarrë veprime administrative për fillimin e procedurës së privatizimit (*shkresa drejtuar ministrisë, kërkesa për regjistrim pronash, korrespondenca me institucionet etj*.) nuk përbën vetvetiu moment privatizimi dhe nuk sjell ndërprerjen automatike të detyrimit financiar. Privatizimi konsiderohet i realizuar vetëm kur përfundon procedura ligjore dhe ekziston një akt përfundimtar, si:

- *miratimi i procedurës së privatizimit nga organi kompetent;*
- *kryerja e shitjes/kalimit të pronës sipas legjislacionit;*
- *lidhja e kontratës së privatizimit dhe përfundimi i efekteve juridike të saj*.

Pra, nisja e procedurës së privatizimit nuk është e barasvlershme me privatizimin e përfunduar.

Për rrjedhojë, në kushtet aktuale, Bashkia Korçë ka detyrim të vazhdojë likuidimin e shumave të përcaktuara nga titulli ekzekutiv deri në momentin kur privatizimi të realizohet faktikisht.

Sa sipër, moszbatimit në kohë të titullit ekzekutiv me argumentin se "ka nisur procedura e privatizimit", është në kundërshtim me detyrimin për ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë, konkretisht:

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 142 pika 3. *Vendimet gjyqësore duhet të zbatohen nga të gjitha organet shtetërore. Moszbatimi i një vendimi gjyqësor të formës së prerë cenon parimin e sigurisë juridike dhe shtetin e së drejtës.*

Kodi i Procedurës Civile, Neni 510, *Përcakton aktet që përbëjnë titull ekzekutiv, ku përfshihen vendimet gjyqësore të formës së prerë*, Neni 511, *Ekzekutimi i titullit ekzekutiv kryhet vetëm mbi bazën e urdhrit të ekzekutimit,* Neni 560 e vijues. *Rregullojnë mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve nëpërmjet përmbaruesit gjyqësor*. Në rastin konkret, përderisa ekziston urdhër ekzekutimi dhe procedurë përmbarimore, Bashkia nuk mund të pezullojë pagesat në mënyrë të njëanshme.

- *Mos finalizimi i procedurës së privatizimit*

Nga dokumentacioni rezulton një vonesë e konsiderueshme:

- *vendimi i Këshillit Bashkiak për privatizimin është marrë në vitin 2016;*
- *procedura me ministrinë ka vijuar për disa vite;*
- *regjistrimi dhe përditësimi i pronave ende nuk është finalizuar*.

Kjo mund të konsiderohet si mungesë e ushtrimit me efektivitet të kompetencave administrative, pasi vonesa sjell rritjen e detyrimit financiar të Bashkisë ndaj kreditorëve, në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 8. Njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë funksionet e tyre në përputhje me nenin 9 të ligjit nr. 139/2015. Bashkia administron pasuritë e veta në interes publik dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi. Mos menaxhimi në kohë i një procedure që sjell detyrime financiare mund të konsiderohet problem administrimi.

Pra nga sasipër, *R.T duhet të likuidohet deri në momentin e përfundimit real dhe ligjor të privatizimit të objektit, jo thjesht deri në momentin kur Bashkia ka nisur procedurën e privatizimit***,** kjo për faktin se kufiri kohor i detyrimit është përcaktuar nga gjykata; Bashkia nuk mund ta

ndryshojë ose interpretojë ndryshe një vendim gjyqësor të formës së prerë; një procedurë administrative në proces nuk prodhon efektet juridike të privatizimit.
Konkluzioni: Bashkia Korçë, megjithëse ka ndërmarrë veprime administrative për privatizimin e pronës, nuk ka realizuar ende privatizimin faktik dhe juridik të objektit. Për sa kohë që privatizimi nuk është përfunduar, detyrimi financiar ndaj kreditorit R.T vijon sipas vendimit gjyqësor nr. 150, datë 19.01.2010. Inicimi i procedurës së privatizimit nuk përbën shkak ligjor për ndërprerjen e pagesës së qirasë. Bashkia duhet të marrë masa për përshpejtimin e procedurave të privatizimit dhe njëkohësisht të sigurojë zbatimin e plotë të titullit ekzekutiv.
Për sa sipër personat përgjegjës: S.F., *me detyrë Kryetar i Bashkisë*, V.Z., *me detyrë Drejtoreshë e Drejtorisë së Financës, Buxhetit dhe MFK* dhe A.D., *me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.*

IV. REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Bashkinë Korçë, si dhe i strukturës organizative dhe kuadrit të brendshëm rregullator të institucionit, rezultoi se kuadri i brendshëm organizativ dhe etik paraqet nevojë për plotësim dhe harmonizim. Konkretisht, Bashkia Korçë nuk ka hartuar dhe miratuar një Kod Etike institucional si dokument i veçantë, i cili të përcaktojë në mënyrë të unifikuar parimet e integritetit, standardet e sjelljes profesionale, përgjegjësitë individuale të punonjësve, trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit dhe mekanizmat për monitorimin e zbatimit të tyre. Gjithashtu, rezultoi se Rregullorja e Brendshme e organizimit dhe funksionimit të administratës nuk është harmonizuar me strukturën organizative faktike të miratuar për vitin 2025, pasi në të vijon të parashikohet Sektori i Kontrollit Veterinar pranë Drejtorisë së Kontrollit të Territorit, ndërkohë që ky sektor nuk rezulton më pjesë e strukturës organizative të miratuar.
Këto mangësi ndikojnë në qartësinë e kuadrit institucional lidhur me parimet e integritetit dhe etikës, ndarjen e funksioneve dhe përgjegjësive, linjat e raportimit dhe përgjegjshmërinë individuale të punonjësve, duke përbërë dobësi në komponentin "Mjedisi i Kontrollit" të sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.
Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 "*Për rregullat e etikës në administratën publike*", neni 4; Ligjin nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", neni 9, pika 1/1, shkronja "b"; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar, nenet 19 dhe 20, pika 2, shkronja "c", si dhe komponentin "Mjedisi i Kontrollit", lidhur me krijimin e një mjedisi institucional të bazuar në integritet, vlera etike, qartësi organizative dhe ndarje të përcaktuar të përgjegjësive; Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Korçë, miratuar me Vendimin nr. 142, datë 01.03.2021, e ndryshuar, pika 60.1.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1.1, faqet 22-30, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Korçë, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme Juridike dhe Burimeve Njerëzore, të marrë masa për rishikimin, plotësimin dhe harmonizimin e kuadrit të brendshëm institucional, duke:
- hartuar, miratuar dhe vënë në zbatim Kodin e Etikës të Bashkisë Korçë, si dokument të veçantë institucional, ku të përcaktohen qartë parimet e integritetit, standardet e sjelljes profesionale, përgjegjësitë e punonjësve, trajtimi i konfliktit të interesit dhe mekanizmat e monitorimit të zbatimit të tij; dhe
- rishikuar dhe përditësuar Rregulloren e Brendshme të organizimit dhe funksionimit të administratës, me qëllim harmonizimin e saj me strukturën organizative faktike të miratuar, duke reflektuar saktë strukturat, funksionet, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i organizimit dhe funksionimit të Njësisë së Auditit të Brendshëm në Bashkinë Korçë rezultoi se, megjithëse njësia është krijuar në përputhje me kriteret e përcaktuara në VKM nr. 83, datë 03.02.2016 "*Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik*", dhe gjatë vitit 2025 ka hartuar Planin Strategjik dhe Planin Vjetor të Auditimit, ka realizuar auditimet e planifikuara si dhe ka raportuar veprimtarinë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, u konstatuan mangësi që ndikojnë në efektivitetin e funksionit të auditimit të brendshëm dhe në sistemin e kontrollit të brendshëm të institucionit.
Konkretisht, Bashkia Korçë nuk ka ngritur Komitetin e Auditimit, në kundërshtim me nenin 12, pika "b" dhe nenin 14 të Ligjit nr.114/2015, datë 22.10.2015 "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*", duke mos siguruar strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, monitorimin e zbatimit të rekomandimeve dhe mbështetjen e titullarit në forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.
Gjithashtu, nga shqyrtimi i Planit Vjetor të Auditimit rezultoi se planifikimi nuk është bazuar plotësisht në analizën e riskut, pasi nuk janë përfshirë për auditim procese dhe struktura me risk të lartë, si aktiviteti i prokurimeve publike dhe Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit (lejet e ndërtimit/ zhvillimit), në kundërshtim me nenin 13 të Ligjit nr.114/2015, datë 22.10.2015 "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*", pikën 3.1.3 të Manualit të Auditimit të Brendshëm dhe Standardin 2010 "Planning", duke kufizuar mbulimin me auditim të fushave me ekspozimin më të lartë ndaj parregullsive.
Dosjet e auditimit, megjithëse janë organizuar sipas strukturës së Manualit të Auditimit të Brendshëm, nuk arkivohen pranë arkivit të Bashkisë, në kundërshtim me nenin 22 të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për arkivat*" dhe nenin 19 të Normave Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor, duke krijuar risk për ruajtjen, administrimin dhe gjurmueshmërinë e dokumentacionit zyrtar.
Po ashtu, Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka krijuar dosjet e përhershme, në format fizik dhe elektronik, për njësitë e audituesh me, në kundërshtim me pikën 6.3 të Manualit të Auditimit të Brendshëm dhe Standardin 2330 "Dokumentin Informacion", duke ndikuar negativisht në ruajtjen e memories institucionale, planifikimin mbi bazë risku dhe vazhdimësinë e procesit të auditimit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1.2 faqet 30-33, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Korçë, në bashkëpunim me drejtuesin e Njësisë së Auditit të Brendshëm, të marrë masa për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit, sipas kërkesave ligjore; të rishikojë planifikimin strategjik dhe vjetor të auditimit, bazuar në një analizë të dokumentuar të riskut, duke siguruar identifikimin, vlerësimin dhe prioritizimin e fushave dhe proceseve që paraqesin nivel më të lartë risku, me qëllim përfshirjen e tyre në planet e auditimit, si dhe të sigurojë administrimin dhe arkivimin e dosjeve të auditimit sipas rregullave në fuq.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje auditimi: Nga auditimi i procesit të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2025–2027 dhe i zbatimit të buxhetit të Bashkisë Korçë për vitin 2025, u konstatua se, megjithëse Bashkia ka zhvilluar procesin e planifikimit buxhetor dhe ka miratuar dokumentet përfundimtare, në disa etapa të ciklit buxhetor nuk janë respektuar plotësisht kërkesat procedurale dhe afatet ligjore. Konkretisht, Faza I e PBA-së nuk rezultoi të jetë miratuar nga Këshilli Bashkiak përpara dërgimit në Ministrinë e Financave, vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave janë miratuar jashtë procesit të përcaktuar të PBA-së, ndërsa tavanet përgatitore janë miratuar me vonesë.

Gjithashtu, në zbatimin e buxhetit për vitin 2025 rezultoi një nivel i përgjithshëm realizimi prej 79%, ndërsa realizimi i investimeve ishte vetëm 49%, pasi nga vlera 418,005 mijë lekë të planifikuara u realizua vlera 203,290 mijë lekë, duke mbetur pa u realizuar vlera 214,715 mijë lekë. Mosrealizimi lidhet kryesisht me vonesat në procedurat administrative, mosrealizimin e financimeve dhe të ardhurave të parashikuara, shtyrjen e projekteve shumëvjeçare dhe mungesën e përshtatjes në kohë të programit të investimeve me kapacitetet reale financiare të Bashkisë. Këto mangësi kanë ndikuar në cilësinë e planifikimit buxhetor, në përmbushjen e objektivave të programuar dhe në përdorimin efektiv të burimeve publike, në kundërshtim me kërkesat e neneve 4, 27, 28, 36 dhe 46, të Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar**,** nenit 11 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar**,** dhe kërkesave të përcaktuara në Udhëzimin vjetor të Ministrisë së Financave për përgatitjen e PBA-së 2025–2027 dhe kalendarin përkatës të PBA-së**.**
(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 33-46, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Zhvillimit Ekonomik, strukturat programore dhe Grupin e Menaxhimit Strategjik, të marrin masa për forcimin e procesit të planifikimit, programimit dhe monitorimit buxhetor, duke siguruar: (i) respektimin rigoroz të të gjitha fazave, procedurave dhe afateve të ciklit të PBA-së, përfshirë miratimin paraprak nga Këshilli Bashkiak të dokumenteve të kërkuara përpara dërgimit në Ministrinë e Financave; (ii) hartimin dhe miratimin e një kalendari të detajuar të punës për PBA-në, në përputhje me afatet ligjore dhe udhëzimet e Ministrisë së Financave; (iii) integrimin e parashikimeve të të ardhurave, tavaneve buxhetore dhe programeve të shpenzimeve mbi bazën e burimeve reale dhe të disponueshme të financimit; (iv) kryerjen e analizave periodike të realizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe, kur është e nevojshme, rishikimin në kohë të buxhetit; dhe (v) programimin e investimeve vetëm mbi bazën e një vlerësimi real të burimeve të financimit, gatishmërisë teknike dhe administrative të projekteve, si dhe përcaktimin e qartë të fazave dhe burimeve të financimit për projektet shumëvjeçare, me qëllim shmangien e programimit të fondeve që nuk kanë mundësi reale realizimi dhe rritjen e efektivitetit në përdorimin e burimeve publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi vlerësimin e risqeve buxhetore që burojnë nga detyrimet e prapambetura, rezultoi se Bashkia Korçë në fund të vitit 2024 kishte detyrime të prapambetura në vlerën 14,904,085 lekë, ndërsa për likuidimin e tyre në buxhetin e vitit 2025 janë planifikuar vetëm 4,332,709 lekë, ose rreth 29% e stokut të detyrimeve të mbartura, sipas Vendimit të KB nr.19, datë 25.02.2025. Gjatë vitit 2025 janë krijuar detyrime të reja në shumën 61,171,378 lekë, duke e çuar totalin e detyrimeve të administruara në vlerën 76,075,464 lekë (progresiv). Pjesën më të madhe të tyre, në vlerën 40,712,689 lekë ose rreth 66.6% të totalit të detyrimeve të krijuara gjatë vitit.
Në rastin e detyrimit prej 10,571,376 lekë për TVSH-në e projektit "Shfrytëzimi inteligjent i energjisë", Bashkia e ka regjistruar këtë detyrim si detyrim të prapambetur, megjithëse sipas kontratës detyrimi për pagesën e TVSH-së i përkiste Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.
Si pasojë, planifikimi buxhetor nuk ka reflektuar në mënyrë të plotë ekspozimin financiar të Bashkisë ndaj detyrimeve të mundshme, duke rritur riskun e cenimit të balancës fiskale, nevojës për rialokime buxhetore gjatë vitit dhe përdorimit joefektiv të fondeve publike, veprime në kundërshtim me nenin 4, nenin 8, nenin 9 dhe nenin 10 të Ligjit nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", të ndryshuar; nenet 3, 4, 8 dhe 50 të Ligjit nr.9936/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; nenet 16, 18 dhe 19 të Ligjit nr.10296/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 33-46, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Zhvillimit Ekonomik, të marrë masa, që në procesin e hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm dhe të buxhetit vjetor, për:
- identifikimin dhe inventarizimin e të gjitha detyrimet ekzistuese dhe potenciale, përfshirë detyrimet që burojnë nga proceset gjyqësore, shpronësimet, kontratat shumëvjeçare dhe detyrimet e kushtëzuara;
- kryerjen e një analize periodike e risqeve fiskale dhe të dokumentohet ndikimi i tyre në treguesit buxhetorë;
- planifikimin e fondeve të mjaftueshme për përballimin e detyrimeve të njohura dhe të pritshme, duke shmangur nevojën për rialokime të shpeshta gjatë vitit buxhetor;

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pagesave me bankë të shpenzimeve buxhetore, grupi i auditimit kreu me zgjedhje testime për të identifikuar pagesat e kryera për periudhën objekt auditimi me datën e urdhër shpenzimit mbi 30 ditë, nga data e lëshimit të faturës së furnitorit, nga ku rezultuan shkelje të disiplinës buxhetore sa i takon likuidimit të faturave duke tejkaluar afatin ligjor. Konkretisht, janë likuiduar 44 fatura mbi afatin e parashikuar 30 ditor duke shkelur disiplinën buxhetore që dikton kuadri rregullator në fuqi lidhur me ekzekutimin në kohë të detyrimeve financiare.
Këto veprime janë në kundërshtim me Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 *"*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", i ndryshuar, neni 52 dhe në Ligjin nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" neni 7.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 33-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Zhvillimit Ekonomik, të marrë masa për:
- organizimin dhe monitorimin e procesit të administrimit të faturave, me qëllim që dokumentacioni justifikues të paraqitet në strukturën e thesarit dhe pagesat ndaj operatorëve ekonomikë të kryhen brenda afatit 30-ditor;
- vendosjen e mekanizmave të monitorimit periodik të faturave në pritje për pagesë, me qëllim shmangien e vonesave, parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura dhe respektimin e disiplinës financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i detyrimeve financiare që rrjedhin nga vendimet gjyqësore, rezultoi se gjatë vitit 2025 bashkia ka regjistruar 7 vendime gjyqësore me vlerë detyrimi 38,473,043 lekë, *nga e cila*: 6 vendime për dëmshpërblim lidhur me pensionet e invaliditetit me vlerë 38,022,134 lekë, për këto raste është evidentuar dhe tarifa përmbarimore me vlerë 5,020,473 lekë**,** duke e çuar efektin financiar të kësaj kategorie në 43,042,607 lekë, si dhe një vendim për një punonjës të larguar me vlerë 450,909 lekë**.**
Nga shqyrtimi i dokumentacionit për vendimin e fundit nuk rezultoi që titullari të ketë analizuar shkaqet e humbjes së çështjes gjyqësore ose të ketë kërkuar evidentimin e përgjegjësive administrative të personave, veprimet apo mosveprimet e të cilëve mund të kenë ndikuar në krijimin e detyrimit. Mungesa e analizës së dokumentuar pengon identifikimin e shkaqeve të humbjes së procesit dhe marrjen e masave për të ulur rrezikun e detyrimeve të ngjashme në të ardhmen.
Gjithashtu, u konstatua se, megjithëse në fund të vitit 2025 nuk janë raportuar detyrime të prapambetura nga vendimet gjyqësore në raportimet e dërguara Ministrisë së Financave, detyrimet e krijuara nga vendimet gjyqësore përbëjnë një ekspozim financiar të konsiderueshëm për institucionin, duke rënduar buxhetin me pagesa të dëmshpërblimeve dhe tarifave përmbarimore.

Sa sipër në kundërshtim me pikën 60 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe Ligjin nr. 10296/2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", nenet 8, 16, 19 dhe 21.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 33-46, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
6.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të marrë masa për analizimin e vendimit gjyqësor për punonjësin e larguar, duke përcaktuar shkaqet e humbjes së çështjes dhe, nëse konstatohen shkelje, përgjegjësitë administrative përkatëse. Gjithashtu, të ngarkojë strukturat juridike dhe financiare të ndjekin në mënyrë të vazhdueshme vendimet gjyqësore dhe kostot e ekzekutimit të tyre, me qëllim planifikimin në kohë të detyrimeve dhe shmangien e shpenzimeve shtesë për buxhetin e bashkisë. Të bashkëpunojë me Ministrinë e Shëndetësisë për delegimin e fondeve për kryerjen e pagesës së vendimeve gjyqësore në vlerën 43,042,607 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i Formatit nr. 7/a "*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*" të pasqyrave financiare, rezultoi se në mbyllje të vitit ushtrimor 2025, llogaria 211 "*Pyje, kullota, plantacione*" paraqitet në vlerën 110,930,754 lekë. Referuar analizës së regjistrit të aktiveve në këtë llogari janë regjistruar 84 objekte në vlerën totale 20,310,296 lekë, të cilat sipas natyrës së tyre ekonomike nuk i përkasin kësaj llogarie, por duhet të klasifikohen në llogarinë 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore*" (sipas Aneksit 3.3 b/lidhur RPA). Si rezultat, pasqyrat financiare nuk paraqesin në mënyrë të saktë klasifikimin e aktiveve afatgjata materiale, duke ndikuar në informacionin kontabël mbi strukturën e aktiveve, regjistrin e inventarit fizik dhe llogaritjen e amortizimit sipas kategorive përkatëse, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, konkretisht: Kreu II, pika 5; Kreu III, pikat 24 dhe 30; Aneksi nr. 1, Klasa 2 "Aktivet Afatgjata Materiale", ku përcaktohet klasifikimi sipas natyrës ekonomike të aktiveve.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 79-108, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Zhvillimit Ekonomik, të marrë masa për: (i) rishikimin e regjistrit të aktiveve afatgjata materiale; (ii) riklasifikimin kontabël të 84 objekteve me vlerë 20,310,296 lekë nga llogaria 211 "*Pyje, kullota, plantacione*" në llogarinë 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore*", në përputhje me natyrën ekonomike të tyre dhe kërkesat e planit kontabël;

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2026

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se llogaria 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore*"**,** sipas Formatit 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)", në fund të vitit 2025 paraqitet në vlerën 6,230,694,402 lekë**.** Referuar analizës së inventarit kontabël, nuk është kryer çregjistrimi i 10 objekteve të ujësjellës-kanalizimeve me vlerë totale 38,896,711 lekë, të cilat sipas dokumentacionit duhej të ishin transferuar pranë shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Korçë. Për pasojë, këto aktive vijojnë të paraqiten në evidencën kontabël të njësisë, megjithëse nuk administrohen më prej saj.
Mos çregjistrimi i aktiveve të transferuara ka sjellë: mbivlerësimin e llogarisë *213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore"* me 38,896,711 lekë; pasqyrim jo të saktë dhe jo të plotë të aktiveve afatgjata materiale në pasqyrat financiare; pasaktësi në inventarin fizik dhe regjistrat kontabël të aktiveve; ndikim në llogaritjen e amortizimit dhe në besueshmërinë e informacionit financiar, veprime në kundërshtim me Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85; Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, Kreu II, pika 5 **dhe** Kreu III, pikat 24 dhe 30**.**

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 79-108, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Zhvillimit Ekonomik, të marrë masa që:
- çregjistrimin kontabël të 10 objekteve të ujësjellës-kanalizimeve**,** me vlerë 38,896,711 lekë**,** të transferuara pranë shoqërisë Ujësjellës Kanalizime**,** duke reflektuar saktë ndryshimet në regjistrat kontabël dhe në pasqyrat financiare;
- rakordimin periodikisht të regjistrave të aktiveve me dokumentacionin e transferimeve dhe inventarin fizik.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2026

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të Bashkisë Korçë viti 2025, rezultoi se llogaria 466 "*Kreditorë për mjete në ruajtje*" paraqitet me gjendje në vlerën 48,640,843 lekë në fund të vitit 2024 dhe vlerën 49,021,470 lekë në fund të vitit 2025. Kjo llogari përfaqëson garancitë kontraktore (5% e vlerës së kontratës) të mbajtura për investimet e realizuara dhe është raportuar në mënyrë analitike pranë Degës së Thesarit, si dhe është pasqyruar në anekset e bilancit të vitit 2025.
Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se garancitë që i përkasin periudhës 2015–2025, për të cilat periudha e garancisë nuk ka përfunduar, janë në vlerën 19,309,991 lekë. Gjithashtu, nga dokumentacioni i administruar rezultoi se Drejtoria e Financës dhe Zhvillimit Ekonomik, me shkresën nr. 584 prot., datë 20.01.2026, i është drejtuar Drejtorisë së Planifikimit të Zhvillimit të Territorit dhe Kontrollit (DPZHKT), duke kërkuar marrjen e masave për ekzekutimin e procedurave lidhur me garancitë e kontratave, periudha e të cilave ka përfunduar.
Megjithatë, nga auditimi u konstatua se nga DPZHKT nuk janë ndërmarrë veprime për verifikimin e përfundimit të periudhës së garancisë, njoftimin e operatorëve ekonomikë për paraqitjen e dokumentacionit përkatës dhe procedimin për zhbllokimin apo likuidimin e garancive të mbajtura, duke mbajtur të bllokuara fonde në llogarinë 466 edhe pas përfundimit të afateve kontraktore.
Mos administrimi në kohë i garancive kontraktore sjell: mbajtjen të bllokuar të fondeve në llogarinë 466 edhe pas përfundimit të afatit të garancisë; pasqyrim jo plotësisht të azhurnuar të detyrimeve në pasqyrat financiare; rritjen e riskut për evidentimin e detyrimeve të vjetra pa bazë ligjore dhe dobësimin e kontrollit mbi administrimin e garancive kontraktore.
Veprimet në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39 dhe 50; Urdhrin e MF nr. 3, datë 15.02.2011, "*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 79-108, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
9.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtorinë e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, të kryejnë një verifikim të plotë të të gjitha garancive të evidentuara në llogarinë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje", dhe për të cilat nuk ka pasur pretendime lidhur me realizimin e kontratës, të njoftojë operatorët ekonomikë për paraqitjen e dokumentacionit përkatës dhe të procedojë, sipas rastit, me zhbllokimin ose ekzekutimin e garancive, duke sistemuar gjendjen e kësaj llogarie në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe duke siguruar pasqyrim të saktë në pasqyrat financiare.

Deri me datë 31.12.2026

10. Gjetje auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit dhe regjistrit të pronave rezultoi se Bashkia Korçë administron gjithsej 2222 prona**,** nga të cilat 257 prona në përdorim dhe 1965 prona në pronësi**.** Nga pronat në pronësi, 279 prona janë pajisur me certifikatë pronësie, ndërsa 47 prona janë në proces certifikimi**.** Megjithëse 279 prona janë regjistruar ligjërisht në emër të Bashkisë Korçë, ato nuk janë regjistruar në kontabilitet si aktive afatgjata materiale, me argumentin se nuk disponojnë një vlerë financiare të përcaktuar. Njësia nuk ka ndërmarrë procedurat për vlerësimin e këtyre pronave dhe, si pasojë, nuk ka kryer regjistrimin e tyre në pasqyrat financiare, veprime të cilat çojnë në: (i) aktivet afatgjata materiale të Bashkisë të rezultojnë të nënvlerësuara, (ii) pasqyrat financiare që nuk paraqesin në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen reale të pasurisë publike, (iii) cenimin e besueshmërisë, plotësisë dhe saktësisë së raportimit financiar, dhe (iiii) dobësimin e administrimit, monitorimit dhe mbrojtjes së pasurisë publike, veprime në kundërshtim me Udhëzimi e MF nr. 30, datë 27.12.2011, "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar**,** veçanërisht pikat 2, 26, 28, 29 dhe 74**.**
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 79-108, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
10.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Zhvillimit Ekonomik si dhe strukturat përgjegjëse për administrimin e pronave, të marrë masa për:
- përfundimin e procesit të identifikimit dhe vlerësimit të 279 pronave të pajisura me certifikatë pronësie, në përputhje me legjislacionin dhe standardet kontabël në fuqi;
- regjistrimin e tyre në kontabilitet si aktive afatgjata materiale, pas përcaktimit të vlerës së tyre kontabël sipas metodave të parashikuara në legjislacion;
- rakordimin periodik të regjistrit të pronave me regjistrat kontabël;
- ndjekjen e procedurave për përfundimin e certifikimit të 47 pronave të mbetura dhe vijimin e regjistrimit të tyre në kontabilitet pas përfundimit të procesit të regjistrimit dhe vlerësimit.

Deri me datë 31.12.2026

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të inventarizimit të aktiveve në Bashkinë Korçë dhe njësitë vartëse për vitin 2025, u konstatua se;
*1. Bashkia Korçë***.** Procesi i inventarizimit është zhvilluar në përgjithësi në përputhje me kërkesat ligjore, megjithatë u konstatuan mangësi në dokumentimin e aktiveve të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit, pasi për një pjesë të tyre mungon viti i blerjes dhe përshkrimi i plotë në kartelat e aktiveve. Gjithashtu, për një pjesë të aktiveve të asgjësuara nuk administrohet dokumentacion provues mbi mënyrën e realizimit të asgjësimit, duke kufizuar gjurmueshmërinë e procesit.
2. Klubi Shumësportësh "Skënderbeu". Procesi i inventarizimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit paraqet mangësi procedurale dhe dokumentare, pasi evidentohet mospërputhje kronologjike ndërmjet dokumentacionit, mungesë dokumentimi të plotë të verifikimit fizik të aktiveve, mungesë dokumentacioni provues për asgjësimin e materialeve, si dhe mosfinalizim i procedurës së ankandit, shitjes dhe çregjistrimit të materialeve të ricikluesshme.
*3. Qendra e Artit dhe Kulturës***.** Procesi i inventarizimit është iniciuar me ngritjen e komisionit, por nuk është dokumentuar plotësisht verifikimi fizik i aktiveve, krahasimi me evidencat kontabël, evidentimi i diferencave dhe trajtimi i aktiveve të amortizuara ose jashtë përdorimit, veprime në kundërshtim me Ligjin nr.10296/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 16; Udhëzimi i MF nr.30/2011.
*4. Qendra Rezidenciale e Zhvillimit***.** Procesi i inventarizimit nuk ka përfshirë të gjitha kategoritë e aktiveve, nuk janë analizuar diferencat inventariale dhe dokumentacioni për nxjerrjen jashtë përdorimit nuk përmban argumentimin teknik dhe ekonomik të nevojshëm.
*5. Qendra Ditore e Zhvillimit***.** Mungon relacioni përmbledhës i inventarizimit, nuk është mbajtur procesverbali për fiksimin e dokumentacionit hyrës dhe dalës, si dhe nuk është krijuar dhe miratuar regjistri i unifikuar i aktiveve.

*6. Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes***.** Procesi i inventarizimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit paraqet mangësi në rakordimin e dokumentacionit, ndarjen e funksioneve ndërmjet komisioneve, si dhe nuk është finalizuar me procedurat e ankandit, shitjes dhe çregjistrimit të aktiveve.
*7. Ndërmarrja e Shërbimeve Publike***.** Megjithëse janë kryer inventarizimi dhe vlerësimi i aktiveve, procedurat për nxjerrjen jashtë përdorimit nuk janë finalizuar me miratimin administrativ, çregjistrimin kontabël dhe realizimin e procedurave të asgjësimit, riciklimit ose tjetërsimit, duke sjellë pasqyrim jo të saktë të aktiveve në evidencat kontabël.
8. Shtëpia e Foshnjës "Lulet e Vogla". Nga institucioni nuk kishte filluar procesin e inventarizimit të aktiveve dhe detyrimeve për periudhën raportuese, duke mos garantuar verifikimin fizik dhe dokumentar të pasurisë publike dhe pasqyrimin e saktë të saj në evidencat kontabël.
Për sa sipër në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar: neni 8, 9, 10, 11, 16, 19; Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"**,** i ndryshuar, Kreu III (Regjistri i aktiveve, pikat 26–31); Kreu IV (Inventarizimi, dokumentimi, vlerësimi, nxjerrja jashtë përdorimit dhe çregjistrimi, përfshirë pikat 83 dhe 85/c); Ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative"**,** i ndryshuar, nenet 7, 15 dhe 91 dhe Ligjin nr. 9874/2008 "Për Ankandin Publik"**.**
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 79-108, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
11.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Zhvillimit Ekonomik në bashkëpunim me Sektorin e Financës në Njësitë vartëse të saj, të marrin masa për sigurimin e inventarizimit të plotë të aktiveve, hartimin dhe plotësimin e dokumentacionit përkatës, dokumentimin dhe përfundimin e procedurave për nxjerrjen jashtë përdorimit, tjetërsimin, ankandin dhe çregjistrimin kontabël të aktiveve, duke garantuar rakordimin me evidencat kontabël, gjurmueshmërinë e plotë të procesit dhe respektimin e kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore rezultoi se Bashkia Korçë, edhe për vitin 2025, nuk ka realizuar planin e miratuar të të ardhurave, ku nga vlera e planifikuar prej 1,238,189 mijë lekë, janë realizuar 891,101 mijë lekë, ose 72% e planit, duke rezultuar një mosrealizim prej 347,088 mijë lekë. Edhe gjatë vitit 2024 niveli i realizimit ka qenë 61%, me një mosrealizim prej 485,774 mijë lekë. Megjithëse në vitin 2025 evidentohet një përmirësim i nivelit të realizimit me 11 pikë përqindje dhe ulje e diferencës së mosrealizimit me 138,686 mijë lekë, planifikimi vijon të mos mbështetet në analiza të plota të potencialit fiskal, të bazës së tatimpaguesve dhe të trendit historik të arkëtimeve.
Nga analiza sipas kategorive të të ardhurave rezultoi se të ardhurat nga taksat vendore janë realizuar vetëm 52% të planit, me një mosrealizim prej 293,415 mijë lekë, ku ndikimin kryesor e ka dhënë mosrealizimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë (TNI) (*34% e planit*), taksës mbi tokën bujqësore (*44%*), taksës mbi truallin (*53%*) dhe taksës së ndikimit nga legalizimet (*28%*).
Të ardhurat jotatimore janë realizuar në masën 90% të planit, me një mosrealizim prej 50,114 mijë lekë, kryesisht në tarifat e pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit, mirëmbajtjes së varrezave, zënies së hapësirës publike, tarifës vjetore SH.M.RR.&S.K. dhe të ardhurave nga institucionet e varësisë. Ndërkohë, në zërin "Të ardhura të tjera" janë arkëtuar 48,080 mijë lekë si kontribut në fondin publik të banesave sociale, pa qenë kjo shumë e planifikuar në buxhetin e vitit 2025, duke evidentuar mangësi në procesin e planifikimit buxhetor dhe në vlerësimin e burimeve reale të financimit.

Rezultoi se disa zëra të të ardhurave janë realizuar mbi plan, ndërsa të tjerë kanë paraqitur mosrealizim të konsiderueshëm, pa u dokumentuar analiza mbi shkaqet e devijimeve dhe pa u ndërmarrë masa korrigjuese për përmirësimin e planifikimit dhe administrimit të të ardhurave. Diferencat ndërmjet planifikimit dhe realizimit paraqiten me karakter sistematik, duke evidentuar mangësi në identifikimin e bazës së tatimpaguesve, vlerësimin e potencialit fiskal, monitorimin periodik të realizimit të të ardhurave, analizimin në kohë të devijimeve dhe marrjen e masave administrative për rritjen e nivelit të arkëtimit.
Si pasojë, mosrealizimi i planit të të ardhurave ka ndikuar në krijimin e devijimeve ndërmjet planifikimit dhe realizimit të buxhetit, kufizimin e financimit të shpenzimeve dhe investimeve të planifikuara, uljen e besueshmërisë së planifikimit buxhetor dhe projeksioneve financiare, si dhe evidenton dobësi në administrimin dhe monitorimin e burimeve të të ardhurave vendore.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 4 dhe nenin 32 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; nenin 4**,** nenin 28 dhe nenin 29 të Ligjit nr. 68/2017**,** "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar; nenin 35 dhe nenin 64 të Ligjit nr. 139/2015**,** "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; Ligjin nr. 9632/2006**,** "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar; nenin 8, nenin 16 dhe nenin 19 të Ligjit nr**.** 10296/2010**,** "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.5, faqet 46-79, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)
12.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për:
- hartimin e planit të të ardhurave mbi baza reale, duke u mbështetur në analiza të dokumentuara të potencialit fiskal, bazës së tatimpaguesve, ecurisë historike të arkëtimeve dhe faktorëve ekonomikë që ndikojnë në realizimin e të ardhurave;
- kryerjen e analizave periodike mbi realizimin e të ardhurave sipas çdo zëri buxhetor, evidentimin e shkaqeve të devijimeve nga plani dhe marrjen në kohë të masave korrigjuese për përmirësimin e nivelit të arkëtimit;
- forcimin e administrimit fiskal, përditësimin e bazës së tatimpaguesve dhe monitorimin e vazhdueshëm të burimeve të të ardhurave, me qëllim rritjen e eficiencës në administrimin dhe arkëtimin e taksave e tarifave vendore;

Menjëherë dhe ne vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se në Bashkinë Korçë nuk ishte ngritur Komisioni (ose Struktura) e Apelimit Tatimor, strukturë e cila nuk është parashikuar as në Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë. Si pasojë e mos ngritjes së kësaj strukture, ankimet administrative të taksapaguesve ndaj akteve të administrimit të taksave dhe tarifave vendore janë shqyrtuar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe vendimet përkatëse janë miratuar nga Kryetari i Bashkisë. Kjo praktikë nuk garanton një shqyrtim administrativ të pavarur dhe objektiv, pasi ankimi shqyrtohet nga e njëjta strukturë administrative që ka nxjerrë aktin objekt ankimi, duke mos respektuar parimin e paanshmërisë në procedurat administrative. Mos zbatimi i kërkesave ligjore për ngritjen e strukturës së apelimit tatimor dhe mos reflektimi i saj në aktet e brendshme organizative të bashkisë, sjell: mungesë e një mekanizmi administrativ të pavarur për shqyrtimin e ankesave; cenim i të drejtës së taksapaguesve për një shqyrtim administrativ efektiv dhe të paanshëm; rritje e riskut për konflikte gjyqësore dhe pavlefshmëri procedurale të vendimeve administrative; dobësim i kontrollit të brendshëm dhe i transparencës në administrimin e taksave vendore, veprime në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" dhe nenit 7, si edhe nenit 22 pika 5, të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.5, faqet 46-79, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Korçë, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa për ngritjen dhe funksionalizimin e Strukturës (Komisionit) të Apelimit Tatimor, duke ndjekur procedurat për miratimin në Këshillin Bashkiak të rregullave të organizimit, funksionimit dhe shqyrtimit të ankimeve administrative të taksapaguesve. Gjithashtu, të marrë masa për përditësimin e Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë, duke përcaktuar strukturën e apelimit tatimor, kompetencat, përbërjen dhe procedurat e funksionimit të saj, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Brenda 3 muajve

13.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Korçë, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa që, deri në ngritjen dhe funksionalizimin e Strukturës së Apelimit Tatimor, shqyrtimi i ankimeve administrative të taksapaguesve të kryhet nga autoriteti kompetent, në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke shmangur shqyrtimin e ankimeve nga e njëjta drejtori që ka nxjerrë aktin administrativ objekt ankimi, me qëllim garantimin e paanshmërisë dhe shmangien e konfliktit të interesit.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i administrimit të tarifave të parkimit rezident, parkimit me pagesë dhe tarifave për leje transporti rezultoi se strukturat përgjegjëse të Bashkisë Korçë nuk kanë siguruar një sistem të plotë dhe efektiv të planifikimit, kontrollit dhe administrimit të këtyre të ardhurave.

Për *parkimin rezident*, lejet janë lëshuar kryesisht mbi bazën e kërkesave të paraqitura nga banorët, pa u mbështetur në një metodologji të dokumentuar që të marrë në konsideratë nevojat e zonës, kapacitetin e vendeve të parkimit dhe numrin e mjeteve në pronësi të banorëve. Gjithashtu, nuk janë evidentuar kontrolle periodike të dokumentuara, në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, për verifikimin në terren të mjeteve përfituese dhe vlefshmërisë së lejeve.

Për *parkimin me pagesë*, nga 320 vende parkimi të miratuara, me plan të ardhurash 14,000,000 lekë, janë arkëtuar 13,079,250 lekë, duke rezultuar mosrealizim në vlerën 920,750 lekë. Nga verifikimi nuk rezultoi dokumentacion i mjaftueshëm kontrolli dhe rakordimi ndërmjet numrit të mjeteve të parkuara, biletave të përdorura, kohëzgjatjes së parkimit dhe arkëtimeve. Mungojnë, ndër të tjera, akt-rakordimet, evidencat për administrimin e blloqeve të biletave dhe aktet e kontrolleve periodike. Shkaqet e deklaruara për mosrealizimin e të ardhurave nuk janë mbështetur me dokumentacion provues.

Për *tarifat e lejeve të transportit*, gjatë vitit 2025 janë lëshuar 30 certifikata transporti, 1 licencë, 3 certifikata për transport mallrash për të tretë dhe 20 autorizime. Procesi i evidentimit dhe përcaktimit të të ardhurave është mbështetur kryesisht në kërkesat e subjekteve, pa u evidentuar kontrolle të dokumentuara apo shkëmbim sistematik informacioni me DRSHTRR dhe QKB, për verifikimin e mjeteve dhe subjekteve që plotësojnë kushtet për pajisje me leje/autorizim. Kjo krijon risk për mosidentifikimin e të gjithë subjekteve dhe mjeteve që duhet të përfshihen në skemën e pagesës.

Veprime në kundërshtim me Ligji nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar, nenet 8, 54 dhe 64; Ligji nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*", i ndryshuar, nenet 4 dhe 29; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, nenet 15 dhe 16; si dhe vendimi përkatës i Këshillit Bashkiak "Për miratimin e sistemit të parkimit dhe tarifave", lidhur me kriteret, administrimin dhe kontrollin e lejeve të parkimit dhe parkimit me pagesë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.5, faqet 46-79, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për hartimin dhe zbatimin e një procedure të dokumentuar për administrimin e parkimit rezident, parkimit me pagesë dhe lejeve të transportit, e cila të përcaktojë kriteret dhe metodologjinë e

planifikimit të vendeve dhe lejeve të parkimit, mënyrën e verifikimit periodik të përfituesve dhe mjeteve të parkuara, si dhe kontrollet dhe rakordimet ndërmjet vendeve të parkimit, biletave të përdorura dhe arkëtimeve, me qëllim forcimin e kontrollit të brendshëm dhe garantimin e administrimit të plotë e të saktë të të ardhurave nga tarifat e parkimit.

14.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për krijimin e një mekanizmi të dokumentuar bashkëpunimi me Policinë Bashkiake për planifikimin dhe realizimin e kontrolleve periodike në terren, me qëllim verifikimin e respektimit të kushteve të parkimit, evidentimin e parregullsive dhe ndjekjen e masave përkatëse, duke siguruar dokumentimin dhe shkëmbimin e informacionit mbi rezultatet e kontrolleve.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve paraqitur me shkresat respektive me nr. 1348/16 prot, datë 13.10.2025 dhe me nr. 974/8 prot, datë 17.02.2026, rezultoi se statusi i zbatimit të tyre, në mënyrë të përmbledhur, paraqitet si më poshtë:

a- Për rekomandimet e paraqitura me shkresën me nr. 1348/16 prot, datë 13.10.2025, për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar gjithsej 57 masa, të cilat janë pranuar plotësisht (100%) nga subjekti i audituar, si vijon:

*Masa organizative***:** Janë rekomanduar *37 masa*, me vlerë 77,048 mijë lekë. Janë zbatuar 16 masa (me vlerë 250 mijë lekë), 8 masa janë në proces zbatimi, ndërsa 13 masa (me vlerë 76,800 mijë lekë) nuk janë zbatuar**.**

*Masa për shpërblim dëmi***:** Janë rekomanduar *15 masa*, me vlerë 5,198 mijë lekë. Janë zbatuar 13 masa, me vlerë 4,683 mijë lekë, ndërsa 2 masa në proces zbatimi, me vlerë 515 mijë lekë**.**

Masa 3-E dhe masa për mungesë të ardhurash: Janë rekomanduar gjithsej *5 masa*, me vlerë 712,653 mijë lekë. Nga këto, është zbatuar 1 rekomandim, me vlerë 22,341 mijë lekë, ndërsa 4 rekomandime, me vlerë 690,312 mijë lekë, janë në proces zbatimi.

b- Për rekomandimet e paraqitura me shkresën me nr. 974/8 prot, datë 17.02.2026, për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar gjithsej 13 masa, të cilat janë pranuar plotësisht (100%) nga subjekti i audituar, si vijon:

*Masa organizative***:** Janë rekomanduar *13 masa*. Nga këto, janë zbatuar 10 masa, ndërsa 3 masa janë në proces zbatimi**.**

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 108-155, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1. Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrolli të Lartë të Shtetit", për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përshpejtimin e atyre në proces si më poshtë:

I- Masat e rekomanduara me shkresën me nr. 1348/16 prot, datë 13.10.2025.

A. Masa organizative:

3.1. Rekomandimi: Grupi/supervizori i monitorimit dhe mbikëqyrjes së kushteve të kontratës së shërbimit me objekt: "*Kryerja e shërbimit të pastrimit në qytetin e Korçës*", të marrë masa që në vazhdimësi t'i kërkojë sipërmarrësit të shërbimeve K. SHPK, të plotësojë dokumentet për:

- Hartimin e grafikëve të shërbimeve të cilat, të miratohen nga titullari i AK Bashkia Korçë. Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit duhet të përgatiten nga shoqëria e sipërmarrjes së shërbimeve dhe miratohet çdo muaj dhe çdo vit nga AK.

-Përcaktimit e numrit të punëtorëve që do të punojë në çdo operacion punimesh sipas planit të punës si dhe të deklarojë makineritë që do të punojë në çdo operacion punimesh.

- Hartimin e listë prezencës për çdo ditë pune nga shoqëria e shërbimit të kontratës që detyrimisht duhet të ketë çdo ditë/natë në punë, minimalisht numrin e punëtorëve dhe pajisjeve sipas numrit të deklaruar në ofertën e prokurimit për të garantuar kryerjen në kohë dhe me cilësi të shërbimit të pastrimit.

- Shtimin e kontrolleve dhe mbajtjen e procesverbaleve nga supervizori i punimeve për pasqyrimin e saktë të realizimit të zërave të shërbimeve në zbatim të kushteve të kontratës për pastrimin e Bashkisë Korçë.

5.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Korçë, të marrë të gjithë masat që nga komisionet e ngritura për dokumentet e tenderit të argumentohet vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim dhe se këto kritere të jenë në përpjesëtim dhe të lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.
-Kryetari i Bashkisë Korçë, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, të vlerësohen objektivisht kriteret e DT të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE që nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DT, përbën shkelje të procedurave të prokurimit publik dhe risk real për mosrealizimin me sukses të kontratës.

5.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Korçë, të marrë masa në të ardhmen që në komisionet e ngritura për hartimin e fondit limit të vendosen specialistë të fushës të pajisur me licencat përkatëse, duke përdorur eksperiencat më të mira të fushës, me qëllim mirë përdorimin e fondeve publike.

12.1 Rekomandimi: Nga ana e Këshillit Bashkiak, Bashkia Korçë, sipas kompetencave të tij, të merren të gjitha masat për të analizuar situatat në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit që nuk kanë respektuar kondicionet urbane, evidentimin e personave përgjegjës, si dhe marrjen e masave ndaj tyre sipas përcaktimeve ligjore, me qëllim sigurimin e një metodologjie të unifikuar për shqyrtimin e aplikimeve, në përputhje me dokumentet e planifikimit dhe dispozitat ligjore në fuqi.

13.1 Rekomandimi: Nga ana e Këshillit Bashkiak, Bashkia Korçë, sipas kompetencave të tij, të merren të gjitha masat për:
- Të analizuar situatat në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, pa kërkuar / respektuar mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e tyre;
- Të analizuar situatat në lidhje vlefshmërinë e lejeve të miratuar, kur nuk është marrë mendimin pozitiv nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe akt përputhshmërie nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit (për rastet që përfshihen në Vendimin nr. 41, datë 03.12.2020 të Këshillit Kombëtar të Territorit);
- Evidentimin e personave përgjegjës dhe marrjen e masave ndaj tyre sipas përcaktimeve ligjore, me qëllim sigurimin e një metodologjie të unifikuar për shqyrtimin e aplikimeve, në përputhje me dokumentet e planifikimit dhe dispozitat ligjore në fuqi.

15.1. Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtorisë Juridike, Bashkia Korçë, të merren të gjitha masat për të njoftuar zhvilluesin, i cili ka përfituar lejen e ndërtimit të cituara më sipër, në lidhje me detyrimin që ka ndaj fondit publik për strehim social. Nga Bashkia Korçë të ndiqen të gjitha hapat deri në refuzimin e aplikimeve për pajisje me certifikatë përdorimi, nëse zhvilluesi nuk dakordësohet, për hartimin e akt-marrëveshjes, si dhe përcaktimin e sipërfaqeve që do të përfitohen.

16.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Korçë, të marrë masa që lejet e ndërtimit të miratuara të jenë më përputhje me të gjitha kriteret dhe kondicionet urbane, që përfshijnë intensitetin e ndërtimit, koeficientin i shfrytëzimit të territorit, lartësinë e ndërtimit, sipërfaqen e gjelbërimit dhe numrin e parkimeve, të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor.

18.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Korçë, të marrë masa për të verifikuar në sistemin e-Leje paraqitjen e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm, përpara miratimit të certifikatës së përdorimit.

B. <u>Masa shpërblim dëmi.</u>

1.1. Rekomandimi: Drejtorinë e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të marrë masa, për arkëtimin e shumës 383,349 lekë pa TVSh, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit nga BOE N. & N. ShPK, sipas kontratës së lidhur me nr. 8282/3 Prot, datë 14.11.2022 për realizimin e punimeve civile.

4.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për zbritjen nga garancisë e punimeve të vlerës 132,937 lekë përfituar padrejtësisht nga Kontraktori "V." SHPK, për punime të certifikuara, por të pa realizuara.

C. <u>Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficience dhe efektivitet të fondeve publike.</u>

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimeve tatimore për debitorët dhe në vijim të ndjekë të gjitha rrugët ligjore në rend shterues, për arkëtimin e detyrimeve debitore në vlerën 618,328,823 lekë nga subjektet e biznesit dhe taksapaguesit familjarë.

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Korçë të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë dhe nëpërmjet Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 422 debitorë në vlerën 31,604,528 lekë dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen, duke u shoqëruar me një evidentim të saktë edhe në kontabilitet.

3.1. Rekomandimi: Drejtoria Juridike në bashkëpunim me Drejtorinë e Pyjeve dhe Kullotave dhe me Drejtorinë e Financës të marrin masa për:

- Ndjekjen e të gjithë hapave ligjorë për arkëtimin e vlerës 40,147,956 lekë nga 18 subjekte qiramarrëse që nuk kanë paguar detyrimet për objektet/tokën e marrë me qira.
- Në çdo rast të mospagesës së detyrimeve kontraktore të kërkojë prishjen e kontratës ose të mos nënshkruajë kontratën e re për objektet/tokën e lëshuar me qira, si dhe të llogarisë penalitetet, sipas rastit.

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Korçë të analizojë këto procedura dhe të marrë masa për titullarin e Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse për Arsimin dhe Çerdhet, i cili në cilësinë e titullarit të AK dhe në cilësinë e miratuesit të këtyre procedurave, ka vepruar në mospërputhje me kuadrin ligjor në fushën e prokurimeve publike, duke rritur shpenzimet pa efektivitet të buxhetit të Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdheve në shumën 771,228 lekë**.**

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë dhe Drejtorinë Juridike të marrin masa për:

- Ndjekjen e të gjithë hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës 57,917,505 lekë nga 11 qiramarrësit që nuk kanë paguar detyrimet për objektet/tokën e marrë me qira.
- Në çdo rast të mospagesës së detyrimeve kontraktore të kërkojë prishjen e kontratës ose të mos nënshkruajë kontratën e re për objektet/tokën e lëshuar me qira, si dhe të llogarisë penalitetet, sipas rastit.

5.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, të miratojnë lejet e ndërtimit pasi të sigurohen që subjektet i kanë shlyer të gjitha detyrimet e prapambetura në Bashkinë Korçë, si dhe të ndjekin të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës 2,127,093 lekë ndaj 25 subjekteve të pajisur me leje ndërtimi, sipas Aneksit A11, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave e Tarifave Vendore dhe specialistin e buxhetit Bashkia Korçë të marrin masa që të arkëtojnë diferencat e shkaktuara nga përllogaritjet e gabuara për taksën e ndikimit në infrastrukturë për 6 leje ndërtimi në shumën 13,847,443 lekë, përkatësisht si më poshtë:

- vlera 11,914,178 lekë me pronar dhe zhvillues L.L. dhe O.L. për 5 leje ndërtimi.
- vlera 1,933,265 lekë me zhvillues dhe pronar trualli B.K..

7.2. Rekomandimi: Nga Bashkia Korçë të merren masa për të monitoruar destinacionin e përdorimit të objektit "*V. Resort - Kompleks Turistik 3 Kate + 1 Kat Nëntokë (Zona 2)*", miratuar me vendimin nr. 8590/22, datë 09.12.2022, me zhvillues shoqërinë "S." SHPK, në adresën: Fshati Voskopojë, Korçë dhe, nëse ndryshon destinacioni i objekteve të zhvilluar në lejen e ndërtimit, të përllogaritet taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe të likuidohet diferenca e taksës për vlerën 1,525,253 lekë.

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ankesës së R.T, banuese ne Michigan, paraqitur nëpërmjet postës elektronike të KLSH rezultoi se, me Vendimin nr.150, datë 19.01.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, i formës së prerë dhe i vendosur në ekzekutim, Bashkia Korçë është detyruar të paguajë çmimin e qirasë për përdorimin e truallit në pronësi të ish-pronarëve deri në momentin e privatizimit të objektit. Megjithëse Bashkia ka kryer pagesa pjesore dhe ka ndërmarrë veprime administrative për privatizimin e pronës, procedura e privatizimit nuk është finalizuar ende, ndërsa detyrimi financiar vijon të rritet.
Pretendimi se fillimi i procedurës së privatizimit përbën shkak për ndërprerjen e ekzekutimit të vendimit gjyqësor nuk mbështetet në legjislacionin në fuqi, pasi privatizimi konsiderohet i përfunduar vetëm me realizimin e të gjitha efekteve juridike të tij (miratimi, lidhja e kontratës dhe kalimi i pronësisë). Për rrjedhojë, deri në përfundimin faktik dhe juridik të privatizimit, Bashkia Korçë mbetet e detyruar të zbatojë plotësisht titullin ekzekutiv.
Veprimet dhe mosveprimet e konstatuara janë në kundërshtim me nenin 142, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Nenet 510, 511 dhe 560 e vijues të Kodit të Procedurës Civile; Ligjin nr.139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", nenet 8 dhe 9.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 155-158, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
16.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Korçë, nëpërmjet strukturave përgjegjëse juridike, financiare dhe të administrimit të pronës, të marrë masa:
- për zbatimin e plotë dhe pa vonesa të titullit ekzekutiv, duke vijuar likuidimin e detyrimeve ndaj kreditorëve deri në përfundimin faktik dhe juridik të procedurës së privatizimit, në përputhje me vendimin gjyqësor të formës së prerë.
- të ndjekë me prioritet dhe në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për ekonominë dhe institucionet e tjera kompetente finalizimin e procedurës së privatizimit, me qëllim eliminimin e shkakut që gjeneron detyrime të reja financiare ndaj Bashkisë.
- të forcojë mekanizmat e monitorimit dhe raportimit periodik mbi ecurinë e proceseve gjyqësore dhe administrative që krijojnë detyrime financiare për Bashkinë, me qëllim minimizimin e riskut financiar dhe mbrojtjen e interesave të buxhetit vendor.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË ARDHURAT E MUNGUARA

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të administruar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, si dhe nga kryqëzimi i listave të përcjella nga A.SH.K., Drejtoria Vendore Korçë, me pagesat e kryera për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet, rezultoi se në fillim të vitit 2025 janë trashëguar 373 debitorë, me detyrim të papaguar në vlerën 24,407,330 lekë. Gjatë vitit 2025 janë arkëtuar detyrime të periudhave të mëparshme për 84 debitorë, në vlerën 2,999,685 lekë, *ndërkohë që gjatë vitit janë krijuar detyrime të reja për 85 persona, në vlerën 2,953,821 lekë.*
Në fund të vitit 2025 rezultojnë 374 debitorë, me detyrim progresiv në vlerën **24,361,466 lekë**, i cili është pasqyruar në llogarinë 468 "*Debitorë të ndryshëm*".
Gjithashtu, megjithëse gjatë vitit 2025 janë dërguar 326 njoftime dhe kërkesa për pagesë dhe janë nxjerrë 234 urdhra bllokimi, nuk janë marrë të gjitha masat e nevojshme dhe efektive për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura.

Mos ndjekja në mënyrë të plotë dhe efektive e procedurave për mbledhjen e detyrimeve ka sjellë që në fund të vitit 2025 të mbeten të paarkëtuara vlera prej 24,361,466 lekë, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Korçë dhe duke rritur riskun e vështirësimit të arkëtimit të këtyre detyrimeve.
Veprimet e mësipërme duhet të jenë në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, nenet 9, pika 4 dhe 27; VKM nr. 860, datë 10.12.2014, pika 5; si dhe VKB nr. 158, datë 26.11.2024, "Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore dhe kundërvajtjet administrative për vitin 2025".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.5, faqet 46-79, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Korçë, të marrë masa për evidentimin, verifikimin dhe ndjekjen individuale të të gjithë debitorëve të taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet, me qëllim arkëtimin e detyrimeve në vlerën **24,361,466 lekë**.
Për debitorët që nuk kryejnë pagesën vullnetarisht, të vijojë me marrjen e të gjitha masave administrative dhe ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi, duke dokumentuar në mënyrë të plotë çdo veprim të ndërmarrë deri në arkëtimin e detyrimeve.

Deri me datë 31.12.2026

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i administrimit dhe arkëtimit të gjobave për pagesat e vonuara të detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, rezultoi se deri më 31.12.2025, detyrimet e llogaritura për kamatëvonesa/gjoba për pagesë të vonuar arrijnë në vlerën **45,720,154 lekë**. Kjo vlerë përfshin detyrimet e mbartura deri në fund të vitit 2024, shtesat e llogaritura gjatë vitit 2025, si dhe detyrimet e llogaritura për vitin 2025, pas zbritjes së arkëtimeve të realizuara.
Llogaritja e gjobave për pagesë të vonuar ishte kryer mbi bazën e 0.06% të detyrimit të papaguar për çdo ditë vonesë (nëpërmjet sistemit), por jo për një periudhë më të gjatë se 365 ditë**,** në zbatim të nenit 114 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", si dhe përcaktimeve të paketave fiskale vendore. Megjithatë, niveli i detyrimeve të akumuluara për kamatëvonesa mbetet i konsiderueshëm në raport me arkëtimet e realizuara, ç' ka tregon nevojën për forcimin e masave të administrimit, njoftimit dhe ndjekjes së subjekteve debitore, me qëllim arkëtimin në kohë të detyrimeve dhe shmangien e akumulimit të mëtejshëm të kamatëvonesave, veprime në kundërshtim me nenin 114 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", si dhe përcaktimet përkatëse të paketës fiskale të Bashkisë Korçë për vitin 2025, miratuar me VKB nr. 158, datë 26.11.2024.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.5, faqet 46-79, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Korçë, të marrë masa për evidentimin, njoftimin dhe ndjekjen sistematike të debitorëve për detyrimet e papaguara dhe kamatëvonesat përkatëse në vlerën **45,720,154 lekë**, duke zbatuar në mënyrë të plotë procedurat ligjore të mbledhjes së detyrimeve, me qëllim rritjen e nivelit të arkëtimit dhe parandalimin e akumulimit të mëtejshëm të detyrimeve të prapambetura.

Deri me datë 31.12.2026

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për evidentimin dhe arkëtimin e taksës së tokës bujqësore, rezultoi se në fund të vitit 2025 gjendja debitorë ishte në vlerën 95,861,361 lekë, me një rritje prej 13,202,562 lekë krahasuar me vitin 2024. Gjatë vitit 2025 ishin krijuar debitorë për 10,641 familje, ku numri më i lartë rezulton në NJ.A. Bulgarec, ndërsa më i ulëti në NJ.A. Lekas. Pavarësisht njoftimeve të kryera nga strukturat e Bashkisë dhe njësitë administrative, nuk është kryer punë e mjaftueshme për përditësimin e bazës së të dhënave të subjekteve debitore dhe ndjekjen e plotë të procedurave për arkëtimin e detyrimeve. Për një pjesë të debitorëve, problematikat lidhen me lëvizjet demografike, emigracionin dhe mungesën e përditësimit të të dhënave.

Mosndjekja në mënyrë të plotë dhe sistematike e procedurave të arkëtimit ka ndikuar në rritjen e stokut të detyrimeve të prapambetura dhe në mosrealizimin e të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore për vlerën 95,861,361 lekë, veprime në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, veçanërisht nenet 6 dhe 9, pika 1.3, si dhe me Rregulloren e Bashkisë Korçë, miratuar me Urdhrin nr. 142, datë 01.03.2021, pikat 59.2.1 dhe 59.2.11.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.5, faqet 46-79, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
3.1. Rekomandimi: Sektori i Bujqësisë dhe Sektorit për Kontrollin dhe Mbledhjen e të Ardhurave për Njësitë Administrative, të marrë masa për përditësimin dhe verifikimin e bazës së të dhënave të taksapaguesve të tokës bujqësore, duke evidentuar debitorët sipas njësive administrative dhe duke ndjekur në mënyrë sistematike arkëtimin e detyrimeve në vlerën **95,861,361 lekë.**
Për debitorët që nuk shlyejnë detyrimet pas njoftimit, të vijojë zbatimi i procedurave të mbledhjes me forcë, përfshirë vendosjen e masave të sigurimit të detyrimit dhe ndjekjen e procedurave hipotekore, sipas legjislacionit në fuqi, me qëllim uljen e stokut të debitorëve dhe rritjen e të ardhurave nga kjo taksë.

Deri me datë 31.12.2026

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i administrimit të tarifës së parkimit në Bashkinë Korçë u konstatua se, gjatë lidhjes së kontratave për vendparkime të rezervuara, në 5 raste ishte përcaktuar një kohëzgjatje rezervimi prej 6–7 orësh në ditë, në kundërshtim me Vendimin e KB nr. 158, datë 26.11.2024, Kapitulli IV, pika 2. Si rezultat, ishin llogaritur dhe arkëtuar më pak të ardhura në shumën 30,770 lekë.
Gjithashtu, për disa subjekte me aktivitet hotelier (gjithsej 6 subjekte), të cilat ushtrojnë aktivitet të pandërprerë, 24 orë/ditë dhe 365 ditë/vit, vendparkimet e rezervuara ishin administruar me orare të kufizuara. Sipas dokumentacionit të administruar ka rezultuar se nuk ishin kryer kontrolle dhe verifikime periodike mbi përdorimin faktik të tyre. Për subjektet e evidentuara, diferenca ndërmjet detyrimit për rezervim 24-orësh dhe detyrimit të arkëtuar sipas kontratave ishte ne vlerën 1,295,300 lekë.
Për rrjedhojë, moszbatimi i plotë i përcaktimeve të Paketës Fiskale, mungesa e monitorimit periodik të përdorimit faktik të vendparkimeve dhe mosvlerësimi i natyrës së aktivitetit të subjekteve kanë sjellë mosarkëtim të plotë të të ardhurave vendore në shumën totale 1,326,070 lekë *(1,295,300 + 30,770)***,** si dhe risk për trajtim jo të unifikuar të subjekteve dhe humbje të mëtejshme të të ardhurave buxhetore, veprime në kundërshtim me VKB nr. 158, datë 26.11.2024**,** Kapitulli IV, pika 2; me Ligjin nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*"**,** nenet 35 dhe 54.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.5, faqet 46-79, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
4.1. Rekomandimi: Bashkia Korçë, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për rishikimin dhe unifikimin e kontratave për vendparkimet e rezervuara, në përputhje me përcaktimet e Paketës Fiskale, duke siguruar që kohëzgjatja e rezervimit dhe detyrimi përkatës të përcaktohen sipas kushteve faktike të përdorimit dhe natyrës së aktivitetit të subjektit.
Të kryhen verifikime periodike mbi përdorimin faktik të vendparkimeve të rezervuara dhe të merren masa për evidentimin dhe arkëtimin e detyrimeve të papaguara në vlerën 1,326,070 lekë, në mënyrë që të sigurohet administrimi i plotë, efektiv dhe i barabartë i të ardhurave nga kjo tarifë.

Deri me datë 31.12.2026

5. Gjetje auditimi: Nga auditimi i administrimit dhe likuidimit të kontratave të qirasë për pyje-kullota dhe tokë bujqësore rezultoi se Bashkia Korçë kishte lidhur dhe administronte kontrata qiraje për tokë bujqësore dhe pyje-kullota, ndaj të cilave rezultojnë detyrime të papaguara prej disa vitesh.

Për kontratat e tokës bujqësore, rezultojnë 11 kontrata debitore, me detyrim total 39,284,877 lekë, ku për 3 kontrata me vlerë 2,039,679 lekë Bashkia Korçë është detyruar të ndjekë procedura gjyqësore për arkëtimin e detyrimeve dhe prishjen e kontratave, çështje të cilat janë në proces gjykimi.
Veprimet dhe mosveprimet e konstatuara janë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar, neni 9, pika 1.2, shkronja "a", pika 1.3, shkronja "a" dhe pika 1.6, shkronja "a".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.5, faqet 46-79, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Korçë të marrë masa për forcimin e kontrollit dhe monitorimit të kontratave të qirasë për pyje-kullota dhe tokë bujqësore, duke krijuar dhe mbajtur një regjistër të përditësuar të kontratave, detyrimeve dhe pagesave, me evidentimin e afateve të pagesës dhe të masave të ndërmarra ndaj çdo debitori.
Për çdo kontratë debitore, të merren pa vonesë masat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve në vlerën 37,245,198 lekë, dhe kur është rasti, për zgjidhjen e kontratave.

Deri me datë 31.12.2026

6. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi veprimtarinë e Policisë Bashkiake, rezultoi se gjatë vitit 2025 janë vendosur gjithsej 1,951,000 lekë gjoba, nga të cilat 135,000 lekë ndaj subjekteve private dhe 1,816,000 lekë për kundërvajtje rrugore. Sipas analizës së arkëtimeve të paraqitur nga Policia Bashkiake, gjatë vitit 2025 ishin arkëtuar 115,000 lekë nga subjektet private dhe 924,620 lekë nga kundërvajtjet rrugore, ose në total 1,039,620 lekë**.**
Nga të dhënat e Sektorit të Financës rezultoi se detyrimet e kontabilizuara për gjobat e vendosura gjatë vitit 2025 janë në vlerën 1,946,000 lekë, ndërsa detyrimet e mbartura nga viti 2024 janë në vlerën 71,000 lekë, duke rezultuar në një detyrim total prej 2,017,000 lekë.
Krahasuar me të dhënat e Policisë Bashkiake, sipas të cilave vlera e penaliteteve të aplikuara gjatë vitit 2025 është 1,951,000 lekë, konstatohet një **mosrakordim në vlerën 5,000 lekë**.
Në lidhje me arkëtimet e vitit 2025, sipas të dhënave të Sektorit të Financës, për të dy kategoritë e gjobave është likuiduar vlera 973,000 lekë. Nga kjo vlera prej 708,000 lekë rezultoi e parashkruara për shkak të lehtësive ligjore në pagesë, ndërsa detyrimi i mbetur për pagesë paraqitet në vlerën 336,000 lekë**.** Sipas të dhënave të Policisë Bashkiake, gjatë vitit 2025 është likuiduar vlera 1,032,620 lekë, duke rezultuar një diferencë prej 59,620 lekë më shumë krahasuar me vlerën e paraqitur nga Sektori i Financës.
Gjithashtu, nga krahasimi i të dhënave të Akt-Rakordimit të mbajtur ndërmjet Drejtorisë së Financës dhe Degës së Thesarit, datë 31.12.2025, me të dhënat e likuidimeve të paraqitura nga Sektori i Financës, u konstatua një tjetër mospërputhje. Konkretisht, derdhjet për gjobat e Policisë Bashkiake me kod 7115420 paraqiten në vlerën 604,400 lekë**,** ndërkohë që Sektori i Financës paraqet likuidime në vlerën 973,000 lekë, duke rezultuar një diferencë prej 368,600 lekë, për të cilën nuk është dhënë argumentimi dhe dokumentacioni përkatës.
Sa më sipër, konstatohet se të dhënat e administruara dhe të raportuara nga Policia Bashkiake dhe Sektori i Financës nuk janë të rakorduara, si në lidhje me vlerën e gjobave të vendosura, ashtu edhe me vlerat e arkëtuara dhe të derdhura në Thesar. Mospërputhjet e konstatuara nuk janë shoqëruar me dokumentacion apo shpjegime të mjaftueshme për justifikimin e tyre, duke cenuar saktësinë dhe besueshmërinë e të dhënave financiare dhe të informacionit të raportuar.
Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, neni 8 dhe 9; Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.5, faqet 46-79, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Zhvillimit Ekonomik, në bashkëpunim me Policinë

Bashkiake, të marrë masa për kryerjen e rakordimit të plotë të të dhënave lidhur me gjobat e vendosura, të kontabilizuara, të arkëtuara dhe të derdhura në Thesar, për vitin 2025 dhe detyrimet e mbartura nga vitet e mëparshme, si dhe për hartimin dhe zbatimin e një procedure të dokumentuar për rakordimin periodik ndërmjet strukturave përkatëse dhe Degës së Thesarit.
6.2. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Zhvillimit Ekonomik, në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të marrë masa për verifikimin dhe dokumentimin e diferencave të konstatuara gjatë auditimit, përkatësisht në vlerat 5,000 lekë, 59,620 lekë dhe 368,600 lekë, duke identifikuar dhe analizuar shkaqet e krijimit të tyre.
Në varësi të rezultateve të verifikimit, të kryhen korrigjimet dhe sistemimet përkatëse në evidencat kontabël dhe financiare, kur rezultojnë të nevojshme dhe të mbështetura në dokumentacionin përkatës, me qëllim sigurimin e pasqyrimit të saktë të detyrimeve dhe të ardhurave nga gjobat.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se Bashkia Korçë nuk ka siguruar një administrim efektiv të mbledhjes së detyrimeve tatimore të prapambetura, duke bërë që borxhi tatimor progresiv të vijojë të rritet nga vlera 632,853,801 lekë në fund të vitit 2024 në vlerën 668,442,106 lekë në fund të vitit 2025, **me një rritje prej 35,588,305 lekë**. Nga kjo vlerë, vlera prej 324,836,496 lekë i përkasin detyrimeve të bizneseve, ku vlera 104,904,555 lekë janë detyrime të 772 subjekteve me status pasiv, të pezulluar ose në proces çregjistrimi dhe vlera 343,605,610 lekë i përkasin detyrimeve të familjarëve.
Auditimi evidentoi se, megjithëse Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore (DTTV) ka ndërmarrë masa si dërgimi i njoftimeve për pagesë, bllokimi i llogarive bankare dhe në raste të kufizuara vendosja e barrëve hipotekore, këto masa nuk kanë rezultuar të mjaftueshme për të garantuar arkëtimin e detyrimeve dhe uljen e stokut të borxhit. Gjithashtu u konstatua se një pjesë e konsiderueshme e borxhit i përket detyrimeve me moshë mbi 5 dhe mbi 10 vjet, të cilat përbëjnë rreth **68.8%** të totalit të borxhit të bizneseve. Nuk janë zbatuar në mënyrë të plotë të gjitha masat shtrënguese të parashikuara nga legjislacioni tatimor, veçanërisht vendosja e barrës siguruese dhe sekuestrimi mbi pasuritë e debitorëve, për shkak të mungesës së koordinimit institucional dhe mosdisponimit të informacionit të plotë mbi pasuritë, veprimet në kundërshtim me nenet 89, 90, 91 dhe 93 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar; nenin 34 dhe nenin 54 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore*", i ndryshuar; nenet 8, 9, 15 dhe 64 të Ligjit nr. 139/2015, "*Për Vetëqeverisjen Vendore*", dhe VKB nr. 158, datë 26.11.2024, "*Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore dhe kundërvajtjet administrative për vitin 2025*".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.5, faqet 46-79, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
7.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Korçë, nëpërmjet Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për:
- hartimin dhe zbatimin e një plani konkret veprimi për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura, të bazuar në analizën e riskut, moshën e borxhit dhe aftësinë paguese të debitorëve.
- zbatimin në mënyrë të plotë dhe në kohë të të gjitha masave administrative dhe shtrënguese të parashikuara, përfshirë bllokimin e llogarive bankare, vendosjen e barrës siguruese dhe hipotekore, sekuestrimin e pasurive dhe ndjekjen e procedurave të ekzekutimit për debitorët në vlerën **668,442,106 lekë**.
- kryerjen e një analize të plotë të portofolit të debitorëve me status pasiv, të pezulluar ose të çregjistruar, me qëllim ndjekjen e procedurave ligjore për arkëtimin ose sistemimin e detyrimeve sipas legjislacionit në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 15, shkronja "c", të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", nenin 58 "Llojet e masave disiplinore" të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "*Për Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, si dhe VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 "*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen dhe vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*", **i rekomandoj Kryetarit të Bashkisë Korçë** që, për shkeljet dhe përgjegjësitë e evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, t'i kërkojë Komisionit Disiplinor të institucionit të shqyrtojë rastet e punonjësve përgjegjës dhe, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, të vlerësojë fillimin e procedurave disiplinore.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT